



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



RAPORTI I PERFORMANCËS 2022

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
1.	MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT	
2.	AKTIVITETI AUDITUES	3
2.1	Aktiviteti i KLSH-Së përmes shifrave 2022	3
2.2	KLSH dhe Menaxhimi i Financave Publike	6
2.3	Rezultatet e auditimit	17
2.3.1	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	17
2.3.2	Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore	28
2.3.3	Departamenti i Auditimit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Aseteve	39
2.3.4	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja	44
2.3.5	Departamenti i Auditimit të Performancës	55
2.3.6	Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit	81
2.3.7	Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme	87
3.	KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESIT	91
3.1	Objektivat e Strategjisë së Komunikimit	91
3.2	Bashkëpunimi ndërinstitucional	91
3.3	KLSH dhe Parlamenti	100
3.4	KLSH dhe Media	105
3.5	Programi i Transparencës	106
4.	MENAXHIMI INSTITUCIONAL DHE ZHVILLIMI STRATEGJIK	107
4.1	Performanca bazuar në Kornizën e Indikatorëve të Matjes së Performancës	107
4.2	Implementimi i Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2018-2022	112
4.3	Strategjia e Zhvillimit Institucional 2023-2027	116
5.	ZHVILLIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	119
6.	VLERËSIME NGA BE DHE INTOSAI	127
7.	TREGUESIT BUXHETOR DHE FINANCIAR	131
8.	ANEKSE	137

Mesazhi i Kryetarit

Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko- financiar, në përputhje me mandatin ligjor dhe objektivat strategjikë institucional, paraqet Raportin Vjetor të Performancës, i cili përmbledh veprimtarinë e institucionit për vitin 2022.

Ky vit shënoi vitin e fundit të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2018-2022. Bazuar në rezultatet e monitorimit periodik mbi realizimin e objektivave të kësaj strategjie dhe progresin institucional, ky raport ndër të tjera përmbledh edhe disa nga arritjet kryesore të viteve të fundit, të cilat shërbyen si bazë për hartimin e objektivave të reja për vitet e ardhshme.



Në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023-2027 kemi vendosur si synim, rritjen e cilësisë së punës audituese dhe mbulimit me auditim të fushave me ndjeshmëri publike, orientuar dhe nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030, në funksion të misionit për nxitjen e përdorimit sa më efektiv dhe eficient të fondeve publike, forcimit të llogaridhënies dhe rritjes së integritetit të administratës publike, me qëllim rritjen e besimit të qytetarëve dhe mirëqenien e tyre.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, KLSH jep informacion për menaxhimin financiar dhe kontrollin, cilësinë e zbatimit të buxhetit të shtetit dhe administrimit të pronës publike, nga institucionet e audituara në të gjitha nivelet e qeverisjes, bazuar kjo në fakte dhe evidenca. Në të njëjtën kohë, në funksion të parandalimit të parregullsisve dhe shkeljeve të konstatuara, KLSH ka dhënë rekomandimet përkatëse në drejtim të përmirësimit të treguesve fiskal, të ekonomisë në tërësi dhe mbështetjen e sistemit social dhe atij të kujdesit shëndetësor në veçanti. Për periudhën janar - dhjetor 2022, KLSH e ka realizuar këtë mision nëpërmjet 177 auditimeve të kryera dhe të evaduar në 205 subjekte.

Në përputhje me mandatin ligjor dhe objektivat strategjikë, gjatë vitit 2022, KLSH ka zhvilluar auditime financiare, të përputhshmërisë, auditime performance dhe auditime të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit. KLSH ka kryer auditime tematike për çështje të veçanta me interes publik, të bëra prezent nga qytetarët dhe palë të ndryshme interesi, si dhe auditime mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, për të cilat ka raportuar periodikisht në Kuvend.

Duke vlerësuar vendimmarrjet e Qeverisë dhe Kuvendit për përmirësimin e treguesve fiskal, ekonomik dhe përmirësimin e politikave në ndihmë të qytetarëve, nga rezultatet e auditimeve, gjatë viti 2022, kemi evidentuar raste të përdorimit të fondeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet në fushën e prokurimit publik, shkelje të disiplinës buxhetore në programimin dhe realizimin e shpenzimeve publike me pasojë krijimin e detyrimeve të

prapambetura, parregullsi dhe shkelje në administrimin e të ardhurave tatimore si dhe në keqadministrimin e pronës publike dhe mjedisit.

Sa më sipër, është e nevojshme nga ana e enteve publike të vlerësohet kuadri ligjor dhe efektiviteti i tij në zgjidhjen e problemeve të konstatuara si dhe ndërhyrjet e qeverisë duhet të orientohen dhe hartohen bazuar në raportin kosto-përfitim për çdo projekt me financim të buxhetit të shtetit, duke e bërë vendimmarrjen më dinamike dhe efektive.

KLSH, gjatë vitit 2022, ka vijuar me procesin e vetëvlerësimit nëpërmjet Kornizës së Matjes së Performancës, mjet ky i zhvilluar nga Grupi i Punës së INTOSAI-t. Në këtë proces KLSH u asistua nga ekspertë të Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t dhe të SAI-t i Norvegjisë, si dhe u vlerësua nga një ekspert ndërkombëtar krejtësisht i pavarur nga procesi, çfarë e bën këtë vlerësim edhe më objektiv. Në përfundim të këtij procesi të gjatë vlerësues, të nisur në vitin 2021, i cili përfshiu të gjitha nivelet drejtuese dhe audituese të KLSH, u finalizua me raportin përfundimtar të vetëvlerësimit dhe opinionin e pavarur të ekspertit me një vlerësim shumë pozitiv. Ky raport synon të luajë një rol të rëndësishëm në përpjekjet e KLSH drejt përmirësimit të metodologjive të auditimit, qeverisjes së brendshme dhe etikës, zhvillimit të kapaciteteve, si dhe rritjes së bashkëpunimit me Kuvendin dhe palët e interesit.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, viti 2022, shënon finalizimin e 2 marrëveshjeve bilaterale me SAI-n e Norvegjisë dhe atë të Maqedonisë së Veriut, me theks në fushën e auditimit të performancës ,mjedisit dhe teknologjisë së informacionit.

KLSH ka vijuar pjesëmarrjen aktive në grupet e punës së EUROSAI-it dhe INTOSAI-it, veçanërisht duke u angazhuar në auditime paralele në fusha të ndryshme si: mjedisi apo menaxhimi i fondeve lokale gjatë pandemisë. Kjo në funksion të rritjes së kapaciteteve audituese dhe përfutimit të praktikave më të mira.

Në vitin 2022, në vijim të procesit të integritetit është përmbyllur me sukses raportimi në Komisionin Evropian, në kuadër të Kapitullin 32 “Kontrolli Financiar”, nën komponenti “Auditimi i Jashtëm”, ku KLSH prezantoi një kuadër të plotë të organizimit, funksionimit dhe arritjeve si një institucion modern auditimi, në përputhje me standardet dhe kërkesat e këtij nënkomponenti.

Të nderuar lexues,

KLSH, gjatë 2022 ka përmbushur përgjegjësitë e veta kushtetuese, ligjore dhe misionin institucional, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare të auditimit, me qëllim forcimin e përgjegjshmërisë, rritjen e transparencës dhe parandalimin e rasteve të keqpërdorimit të fondeve publik, duke rritur në vazhdimësi profesionalizmin dhe ruajtur integritetin, paanshmërinë si vlera themelore të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Arben SHEHU

1. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

Vizioni

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.

Misioni

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion kushtetues i pavarur, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin, informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.


Objektivat

Përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022, objektivat e KLSH edhe për vitin 2022 ishin:


- Rritja e impaktit të punës audituese me fokus në 6 E-të (ekonomicitetin, eficiencën, efektivitetin, etikën, mjedisin dhe energjinë);
- Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse;
- Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit.

Në linjë me INTOSAI P-12 “Vlerat dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit - Një ndryshim në jetën e qytetarëve”, KLSH ka adoptuar parimet që përcaktojnë mënyrën se si institucioni duhet të përmbushë mandatin për të forcuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësisë të sektorit publik, duke ruajtur vlerat që lidhen me: Forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të qeverisë në njësitë e sektorit publik; demonstrimin e rëndësisë dhe konsideratës së duhur ndaj qytetarëve, Parlamentit dhe grupeve të tjera të interesit; dhe shndërrimin në një organizatë model, duke udhëhequr nëpërmjet shembullit.

PLANIFIKIMI STRATEGJIK - AUDITIM



AKTIVITETI I KLSH-SË PËRMES SHIFRAVE 2022






SIGMA: PERCEPTIMI I PUBLIKUT, NDIKIMI DHE RËNDËSIA E KLSH

Subjektet e audituara



Palët e jashtme të interesit




2. AKTIVITETI AUDITUES

2.1 AKTIVITETI 2022, përmes numrave

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e institucionit më të lartë të auditimit të jashtëm publik, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për periudhën janar - dhjetor 2022, ka realizuar veprimtarinë audituese duke kryer dhe evaduar 177 misione auditimi në 205 subjekte auditimi. Në përputhje me mandatin ligjor dhe objektivave strategjike institucionale, gjatë vitit 2022, KLSH ka zhvilluar auditime financiare, auditime të përputhshmërisë, auditime performance, auditime të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit, dhe auditime të kombinuara. Gjithashtu, KLSH, krahas përmbushjes së detyrimit ligjor për auditimin dhe raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, ka kryer dhe disa auditime tematike për çështje të veçanta me interes publik, të bëra prezent nga palë të ndryshme interesi. I detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti i KLSH paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela nr. 1: Auditime sipas llojit



Burimi: KLSH

Në përfundim të misioneve të auditimit, bazuar në evidencën e auditimit dhe gjykimin profesional të audituesit, në 138¹ prej tyre është konkluduar me dhënien e Opinionit të Auditimit mbi pasqyrat financiare të subjektit të audituar dhe mbi përputhshmërinë e aktivitetit². Bazuar në Manualin e auditimeve të aplikuara në KLSH, dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, bazuar në vlerësimin material dhe cilësor të gjetjeve të auditimit, janë dhënë opinione të pamodifikuara dhe të modifikuara. Shpërndarja e misioneve të auditimit të kryera gjatë vitit 2022, sipas cilësisë së Opinionit të Auditimit, paraqitet në tabelën në vijim:

¹ Në auditimet e performancës, auditimet IT dhe auditimet tematike konkludohet me mesazhin e auditimit.

² Bazuar në Manualin e Auditimit Financiar dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë

Tabela nr. 2 Auditimet sipas llojit të Opinione/Mesazhit/Konkluzionit

Auditime me opinon (1)	Nr.Auditimeve	Opinione auditimi
Auditime financiare	35	35
Auditime përputhshmërie	43	44 ³
Auditime të kombinuara	60	119 ⁴
Total auditime me opinione	138	198
Auditime me mesazh/konkluzion	Nr.Auditimeve	Mesazhe/konkluzione
Auditime përputhshmërie	2	2
Auditime IT	5	5
Auditime të Performancës	16	16
Auditime Tematike	16	14
Total auditime me mesazh/konkluzion	39	37
TOTALI auditimeve	177	

Burimi: KLSH

Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit

Gjatë vitit 2022, auditimet janë zhvilluar në 205 subjekte. Ato kanë përfshirë institucione të qeverisjes qendrore: ministri dhe agjenci përfshirë: drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre⁵; njësi të vetëqeverisjes vendore: qarqe dhe bashki; institucione që administrojnë fonde speciale: ISSH dhe FSDKSH, institucione të pavarura; shoqëri aksionare me kapital shtetëror në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj. Në vijim është paraqitur shpërndarja e auditimeve të kryera sipas nivelit të qeverisjes (detajuar në nivel institucioni paraqitet në Aneksin A.6)

Tabela nr. 3: Subjektet e audituara sipas nivelit të qeverisjes

Auditimet e KLSH-së janë ushtruar në:	Numër
Institucione të qeverisjes qendrore dhe të vartësisë	37
Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	61
Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	26
Institucionet e administrimit të asetëve dhe mbrojtjes së mjedisit	17
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	9
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e performancës	55
Totali i subjekteve të audituara	205

³ Në auditimin e ushtruar në "Institutin e Integritit të ish të Përndjekurve Politik" dhe në "Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit", është konkluduar në 2 opinione përputhshmërie për 2 subjektet e përfshira në auditim.

⁴ 59 opinione mbi pasqyrat financiare dhe 60 opinione përputhshmërie

⁵ Drejtori të administrimit fiskal dhe doganor.

Rezultatet e auditimeve

Objektivat e misioneve audituese të vitit 2022 janë fokusuar në identifikimin e shkeljeve, mangësive në sistemet e kontrollit në aktivitetin e subjekteve nën auditim me pasoja në buxhetin e shtetit dhe pronën publike, si dhe raportimin e tyre në bazë të klasifikimit si: dëm ekonomik⁶ dhe si parregullsi/paligjshmëri me efekte negative financiare në financat publike⁷, për të cilat janë dhënë respektivisht edhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës. Nga rezultatet e auditimeve, gjatë viti 2022, gjetjet e konstatuara i referohen:

- Përdorimit të fondeve jo me efeciencë, efektivitet dhe ekonomikitet në fushën e prokurimit publik për shkak të mungesës së kontrollit në realizimin e këtyre procedurave, të cilat në shumë raste rezultojnë të kryera jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- Shkelje të disiplinës buxhetore në programimin dhe realizimin e shpenzimeve publike, likuidimin e faturave për shpenzime apo investime, me pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura;
- Parregullsitë dhe shkeljet në administrimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore;
- Keqadministrimin e pronës shtetërore.

Tabela nr. 4: Analiza e dëmit ekonomik/efekteve negative në buxhet, sipas fushave (në mijë lekë)

A. Në fushën e të ardhura	Dëm ekonomik	Efekte Negative për shkak të Parregullsive
Në fushën e zbatimit të legjislacionit tatimor në Qeverisjen Lokale	77,657	10,432,797
Në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore	423,928	17,873,307
Në administrimin urban	-	2,165,390
Të tjera	281,072	600,383
Totali	782,657	31,071,877
B. Në fushën e shpenzimeve		
Në fushën e pagave, sigurime dhe shpërblime	25,965	357,849
Në fushën e shpenzimeve operative	31,429	3,118,557
Në shpenzimet për investime	664,096	12,070,705
Të tjera (shkelje në disiplinën buxhetore)	4,592	41,894,866
Totali	726,082	57,441,977
Totali (A+B)	1,508,739	88,513,854

Burimi: KLSH

⁶ Dëmi ekonomik referohet detyrimit të shpërblimit monetar të një individi ose subjekti që i shkaktohet entit shtetëror të audituar në lidhje me veprime ose mosveprime në cenim të disiplinës financiare dhe kuadrin rregullator përkatës.

⁷ Efekti negative në performancën e subjekteve nën auditim i referohet efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimit me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Tabela nr. 5: Mangësi në aktivitetin kontrollues me ndikim negativ në të ardhurat tatimore dhe doganore


Në mijë lekë

Efekte negative në të ardhura	Detyrime tatimore, të vlerësuara	Penalitete të vlerësuara	Vlera totale
Nga aktiviteti tatimor	78,447,741	27,536,646	105,984,387
Nga aktiviteti doganor	1,503,790	-	1,503,790
Total	79,951,531	27,536,646	107,488,177

Mbi rekomandimet e dhëna sipas natyrës

Në institucionet e audituara gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, KLSH ka adresuar gjithsej 5,420 rekomandime, nga të cilat: 52 propozime për përmirësime ligjore; 3,283 masa organizative; 1,047 masa disiplinore dhe administrative, 352 masa për shpërblim dëmi dhe 686 masa për efekte negative në buxhet.

Grafik nr. 1: Masat e rekomanduara nga KLSH-ja sipas llojit, viti 2022



Burimi: KLSH

KLSH, në aktivitetin auditues të vitit 2022, ka pasur në fokus evidentimin dhe raportimin e dobësive të sistemit, mungesës së kontrollit të brendshëm, përgjegjësisë menaxheriale, si një element i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Në këtë kuadër, KLSH ka referuar në organet kompetente 4 kallëzime penale, pranë Prokurorive të rretheve gjyqësore për 16 zyrtarë të niveleve të ndryshme. Gjithashtu, në 7 vendime të Kryetarit të KLSH-së, është kërkuar trajtimi tekniko-juridik i gjetjeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për vlerësim të elementëve penalë dhe referim pranë organit të prokurorisë, raste këto të cilat më pas i janë dërguar Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, referuar dhe kërkesës së këtij organi.

2.2 KLSH DHE MENAXHIMI I FINANCEVE PUBLIKE

Përcaktuar në dokumentin “Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022”, gjetjet dhe rekomandimet e KLSH në fushën e menaxhimit të financave publike do të shërbejnë si udhërrëfyes për rritjen e përpjekjeve për të përmirësuar shkallën e zbatimit të tyre, në funksion të mbështetjes së një ekonomie më të zhvilluar dhe shërbimeve më të mira për qytetarët; duke rritur përgjegjshmërinë, transparencën, eficiencën dhe disiplinën fiskale në planifikimin dhe shpenzimin e fondeve publike. Menaxhimi i financave publike është i lidhur ngushtë me ndërtimin e një sistemi financiar që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik të vendit, sistem ky që do të garantonte qëndrueshmërinë afatgjatë të rritjes ekonomike.

Në linjë me përmbushjen e detyrimit kushtetues por edhe të misionit dhe objektivave strategjike të zhvillimit institucional, aktiviteti i auditimit të KLSH, edhe gjatë vitit 2022 ka ndjekur një qasje të auditimit me bazë rrisht për identifikimin e tyre si dhe të kriterëve të vlerësimit të efektshmërisë të sistemeve të kontrollit financiar dhe përputhshmërisë ligjore të parashikuar për menaxhimin e financave publike. Në këtë kuadër, në tetor 2022, KLSH ka paraqitur në Kuvend raportin “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit 2021”, në të cilin janë identifikuar problematikat, mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në menaxhimin e financave publike duke mbuluar proceset e hartimit, ekzekutimit dhe raportimit të treguesve të konsoliduar fiskal përfshirë borxhin publik dhe përdorimin e fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Në konkluzionet e auditimit, KLSH ka sjellë në vëmendje risqet e identifikuar për mirëadministrimin e financave publike dhe zbatimin e kontrolleve të parashikuara të disiplinës fiskale, ndërsa nëpërmjet rekomandimeve të lëna, KLSH ka kërkuar adresimin e menjëhershëm të problematikave të identifikuar në funksion të mirëadministrimit të financave publike dhe monitorimit të kujdesshëm të treguesve fiskal dhe makro-ekonomik.

Problematika, mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në cdo nivel qeverisjeje të audituar paraqiten në vijim.

1. Në auditimet e institucioneve qendrore, rezultuan parregullsi:

Në lidhje me çështjet të cilat kanë kualifikuar opinionet mbi pasqyrat financiare vecojmë: pasqyrimin jo të drejtë të gjendjes së aktiveve, kapitalizim jo të saktë të vlerave të studim projekteve; njohje e detyrimeve në momentin e likuidimit dhe jo në momentin e konstatimit; Shpenzime për vendimet gjyqësore të formës së prerë, të panjohura në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara me pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura; procese inventarizimit të pa finalizuara; etj.

Gjatë procesit të zbatimit të buxhetit u evidentuan raste të: planifikimit të dobët buxhetor, me pasojë rishikimin dhe ndryshimin e vazhdueshëm të tij nga plani fillestar i miratur; mungesës së monitorimit të zbatimit të buxhetit nëpërmjet raporteve periodike sipas parashikimeve ligjore, duke nisur që nga faza e përgatitjes dhe dorëzimit të kërkesave për

programin buxhetor afatmesëm; mos implementimit të fazave të PBA-së përmes sistemit AFMIS; mungesës së fondeve për investime prioritare si psh.në qendrën rezidenciale, e cila rrezikon jetën e fëmijëve në rastet e rënies së zjarrit; shpenzime pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, si rezultat i dëmshpërblimeve për punonjësit e larguar padrejtësisht, si dhe për studentë, të cilët kanë përfunduar studimet e financuara nga Fondi i Ekselencës dhe kanë detyrimin të kthehen e të punojnë në Shqipëri.

Mbi rregullshmërinë e procedurave të prokurimit publik u evidentuan raste ku: kërkesat e njësisë së prokurimit, në lidhje me stafin, licencat, certifikatat e kërkuara, nuk përkojnë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet; nuk janë kryer verifikimet për plotësimin e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik (OE); përdorimi i skemës së marrëveshjeve të ndaluara nga operatorë ekonomikë të sigurimit të jo-jetës/jetës; janë përdorur procedura “negocim pa shpallje” pa plotësuar kushtet si të tilla; raste të përlogaritjes së fondit limit në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi; mungesë dokumentacioni verifikues për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në DST; mungesë e njohurive ligjore nga ana e personelit të angazhuar në prokurime publike; raste të mos ngritjes së strukturave të dedikuara për monitorimin e kontratave duke rrezikuar procesin e mbikëqyrjes dhe /apo marrjes në dorëzim të mallrave.

Gjatë zbatimit të punimeve rezultuan: diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar; zëra punimesh të ekzekutuar pas përfundimit të kontratës ose jashtë afateve të saj; punime të ndërtimit të realizuara jo në përputhje me specifikimet teknike; punime të pakryera në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve; tejkalim të afateve në zbatim të kontratës; etj.

Mbi dhënien me qera të tokës dhe procesin e shpronësimit, u evidentuan: sipërfaqe toke bujqësore me status juridik “të pa regjistruar” në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, duke rritur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore nga palë të treta; të ardhura të munguara nga qeraja e tokës bujqësore si pasojë e pasaktësive në llogaritjen e vlerës së qerasë apo mospagesës në kohë të qerasë së tokës; procese të ngadalta të monitorimit të kontratave të qerave; Sa i takon procesit të shpronësimit rezultoi se aktet nënligjore që rregullojnë këtë proces nuk janë të përditësuara.

Mbi sigurinë e shëndetit publik, u evidentua: nivel i ulët i shkallës së realizimit të analizave që kryhen krahasuar me mostrat e grumbulluara; mungesë e një programi vjetor për numrin e analizave të barnave mbështetur në të dhënat statistikore të viteve të kaluara dhe prognozatat e vitit të ardhshëm; Sektori i inspektimit për të tre vitet objekt auditimit nuk ka planifikuar dhe zhvilluar asnjë inspektim të sistemit të sigurisë për pajisjet mjekësore në spitale, laboratore dhe klinika ku janë të instaluar këto pajisje.

Mbi deinstitutionalizimin, rezultoi se: niveli aktual i implementimit të Planit të Deinstitutionalizimit nuk ka favorizuar zbatimin në një shkallë më të gjerë të tij; ka pasur mungesë koordinimi dhe ndërveprimi midis institucioneve të përfshira në zbatimin e tij; apo likuidime të padrejta të pagesave për trajnimet e kyera, referuar planit të deinstitutionalizimit, nga bashkitë pilot, etj.

Mbi shfytëzimin e burimeve natyrore u evidentua se: ende nuk ka hyrë në prodhim rreth 70% e total energjisë së kontraktuar për HEC-et nën 2 MW, jo objekt koncesioni, dhe rreth 50% e total energjisë në kontrata koncesionare të lidhura për HEC; nderkohë rreth 35% e kontratave koncesionare për *shfrytëzimin e burimeve hidroenergjitike* janë jashtë afatit, kanë rezultuar me shkelje ose janë në procese gjyqësore, si dhe nuk është përfituar prej tyre “fee koncesionare” (energji elektrike pa pagesë) në vlera të konsiderueshme.

Në lidhje me miratimin e ndërtimeve të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni (fotovoltaike/ eolike/ hidrike), rezultuan vështirësi në gjurmimin e procesi pasi dosjet për miratimin e impianteve fotovoltaike/ eolike nuk përmbajnë aktet e gjeneruara nga strukturat e MIE; nuk është kryer një vlerësim i drejtë i aftësive teknike, financiare dhe ekonomike të subjekteve aplikues nga komisionet e vlerësimit të aplikimeve.

Mbi kontratat e koncesioneve dhe partneritetit publik privat rezultoi se në disa raste, gjatë realizimit të procedurave konkurruese për dhënien me koncesion për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike hidrike, nuk është bërë më parë identifikimi i koncesionit të mundshëm të projektit, shoqëruar me analizën e rentabilitetit dhe përshtatshmërisë financiare

Në lidhje **me shfrytëzimin e burimeve minerare**, rezultoi se: nuk janë hartuar dhe dërguar në strukturën shtetërore përgjegjëse, informacionet periodike mbi realizimin e treguesve të aktivitetit; Nuk është kryer e plotë ose nuk është kryer fare mbikëqyrja dhe monitorimi, sikundër kërkon kuadri ligjor për sektorin minerar; Nuk janë përfshirë në skemën e inspektimit, monitorimit dhe kontrollit impiantet apo fabrikat e pasurimit të mineraleve; Nuk likuidohet në kohë ose fare garancia financiare vjetore për rehabilitimin mjedisor të zonës së lejuar minerare.

Në lidhje **me shfrytëzimin e burimeve hidroenergjitike** rezultoi se: është hequr kriteri për monitorim vjetor të veprimtarisë hidronergjetike, si dhe shtyrja në kohë e sanksioneve për këtë qëllim, deri në shuarje e tyre, si pasojë e ndryshimit të monitorimit të prodhimit vjetor të energjisë elektrike me VKM nr. 332, datë 6.6.2018; Gjatë monitorimit të kontratave koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve në vitin 2019 deri 2021, nuk ka pasur asnjë rast të ekzekutimit të penaliteteve në vlerën 23,143,439 mijë lekë; si pasojë e mungesës së oponencës teknike në rastet e ndryshimit të prodhimit të energjisë elektrike, ka munguar në buxhet vlera prej 15,590 mijë lekë; etj.

2. Në auditimet e institucionet e vetëqeverisjes vendore, rezultuan parregullsi:

Në lidhje me çështjet të cilat kanë kualifikuar opinionet mbi pasqyrat financiare, për shkak të: pasqyrimit jo të drejtë të ngjarjeve ekonomike në kontabilitet; llogari të pa justifikuara me dokumentet e nevojshëm kontabël, mangësi në rakordimet me Thesarin; mos përgatitja e dokumentacionit për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme; mungesa e regjistrit kontabël; mungesa e evidentimit në pasqyrat financiare të masave të shpërbllimit të dëmit; aktive të paregjistruara në ASHK; mos përlllogaritje e amortizimit për aktive mbi bazë të dhënave historike; fatura që nuk paraqiten me vlerën reale; nuk disponohen

dokumente pronësie për objektet e trashëguara nga njësitë vendore që u shkrinë me reformën territoriale; mungesa të inventarit fizik dhe të regjistrit të aktiveve.

Vijojnë të evidentohen mangësi në **procesin e planifikimit, kontabilizimit dhe mbledhjes së të ardhurave** për mbledhjen e të ardhurave të cilat janë parashikuar në paketën fiskale dhe buxhetin vjetor, si dhe të ardhura të tjera që vijnë nga qiraja e aseteve të njësisve vendore, apo gjoha të aplikuara nga inspektorati i mbrojtjes së territorit; ka vijuar problematika e mos zbatimit të detyrimeve kontraktuale për kontratat e qirasë; rezultuan raste të mos pajisjes me certifikatë/autorizim nga subjektet të cilat zhvillojnë aktivitet në fushën e shitjes me pakicë të karburanteve dhe nënprodukteve të tyre për konsumatorët fundorë; ka vijuar problematika e mosvjeljes së taksave nga strukturat e administratës së bashkive, për të cilët nuk janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme ligjorë.

Në lidhje me programimin buxhetor rezultoi se ndërmerren angazhime buxhetore të pambështetura në planifikime realiste; rezultuan raste ku janë lidhur kontrata pa pasur në dispozicion minimalisht 20% të vlerës së kontratës në vitin e parë të financimit, çfarë krijojnë kushte për krijimin e detyrimeve të prapambetura; nuk janë marrë masa për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura dhe planifikimin e një grafiku likuidimi të këtyre detyrimeve.

Në fushën e prokurimit publik u evidentuan raste të paligjshmërisë së fondeve publike me pasoja dëm ekonomik si pasojë e skualifikimeve të padrejta të operatorëve ekonomikë; vendosje të kriterëve jo në përputhje me zërat e preventivit, si dhe mos argumentimi në procesverbal i kërkesave në lidhje me kategoritë e licencave, numrin e punonjësve dhe kategoritë e punësimit, numrin dhe llojin e mjeteve etj., sipas grafikut të punimeve; mos argumentim të kriterëve dhe vendosjen e tyre jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit; vlerësimi i ofertave nga KVO, në kundërshtim me aktet rregullative; mos zbatim i rregullave në fushën e ndërtimit, kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të punimeve si dhe mos zbatim i disa zërave të punimeve me pasojë dëm ekonomik; Shtyrje e afatit të përfundimit të punimeve pa argumente teknike.

3. Në auditimet e kryera në institucionet e pasurive të paluajtshme rezultuan problematika:

Në fushën e legalizimeve, ku u evidentua se, janë miratuar legalizime të objekteve informale, duke mos zbatuar kriterin e miratimit të parcelës ndërtimore sa 3-fishi i bazës së objektit, fenomen ky i vërejtur në të gjitha DVASHK e audituara. Në veçanti, problematikat më të mprehta përfshijnë legalizime të objekteve në zona arkeologjike konstatuar në Durrës dhe Shkodër, në zonat e mbrojtura në Pogradec, mbi trupin e rrugës, kanaleve dhe infrastrukturën hekurudhore në të gjitha DVASHK, si dhe legalizime për objekte që nuk janë ndërtuar me materiale të qëndrueshme dhe legalizime të objekteve jashtë afatit ligjor.

Në fushën e regjistrimeve të pasurive të paluajtshme, për të 8-të drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të audituara u evidentua se, janë regjistruar prona pa administruar titujt e pronësisë, në mungesë të dokumentacionit ligjor për lejet e ndërtimit, me Vendime të Komisionit të Kthimit Pronave, duke regjistruar objekte apo sipërfaqe trualli që nuk ka qenë objekti trajtimi nga vendimet përkatëse. Gjithashtu, janë vërejtur raste të

regjistrimit të ngastrave për sipërfaqe toke më shumë sesa përcakton vetë AMTP-ja, duke ndryshuar zërin kadastral.

4. Në auditimet e performancës, referuar edhe Indikatorit të Vetëvlerësimit nr. 8 (SAI⁸ 8) sipas Kuadrit të Vetëvlerësimit të SAI-ve, të miratuar nga INTOSAI, është plotësuar kriteri i mbulimit të fushave që dikton ky indikator, duke mbuluar me auditim 6 nga 10 fushat e kërkuara⁹, ku u shfaqën mangësi ndër të tjera:

Në fushën e Mjedisit & Energjisë u evidentua se: (i) Drejtimet dhe politikat e Ministrisë së Mjedisit (sot MTM) në lidhje me *reduktimin e mbetjeve* nuk kanë qenë në linjë me objektivat strategjike kombëtare dhe evropiane; (ii) Masat e marra nga institucionet përgjegjëse lidhur me *menaxhimin e përdorimit të burimeve ujore* kanë qenë pjesërisht efektive dhe eficiente si pasojë edhe e mungesës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional; (iii) Politikat e ndjekura lidhur me *hapësirat publike, gjelbërimin e qytetit*, rezultuan të ishin ambicioze por të pashoqëruara me kapacitete të mjaftueshme financiare dhe logjistike nga ana e bashkisë Tiranë; (iv) në drejtim të *politikave mjedisore në nivel vendor*, thuajse në të gjitha NJVQV-të e audituara kanë munguar strukturat e dedikuara për të prodhuar politika mjedisore, si dhe qartazi ka munguar mbështetja me fonde buxhetore; (v) Sa i takon *lagunave si ekosistemet më të përfaqësuara në bregdetin shqiptar*, me ndikim në përmbushjen e objektivave të klimës globale, zhvillimit të qëndrueshëm dhe biodiversitetit, konstatuam se, nuk kanë patur vëmendjen duhur dhe nuk i kanë shpëtuar problematikave të ndërtimeve të padisiplinuara, ndotjes, tjetërsimit, apo shfrytëzimit pa kriter.

Në fushën e Infrastrukturës & Transportit u evidentua se: (i) *në drejtim të garantimit të drejtave të pasagjerëve*, nuk ka pasur një Strategji me objektiva konkrete dhe as plane veprimi, duke treguar deri diku mungesë fokusi ndaj garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pasagjerëve që përdorin transportin ajror; (ii) Strategjia për Sigurinë Rrugore 2011-2020 nuk është rishikuar asnjëherë.

Në fushën e Sigurisë Sociale u evidentua se: (i) Menaxhimi i Sistemit të Identifikimit, Regjistrimit të Kafshëve Blegtorale RUDA nuk rezultoi krejtësisht efektiv, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e nivelit të sigurisë ushqimore të produkteve nga ferma në tavolinë për popullatën; (ii) Pavarësisht masave të marra në funksion të arritjes së një niveli të kënaqshëm të sigurisë ushqimore, reformat strukturore nuk janë kryer bazuar në nevoja dhe kriteret e qarta vlerësuese, në analiza të sakta të kostove, veçanërisht në fushën e investimeve për laboratorë dhe infrastrukturë ndihmëse në institucionet e zinxhirit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve (PMB).

8 Ndarja e fushave të auditimeve te performancës behet Referuar Indikatorit të Vetëvlerësimit nr. 8 (SAI 8) sipas Kuadrit të Vetëvlerësimit, të miratuar nga INTOSAI

⁹ Self-Assessment Indicator 8 – SAI 8 parashikon se: “Gjatë 5 viteve, Institucioni Suprem i Auditimit të ketë evaduar raporte që mbulojnë të paktën 6 nga 10 fushat në vijim (sipas ISSAI 12:5, dhe ISSAI 300:36), konkretisht: 1. Shëndetësia; 2. Mjedisi; 3. Mbledhja e të Ardhurave; 4. Infrastruktura; 5. Financat dhe Administrata publike; 6. Siguria sociale dhe tregu i punës; 7. Arsimi; 8. Mbrojtja; 9. Zhvillimi ekonomik kombëtar; 10. Reforma të rëndësishme në sektorin publik.

Në fushën e Kulturës rezultoi se: Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e monumenteve të kulturës nuk e kanë orientuar veprimtarinë e tyre në mënyrë efektive, me qëllimin final, mbrojtjen, mirë - administrimin, inventarizimin dhe vlerësimin e monumenteve në vendin tonë.

Në fushën e Arsimit rezultoi se: Procesi mësimor on-line shfaqti mangësi në drejtim të pamundësisë për t'u monitoruar dhe si pasojë për t'u matur edhe cilësia e tij; Universitetet nuk arritën të prioritarizonin buxhetet në funksion të orientimit të fondeve karshi nevojave që diktoi pandemia; Mungesa e një strategjie të miratuar për sportin ka cenuar realizimin e objektivave për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe veprimtarive të tjera rekreative me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve që të merren me edukim fizik dhe sporte.

5. Në auditimet e institucioneve mjedisore rezultuan mangësi në:

Fushën e inspektimit mjedisor: pamjaftueshmëri financiare dhe organizative, mungesë analizë risku për inspektimin e subjekteve me risk të lartë, si dhe mangësi në procedurat inspektuese;

Në fushën e menaxhimit të zonave të mbrojtura mungonin baza e të dhënave mbi ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura, regjistrimin e këtyre zonave dhe mos përcaktimin e zonave buferike; si dhe

Në fushën e menaxhimit të fondit pyjor mangësi përgjatë procesit të inventarizimit dhe dixhitalizimit të fondit pyjor.

6. Në auditimet e Teknologjisë së Informacionit (TI) rezultuan mangësi në drejtim të:

Funksionimit të Qeverisjes TIK, nga ku rezultoi se mungesa e strategjive institucionale dhe strategjisë në drejtim të teknologjisë së informacionit ka mbartur riskun e keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve të audituara;

Sigurisë së Informacionit, nga ku rezultoi se identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve dhe bizneseve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit pa ndërprerje nëpërmjet teknologjisë së informacionit, është i pamjaftueshëm dhe mbartin risqe të larta në mbarëvajtjen e funksionaliteteve të ndërtuara në shërbim të qëllimit dhe objektivave institucionale;

Zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit, nga ku rezultoi se investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit;

Auditimit të Sistemeve, nga ku rezultoi se performanca e funksionimit të sistemeve në disa subjekte ishte jo e kënaqshme, pasi sistemet vazhdimisht punojnë me ndërprerje dhe kanë probleme me ecurinë normale të punës duke ndikuar në veprimtarinë e institucionit, në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve dhe bizneseve.

6. Në auditimet e shoqërive publike u shfaqën mangësi që lidhen me: Mungesën nga ana e shoqërive aksionere, të analizave ndaj problematikave me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar; Problematika në fushën e rekrutimeve të stafit si: emërime, largime, pezullime, dorëheqje, ndryshime pozicioni dhe ndryshime page pa dhënë shpjegimet përkatëse, apo sistem diferencial dhe i pabazuar pagash; Shpenzime jo efektive të fondeve si pasojë e ndërprerjes së paligjshme të marrëdhënieve të punës; Problematika në procedurat e prokurimeve dhe zbatimin e punimeve lidhur me: favorizime të Operatorëve Ekonomikë, specifikime teknike që nuk garantojnë cilësinë e kërkuar, përzgjedhja e mënyrës së vlerësimit në kundërshtim me parimet e përcaktuara, si dhe përfitime të padrejta fondesh si rrjedhojë e likuidimit të punimeve/shërbimeve të pakryera; Për tregtimin e energjisë elektrike është kërkuar paraqitja e një çmimi fiks për sasinë në shitje apo blerje, pa u referuar në çmimin orar të bursës; Mos plotësim i regjistrit të aktiveve; etj.

7. Në auditimet e projekteve me financim të huaj rezultuan: parregullsi në mbajtjen e librave dhe regjistrave kontabël, ku të pasqyrohen hyrje të plota dhe të sakta për të gjitha transaksionet financiare dhe nuk është kryer asnjë auditim dhe të jetë paraqitur raport nga auditues të pavarur; likuidim i punimeve të pakryera si dhe në disa raste vonesa në likuidimin e TVSH-së; Tejkallime të afateve të zbatimit të projekteve me pasojë rritje e kostove totale të tij si rrjedhojë e pagesave për shërbime konsulente, staf PMU, etj.; Mangësi në studimet paraprake, projekt-idetë apo projekt preventivët shoqërohen me kosto shtesë apo me vonesa të zbatimit të punimeve, kjo në disa raste edhe për shkak të kohës së gjatë nga hartimi i projektit deri në implementimin e tij; si dhe të ardhura të munguara nga mos respektimi i kushteve kontraktuale me koncesionarin.

8. Në auditimet e Buxhetit të Shtetit rezultuan mangësi në drejtim të:

Të Ardhurave ku rezultoi se: nivelet e ndryshimeve të synimeve dhe objektivave, në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale, dhe realizimi i tyre, treguan edhe një herë mungesë të saktësisë në parashikimin e treguesve analitikë të të ardhurave në periudhë afat mesme dhe vjetore. *Sa i takon të ardhurave tatimore*, edhe për vitin 2022 rezultoi se, megjithëse janë tejkalluar të ardhurat në total, plani i të ardhurave të buxhetuara në zërin e TVSH-së, që është dhe kontribuesi kryesor në të ardhurat buxhetore, dhe të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale nuk janë realizuar; Metodologjia e përdorur për shpërndarjen e planit të të ardhurave tatimore në njësitë e varësisë, nuk merr në konsideratë faktorë korrektues dhe plotësues sipas sektorëve të ekonomisë, fashave të tatimpaguesve dhe problematikat e lidhura me to sipas rajoneve administruese; Masat e marra për rikuperimin e borxhit tatimor, nuk paraqiten në nivelin e kërkuar dhe jo vetëm që nuk kanë kontribuar në rritjen e të ardhurave vjetore por njëkohësisht janë rritur detyrimet edhe me 12.4 miliard lekë krahasuar me vitin 2020; Përcaktimi i vlerës doganore sipas indikatorëve dhe klasifikimeve të kodit tarifor, me qëllim standardizimin dhe unifikimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar abuzivitetin dhe shmangien e detyrimeve doganore, mbetet një problematikë që kërkon forcimin e kontrolleve nga ana e administratës doganore.

Të Borxhit Publik dhe Deficitit Buxhetor, rezultoi se deficitin buxhetor në fund të vitit 2021 ishte 85,397 milion lekë (ose 4.5% të PBB). Pavarësisht se, janë respektuar tavanet e

ekzekutimit të deficitit buxhetor gjatë vitit, duhet theksuar se ai ka arritur nivelin prej 61.5% të tij në muajin dhjetor, për shkak se 44% e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm janë kryer në këtë muaj, duke komprometuar përdorimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike, nga përqendrimi i përdorimit të tyre në fund të vitit.

Stoku i borxhit publik i raportuar sipas buxhetit faktik ndaj PBB është në nivelin e 73.2% në vitin 2021 nga 74.5% në vitin 2020, si pasojë e rënies së borxhit të pushtetit lokal dhe normës së rritjes së PBB-së më shumë se rritja e stokut të borxhit publik. Kështu, ritmi vjetor i rritjes së PBB-së është më i madh se borxhi, por vetë borxhi rezulton me rritje në vlerë prej 158,506 milion lekë ose me rreth 13% më shumë se viti 2020. Gjatë vitit 2021 nuk janë emetuar bono thesari 6-mujore për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit në shumën 6.9 miliard lekë, me efekt në nënvlerësimin e stokut të borxhit faktik të raportuar në fund të vitit 2021; Pagesat e principalit dhe interesave për garancitë jo performuese kryhen nga Buxheti i Shtetit, pa u marrë të gjitha masat e nevojshme nga ana e institucionit huadhënës për rikuperimin e detyrimit, por vetëm bazuar në vetë deklarimin e përfituesit të garancisë mbi paaftësinë paguese të tij.

Krijimi i detyrimeve të reja në shumën 6,511 milion lekë të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2021, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse; Garancitë shtetërore paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre, pasi thuhet se gjithë ulja e stokut të garancive të huaja i atribuohet pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit.

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në vijimësi nuk merren masa për rikuperimin e detyrimeve të krijuara ndër vite nga marrëdhëniet e nënhuasë e garancisë, por vazhdimisht krijohen detyrime të reja, kushtëzuar kryesisht edhe nga detyrimet e ndërsjella midis shoqërive tregtare me kapital shtetëror në sektorin energjetik si dhe problemeve me mirëadministrimin e shoqërive në tërësi (sektori energjetik, sektori i ujësjellësve apo edhe pushteti vendor), reflektuar në paaftësinë paguese të tyre.

Stoku i detyrimeve të prapambetura me vlerë 13,335 milion lekë, më 31.12.2021 (në bazë të vetë deklaramenteve të njësive buxhetore) rezultoi me një pakësim krahasuar me vitin 2020 në vlerën prej 982 milion lekë, ku 48% i përket detyrimeve të njësive të qeverisjes qendrore dhe 52% qeverisjes vendore. Në njësitë e qeverisjes qendrore, pjesën më të madhe të stokut të detyrimeve të prapambetura e përbëjnë vendimet gjyqësore me 51.4% të detyrimeve, të ndjekura më pas nga detyrime të tjera me 16.9%, investime 12%, shërbime më 8% etj., si dhe janë vetëm tre ministri: MIE, MFE dhe MM të cilat përfaqësojnë rreth 81% të totalit të këtij stoku. Rezultoi nivel i lartë i detyrimeve të ndërsjella midis kompanive të sektorit energjetik dhe mungesa e rakordimit mes tyre, e cila ekspozon buxhetin e shtetit përpara riskut të krijimit të detyrimeve të reja; Vështirësitë financiare të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, të cilat paraqiten me detyrime të akumuluar konsiderueshëm, përbëjnë gjithashtu risk të shtuar për shkak të nevojës për mbështetje buxhetore; MFE ka vijuar të mos përfshijë në raportimin e detyrimeve të prapambetura, detyrimet e shtetit shqiptar nga vendimet Gjykatave të Arbitrazhit dhe Gjykatës së të Drejtave të Njeriut; Sa i takon *Kontratave koncesionare/PPP* rezultoi se janë kryer pagesa për vitet e kaluara në vlerën prej

292,593 mijë lekë ose 2.5 % e shpenzimeve gjithsej për to, të cilat përbëjnë risk të shtuar për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Programimit të shpenzimeve buxhetore, ku vijuan të shfaqen mangësi të theksuara të planifikimit të investimeve publike nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore, me efekt presion për rritjen e borxhit publik, si pasojë e mosrespektimit të kufijve të miratuar për shpenzime në vitin buxhetor aktual dhe kufijtë e miratuar për vitet e ardhshme buxhetore; Mangësi në përgatitjen e PBA-së në lidhje me afatet, dokumentacionin argumentues të projekteve të reja dhe reflektimin nga ana e njërive buxhetore të sugjerimeve të MFE-së; Gjatë vitit 2021 rezultuan të jenë kryer 377 rishikime buxhetore pas datës 15 nëntor 2021, në mospërputhje me nenin 48 të Ligjit organik të buxhetit.

Përdorimit të SIFQ përgjatë planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit, ku rezultoi se: (i) raportet e ndërtuara dhe ofruara nga SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor nuk përdoren nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit si një mënyrë për të kontrolluar saktësinë e detajimit të buxhetit fillestar dhe më pas atij operativ; (ii) Plani i buxhetit të miratuar me Aktin e fundit Normativ, krahasuar me atë të hedhur në SIFQ sipas treguesve fiskal ka diferenca në pothuajse tek të gjithë zërat e shpenzimeve, me një vlerë neto prej 13,999 milion lekë; rishikime të shumta të fondeve buxhetore të kryera përgjatë gjithë vitit, ku rezultojnë rreth 2,517 projekte të rishikuar, me një ndryshim neto të fondeve disponibël prej 65.1 miliard lekë, si dhe 348 regjistrime të rialokimeve me data kontabël, efektive më të hershme (retrospektive); (iii) Mospërputhje mes të dhënave të APP dhe të dhënave mbi kontratat e regjistruara në SIFQ. Në SIFQ gjatë vitit 2021, rezultojnë 635 rekorde unike të dokumentit urdhër-prokurim, me vlerë totale 127.25 miliard lekë, nga rreth 26 mijë kontrata të regjistruara, pasi njësitë ekonomike, nuk regjistrojnë në çdo rast pranë degëve të thesarit urdhër-prokurimet para fillimit të procedurave në APP; 333 nga 635 urdhër-prokurime të regjistruara me datë viti 2021, rezultojnë të lidhura me një kontratë të nënshkruar në vitet e mëparshme (2014-2020), etj.; Gjithashtu sa i takon respektimit të disiplinës buxhetore, gjatë auditimit të *Kontratave koncesionare/PPP* rezultoi se: është vijuar me kryerjen e pagesave për shërbime të pakryera për shërbimin e dializës; Vështirësi në monitorim sa i takon instrumenteve kirurgjikale, si dhe vështirësi në respektimin e tavanit buxhetor, me ndikim ç 'balancim në buxhet dhe kufizime në ndërhyrje për pacientët; si dhe ndryshimi i numrit të instrumenteve kirurgjikale në mënyrë të paargumentuar për disa prej seteve nga viti në vit.

Në lidhje me përdorimin e Fondit Rezervë, ku rezultuan: mangësi në plotësimin e dokumentacionit lidhur me vendimet për përdorimin e këtij fondi apo sugjerimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë, përpara se të merreshin këto vendime; Përdorim i fondit rezervë si "shtesë buxheti", kur në fakt këto shpenzime duhet të parashikoheshin në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore të planifikimit të buxhetit, dhe të miratoheshin me ligjin vjetor të tij, apo dhe të cilësoheshin si "emergjencë". Akordimi dhe përdorimi i fondit rezervë për të financuar shpenzime të paplanifikuara operative dhe të investimeve, si dhe pagesa të prapambetura të institucioneve buxhetore ka devijuar nga parimi i përgjithshëm i qëllimit të këtyre fondeve për amortizimin e ngjarjeve të papritura si fatkeqësi natyrore, etj., duke sjellë për pasojë

denatyrimit të përdorimit të fondit rezervë.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë **nuk janë paraqitur në Kuvend pasqyrat financiare të konsoliduara të shtetit**. Kuadri rregullator lidhur me Kontabilitetin Publik nuk ka pasur përmirësimin e synuar. Mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik vijon të rregullohet me Udhëzimin Nr.8, datë 09.03.2018, të paplotë dhe me probleme nga pikëpamja konceptuale. Progresi i bërë në lidhje me hartimin e bazës ligjore dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit është i pamjaftueshëm. KLSH ka konkluduar se, Pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), nuk pasqyrojnë plotësisht gjendjen reale financiare të saj.

Në drejtim të **Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) dhe Auditimit të brendshëm** rezultoi se ka vijuar të mungojë angazhimi i duhur për përmirësimin e nevojshëm dhe të domosdoshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike. Në auditimet e institucioneve qendrore rezultuan raste të: mungesës së gjurmës të auditimit; ndryshime organizative-strukturore të paflektuara në rregullore të brendshme; mungesë trajnimesh në funksion të forcimit të kontrolleve të brendshme; vakanca të vazhdueshme të cilat rrezikojnë të cenojnë realizimin e objektivave institucionale, etj. Në auditimet e njësitëve të vetëqeverisjes vendore, rezultoi se, vijojnë të mbeten pa u kuptuar koncepte të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe nuk janë kryer disa procedura në lidhje me 5 komponentët e MFK-së, si: mungesa e procedurave të sinjalizimit të rasteve të parregullsisve, mashtrimeve, të veprimeve korruptive; mungesa e programeve të trajnimit për integritetin dhe sjelljen; mungesa e planeve të investimit për programet e Teknologjisë së Informacionit (TI), dhe e procedurave për ruajtjen e të dhënave të aktiveve; mungesa e një plani menaxhimi të riskut të TI për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish; etj.

Ndërsa, *veprimtaria e auditimit të brendshëm* në sektorin publik shfaq një progres të moderuar, por vijon të jetë ende larg pritshmërive dhe me sfida thelbësore teknike dhe profesionale. Fakti që për vitin 2021 janë 42 ente publike (19 institucione të pavarura, 13 agjenci dhe 10 bashki) të pa mbuluara me auditim, në asnjë nga format e përcaktuara në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator (ose rreth ¼ e të gjitha institucioneve për auditim), tregon se mungon mbikëqyrja e sistemeve të kontrollit. Veç kësaj, strukturat e auditimit të brendshëm rezultojnë me mungesë për 52 pozicione audituesi ose 25%, duke vijuar në të njëjtat problematika si në vitet e kaluara.

PROCESI I AUDITIMIT

Kontrolli i cilësisë dhe zbatimit të standardeve

Faza 1. Planifikimi Auditimit

- Marrja e Plan Veprimit për rekomandimet,
- Marrja e raportit mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve,
- Kryerja e auditimit për zbatimin e rekomandimeve

Faza 2. Puna në Terren

- Prezantimi me njësinë që do të auditohet,
- Mbledhja e evidencave të auditimit nëpërmjet , procedurave dhe teknikave të përshtatshme të auditimit,
- Përditësimi i vlerësimit të riskut nga faza e planifikimit,
- Dokumentimi në vijimësi i auditimit, komunikimi dhe kontrolli i cilësisë (kontrolli në të nxehtë),
- Takimi përmbyllës.

Faza 3. Raportimi

- Vlerësimi nëse është marrë evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme,
- Konsiderimi i materialiteti/rëndësisë për qëllime të raportimit,
- Hartimi i gjetjeve, rekomandimeve dhe Opinionit të Auditimit,
- Përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit të Auditimit
- Shqyrtimi i observacioneve dhe reflektimi i tyre,
- Takimi përmbyllës i mirëkuptimit,
- Raporti Përfundimtar i Auditimit,
- Vendimi
- Përcjellje dhe Arkivimi i Dosjes së Auditimit

Ndjekja Rekomandimeve

- Përcaktimi burimeve (sipas Planit Vjetor)
- Mbledhja informacionit paraprak
- Njohja me subjektin
- Vlerësimi i Kontrollit të Brendshëm
- Vlerësimi i riskut dhe materialitetit
- Përcaktimi i objektivave të auditimit dhe fushëveprimit
- Hartimi dhe miratimi i Programit të Auditimit

2.3 REZULTATET E AUDITIMIT ¹

2.3.1 DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TE BUXHETIT TË SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2022 ka realizuar 18 auditime. Në institucionet e audituara, gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, janë adresuar gjithsej **615 rekomandime**, nga të cilat: 3 masa janë për përmirësime ligjore, 340 masa organizative, 184 masa disiplinore, 1 masë administrative, 41 masa shpërblim dëmi dhe 46 masa për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike, të konstatuara në fushat si vijon:

Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj për periudhën e aktivitetit të vitit 2021, janë evidentuar problematika dhe mangësi në të gjitha fazat e planifikimit, miratimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit, konkretisht:

Në procesin e detajimit të projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2021-2023; detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore; shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve të tjera të investimit publik për detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara, mos regjistrimin e kontratave dhe rrjedhimisht mos regjistrimin e obligimit në sistemin SIFQ, duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore pa fonde disponibël. Këto problematika të konstatuara, kryesisht në programet buxhetore “Transporti rrugor”, “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, “Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes”, “Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit kombëtar të komunikimit të sigurt”, “Identifikimi elektronik i zgjedhësve” krijojnë kushte për krijimin e detyrimeve të prapambetura me efekt në rritjen e presionit për rritjen e borxhit publik;

Janë regjistruar plan pagesash në vitin 3 për 15 projekte në shumën 1,866 milion lekë, pa asnjë plan pagese për vitin aktual, vitin 1 dhe vitin 2; janë paguar detyrime të prapambetura në verën 10,065 milion lekë, të cilat përfaqësojnë rreth 14% të Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm të realizuara për vitin 2021;

Si dhe është konstatuar se edhe gjatë këtij viti përsëri ka një numër të lartë rialokimesh të fondeve buxhetore, prej 20,533 rekordesh, me një vlerë në rritje prej rreth 368,711 milion lekë, vlerë në ulje prej 303,636 milion lekë, dhe ndryshim neto në buxhet prej 65,074 milion lekë, ku prej të cilave 379 prej tyre pas datës 15 nëntor, në kundërshtim me ligjin organik për menaxhimin e buxhetit.

Gjithashtu, plani i buxhetit të miratuar me Aktin Normativ nr. 34, datë 03.12.2021 dhe plani operativ sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, krahasuar me planin e hedhur në SIFQ për zërat sipas treguesve fiskal janë konstatuar diferenca në pothuajse të gjithë zërat e shpenzimeve, me një vlerë neto prej 13,999 milion lekë;

Sipas modulit të kontratave në sistemin SIFQ, rezultoi se, janë nënshkruar 1033 kontrata pas datës 15 Tetor për investimet publike, vlera e kontraktuar e të cilave për vitin 2021 rezulton 4,295 milion lekë, ndërsa vlera totale e kontraktuar 40,311 milion lekë.

Nga të ardhurat dytësore për vitin 2021, të regjistruara në SIFQ, rezultoi se janë realizuar investime kapitale me financim të brendshëm në vlerën për 1,148 milion lekë, investime që nuk kanë plan buxheti

¹ Raportet e Auditimit dhe Vendimet përkatëse, janë të publikuara në web-in e KLSH-së: https://www.klsh.org.al/cat_list/160

të miratuar, ndërkohë që në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar janë raportuar të realizuara ndaj planit të buxhetit;

Rezultuar 42 raste, me vlerë 541,213 mijë lekë në tejkalim të afatit 30 ditor të procesimit dhe ekzekutimit të pagesave dhe 26,561 fatura në total me vlerë 43,928,109 mijë lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor. Ndërkohë, evidentohen 13988 kontrata nga 25291 kontrata të regjistruara gjithsej, ose 53%, me vlerë 163.2 miliard lekë, të regjistruara në shkelje të afatit 5 ditor.

Fondi i rindërtimit prej 48,998 milion lekë i shpërndarë me VKM, deri në fund të vitit 2021, është mbi vlerën e përcaktuar në ligjet vjetore të buxhetit të vitit 2020 dhe 2021 për këtë fond. Shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore; për financimin e një pjese të projekteve të rindërtimit, në VKM përkatëse të dala për përdorimin e këtij fondi është përcaktuar si burimi financimi edhe ngurtësimi i fondeve, në vlerën rreth 4,468 milion lekë, nga projekte të tjerat të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, formë e cila nuk është e mbështetur në bazë ligjore.

Detyrimet e prapambetura raportuar nga MFE në rreth 13,811 milion lekë (duke përfshirë edhe stokun e rimbursimit të TVSH) nuk janë të përfshira në treguesit fiskalë të konsoliduar;

Nga ana e KZHR nuk është marrë asnjë vendim për shpërndarjen e financimit për projekte të reja përgjatë vitit 2021, por vlera e alokuar për këtë fond është përdorur për financimin e kontratave në vazhdim nga vitet e kaluara si dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në total për 107 milion lekë.

Fondi Rezervë rezulton të jetë përdorur edhe për shpenzime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit vjetor dhe përgjatë vitit ai është rishpërndarë në projekte të tjera nga sa planifikuar fillimisht.

Borxhi Publik për vitin 2021 paraqitet me ulje krahasuar me planifikimin, por krahasuar me vitin 2020 ka pësuar rritje në vlerë absolute. Problematika u konstatua në lidhje me mos arkëtimin e plotë të të drejtave të buxhetit të shtetit nga marrëdhëniet e nënuasë, që subjektet kanë krijuar në vite, duke krijuar detyrime të reja në vlerën 6,511 milion lekë; garancitë shtetërore paraqesin risk të shtuar, pasi përfituesit e tyre janë të paafte në shlyerje, duke shkaktuar rritjen e detyrimeve me 1,932.9 milion lekë. Ndërkohë, efekti i mungesës së emetimit të instrumentit të bonove të thesarit 6-mujore për mbulimin e humbjes së Bankës së Shqipërisë, në shumën 6,928 miliard lekë përfaqëson një nënvlerësim të stokut të borxhit real të raportuar në fund të vitit 2021.

Në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, në lidhje me shkallën e zbatueshmërisë së akteve ligjore, nënligjore dhe rregullative, u evidentuan devijime materiale, por jo të përhapura në fushën e prokurimeve, planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, ekzekutimin e vendimeve të gjyqësorit, si dhe regjistrimin e ngjarjeve ekonomike jo në përputhje me parimet e kontabilitetit dhe bazës ligjore në fuqi. Kështu, nga MFE janë kryer pagesa për dy kontrata sistemesh të MFE lidhur nga AKSHI, për të cilat MFE nuk ka planifikuar fonde për to; dy kontrata investimi janë raportuar në të njëjtin kod projekti investimi sipas databazës së të dhënave; kërkesat për rialokim fondesh për shpenzimet operative të Aparatit të MFE-së bëhen nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili ushtron njëkohësisht funksionet e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit të Parë Autorizues të MFE, duke rezultuar në thyerje të sistemeve të kontrollit të brendshëm; MFE nuk ka transferuar aktiveve IT tek AKSHI jo në përputhje me përcaktimet e akteve

ligjore. Procedurat e prokurimit, si dhe lidhja e kontratave për mallrat apo shërbimet në fushën e teknologjisë së informacionit, janë zhvilluar dhe nënshkruar nga AKSHI, ndërsa vetë investimi si dhe detyrimi financiar kalojnë dhe i takojnë MFE. Aktualisht sistemet e IT dhe infrastruktura hardware e MFE, janë ende pjesë e aktiveve të MFE-së, e për pasojë edhe detyrimet juridike dhe financiare mbi këto sisteme; janë kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për 15 ish punonjës të larguar nga puna me efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit 16,945 mijë lekë gjithsej.

KLSH ka marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme të auditimit, duke shprehur opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të MFE, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, pasi: Pasqyrat financiare nuk janë hartuar, miratuar dhe nënshkruar nga strukturat përgjegjëse për raportimin financiar, si dhe nuk janë paraqitur konform kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018; të ardhura nga shitja për vitin 2021 në shumën 239,086 mijë lekë, për aktive afatgjata të cilat nuk janë të regjistruara në pasqyrat financiare të MFE-së; evidentohet trajtimi jo i drejtë kontabël i bonove të privatizimit, pasi nuk ka evidencë në pasqyrat financiare të MFE; në lidhje me sasinë e letrave me vlerë me bazë të drejtën për të privatizuar asetet afatgjata të shtetit; Për 4 projekte me financim të huaj, të realizuara gjatë vitit 2021.

Janë evidentuar fonde në vlerën 14,400 mijë lekë të planifikuara dhe raportuara si investime kapitale, të cilat janë të angazhuara në shpenzime operative, duke rritur llogarinë e investimeve në proces si pasojë e klasifikimit jo të duhur në llogarinë kontabël; është konstatuar pasqyrim jo i saktë dhe i plotë i shpenzimeve për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara dhe trupëzuara me burim financimin e huaj, afërsisht në shumën 246,055 mijë lekë; në kontabilitet pasqyrohet vetëm TVSH, ose vlera prej 20% e situacionit përkatës në lidhje me projektet e investimit, ndërsa vlera prej 80% e investimit në proces është jashtë pasqyrës së pozicionit, duke denaturuar vlerën reale të investimit të paraqitur në pasqyrat financiare.

Nga auditimi i përputhshmërisë të ushtruar në **“Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit” (DH/MFKK):**

Në lidhje me harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi mbi funksionet dhe kompetencat e DH/AB dhe *Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm (KKAB)* rezultoi se, pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 114/2015 i ndryshuar dhe pika 1, Kreu 1 i VKM nr.116/2016 “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e KKAB në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”, nuk ka të përcaktuar ndarjen e funksioneve të DH/AB dhe KKAB.

Në lidhje me *regjistrin e audituesve të certifikuar* në sektorin publik i përditësuar dhe publikuar edhe në faqen zyrtare të MFE, nuk jepet informacion i mjaftueshme në lidhje me statusin e audituesve aktiv ose pasiv, duke bërë paraqitjen e të dhënave jo të plota për audituesit e certifikuar në vite, si dhe nuk ka miratim zyrtar të modelit të certifikatës nga ana e Ministrit, model ky që vijon tu shpërndahet audituesve të brendshëm që prej vitit 2017;

Nga auditimi mbi procedurat e përgatitjes së Raportit vjetor 2021 të KBFP, kanë rezultuar mangësi në plotësimin e tij, pasaktësi në të dhënat e relatuara, si dhe mos përfshirje e të dhënave për gjithë subjektet të cilat e kanë detyrim sipas Ligjit nr. 10926/2010 i ndryshuar;

Nga auditimi i organizimit të strukturave të NJAB-ve rezultoi se, në nivel sistemi ka 34 institucione që në përbërje të strukturave të NJAB-ve kanë më shumë se 1/3 të punonjësve të pa certifikuar, jo në

përputhje me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" si dhe 53 institucione ose 40% e tyre kanë strukturë të paplotë në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83 datë 03.02.2016, si dhe 28 institucione kanë planifikuar numrin e audituesve në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83 datë 03.02.2016;

Nga auditimi i saktësisë së Raportit vjetor të KBFP për vitin 2021 u konstatua se, nga DH/MFKK nuk është kryer asnjë analizë e pyetësorëve të dërguar nga njësitë publike, me qëllim përcaktimin e saktësisë dhe konsistencës së plotësimit të tyre, ku nga 138 subjekte që kanë raportuar/plotësuar pyetësorin, për 120 subjekte nuk është bërë vlerësimi.

Në **Bankën e Shqipërisë** për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më datë 31.08.2021, problematikat e konstatuara përfshijnë sa vijon:

Gjatë vitit 2020 në Bankën e Shqipërisë janë dorëzuar 2,547 milion lekë bono privatizimi dhe përgjatë periudhës 01.01.2021 deri më 31.08.2021 janë dorëzuar 1,916.5 milion lekë bono privatizimi për asgjësim nga bankat e nivelit të dytë të cilat nuk janë të përfshira në VKM për grumbullimin e dorëzimit të tyre; nuk është mbuluar rezerva negative e rivlerësimit të valutave nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë brenda afatit të parashikuar në nenin 64 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë"; mos realizimin e investimeve sipas buxhetit të miratuar duke mbartur objektet vit pas viti dhe nisjen e procedurave për prokurim në fund të vitit, duke sjellë pa mundësinë për realizimin e fondeve të miratuara; parregullsi në vendosjen e kriterëve kualifikuese për kandidatët në zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe kualifikimin e kandidatëve, mungesë monitorimi në kohë të kontratave, etj.

Në **Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve**, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, problematikat e konstatuara përfshijnë sa vijon:

Gjendja e detyrimeve të papaguara deri me datën 31.12.2021 është 134,935 milion lekë, me një rritje neto prej 12.5 miliard lekë krahasuar me një vit më parë; nuk është respektuar plani i rimbursimit të TVSH-së i cili është tejkaluar në shumën 7.1 miliard lekë. Në mbyllje të periudhës ushtrimore 2021, rezultojnë 69 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale prej 1,893,609 mijë lekë, në tejkallim të afatit ligjor 60-ditor, veprime këto në kundërshtim me ligjin 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nga auditimi ka rezultuar se, vlera e stokut të rimbursimit të TVSH-së të vlerësuar është 2,370,259 mijë lekë nga 476,650 mijë e paraqitur nga DPT;

Të ardhurat tatimore neto paraqiten me mosrealizim për vlerën 7,134,393 mijë lekë, ose janë arkëtuar më pak në masën 4.7%, ku ndikim ka dhënë mosrealizimi i të ardhurave nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, nga Taksat Kombëtare dhe Taksa e Qarkullimit Rrugor; mangësi në përbërje të të ardhurave faktike të vitit ushtrimor të strukturuar sipas natyrës dhe llojit, janë edhe të hyrat e kontabilizuara në llogarinë 466 "Mjete në ruajtje", e cila përfaqëson arkëtimet e paidentifikuara deri në sistemimin e tyre;

Mangësi në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, ku rezultojnë parregullsi në plotësimin e vendeve vakante, në përshkrimet e punës për punonjësit jashtë shërbimit civil për Drejtorinë e Hetimit Tatimor dhe Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, ku shfaqen raste që për të njëjtin përshkrim pune me të njëjtat detyra funksionale, të ndryshojë kriteri i nivelit të arsimimit apo fushës së edukimit, si dhe mangësi në shkëputjen e marrëdhënieve të punës e në administrimin e dosjeve të personelit. DPT ka kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna në vlerën totale 186,466 mijë lekë, vlerë e cila ka efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit;

mangësi në zbatimin e buxhetit institucional për shpenzimet operative për vitin 2021, si dhe në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare; mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, ku moduli i riskut nuk është përmirësuar apo nuk i janë shtuar rregulla të reja që nga viti 2015 i implementimit të tij, pasi ky modul shqyrton automatikisht aspekte të veçanta të dokumentacionit tatimor të çdo tatimpaguesi. Pra, mungon përditësimi për të qenë në koherencë me gjithë ndryshimet që ka pësuar legjislacioni fiskal ndër vite, vetë administrata tatimore por edhe profili i tatimpaguesve. Rezulton se, edhe pse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën drejtori kryhet manualisht, pasi sistemi nuk merr në konsideratë: Subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale;

Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT e DRT, të cilat konstatohen në unifikimin e organizimit dhe të strukturës në përputhje me ligjin dhe udhëzimin e procedurave tatimore, në rritjen e pavarësisë, në përfundimin e analizimit e rasteve të denoncimeve të ardhura etj.;

Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, të cilat konstatohen në monitorimin periodik të punës së Drejtorive Rajonale Tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor, në përfundimin e kontrolleve dhe arkëtimin e detyrimeve, në realizimin e kontrolleve nga zyra nëpërmjet mbledhjes dhe përpunimit të dhënave nga sistemi C@ts, në mos përfundimin e kontrolleve për disa vite; mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar, e cila nuk ka përmbushur misionin e krijimit të saj, duke qenë një strukturë jo efiçente në përmbushje të përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara nga legjislacioni përkatës i fushës, ku shkaku kryesor i kësaj situate është mungesa e akteve ligjore dhe nënligjore për të operuar normalisht në funksion të qëllimit të krijimit të kësaj drejtorie; mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Verifikimit dhe Kontrollit në Terren, që kanë të bëjnë me procedurat e ndjekura nga inspektorët në terren dhe bazueshmëria ligjore e akteve të mbajtura prej tyre.

Nga auditimi i përputhshmërisë, i ushtruar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave” (DPD), për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2021 deri në 31.10.2021, rezultuan problematikat si vijon:

Gjendja e borxhit doganor në 31.12.2021 është në shumën 45,711,586 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4688 raste, borxh ky i trashëguar përgjatë viteve gjithmonë në rritje, ku vetëm për vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 657,648 mijë lekë ose me 1 % shtesë, si rezultat i mos marrjes së masave të duhura dhe efikase për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, mos plotësim me personelin e duhur të strukturave të menaxhimit të borxhit në degët doganore, vlerësim jo i duhur si dhe mungesë e aktiviteteve shtesë të kontrollit, nga ana e drejtuesve të DPD, për të minimizuar të gjitha problematikat dhe mangësitë, të cilat kanë sjellë këtë nivel të lartë të borxhit doganor dhe për më tepër trendin në rritje të tij.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e procedurave të ndjekura nga ana e DPD, në lidhje me rekrutimin e punonjësve, emërime, transferime, etj. janë evidentuar mangësi në procesin e rekrutimit të punonjësve, në procedurat e transferimit të punonjësve brenda sistemit dhe respektimin e afatit të transferimit, të cilat kanë sjellë efekte financiare negative në buxhetin e shtetit në shumën 6,995 mijë lekë.

Janë kryer shpenzime për likuidim të vendimeve gjyqësore për punonjës të larguar në shumën 18,856

mijë lekë të cilat përbëjnë përdorim pa efikasitet dhe efektivitet të fondeve të institucionit, pasi janë rezultat i vendimmarrjes jo të drejtë për largimin e tyre nga puna.

Gjithashtu, është konstatuar se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore nuk është kryer vullnetarisht, me qëllim shmangien e shpenzimeve të panevojshme, por është kryer me përmbarues privat, duke shkaktuar shpenzime shtesë në shumën prej 1,355 mijë lekë.

Nga auditimi i përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të “Institutit të Sigurimeve Shoqërore” (ISSH), për periudhën e veprimtarisë, nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2021, ka rezultuar se në vitin 2021 numri i kontribuuesve gjithsej në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore është rritur me 42 960 persona, nga të cilët rreth 26% i përkasin sektorit shtetëror (buxhetor dhe jobuxhetor) kontribute që paguhet në pjesën më të madhe nga buxheti i shtetit; është ulur numri i kontribuuesve në subjektet private me 31 085 persona dhe janë rritur ndjeshëm të vetë punësuarit.

Detyrimet e papaguara në afat për kontributin e sigurimeve shoqërore më 31.12.2021 janë në vlerën 15,866,737 mijë lekë, që i përket 103 628 subjekteve. Gjatë vitit 2021 janë rritur detyrimet e pa paguara në vlerën prej 1,474,616 mijë lekë, ose 9% e totalit, e përfaqësuar me shtimin e 6 795 subjekteve debitore. Në detyrimet e papaguara të vitit 2021, 65% i përket biznesit të vogël, 30% biznesit të madh dhe pjesa e tjetër subjekteve jo buxhetore.

Referuar auditimit të kryer në ISSH rezulton se, raporti kontribuues/ përfitues, një nga treguesit kryesor të funksionimit të qëndrueshëm të skemës dhe të uljes së financimit buxhetor, në vitin 2021 është 1.42, ose 0.05 pikë më mirë se në vitin 2020, ajo e nivelit të vitit 2014, duke evidentuar zhvillim kritik të shkallës së varësisë së sistemit. Kjo shkallë e lartë varësie, e pamjaftueshme për mbulimin e parametrave financiar të sistemit është kompensuar me rritjen e subvencioneve buxhetore dhe gjithashtu nga masa pensionesh të kufizuara në mënyrë administrative, nëpërmjet tavaneve, të cilat kanë dëmtuar lidhjen organike midis kontributit dhe përfitimit, si dhe kanë stimuluar shmangiet nga pagesat për së paku të gjithë ata që kanë pasur rroga mbi nivelin e pagës mesatare.

Deficiti fiskal i skemës së sigurimeve shoqërore, i konsideruar diferenca midis shpenzimeve dhe të ardhurave nga kontributet (përfshirë kontributet dhe financimet me destinacion nga buxheti i shtetit), në vitin 2021 ka qenë 37,725 milion lekë, një deficit me rritje të vazhdueshme nga viti në vit, duke u rritur në vlerë absolute në shumën prej 900 milion lekë kundrejt vitit 2020, megjithëse ka një përmirësim prej 0.14 pikë përqindje. Si rezultat i shpenzimeve të mësipërme, niveli i subvencionit faktik ka qenë më i ulët se ai i llogaritur për 2,994 milion lekë. Duhet theksuar se subvencionimi i skemës së sigurimeve shoqërore në vendin tonë nga buxheti i shtetit vazhdon të mbetet akoma i lartë, pasi ato përfaqësojnë 25.5% të shpenzimeve gjithsej për sigurimet shoqërore.

Nga auditimi i përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të “Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor” (FSDKSH), për periudhën e veprimtarisë së saj nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2021, u konstatua se:

Këshilli Administrativ nuk ka ushtruar plotësisht kompetencat ligjore përcaktuar në nenin 20 të Ligjit nr.10383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zgjedhjen dhe emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe propozimin e ndryshimeve ligjore për rregullimin e nenit 16 të ligjit, sipas të cilit në përbërje të Këshillit Administrativ anëtar i 7 i tij është ende përfaqësuesi i ish Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,

ministri e cila nuk ekziston më që prej vitit 2017, dhe për pasojë KA funksionon me 6 anëtar gjithsej që prej këtij momenti;

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës koncesionare për sterilizimin, rezultoi se: nuk ekziston një protokoll i saktë i ndërhyrjeve/seteve, numri i seteve në aneks kontratë dhe faktit sipas diagnozave të aplikuara. Është ndryshuar numri i instrumenteve në sete në vite edhe për të njëjtën diagnozë/ndërhyrje, ka raste që janë aplikuar dhe paguar 2 dhe 3 nivele kompleksiteti, duke sjellë mosrespektim të tavanit buxhetor, me pasojë kufizimin e ndërhyrjeve për pacientët;

Nga Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare nuk është rregulluar pjesa e dokumentimit të procedurës së njoftimit të pacientëve të renditur në listë pritje për paketat shëndetësore të ofruara; aktualisht njoftimi për përfitimin e paketës shëndetësore bëhet nëpërmjet telefonit, duke e bërë këtë fazë të procesit të vështirë për tu kontrolluar dhe jo transparente; DSHSU nuk ka kryer kontrole në 3 spitale Universitare, si dhe nuk ka kryer kontrole në 6 spitale jo publike me të cilat ka lidhur kontratë;

Nuk janë kryer kontrole në subjektet farmaceutike me rimbursimin më të lartë sipas rajoneve specifike në disa raste dhe nuk janë kryer kontrole në të gjitha subjektet farmaceutike me rimbursim mesatar mujor mbi 2 milion lekë, si dhe nuk është tërhequr dokumentacioni gjatë ushtrimit të kontrollit;

Nuk është respektuar taveri i rimbursimeve i përcaktuar në ligjin e buxhetit, të ndryshuar, duke e tejkaluar atë me 367 milion lekë, si dhe konstatohet se kanë mbetur pa paguar detyrimet në lidhje me rimbursimin e pranuar për muajt nëntor-dhjetor në total prej 1,027 milion lekë;

Gjatë vitit 2021, nga AKSHI janë zhvilluar për llogari të FSDKSH, 2 procedura prokurimi, të cilat nuk kanë qenë të planifikuara në regjistrin e parashikimeve dhe nuk rezultojnë të deklaruar as në Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve për vitin 2021;

Komisioni Teknik i Listës së Barnave të Rimbursueshme (LBR) ka përfshirë 9 barna, çmimi CIF i të cilave është deklaruar pas datës 31.10.2021, në kundërshtim me pikën 15 të VKM nr.645 datë 01.10.2014 "Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave" të ndryshuar, duke sjellë për pasojë rimbursim gjatë periudhës 01.08.2021-31.12.2021, për katër prej tyre në vlerën totale 56,770 mijë lekë;

Janë kryera pagesa për koncesionin e dializës për shërbime të pakryera në shumën 69,996 mijë lekë, gjithashtu është konstatuar se për 5 qendrat e hemodializës janë kryer 1,447 seanca dialize të faturuara mbi projeksionin e përcaktuar në kontratën koncesionare për ofrimin e shërbimit, me një efekt financiar në shumën 16,211 mijë lekë;

Ka rezultuar përdorim pa efektivitet i fondeve buxhetore në shumën 20,628 mijë lekë, si rezultat i kryerjes së likuidimeve për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna.

Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë², për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2020, për pasqyrat financiare, krahas devijimeve materiale sasiore, kanë rezultuar dhe gabime/parregullsi të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre, mbi bazën e të cilave KLSH ka dhënë opinion të kualifikuar. Për vitin 2020 nuk është kryer inventari fizik, duke ndikuar në paraqitjen jo të saktë dhe të plotë në pozicionin financiar të llogarive të aktiveve në fund të vitit.

² Të dhënat janë përmbledhëse për dy auditime.

Për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, për pasqyrat financiare, rezultoi se për vitin 2021 nuk është kryer inventari fizik duke mos dhënë siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket llogarive të aktiveve, në fund të vitit.

Bazuar në evidenca të mjaftueshme të auditimit mbi çështjet e përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë konstatohet se DRTT nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit me: a) qarkullimin sipas kasës më të madhe se të ardhurat e deklaruara në deklaratat e TFTH-së dhe TVSH-së, b) diferenca pozitiv/negative të pa justifikuar midis qarkullimit të deklaruara në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e tatimit mbi fitimit dhe c) diferenca pozitiv/negative të pajustificuar të qarkullimit të deklaruar të eksporteve/importeve në tatime dhe dogana për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2021, si dhe parregullsi në procedurën e rimbursimit të TVSH-së, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimor, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit të vlerësuara gjithsej në vlerën 102,596,691 mijë lekë, për të cilat i është rekomanduar administratës tatimore ri kontrolli tatimor me qëllim arkëtimin e tyre.

Duhet theksuar se në vlerën e mësipërme përfshihen të ardhurat tatimore të vlerësuara të munguara, kamatëvonesat dhe penalitetet sipas rastit.

Gjithashtu, të ardhurat e munguara të vlerësuara nga auditimi i përkasin mangësive të konstatuara në veprimtarinë e sektorit të kontrollit nga zyra dhe të inspektimeve të kryera gjatë kontrolleve tatimore në vend, një pjesë e të cilave janë dhe para vitit 2018.

Nga auditimi financiar dhe i përputhshmërisë, i ushtruar në **Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër**, për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2020 deri në 30.06.2022, u evidentuan si vijon:

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të kontrollit nga zyra, diferenca të konsiderueshme në qarkullimin e të ardhurave të deklaruara në kasat fiskale me të ardhurat e deklaruara në deklaratat e TFTH-së dhe TVSH-së; në qarkullimin e deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit, të klasifikuara si të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për periudhën objekt auditimi, të cilat sipas përlllogaritjeve paraprake rezultojnë në shumën 754,281 mijë lekë. Diferenca të konsiderueshme në vlerën e importeve dhe eksporteve të deklaruar në tatime dhe të deklaruar në doganë, të klasifikuara si të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, për periudhën objekt auditimi, të cilat sipas përlllogaritjeve paraprake rezultojnë në shumën 355,266 mijë lekë.

Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, ka rezultuar se në disa raste nuk ishin analizuar në përputhje me Ligjin nr. 9920/2008, kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e Programit të Kontrollit, mbi verifikimin e pasqyrave financiare të subjekteve tatimpagues dhe deklarimet e tatimpaguesve, gjë e cila ka sjellë përlllogaritjen paraprake të të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, në shumën 86,410 mijë lekë.

Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të kontrollit, nga 30 dosje kontrolli tatimor të audituara, në 15 prej tyre, nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklarimeve të subjektit, në kundërshtim me

kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e programeve të kontrollit, si dhe Ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, me ndryshime.

Nga auditimi financiar dhe i përputhshmërisë, i ushtruar në **Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan**, për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2020 deri në 30.06.2022, rezultoi se:

Spektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e Tatim Fitimit të Thjeshtuar dhe Tatim Fitimit për tatimpaguesit, nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për 398 tatimpagues, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale duke shkaktuar efekte negative në të ardhurat tatimore të përlllogaritura paraprakisht në vlerën 111,051 mijë lekë detyrim tatimor, nga e cila penalitete në vlerën 55,525 mijë lekë për kundravajtjet në lëshimin e faturave tatimore.

Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, rezultoi se në disa raste nuk ishin analizuar në përputhje me Ligjin nr. 9920/2008, kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e Programit të Kontrollit, mbi verifikimin e pasqyrave financiare të subjekteve tatimpagues dhe deklaratimet e tatimpaguesve, gjë e cila ka sjellë përlllogaritjen paraprake të të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, në shumën 86,809 mijë lekë.

Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të kontrollit, nga 30 dosje kontrolli tatimor të audituara, në 12 prej tyre, nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar plotësisht procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklaratimeve të subjektit, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e programeve të kontrollit, si dhe Ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, me ndryshime.

Nga auditimi në **Degën e Doganës Tiranë**, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, rezultoi se: nuk janë ndjekur metodat e vlerësimit doganor lidhur me mallrat e importuar; është pranuar transaksioni për raste kur vlerat e artikujve kanë qenë nën referencë, edhe pse dokumentacioni bashkëngjitur praktikave doganore nuk justifikonte metodën e përdorur; llogaritja e detyrimeve doganore në disa raste nuk ka qenë e njëjtë për operatorë të ndryshëm për të njëjtin artikull nga e njëjta origjinë, sipas të dhënave të disponueshme; janë konstatuar raste të mospagimit të taksës kombëtare të ambalazhit plastik dhe raste të mos pagesës së taksës kombëtare të akcizës; disa praktika doganore rezultojnë me keq klasifikim të kodit tarifor të artikujve të importuar, me pasojë në shmangien e detyrimeve doganore; moszbatim i kërkesave të ligjit “Për Akcizat në RSH”; janë konstatuar veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi gjatë veprimtarisë doganore të regjimeve ekonomike RPA dhe RLP, me pasojë mos pagesën e detyrimeve doganore efektive dhe shkelje të afateve ri eksportuese dhe autorizuese të shtyrjeve të afateve të veprimtarisë së këtyre aktiviteteve; mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi gjatë procedurave administrative të vendimmarrjes nga ana e Autoritetit Doganor, etj.

Për përmirësimin e situatës janë rekomanduar 7 masa organizative, janë kërkuar 4 masa për shpërblim dëmi për mangësi në vlerësimin doganor, në llogaritjen e koeficienteve të shfrytëzimit, afateve të mbylljes së Regjimit të lejimit të përkohshëm, në procedurat e vendimmarrjes administrative, etj., gjithsej në vlerën prej 503,215 mijë lekë, si dhe është kërkuar të merren masa për evidentimin e detyrimeve (kamatëvonesa) për shumën 454,434 mijë lekë në regjistrin e borxhit.

Në auditimin e **Degës së Doganës Durrës**, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, bazuar në evidenca të mjaftueshme të auditimit mbi çështjet e përputhshmërisë ligjore

në veprimtarinë e kësaj dege, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë. Kjo pasi: janë konstatuar mangësi në procedurat doganore të importit, mos aplikimin e saktë të elementëve të vlerës së mallit për qëllime të vlerësimit doganor; procedura vlerësimi të transportit për qëllime të vlerësimit doganor jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; klasifikime tarifore jo në përputhje me nomenklaturën e mallrave në RSH; deklarime doganore me pasojë mos pagesën e detyrimeve të akcizës; rivlerësime të mallrave të natyrës autovetura jo në përputhje me legjislacionin në fuqi; raste ku për disa subjekte vlerat e artikujve të importuar janë deklaruar dhe trajtuar me transaksion edhe pse dokumentacioni bashkëlidhur nuk i plotëson kushtet për tu trajtuar me transaksion; i njëjti subjekt për të njëjtin artikull të importuar në shumë raste është rivlerësuar artikulli për raste të tjera jo; deklarime të çmimeve të produkteve të gatshme nën çmimin e lëndës së parë, trajtimi i mallrave të përdorur me transaksion nën çmimin e lëndës së parë; veprime jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në lidhje me klasifikimin tarifor të mallrave; nga agjencitë doganore janë keq klasifikuar mallra në kodin tarifor; njohjen e firove të lejuara në procedura të thjeshta të transferimit të mallit mbi përcaktimet e normativave të lejuara sipas legjislacionit në fuqi; janë konstatuar veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi gjatë veprimtarisë doganore të regjimeve ekonomike RPA dhe RLP, me pasojë mos pagesën e detyrimeve doganore efektive dhe shkelje të afateve ri eksportuese dhe autorizuese të shtyrjeve të afateve të veprimtarisë së këtyre aktiviteteve; mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi gjatë procedurave administrative të vendimmarrjes nga ana e Autoritetit Doganor, etj.

Nga auditimi i përputhshmërisë të ushtruar në **“Institutin e Integritit të Ish të Përndjekurve Politikë” (IIPP) dhe në “Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojet e Komunizmit”**, për periudhën veprimtarisë së tij, nga data 01.01.2018 deri në 30.06.2022, rezultoi se:

Në lidhje me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon veprimtarinë e Institutit të Integritit të ish të Përndjekurve Politik ende nuk janë bërë përditësimet përkatëse për varësinë e institucionit, si dhe ende nuk është miratuar rregullorja e re funksionale pas ndryshimit të ligjit në 2014 dhe strukturave të një pas njëshme. Kjo pasi rezulton një institucion në varësi të një ministrie që nuk ekziston më ish MMSR dhe pa një rregullim të detyrave funksionale të punonjësve në përputhje dhe koherencë me ndryshimet e bëra për një hark kohor prej 20 vitesh, nga miratimi i rregullores së fundit, aktualisht në fuqi; Nuk ka një procedurë të përcaktuar në akte administrative për: ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të shpërndarjes së fondeve dhe monitorimit të tyre; veprimtarinë e komisionit të shpërndarje së ndihmave në shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave; veprimtarinë e komisionit të monitorimit, si dhe dokumentacionin justifikues të domosdoshëm mbi të cilën do bazohet monitorimi; Nga auditimi i dosjeve të ndihmës ekonomike dhe atyre me informacion për personat e zhdukur u konstatua se, kërkesat e dorëzuara sipas formateve tip për ndihmë ekonomike dhe për informacion mbi familjarët, bazuar në të cilat nisin procedurat respektive administrative në institucion, nuk janë protokolluar dhe regjistruar nga zyra e protokoll-arkivës, duke cenuar plotësinë e evidencës dhe gjurmën e auditimit; Ka rezultuar përdorim pa efektivitet i fondeve buxhetore në shumën 4,312 mijë lekë, për periudhën 2018-2020, si rezultat i kryerjes së likuidimeve për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna.

Nga auditimi i përputhshmërisë të ushtruar në **“Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit” (AMLF)**, për periudhën veprimtarisë së tij, nga data 01.01.2017 deri në 31.12.2021, rezultoi se:

Ristrukturimi i AMLF shpallur me VKM Nr.598, datë 09.10.2018 “Për pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit”, ka mbetur në proces i pa përfunduar dhe në tejkalim të afateve ligjore, si rezultat i mos veprimit nga Komisioni i Ristrukturimit; Rregullorja e brendshme e AMLF-së nuk është përditësuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.155/2015 me ndryshime, duke filluar me emërtimin e institucionit dhe emërtimin e drejtorive sipas strukturës organike të miratuar me Urdhrin nr. 61, datë 07.05.2020 të Kryeministrit; Procesi i rakordimit me organet tatimore në lidhje me detyrimet tatimore është një proces formal dhe i paplotë, kryesisht përcjellje e njëanshme e informacionit, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 57 të Ligjit 155/2015 i ndryshuar; Për periudhën 2017-2021 nuk rezultojnë të jetë ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar; Mjetet e konfiskuara të cilat janë gjendje në magazinë deri me datë 31.12.2021 në sasinë 10709 (njësi) nuk janë asgjësuar për shkak të vakumit ligjor, duke sjellë kosto financiare për institucionin, në lidhje me ruajtjen dhe administrimin e tyre pasi është marrë ambient me qira mujore, etj.

Nga auditimi financiar dhe i përputhshmërisë, i ushtruar në “**Agrokredit**” SHA, për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2019 deri në 31.10.2021, rezultoi se:

Për vitin 2020, nuk është bërë një përlllogaritje e saktë e shumave të zhvlerësimit të huave për klientët gjë e cila është reflektuar në zërin “aktive të tjera financiare afatgjatë”; kolateralet janë evidentuar sipas vlerës së tyre në datën e marrjes në ri posedim, duke mos u paraqitur me vlerën e drejtë si dhe nuk është bërë një rivlerësim i aktiveve të mbajtura për shitje për të përcaktuar vlerën e tyre të drejtë.

Portofoli i huave nuk paraqet gjendjen reale të ditëve me vonesë pasi, në fund të çdo muaji nga strukturat e Shoqërisë janë kryer ndërhyrje në mënyrë manuale për klasifikimin e klientëve, veprime të cilat paraqesin risk në ndryshimin e të dhënave dhe besueshmërinë e tyre.

Nuk ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm, nuk ka njohuri mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, konkretisht: nuk janë zbatuar procedurat e përcaktuara në Manualin e Administrimit të Kredisë dhe të Politikave të Kredisë dhe Rrezikut gjë e cila ka sjellë rritjen e kredive të klasifikuara “me probleme” ose “të humbura”. Sistemi informatik i menaxhimit të portofolit të huave nuk tregon gjendjen reale të ditëve me vonesë për klientët, ndërkohë që në fund të çdo muaji kryhen rregullime manuale nga stafi i shoqërisë për klasifikimin e klientëve, fakt ky që rrit mundësinë e gabimeve njerëzore dhe vlerësohet me risk të lartë. Për këtë arsye nuk është e mundur arritja e sigurisë mbi klasifikimin e klientëve/kredive dhe gjithashtu portofolit.

Llogaritja e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë është e gabuar nga Agrokredit SHA duke sjellë një diferencë të mbajtur më pak në fondin rezervë nga norma e lejuar për tre vitet 2019-2021.

Gjithashtu, janë kryer shpenzime për vendime gjyqësore për punonjës të larguar në shumën 7,383 mijë lekë, të cilat përbëjnë përdorim pa efikasitet dhe efektivitet të fondeve të shoqërisë, pasi janë rezultat i vendimmarrjes jo të drejtë për largimin e tyre nga puna.

2.3.2 DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE:

Gjatë vitit 2022, u kryen **22 auditime gjithsej**, të cilat të analizuar sipas fushave përfshijnë: sistemin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare 2 auditime; sistemin e infrastrukturës dhe energjisë 4 auditime; sistemin e shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale 4 auditime; sistemin e kulturës 2 auditime; sistemin

e drejtësisë 3 auditime; sistemin e arsimit 2 auditime; sistemin e bujqësisë dhe zhvillimit rural 1 auditim, dhe fusha të tjera: 2 auditime.

Sipas tipologjive dhe llojeve të auditimeve, 22 auditimet e kryera gjatë vitit, përbëhen nga:

- ✓ 6 auditime të përputhshmërisë
- ✓ 12 auditime të kombinuara (financiare e të përputhshmërisë)
- ✓ 2 auditime tematik,
- ✓ 2 auditime të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna (follow up).

Në institucionet e audituara, gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, nga auditimet e Departamentit janë adresuar gjithsej **535 rekomandime**, nga të cilat: 13 masa janë përmirësime ligjore, 394 rekomandime organizative, 45 masa disiplinore dhe 2 masa administrative, 42 masa shpërblim dëmi, 39 masa për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, të konstatuara në fushat si vijon:

Mbi Saktësinë dhe vërtetësinë e pasqyrave financiare, rezultoi se:

Në institucionin *Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)*, u evidentua paraqitje jo e drejtë e gjendjes financiare të institucionit sa i takon vlerës neto të aktiveve për shkak të kapitalizimit jo të saktë të vlerave të studim projekteve apo të klasifikimeve kontabël jo në përputhje me planin kontabël publik; si dhe njohja e detyrimeve në momentin që ato likuidohen dhe jo në momentin e konstatimit.

Në *Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)* ka një pasqyrim jo të drejtë të llogarive të vlerës neto të aktiveve për shkak të: mungesës së kapitalizimit të vlerave të investimeve si shtesë pas përfundimit të ciklit të ndërtimit/ rikonstruksionit; nuk janë kontabilizuar aktivet pas vlerësimit si jashtë përdorimi; nuk pasqyrohet rritja e aktiveve; klasifikime kontabël jo në përputhje me planin kontabël publik, duke mos lejuar evidentimin e saktë të vlerës neto të aktiveve që disponon institucioni.

Në *Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë, “Zyber Hallulli”* Tiranë u evidentua mungesë e regjistrit të aktiveve dhe keq klasifikim i aktiveve në llogaritë ekonomike që në momentin e blerjes së tyre.

Në *Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore*: Pasqyrim jo i plotë i llogarisë “Toka troje terren”; likuidim të faturave duke tejkaluar afatin e parashikuar ligjor 30 ditor; etj.

Në institucionin *Ministria e Kulturës (MK)*: Pasqyrim jo i plotë dhe i drejtë në pasqyrat financiare të vitit 2020, të llogarisë “Toka troje terren”, si dhe “Ndërtime e konstruksione”, duke mos pasqyruar truallin që sipas VKM nr.665, datë 27.08.2020, i ka kaluar në administrim të MK, me një sipërfaqe prej 2.488 m² si dhe 4 objekteve “Grup Depo Ish-reparti ushtarak nr.5001”, me vendodhje në Brar.

Në institucionin *Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MAS)*: (i) Shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara si dhe janë krijuar detyrime të prapambetura për periudhën shtator 2020-shtator 2021, në vlerën 11.5 milion lekë për largime të padrejta nga puna; (ii) mos kontabilizim i saktë i zërave në pasqyrat financiare duke fryrë vlerën e aktiveve; (iii) Dëm ekonomik në buxhetin e shtetit si rezultat i mos mbajtjes së tatimit mbi të ardhurat si dhe për përfitimin dy herë të dëmshpërblimit për personat gjyqëfitues që kanë qenë të punësuar paralelisht me kohë të plotë.

Në *Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*, u evidentua pasaktësi në kontabilizim të llogarive: “Toka troje terren”, e cila është kontabilizuar në mënyrë të padrejtë në vlerën 0 lekë; “Personeli, paradhënie,

deficiti, gjoba” për gjobat që vijnë si rezultat i mos zbatimit të kushteve të kontratës për dhënie me qera të tokave bujqësore lidhur midis përfituesit dhe MBZHR; si dhe pasaktësi në llogarinë “*Debitore të ndryshëm*”, për klasifikimin e tyre me qëllim ndjekjen e të gjitha hapave ligjore për arkëtim; Për vitin 2020 ende nuk ishin finalizuar procedurat e inventarizimit, duke mos proceduar me procesin e asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër.

Në *Kuvendin e Shqipërisë* u evidentua: Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave; gjendje të lartë të mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm.

Në *Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, (DSHQ) Tiranë*, u evidentua se: (i) institucioni ka të drejta dhe detyrime të mbartura që nga viti 2005-2016 për të cilat nuk janë krijuar provizione. Në pasqyrën e pozicionit financiar të DSHQ trashëgohet në vite një provizion, i lidhur me kërkesat e arkëtueshme në vlerën 29,400,000 lekë, baza metodologjike për llogaritjen e te cilit nuk është e qartë. Kjo shumë mund të përdoret nga DSHQ për të mbuluar disa nga kërkesat e arkëtueshme afatgjata pa shpresë arkëtimi, pasi të jenë kryer më parë të gjitha procedurat e duhura ligjore; (ii) Nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve, ndonëse në raportin përfundimtar të komisionit të inventarizimit janë evidentuar aktive të cilat konsiderohen si jashtë përdorimit për shkak të ndryshimit të teknologjisë, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011. etj.

Në *Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)*, u evidentua se: institucioni ka të drejta dhe detyrime të mbartura që nga viti 2005-2016 dhe se Aktivet Afatgjata Materiale të shoqërisë për nënkategorinë toka dhe ndërtesa rezultuan me pasaktësi në kontabilizimin e vlerave të tyre.

Mbi procesin e programimit dhe zbatimit të buxhetit rezultoi se:

Në *Ministrinë e Mbrojtjes*: (i) nuk janë përgatitur dhe dorëzuar kërkesat për programin buxhetor afatmesëm për programin e buxhetit të administruara nga aparati PBA 2020-2021, 2021-2023 (faza e parë); (ii) nuk janë implementuar fazat e PBA-së përmes sistemit AFMIS; (iii) planifikimi i buxhetit ka mospërputhje mes shifrave të përlogaritura për financimin e projekteve sipas viteve; (iv) nuk janë hartuar raportet e monitorimit të buxhetit; (v) Buxhetimi nga Ministria e Mbrojtjes i dy godinave ushtarake nuk ka qenë në funksion të Forcave të Armatosura për të cilin buxheti i shtetit ka investuar, por me VKM i ka kaluar në përdorim të tretëve; (vi) Ministria e Mbrojtjes rezultoi me gjendje të mangët operacionale të helikopterëve të destinuar për emergjencat civile (zjarret), duke krijuar boshllëk në kryerjen e operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë në muajin gusht 2021 (nga 4 helikopterë gjithsej, ka rezultuar gjendje vetëm 1, për shkak të defekteve; si pasojë janë shpenzuar pa efektivitet ekonomik 36,069 mijë lekë për blerjen e shërbimit me dy helikopterë).

Në *DPSHTRR*:(i) Nuk është hartuar programi afatgjatë dhe afatmesëm, ku pritej të paraqiteshin prioritetet dhe objektivat strategjik të institucionit; (ii) Ka munguar analiza e realizimit të investimeve; (iii) Vlera e investimeve të përealizuar në vitet e mëparshme, e mbartur për tu realizuar në vitin 2021, nuk është paraqitur në mënyrë të saktë; etj.

Në *Ministrinë e Kulturës*, rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin e parashikuar ligjor 30 ditor.

Në *Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) Tiranë*: (i) Nuk është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Programit për përgatitjen e PBA-së; Shpenzimet që institucioni planifikon rezultuan më të larta se vetë të ardhurat që priten të arkëtohen nga institucioni, duke riskuar që institucioni të përballet me

vështirësi ekonomiko-financiare gjatë realizimit të objektivave të saj; (ii) Institucioni ndër vite nuk ka një program zhvillimi afatmesëm ku të përcaktohen objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave dhe rrjedhimisht të rezultatit të saj financiar; (iii) Për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve, në pagesat e shoqërive koncesionare për kryerjen e oponencës teknike nga ana e AKBN, nuk është llogaritur dhe paguar TVSH mbi vlerën e tarifës (por është konsideruar e përfshirë brenda saj), etj.

Në *Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH)*: Mungesa e një analize të mirëstrukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore si dhe mungesa e raporteve periodike të monitorimit të buxhetit; Mungesa e formularit standard të hartimit të PBA faza e dytë; një pjesë e projekteve të parashikuara në programin “Programe Zhvillimi” GOA, në programin “Granti Infrastruktura Vendore Rajonale” IVR dhe në programin “100 Fshatrat” paraqiten me përqindje të ulët realizimi, ndërsa pjesa tjetër nuk kanë argumentim justifikues se përse rialokohen fondet gjatë periudhës deri sa bëhen 0 (zero) vlerat në fund të vitit; Rezultoi tejkallim i afatit ligjor sa i takon likuidimit të faturave dhe i raportimit në kohë i detyrimeve të prapambetura; Nuk raportohen në kohë detyrimet detyrimet e reja dhe ato të prapambetura.

Në institucionin rezidencial të përkujdesjes sociale, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, “Zyber Hallulli”, Tiranë: Mungesa e raporteve periodike të monitorimit të buxhetit; si dhe mos miratim i fondeve për investime në qendrën rezidenciale për ndërtimin e shkallëve të emergjencës, e cila rrezikon jetën e fëmijëve në rastet e rënies së zjarrit.

Në *Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)*: nuk është dorëzuar faza e parë e Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm; Kërkesat buxhetore kryhen duke tejkalluar në vlera të ndjeshme parashikimet, dhe duke mos ju referuar viteve paraardhëse; si dhe nuk është vijuar me procedurën e ndjekjes me përmbarues të gjobave të vendosura nga sektori i inspektimit, për 53 subjekte, në vlerën në vlerën 7,180 mijë lekë.

Në *Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve*: shpenzime pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet si rezultat i dëmshpërblimeve për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna në vlerën 139,700 mijë lekë; si dhe sa i përket ndjekjes së Fondit të Ekselencës për studentë të cilët kanë përfunduar studimet e financuara nga fondi i ekselencës dhe kanë detyrimin të kthehen e të punojnë në Shqipëri në vlerën 128,784 mijë lekë.

Në *Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës (DPSHP)*: Përdorim pa efektivitet i fondeve buxhetore, sa i përket shpenzimeve të kryera për pagat e punonjësve të Drejtorisë së Mbikëqyrjes Elektronike në vlerën 14,291 mijë lekë, njësi që nuk ka funksionuar, si pasojë e problematikave të konstatuara në funksionimin e “pajisjes së gjurmimit”.

Mbi Rregullshmërinë e procedurave të prokurimit publik rezultoi se:

Në *Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit*, në 5 procedura, kërkesat e njësisë së prokurimit, në lidhje me stafin, licencat, certifikatat që operatorët ekonomikë ofertues duhet të disponojnë nuk përkojnë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet; Në 4 procedura prokurimi KVO nuk ka bërë verifikimin e plotësimin të specifikimeve teknike nga operatori ekonomik.

Në *Ministrinë e Mbrojtjes*: (i) Për 22 procedura prokurimi, operatorët ekonomikë të sigurimit të jojetës/jetës që operojnë në territorin Shqiptar, kanë përdorur skemën e marrëveshjeve të ndaluara duke rënë dakord që të mos paraqiten secili më vete, por të gjithë së bashku, si bashkim operatorësh, duke përdorur skemën e kryesuesit (përfaqësimit) me rotacion, paraqitur në rrotullim kryesuesin

(përfaqësuesin) jo vetëm në renditje por dhe në përqindjen e pjesëmarrjes në kontratë, dhe duke krijuar një treg të mbyllur të sigurimeve (për sigurimin e jo-jetës/jetës me vlerë 4,751,484 mijë lekë); (ii) për projektin “Ndërtimi i objektit poli funksional dhe infrastrukturës ushtarake, Garnizoni Bërzhitë, Tiranë”, me vlerë 460,738 mijë lekë, nuk është zgjedhur procedura e duhur në përputhje me objektin e prokuruar; (iii) në procedurën e prokurimit “Blerje pajisje për përcaktimin e vendndodhjes së mjeteve të Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë me sistemin global të vendndodhjes/GPS, sensor të matjes së konsumit të karburantit dhe pajisje të tjera në funksion të sistemit” fondi limit është llogaritur në mesataren aritmetike zë për zë për të 6 artikujt (pajisjet) të tre ofertave të kërkuara dhe të ardhura nga operatorët ekonomik, veprim në kundërshtim me Rregulloren e Këshillit të Ministrave nr. 4248 prot., datë 16.10.2008.

Në *DPSHTRR*: (i) Nga autoriteti kontraktor nuk është marrë parasysh ndarja në lote e procedurave, në rastin kur kontrata përbëhet nga punë të ngjashme, por në adresa të ndryshme, gjë që kërkon angazhim të njëkohshëm në dy kantiere; (iii) AK ka vendosur kërkesa, të cilat nuk janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet; (iv) Operatorët ekonomik fitues nuk kanë paraqitur dokumente, të cilat vërtetojnë se plotësojnë kriteret e përcaktuara në DST; (v) Licencat profesionale NZ të punimeve dhe vlera e punimeve, nuk plotësonin kushtin e përcaktuar në DST, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008.

Në *Ministrinë e Infrastrukturës* dhe *Energjistikës*: Kriteret për kualifikim kanë qenë të paargumentuara dhe jo në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratave; Përlllogaritja e gabuar e fondit limit për objektin e kontratës “Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës Porti i Jahteve – Bypass Oriku Dukat (Ura e Shën Elizës)” ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 155,695 mijë lekë me TVSH.

Në *FSHZH*: AK ka vendosur kërkesa, të cilat nuk janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës; Jo të gjithë kriteret e pjesëmarrjes janë argumentuar teknikisht; AK ka përcaktuar si kriter për shpalljen e ofertës fituese, ofertën “ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto”, kriter i cili është i paargumentuar dhe që ka ndikuar në përzgjedhjen e fituesit në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi; Në mënyrë të gabuar, i është ngarkuar një punonjësi të vetëm shqyrtimi i ankesës/ave dhe dhënia e një vendimi; KVO nuk ka bërë verifikimin e plotësimit të specifikimeve teknike nga OE, duke mos vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë.

Në *Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë, “Zyber Hallulli” Tiranë*: (i) Mungesë e njohurive ligjore nga ana e personelit të angazhuar në prokurime publike dhe si pasojë mos ngritjes së strukturave të dedikuara për monitorimin e kontratave; (ii) Nuk parashikohen si detyrime kontraktore për OE-të, kriteret si: lloji i automjeteve me targa, certifikatat ushqimore, kushtet e transportit, etj me qëllim ruajtjen e sigurisë ushqimore; Komisionet në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli” të miratuara në fillim të vitit buxhetor, kanë rrezikuar që, duke mos u informuar në kohë mbi OE-në fitues, si dhe mbi kriteret e veçanta të kontratave, të kenë marrë në dorëzim mallra nga palë të treta, pa verifikuar nëse plotësojnë ose jo kriteret e kërkuara (pasi është e pamundur të kryhet mbikëqyrje, në mungesë të elementëve për tu mbikëqyrur); (iii) Raste kur certifikatat shëndetësore veterinarë, ose raport analizat e kryera nga AKU, janë paraqitur nga persona fizikë ose operatorë ekonomikë të tjerë, të ndryshëm nga ata që kanë qenë pjesë e procedurës tenderuese. (iv) Personat fizikë nuk figurojnë në listëpagesat e OE-së fituese, duke krijuar një situatë të paqartë se mbi ç’ bazë institucioni ka lejuar përfshirjen në

zbatimin e kontratës (pra ofrimin e ushqimeve) të disa personave “të pa përfshirë” më parë në asnjë prej procedurave të ndjekura për prokurimin e mallit në fjalë (Ushqime). Për më tepër që, sipas DST opsioni i nën kontraktimit nuk është i lejuar. Gjithë sa më sipër vë në diskutim cilësinë e ekzekutimit të kontratave të lidhura mbi prokurimet e kryera për “Blerje Ushqimesh”.

Në *Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)*, prokurimi me objekt “Blerje pajisje - Aparatura për analizat e barnave për përdorim njerëzor”, është i pashoqëruar me procesverbalin e argumentimit të nevojave të laboratorit të kontrollit për pajisje të reja si dhe i pa argumentuar në hartimin e specifikimeve teknike.

Në *Ministrinë e Kulturës (MK)*: Për procedurat e konkurimit publik, nuk është parashikuar komisioni dhe mënyra për llogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi; Në llogaritjen e fondit limit nuk ka asnjë preventiv fillestar apo planimetri të objektit dhe se si kanë dalë këto zëra dhe sasitë e secilës prej tyre; janë konstatuar raste kur lidhja e kontratave midis AK dhe OE për punimet e veprave të monumenteve të kulturës është bërë në kushtet e mungesës së lejeve për miratimin e ndërhyrjes nga KKTKM.

Në *Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (MAS)* u evidentuan: (i) diferenca në fondin limit të përlllogaritur nga MAS ndaj çmimit të përcaktuar nga AKSHI për procedurën “Blerje pajisje elektronike dhe elektro shtëpiake për konviktet e studentëve Shkodër, Vlorë dhe Korçë”; (ii) Veprime të parregullta e fiktive lidhur me marrjen në dorëzim të mobiljeve dhe pajisjeve didaktike për laboratorët fizikë-kimi-biologji, në vlerën 8,598 mijë lekë, pasi mallrat e mësipërm nuk gjendeshin në ambientet e institucionit arsimor; (iii) Shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën 46,887 mijë lekë, si rezultat i mospërputhshmërive të konstatuara në kontratat e furnizimit për prokurimet e kryera nga MAS në kuadër të rindërtimit të shkollave nga tërmeti, në 2 procedurat prokurimi: “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e Sistemit Arsimor Parauniversitar” si dhe “Blerje pajisje didaktike për laboratorët fizikë-kimi-biologji”.

Në *Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, Tiranë (DSHQ)*, rezultoi se dosjet e prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit; Procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 12 të ligjit nr. 9643, “Për prokurimin publik” pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët, por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.

Mbi rregullshmërinë e procedurave gjatë zbatimit të punimeve rezultoi se:

Në *Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit*: Në kontratën me objekt “Ndërtim i objekteve të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër”, në librezat e masave dhe në situacionin përfundimtar janë përfshirë volume punimesh të pakryera për 8 zëra punimesh, në shumën 1,459 mijë lekë pa TVSH; Në dy procedura të zbatimit të kontratave, magazinimi i mallrave me fletë-hyrje është bërë më përpara se “Komisioni i pritjes, Kolaudimit të Mallrave.

Në *Ministrinë e Mbrojtjes*, u evidentuan: Diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit), në katër objekte; zëra punimesh të dorëzuar jashtë afateve të përcaktuara në kontratën bazë dhe amendamentin e saj; Kontrata/punimet kanë përfunduar me vonesë; Zëra punimesh të ekzekutuar pas përfundimit të kontratës ose jashtë afateve të saj.

Në *DPSHTRR*: Në zbatimin e punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstrukcion dhe përmirësim i ambienteve të Drejtorisë Rajonale Tiranë” janë kryer punime ndërtimi jo në përputhje me specifikimet teknike për zërin e punimeve: “F.V Dyer të brendshëm e druri importi cilësi e I-rë”, në vlerën 300.8 mijë lekë pa TVSH.

Në FSHZH u evidentua: (i) Mos realizim i punimeve sipas termave të referencës dhe projektit fillestar; Punime të ndërtimit të realizuara jo në përputhje me Specifikimet Teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe kontratat e sipërmarrjes; (ii) Diferenca në volume për zërat e punimeve; (iii) Situacione pjesore progresive të dorëzuara nga OE të pashoqëruara me librezë masash pjesore; (iv) Punime të pakryera në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve; si dhe (v) objekte të papërfunduar brenda afatit të ofruar nga sipërmarrësi, ku nga AK rezultoi se nuk janë llogaritur dhe arkëtuar penalitete ndaj sipërmarrësve të kontraktuar, për vonesat në përfundimin e kontratave të sipërmarrjes së punimeve të ndërtimit.

Në *Ministrinë e Kulturës*, u evidentua mos realizim i punimeve sipas termave të referencës dhe projektit fillestar; Diferenca në volume për zërat e punimeve; si dhe punime të pakryera në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve.

Në *Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës (DPSHP)*, u evidentua tejkalim i afateve në zbatim të kontratës me objekt “Rikonstrukcion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës”, për të cilën penalteti përlllogarit në vlerën prej 9,434, mijë lekë.

Në *Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, (DSHQ) Tiranë*, rezultuan likuidime zërash të pajustificuar në shumën 420 mijë lekë gjatë zbatimit të kontratave “Hidroizolimi i tarracës së Pallatit të Kongreseve” dhe “Suvatim me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseve”

Mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm rezultoi se:

Në institucionin *Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit*: nuk është hartuar gjurma e auditimit; si dhe ka munguar hartimi i urdhrat për ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut apo përcaktimin e koordinatorëve të deleguar në çdo njësi.

Në institucionin *Ministria e Mbrojtjes*: (i) Nuk janë hartuar gjurmët e auditimit për procedurat kryesore; (ii) Mbledhjet e GMS-së, nuk janë dokumentuar (iii) Institucioni nuk ka një kod etike të miratuar dhe nuk janë miratuar procedura për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën, si dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara nëpërmjet ndonjë urdhri apo udhëzimi për këtë qëllim; (iv) Ndryshimet e strukturës nuk janë reflektuar në rregulloren e brendshme të institucionit; (v) Nuk është përditësuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve.

Në *FSHZH*: (i) Kodi i Etikës i hartuar nga NJAB nuk ka miratimin dhe nënshkrimin e Drejtorit Ekzekutiv, datën kur është hartuar, datën e miratimit, dhe si pasojë as miratim të Këshillit Drejtues (KD); (ii) Nuk janë hartuar dokumentet e gjurmës së auditit; (iii) Nga FSHZH nuk janë marrë masa për planifikimin e miratimit të planeve strategjike dhe vjetore në rendin e ditës së mbledhjeve të KD; (iv) Nuk është hartuar Regjistri i Riskut.

Në *Ministrinë e Kulturës*: Punonjësit nuk kanë marrë pjesë në trajnime mbi menaxhimin e riskut; Institucionet e varësisë nuk rezultojnë të kenë gjurmë auditimi të miratuara; Problematika e pozicioneve vakante në stafin e njësisë së auditimit të brendshëm është prezente gjatë të dy viteve të

periudhës nën auditim, ku vihet re se Drejtuesi i njësisë së AB ka ushtruar dhe rolin e përgjegjës të grupit për shkak të mungesës së stafit.

Në *DPSHP*: (i) raportet e Drejtorisë së Inspektimit & Shërbimeve Komunitare, janë paraqitur në tejkallim të afateve dhe me mungesa në dokumentacion shoqërues; (ii) Konkluzionet e grupeve të inspektimit nuk kanë rezultuar në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, duke mos propozuar masa disiplinore konkrete ndaj punonjësve të shërbimit të provës; (iii) Të dhënat e dosjeve aktive fizike për personat në mbikëqyrje, nuk janë në përputhje me dosjet aktive në formatin elektronik; (iv) Janë evidentuar problematika në hedhjen në sistem të të dhënave të dosjeve fizike për personat nën mbikëqyrje përgjatë periudhës 2018-2020, çka e ka bërë jo eficient procesin e digjitalizimit të shërbimit të provës për periudhën në fjalë.

Në *Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*: nuk është përditësuar Rregullorja e Brendshme pas ndryshimeve ligjore në organizimin e institucionit; ende nuk janë finalizuar aktet e miratuara nga KLGJ mbi përshkrimet standarde të punës, kurrikula për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë, si dhe rregullat për treguesit e kritereve që lidhen me kriteret e vlerësimit, burimet dhe procedurën e vlerësimit periodik të punonjësve.

Në *Kuvendin e Shqipërisë*: (i) ka munguar Gjurma e Auditimit për ndjekjen, regjistrimin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për institucionin e Kuvendit të Shqipërisë; (ii) Parregullsi në kryerjen e inventarizimit vjetor të aktiveve afatgjata për periudhën objekt auditimi; (iii) Njësia e Auditimit të Brendshëm e këtij institucioni në strukturë, përgjigjet dhe raporton tek Njësia e Autorizues, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi; (iv) Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë, në disa nene të saj nuk është e harmonizuar me kuadrin ligjor, standardet dhe kërkesat profesionale mbi organizimin dhe funksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm të pavarur dhe eficient në sektorin publik.

Në *Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, (DSHQ) Tiranë*: (i) dosjet e prokurimeve nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit; (ii) struktura e auditit të brendshëm ka funksionuar me 2 auditues (2 specialistë) duke çuar në uljen e numrit të auditimeve gjithashtu në mungesën e sigurimit të kontrollit të cilësisë për raportet e auditimit; (iii) Dosjet personale të nëpunësve kanë mangësi dhe parregullsi në dokumentacion, veprime në kundërshtim me VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”

Në *Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ)*, rezultuan disa vende vakante për mjekë, duke cenuar realizimin e funksioneve dhe objektivave të këtij institucioni

Mbi dhënien me qera të tokës dhe procesi i shpronësimit rezultoi se:

Në *Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*: (i) Rreth 15,896 ha e 5,334 m² sipërfaqe të lira, tokë bujqësore, në administrim të MBZHR, paraqiten me status juridik “të pa regjistruar” pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke rritur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore, nga palë të treta; Ndërsa sipërfaqja prej 3,137 ha rezulton e regjistruar, në momentin kur ka filluar procedura e dhënies me qira të tokës bujqësore nga MBZHR, por nuk rezulton e kontabilizuar; (ii) evidentohet se është llogaritur më pak, çmimi fillestar i qerasë të tokës bujqësore, për pasojë të ardhurat nga qeraja e tokës bujqësore

janë të nënvlerësuara, në vlerën prej 197 mijë lekë; Nga subjektet qiramarrëse nuk janë zbatuar detyrimet kontraktore për mospagesat e qirasë në kohë dhe për mosrealizimin e investimeve të paraqitur sipas plan-investimeve, duke shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën 61,513 mijë lekë; (iii) proces shumë i ngadaltë i monitorimit të kontratave të qerave, pasi: (a) deri në fund të vitit 2019, janë realizuar 8 monitorime nga 40 kontrata në fuqi (ose monitoruar rreth 20 % të kontratave); (b) përgjatë vitit 2020, realizuar 6 monitorime (ose monitoruara rreth 12% të kontratave); si dhe (c) përgjatë 3 mujorit të parë të vitit 2021, nuk është realizuar asnjë monitorim nga 51 kontrata në fuqi.

Në *Ministrinë e infrastrukturës dhe energjitikës* u evidentua se, aktet nënligjore që rregullojnë procesin e shpronësimit publik janë të papërditësuara, përfshirë aktet që përcaktojnë procedurën që duhet ndjekur dhe ato që rregullojnë metodologjinë e vlerësimit të objekteve që shpronësohen; Në asnjë prej proceseve të shpronësimit nuk përcaktohej afati i fillimit e përfundimit të punimeve për të cilat kryhet shpronësimi ose afati i realizimit të qëllimit të shpronësimit.

Mbi sigurinë e shëndetit publik, rezultoi se:

Në *AKBPM*: (i) Shkalla e realizimit të analizave që kryhen për mostrat e marra, rezultoi në nivel shumë të ulët krahasuar me mostrat e grumbulluara, konkretisht: për vitin 2020, kur edhe është shpallur edhe gjendja e jashtëzakonshme për COVID-19, laboratorit i kontrollit nuk ka kryer asnjë analizë mbi barnat krahasuar me vitin 2019, ku janë kryer 73 analiza, si dhe vitin 2021 ku janë kryer 67 analiza; (ii) Sektori i laboratorit nuk ka një program vjetor për numrin e analizave që do të kryejë mbështetur në të dhënat statistikore të viteve të kaluara dhe prognozot e vitit të ardhshëm, në koordinim me sektorët e tjerë brenda *AKBPM*, si dhe mungon një akt nënligjor, ku të përcaktohet numri i mostër-marrjeve të detyrueshme dhe sondazheve, që duhet të analizohen gjatë një viti nga ku kryerja e këtij aktiviteti ka efekte financiare jo vetëm për *AKBPM*, por edhe për subjektet tregtare të cilat për çdo analizë laboratorike, duhet të dorëzojnë mostrat e barit si dhe standardin ose materialin referencë (CRM) vetëm për lëndën aktiv që është përdorur për prodhimin e tij; (iii) Sektori i inspektimit për të tre vitet objekt auditimit nuk ka planifikuar dhe zhvilluar asnjë inspektim të sistemit të sigurisë për pajisjet mjekësore në spitale, laboratore dhe klinika ku janë të instaluar këto pajisje.

Mbi deinstitutionalizimin, rezultoi se, në *Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH)* (i) niveli aktual i implementimit të Planit të Deinstitutionalizimit nuk ka favorizuar zbatimin në një shkallë më të gjerë të tij; Evidentua mungesë koordinimi dhe ndërveprimi midis institucioneve të përfshira në zbatim; (ii) likuidime të padrejta të pagesave për trajnimet e kryera, referuar planit të deinstitutionalizimit, nga dy bashkitë pilot, Bashkia Vlorë dhe Korçë, në shumën prej 1,779 mijë lekë; (iii) Nisma ARSIS ka përfituar padrejtësisht pagesën prej 650 mijë lekë për draft dokumentet e prodhuara për dy bashkitë pilot, në lidhje me hartimin e buxhetit për planin e deinstitutionalizimit; si dhe (iv) ka përfituar padrejtësisht pagesën prej 410 mijë lekë për shërbime të kryera për punë të pa dokumentuar dhe pa detyrime juridike për Bashkinë Korçë.

Mbi shfrytëzimin e burimeve natyrore, në lidhje me:

Miratimin e ndërtimeve të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni (fotovoltaike/ eolike/ hidrike), në *MIE* rezultoi se: Komisionet e Vlerësimit të Aplikimeve për miratimin e impianteve fotovoltaike/ eolike nuk kanë kryer një vlerësim të drejtë të aftësive teknike, financiare dhe ekonomike të subjekteve aplikues; Dosjet për miratimin e impianteve fotovoltaike/ eolike përmbanin vetëm dokumentacionin e aplikuesit dhe jo aktet e gjeneruara nga vetë strukturat e *MIE*, si dërgimi i njoftimit për pranimin e aplikimit, raportet e Komisionit të Vlerësimit të

Aplikimeve, dhënia e miratimeve paraprake e përfundimtare, të cilat nuk ishin pjesë e dosjeve, por administroheshin nga Drejtoria përgjegjëse, duke vështirësuar gjurmimin e procesit; Dosjet e procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Hidrocentraleve nën 2 Mw, që nuk janë objekt koncesioni kanë mangësi të theksuara në dokumentacion në të gjithë fazën e aplikimit; MIE ka lidhur 87 kontrata jo koncesionare për HEC nën 2 Më, me prodhim vjetor energji 453,248,902 Kw/h, nga të cilat 57 kontrata të lidhura me prodhim vjetor energji 317,350,850 Kw/h (ose 70% e totalit) nuk kanë hyrë në prodhim; MIE nuk ka paraqitur informacion lidhur me veprimet e saj në drejtim të zbatimit të penaliteteve dhe zgjidhjes së problematikave të evidentuara sipas kontratave përkatëse nga procesi i monitorimit të kryer nga AKBN mbi kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni.

Kontratat e koncesioneve dhe partneritetit publik privat, në MIE rezultoi se: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për disa kontrata të lidhura me shoqëritë koncesionare gjatë realizimit të procedurave konkurruese për dhënien me koncesion për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike hidrike, nuk ka bërë më parë identifikimin e koncesionit të mundshëm të projektit, shoqëruar me analizën e rentabilitetit dhe përshtatshmërisë financiare; Nga 182 kontrata koncesionare të lidhura për HEC, me prodhim vjetor energji 7,564,399,525 Kw/h, nuk kanë hyrë në prodhim 64 prej tyre, me prodhim vjetor energjie 3,759,366,951 Kw/h (ose 50% e totalit); Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP) të kontratës koncesionare "Rehabilitimi, operimi dhe transferimi (ROT) i rrjetit të transportit hekurudhor në linjat Fier-Ballsh dhe Fier - Vlorë" është karakterizuar nga ndryshime të shpeshta, kryesisht në periudhën 2016-2018.

Shfrytëzimin e burimeve minerare, në institucionin Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) Tiranë, rezultoi se: (i) Zbatimi i kriterëve mbi lejet minerare dhe miratimin e planit vjetor për subjektet e licencuar, rezultoi se zotëruesit e lejeve minerare nuk kanë paraqitur për miratim planin vjetor të veprimtarisë (ku të specifikohet sasia e prodhimit, shitjeve, vlera e investimeve, vlerat e garancive, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit);

(ii) Nuk janë hartuar dhe dërguar në strukturën shtetërore përgjegjëse, informacionet tremujore dhe vjetore me treguesit mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare dhe planin vjetor të punës, në kundërshtim me kërkesat e pikës b dhe c, të nenit 25 të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

(iii) Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive dhe aktivitetit minerar të raportuar nga subjektet e licencuara dhe zbatimi i kërkesave të legjislacionit minerar jo vetëm që nuk është ushtruar i plotë dhe 2 herë në vit, por për shumë subjekte nuk është kryer asnjë kontroll apo inspektime, në shkelje të nenit 43, i ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në RSH", i ndryshuar, dhe neni 16, pikat 6-9 të Statut-Rregullores së AKBN;

(iv) Evidenca vjetore për veprimtarinë e aktivitetit prodhues dhe tregtar të shoqërive që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar, nuk është plotësuar me të gjithë treguesit kryesorë të prodhimit, të shitjes, të ardhurat e realizuara dhe renta e paguar, në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në RSH", i ndryshuar;

(v) AKBN (Drejtoria përkatëse) nuk kanë përfshirë në skemën e inspektimit, monitorimit dhe kontrollit impiantet apo fabrikat e pasurimit të mineraleve, në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në RSH”, i ndryshuar, nenit 1 dhe 2;

(vi) nga ana e subjekteve të licencuar për shfrytëzim mineral, nuk likuidohet garancia financiare vjetore për rehabilitimin mjedisor të zonës së lejuar minerare, ose nuk likuidohet në kohë, në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 741, datë 09.09.2015. Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, duke konstatuar këto vonesa në kryerjen e pagesës së garancisë financiare për rehabilitimin, ka marrë masa duke propozuar revokimin për këto subjekte në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral”, neni nr. 47, pika nr.1, germa “ç”.

Shfrytëzimit të burimeve hidroenergjitike rezultoi se në AKBN:

(i) Grupi i punës për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i VKM nr.822, datë 07.10.2015, ka evidentuar së 35% të kontratave koncesionare janë jashtë afatit, me shkelje, si dhe në procese gjyqësore (92 nga 265) gjë që tregon për nivelin e dobët të monitorimit nga të gjitha institucionet përkatëse, përfshirë dhe AKBN;

(ii) Si rezultat i mos ndryshimit në rritje të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike nga shqyrtimi i oponencës teknike për projektet e zbatimit në kontratat koncesionare për 25 prej tyre, ka sjellë për pasojë mungesën e përfitimit nga *fee koncesionare* (energji elektrike pa pagesë) në vlera të konsiderueshme. Gjithashtu, mungesa e reflektimit të ndryshimit të fuqisë (në kw) së hidrocentraleve në 11 prej tyre, sipas projektit të zbatimit të vlerësuar më të ulët së kontrata nga 7 deri në 60%, rrezikon koncesionarët për penalizim në vlera të konsiderueshme për ulje të fuqisë së instaluar; (iii) Ndryshimi i monitorimit të prodhimit vjetor të energjisë elektrike me VKM nr. 332, datë 6.6.2018, pika 1/a duke e kaluar me mesatare për periudha 5-vjeçare, ka sjellë për pasojë heqjen e monitorimit vjetor të veprimtarisë hidronergjetike, reduktimin funksionit institucional të sektorit përkatës, si dhe shtyrjen në kohë të sanksioneve për këtë qëllim duke i zbutur deri në shuarje e tyre, krahas përfshirë këtu dhe ndryshimin e çmimit të blerjes të energjisë elektrike përgjatë 5 viteve për efekt penaliteti;

(iv) Gjatë monitorimit të kontratave koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve në vitin 2019 deri 2021, Drejtoria përkatëse në AKBN ka evidentuar parregullsi në kundërshtim me kushtet kontraktore, penalitete në vlerën 23,143,439 mijë lekë, për të cilat është njoftuar autoriteti kontraktor MIE për secilën kontratë koncesionare por nuk rezultoi asnjë rast i ekzekutuar, (procesi i aplikimit të penaliteteve është kompetencë e MEI). Gjithashtu, mungesa e shoqërimit të ndryshimit të prodhimit të energjisë elektrike nga oponenca teknike në kontratat koncesionare sjell për pasojë mungesën e përfitimit buxhetor për 15,590 mijë lekë, dhe të dyja së bashku në vlerën 23,159,029 mijë lekë;

(v) Nga monitorimi disa koncesionarë nuk kanë paraqitur dokumentacionin e lejes së ndërtimit, apo leje të tjera, por nga ana e AKBN, nuk është marrë asnjë masë për sensibilizimin e organeve kompetente;

(vi) Nga monitorimi disa koncesionarë kanë ndryshuar kapacitetin e prodhimit, megjithatë nga ana e AKBN nuk janë bërë llogaritjet për pasojat e veprimit në lidhje me sasinë e energjisë dhe të ardhurave që do të mungojnë nga prodhimi më i ulët i energjisë për shtetin (për rastet kur kapaciteti është më i ulët), si dhe problematika që krijohet në deformimin e skemave të miratuara dhe pasojat në funksionim;

(vii) Nisur nga numri i lartë i HEC-eve të miratuara, por të pa filluara, edhe për periudha të gjata të konsiderueshme të cilët konsiderohen pa shpresë realizimi, nuk është shoqëruar me njoftimet përkatëse për ndërprerjen e kontratës, për t'i dhënë mundësinë operatorëve të tjerë për realizimin e mundshëm të këtyre investimeve.

Gjithashtu rezultuan problematika të tjera në:

Procedurat e ndjekura për shpërblimin dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, në MAS³, si: (i) mospërditësimi i Rregullores së brendshme me ndryshimet që ka pësuar struktura organike; (ii) mos përfshirja në grupet e punës, të një specialisti të fushës, për trajtimin e shpërblimeve për sportistët elitar; (iii) Mungesa e bazës së të dhënave tip, ku të jepen dhe përditësohen të dhëna mbi shpërblimin e sportistëve elitar; (iv) si dhe nevojën e rishikimit të Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021, pasi këto akte nuk parashikojnë afate ligjore për ndjekjen e procedurës për shpërblimin e sportistëve elitar si dhe të drejtën e ankimit; (v) Në 4 raste praktikata për dhënien e shpërblimit sportistëve elitar, kanë mungesë dokumentacioni.

Në procedurat e rimbursimit të çmimit të biletës së transportit të mësuesve që udhëtojnë në linjën Librazhd-Gorenjë dhe anasjelltas rezultojnë: (i) Mungesa e raportimit *pranë MAS-it* sipas kërkesave të VKM Nr. 682, datë 29.07.2015; (ii) Mos përputhje në çmimin e biletës së transportit ndërqytetës dhe çmimit të biletave për linjat rrethqytetase të Bashkisë Librazh; etj.

Nga auditimi tematik, institucionet Ministria e Kulturës dhe Cirku i Tiranës, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më datën 30.09.2021 rezultoi se: (i) Nga shqyrtimi i fashikullit të gjyqimit të procesit gjyqësor me palë paditëse Shoqëria “U...” shpk dhe palë e paditur Cirku Kombëtar, rezulton se janë zhvilluar 15 seanca gjyqësore dhe vetëm për 2 prej tyre rezulton ka patur memo informuese, në kundërshtim kjo të përcaktimeve të pikës 3 të nenit 46 të Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës. Gjithashtu rezultoi se, përfaqësuesit e autorizuar kanë munguar në 2 seancat e fundit gjyqësore; (ii) Në asnjë moment nga përfaqësuesi ligjor i Cirkut Kombëtar nuk janë ngritur pretendime në lidhje me mos thirrjen e Avokaturës së Shtetit në këtë proces gjyqësor si subjekt i interesuar, bazuar në përcaktimet e neni nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 5 të Ligjit nr. 10018/2008 “Për avokaturën e shtetit”; (iii) Vendimi nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është protokolluar pranë Cirkut Kombëtar me nr. 26, datë 17.01.2020, bërë i formës së prerë dhe nuk është ankimuar brenda 03.02.2020, nga Cirku Kombëtar, sipas parashikimeve të nenit 443 të Kodit të Procedurës Civile; (iv) Nga auditimi i dosjeve të personelit, rekrutuar/ lëvizjet në kategori të punonjësve në Cirkun Kombëtar nuk konstatohet asnjë dokument provues për zhvillimin e konkursit apo asnjë dokument tjetër mbështetës që të paraqesë specifikat/specialitetet e akrobatit, si p.sh. një relacion shpjegues nga specialistët e fushës. Nuk gjendet asnjë informacion për disiplinat apo numrat që kryejnë akrobatët e rekrutuar gjatë 2020, në

³ auditim përputhshmërie e objekt shpërblimin dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë në zbatim të Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, si dhe çështje që kanë të bëjnë me shpenzimet për rimbursimin e shpenzimeve të transportit të mësuesve në qarkun e Librazhdit në zbatim të VKM Nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” si dhe verifikimin e procedurës së ndjekur nga një institucion arsimor mbi vlerësimin e kualifikimit për vend të lirë pune për periudhën nga 01.01.2021 deri më 30.06.2022.

kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të institucionit “Punonjësit e Cirkut Kombëtar”; Ka munguar fizikisht pjesa e djegies së sistemit të ngrohjes së institucionit në vlerën 957,659 lekë.

Në lidhje me aktivitetin Shërbimin e Provës (në DPSHP), mbi kontrollet e ushtruara në degët rajonale, rezultoi se: Raportet janë paraqitur në tejkalim të afateve dhe ka munguar dokumentacioni bashkëlidhur; Konkluzionet e grupeve të inspektimit nuk janë në raport të drejtë me problematikat e konstatuara, duke mos propozuar masa disiplinore konkrete ndaj punonjësve të shërbimit të provës; Të dhënat e dosjeve aktive fizike për personat në mbikëqyrje, nuk janë në përputhje me dosjet aktive në formatin elektronik; si dhe problematika në hedhjen në sistem të të dhënave të dosjeve fizike për personat nën mbikëqyrje përgjatë periudhës 2018-2020, çka e ka bërë jo eficient procesin e digjitalizimi të shërbimit të provës për periudhën në fjalë.

2.3.3 DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE ASETIVE

Gjatë vitit 2022, nga Departamenti i Vetëqeverisjes Vendore, u realizuan gjithsej **72 auditime**, nga të cilat 34 auditime financiare dhe 35 auditime përputhshmërie dhe financiare, 1 auditim tematik dhe 2 auditime të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna. Në institucionet e audituara, gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, nga auditimet e Departamentit janë adresuar **gjithsej 2,426 rekomandime**, nga të cilat: 1,298 masa organizative, 391 masa disiplinore, 89 masa administrative, 190 masa shpërblim dëmi, 458 masa për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike, të konstatuara në fushat si vijon:

Në lidhje me çështjet të cilat kanë kualifikuar opinionet mbi pasqyrat financiare, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë dhënë gjithsej 60 opinione nga ku: 14 me theksim të çështjes, 39 opinione të modifikuar/kualifikuar dhe 7 opinione të modifikuar/kundërt. Çështjet kryesore të cilat kanë kualifikuar opinionet mbi pasqyrat financiare konsistojnë në: pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë; llogari të pa justifikuara me dokumentet e nevojshëm kontabël, mangësi në rakordimet me Thesarin; mospërgatitja e dokumentacionit për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme.

Kryesisht në shumicën e njësive të vetëqeverisjes vendore, nuk janë përfshirë në inventarizim llogari të ndryshme; nuk ka një regjistër kontabël; mangësi kontabilizimi gjatë vitit, mungesë rakordimi në pasqyrat financiare, llogari që nuk janë të justifikuara me dokumentet e nevojshme kontabël e ligjorë, mangësi rakordimi me thesarin, mungesa e evidentimit në pasqyrat financiare të masave të shpërblimit të dëmit, aktive të paregjistruara në ASHK, nuk është llogaritur amortizim për aktivet mbi bazë të dhënave historike; nuk disponohen dokumente pronësie për objektet e trashëguara nga njësitë vendore që u shkrinë me reformën territoriale; mungesa të inventarit fizik dhe të regjistrit të aktiveve etj.

Në lidhje me vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e vetëqeverisjes vendore rezultoi se, përgjithësisht kanë funksionuar aspekte të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm por akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte si dhe nuk janë kryer disa procedura në lidhje me të 5 të komponentët si:

(i) Për “Mjedisin e Kontrollit”: Mungesa e procedurave të sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive; mungesa e programeve të trajnimit për integritetin dhe sjelljen; mungesa e raporteve periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm; etj.; (ii) Për “ Menaxhimin e Riskut” janë konstatuar mangësi në hartimin e regjistrave të risku në nivel bashkie, ku të identifikohen dhe të bëhet vlerësimi i risqeve për të gjitha drejtoritë si dhe një plan-

menaxhimi i risqeve si dhe mungojnë plan-veprimet vjetore operacionale të miratuara, për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesëm. (iii) Për “Aktivitetet e kontrollit” nuk ka plane investimesh për programet e Teknologjisë së Informacionit (TI), nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve si dhe nuk ka një plan menaxhimi të riskut të TI për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish; (iv) Për “Informimin dhe komunikimin”: Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave; (v) Për “Monitorimin”: Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti; Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur.

Në lidhje me funksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm: Në 7 subjekte nuk ka strukturë funksionale për kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm; Në 9 subjekte specialistët e Njësisë së Auditit të Brendshëm nuk janë të gjithë të kualifikuar/certifikuar/trajnuar sipas përcaktimeve të ligjit; Në dosjet e auditimit ka mungesa të dokumenteve që vërtetojnë kryerjen e të gjitha fazave të auditimit që nga planifikimi i angazhimit për auditim dhe deri në vlerësimin e cilësisë së auditimit në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Auditit të Brendshëm, rezultuar në 6 subjekte; Nuk janë ndërmarrë angazhime auditimi në fusha me risk të lartë siç janë prokurimet, aktiviteti i Drejtorisë Financës, Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorisë së të Ardhurave apo Menaxhimi i Aseteve, rezultuar në 14 subjekte; Njësitë e Auditit të Brendshëm funksionojnë jo me numrin e duhur të punonjësve, rezultuar në 9 subjekte; në 7 subjekte nuk është realizuar plani i auditimeve në masën 100%; Nuk është kryer një analizë dhe vlerësim i riskut në hartimin e planit vjetor të auditimit si dhe gjatë realizimit të auditimit nuk janë kryer etapat dhe procedurat e auditimit, rezultuar në 2 subjekte; Nuk janë kryer auditime me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, rezultuar në 3 subjekte.

Në lidhje me procesin e planifikimit, kontabilizimit dhe mbledhjes së të ardhurave: (i) Rezultuan mangësi nga strukturat përkatëse si dhe titullarët e institucioneve për mbledhjen e të ardhurave të cilat janë parashikuar në paketën fiskale dhe buxhetin vjetor, si dhe të ardhura të tjera që vijnë nga qiraja e asetëve të njësive vendore, apo gjoba të aplikuara nga inspektorati i mbrojtjes së territorit; rezultuan mangësi që lidhen kryesisht me mos ndjekjen e procedurave ligjore të përcaktuara në ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për mbledhjen e detyrimeve tatimore, mos zbatimin e detyrimeve kontraktuale për kontratat e qirasë, mos pajisjen me certifikatë/autorizim subjektet të cilat zhvillojnë aktivitet në fushën e shitjes me pakicë të karburanteve dhe nënprodukteve të tyre për konsumatorët fundorë, etj.; (ii) Në të gjitha subjektet e audituara është evidentuar fakti se nga strukturat e administratës së bashkive, për vjeljen e detyrimeve ndaj subjekteve debitorë nuk janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme ligjorë, si; bllokimi i llogarive bankare, vendosja e barrës siguroese në Drejtorinë Rajonale të Transportit (për mjetet), apo ASHK (ish- ZVRPP), mos aplikim të gjobave për mos pagesën në afat, dhe në asnjë nga

bashkitë e audituara, nuk evidentohet të jetë ndërmarrë hapa për “Kallëzim penal” e ndaj tatimpaguesve, pavarësisht faktit se një pjesë e konsiderueshme e subjekteve janë debitorë në vite dhe me aktivitet, të cilëve vetëm ju ngarkohen detyrime pa mundësuar arkëtimin e tyre në vite. Megjithëse nga KLSH-ja në mënyrë permanente në të gjithë auditimet e kryera janë rekomanduar masa për vjeljen e detyrimeve fiskale, në zbatim të dispozitave ligjore.

Në lidhje me programimin buxhetor rezultoi se: Bashkitë kanë vijuar të planifikojnë angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara, nuk bëhet analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021 sipas përcaktimeve ligjore; gjithashtu vijohet të mos analizohen rastet e vendimeve gjyqësore, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore sikundër diktojnë procedurat standarde të zbatimit të buxhetit; rezultuan raste të lidhjes së kontratave pa pasur në dispozicion minimalisht 20% të vlerës së kontratës në vitin e parë të financimit; konstatuam raste të mos likuidimit në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës; mos planifikim i grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura; nuk janë marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta;

Në fushën e prokurimit publik rezultuan të meta dhe mangësi si vijon:

Nuk përcaktohet saktë objekti i prokurimit; janë zhvilluar prokurime vlerësuar më parë nevojë nevojë për mallra, punë apo shërbime dhe në disa raste edhe në mungesë të fondeve në dispozicion; mos depozitim në Degën e Thesarit të urdhër-prokurimeve përpara fillimit të procedurës, veprime të cilat çojnë në kryerjen e procedurave pa fonde dhe rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore; Në Njësitë e hartimit të dokumenteve të tenderit janë përfshirë punonjës me arsim të lartë, por profesionet që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, si në rastin e procedurave për punë civile ku nuk ka inxhinierë të fushës të cilët kanë njohuri mbi objektin e prokurimit; gjithashtu janë aplikuar kritere të cilat nuk përputhen me objektin e prokurimit, duke ndikuar direkt në prezencën e konkurrencës midis OE.

Rezultuan raste ku plotësimi i kriterëve të veçanta për kualifikim bëhet nga njësia e prokurimit në mënyrë të paargumentuar, duke vendosur kërkesa të tilla që favorizojnë operatorë ekonomikë të paracaktuar dhe duke ndikuar në mënyrë indirekte në mos realizimin e objektivit kryesor të prokurimit. Mos përcaktimi i drejtë i këtyre kriterëve ka të bëjë kryesisht në kontratat për punë civile në lidhje me: (i) Përcaktimin e kategorive të licencës dhe klasifikimin e kategorisë; duke vendosur kategori licence më të lartë se volumet e punës, apo kategori që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit. (ii) Përcaktimin e numrit të punonjësve në mënyrë të paargumentuar me volume pune, në shumë raste shumë më të madh seç duhet, ose më të vogël që nuk realizon qëllimin e prokurimit, etj.

(iii) Kërkimi i dokumentacionit të shtuar për vërtetimin e numrit të punonjësve siç është formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore, etj; (iv) Makineri të paargumentuara me volume pune, nyje inertesh apo betoni në pronësi apo me qira, duke mos vendosur kërkesën për realizimin edhe me kontratë furnizimi; (v) Kërkesa për staf drejtues teknik të shtuar që të jenë edhe në listë-pagesa,

kërkesë që kufizon numrin e shoqërive pjesëmarrëse që nuk zotërojnë staf teknik të përhershëm dhe mund ta zotërojnë me kontratë pune të përkohshme; (vi) Në disa autoritete kontraktore është konstatuar si kërkesë e shtuar në kërkesat e veçanta për kualifikim “paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga autoriteti kontraktor, që nuk është debitor në këtë autoritet”, kërkesë kjo e tejkualuar mbi kërkesat e ligjit të prokurimit publik, pasi marrja e këtij vërtetimi sjell dijeninë e operatorëve pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke kompromentuar procedurën dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në konkurrencën e ndershme të procesit të prokurimit etj.; Në disa raste, anëtarët e KVO-së, në vlerësimin e ofertave kanë s`kualifikuar në mënyrë të padrejtë OE me vlerë më të ulët dhe kanë kualifikuar OE me vlerë më të lartë, me pasojë dëm ekonomik, apo paligjshmëri në zbatimin e procedurës së prokurimit; Në rastet e anulimit të procedurave të prokurimit publik, përpara se të fillojë një procedurë e re, nuk analizohen shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës dhe nuk i korrigjojnë ato në mënyrë që të bëjnë të mundur rritjen e konkurrencës.

Në lidhje me problematikat e konstatuara nga zbatimit të kontratave të punimeve dhe mallrave, rezultoi se, nga mos zbatimi i rregullave në fushën e ndërtimit, kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 112,802 mijë lekë, për mangësitë dhe problematikat si vijon: (i) Nga auditimet e kryera rezultojnë disa projekte me mangësi teknike, të hartuara nga zyrat (pa studiuar terrenin) dhe që gjatë zbatimit të punimeve pësojnë ndryshime thelbësore; (ii) Preventivi fillestar, nuk përputhet me volumet e projektit; (iii) Çmimet e preventivit të fondit limit, të cilat nuk janë të parashikuara në manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit, nuk shoqërohen me analiza çmimi, apo i kanë analizat e çmimeve jo sipas Udhëzimit të KM “Mbi klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; -(iv) Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve pa argumente teknike, për shmangien e penaliteteve të parashikuara në kontratë për vonesa në përfundimin e punimeve; (v) Devijimet nga volumet e situacionuara, që zbulohen nga dokumentacioni i administruar në dosjen teknike dhe ballafaqimi i punimeve në terren.

Në lidhje me problematikat e konstatuar në Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, rezultoi se: nuk janë pasqyruar saktë volumet e pasqyruara në projektet e ndërtimit, me qëllim përcaktimin e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe respektimin e kriterëve sipas pasaportës së njësive strukturore; nuk janë respektuar distancat ndërmjet pronave kufitare, pronave nga kufiri i rrugës, si dhe lartësitë e objekteve; Nuk janë shqyrtuar të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit/infrastrukturore, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit; Nuk janë mbajtur akt kontrole me subjektin zhvillues; mbikëqyrësin e punimeve dhe firmën zbatuese të punimeve të ndërtimit në kundërshtim me nenin 27/1 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar si dhe nenin 51 107 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”.

2.3.3.a AUDITIMET NË INSTITUCIONET E ASETËVE DHE PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në institucionet e pasurive të paluajtshme u realizuan gjithsej **8 auditime përputhshmërie** dhe 2 auditime të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve dhe u adresuan gjithsej **388 rekomandime**, nga të cilat: 1 masë është përmirësim ligjor, 231 masa organizative, 125 masa disiplinore, 31 masa për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, të konstatuara në fushat si vijon:

Në fushën e legalizimeve, rezultuan problematikat që lidhen me:

Cenimin e zonave arkeologjike dhe zonave të mbrojtura: Në DVASHK Durrës dhe Shkodër janë konstatuar raste të legalizimeve të objekteve në zona të rëndësisë së veçantë historike dhe arkeologjike. Konkretisht, në 1 rast nga verifikimi i pozicionimit të objektit rezulton se objekti i legalizuar ndodhet 20m pranë Kullës Veneciane dhe 10m nga muret rrethuese të kalasë së Durrësit, në zonën arkeologjike A të qytetit të Durrësit miratuar me VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”. Ndërsa në DVASHK Shkodër është miratuar objekti “shtesë anësore” me sipërfaqe ndërtimi, ndodhur në distancë 7m nga një banesë, monument kulture i kategorisë së I-rë. Në DVASHK Pogradec është legalizuar një objekt brenda kufirit të zonës së mbrojtur “Peizazh i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit dhe në një rast Brenda kufirit të Zonës me Rëndësi Kombëtare Drilon-Tushemish.

Moszbatimin e kriterëve të parcelës ndërtimore: Në të gjitha DVASHK-të e audituara, është miratuar legalizimi i objekteve informale dhe kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore duke mos respektuar kriterin e 3- fishit të bazës së ndërtimit, veprime që kanë sjellë përfitim të padrejtë nga zotëruesit e lejeve të legalizimit përkatëse, duke përfituar sipërfaqe truall më shumë sesa i akordon kuadri ligjor dhe përmes çmimeve favorizuese. Si pasojë, nuk janë marrë masa që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues.

Moszbatimin e kriterit të distancës nga rrugët dhe kanalet: Në të gjitha DVASHK-të e audituara është konstatuar legalizimi i objekteve pa respektuar distancat nga kanalet duke mos administruar informacion nga institucionet përkatëse në lidhje me llojin dhe kategorinë e kanaleve pranë të cilave janë ndërtuar këto objekte, në zbatim të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 47, pika 1/ç të ligjit nr.24/2017, datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”. Po ashtu, janë kryer legalizime të objekteve në buzë të rrugës kategoria “B”, pa marrë miratimin e institucioneve përkatëse.

Objekte të paqëndrueshme: Kryesisht, në DVASHK Kavajë dhe Rurale 1 janë konstatuar legalizime të objekteve të paqëndrueshme (llamarinë) dhe të pa lidhura pazgjydhshëmrisht me tokën, pra jashtë fushës së kuadrit rregullator, të cilat sjellin si pasojë përfitime të sipërfaqeve truall me çmime favorizuese. Këto raste paraqesin risk të lartë për tjetërsimin e sipërfaqeve arë dhe truall, në zona me rëndësi të veçantë për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe turistike.

Në fushën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, rezultuan problematikat që lidhen me:

Regjistrimin e Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi: Në të gjitha DVASHK e audituara janë konstatuar transaksione e veprime me pasuri të paluajtshme, ku titulli i pronësisë, konkretisht Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi, ka rezultuar fotokopje si dhe është ndryshuar zëri kadastral nga “truall” në arë” në mungesë të dokumentacionit argumentues. Një tjetër problematikë e konstatuar, fenomen ky i shtrirë në të gjitha drejtoritë vendore të ASHK-së ka të bëjë me mos kalimin në pronësi “shtet” të sipërfaqeve që rezultojnë më tepër sesa përcakton Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi.

Regjistrimin e pasurive të përfituara me proces privatizimi. Në DVASHK Kavajë dhe Fier është konstatuar se ka munguar dokumentacioni i privatizimit të aksioneve shtetërore dhe likuidimit të vlerës së aksioneve që kanë kaluar nga shteti tek individët aksionarë (për DVASHK Kavajë). Fenomen tjetër i konstatuar është se janë regjistruar pasuri të llojit “objekt+truall” pa administruar dokumentacionin tekniko-ligjor të privatizimit, si kontratat e noterizuara të blerjes së godinës dhe truallit.

Regjistrimin e vendimeve të kthimit dhe kompensimit të pronave (VKKKP). Në DVASHK Fier është konstatuar se është kryer regjistrimi i pasurisë së përfitur me VKKKP, ku në sipërfaqen e njohur dhe kthyer ish-pronarëve rezulton një pasuri e llojit “kanal”, e cila nuk ka kaluar shtet. Po ashtu, është konstatuar regjistrimi i një sipërfaqeje më tepër sesa përcakton vendimi i kthimit dhe kompensimit të pronave. Në DVASHK Shkodër ka rezultuar se është regjistruar një sipërfaqe prej 30, 000 m² pa administruar konfirmimin nga Agjencia e Trajtimit të Pronave se vendimi përkatës është origjinal.

Regjistrimin e lejeve të ndërtimit: Në DVASHK Durrës është konstatuar regjistrimi i pasurive në kundërshtim me vendimin e këshillit të rregullit të territorit. Po ashtu, dokumentacion i lejes së ndërtimit nuk është përcjellë me shkresë nga autoriteti vendor, sipas ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën” dhe ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. Në DVASHK Kavajë është konstatuar regjistrimi i lejes së ndërtimit pa administruar vërtetimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë. Ndërsa në një rast, mungon kontrata e shitjes së truallit midis Këshillit të Rrethit/Bashkisë dhe blerësit.

2.3.4 DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA:

Gjatë vitit 2022, nga Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, u realizuan gjithsej **26 auditime**, nga të cilat 18 janë auditime të realizuara në Shoqëri Aksionare, 6 në projekte me financime të huaja dhe 2 auditime mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimet e mëparshme. Sipas llojeve të auditimit, gjatë vitit 2022, u realizuan 18 auditime përputhshmërie, 1 auditim financiar, 4 auditime të kombinuara, përputhshmërie dhe financiare, 1 auditim performance dhe 2 auditime të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Në nga auditimet e Departamentit gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, janë adresuar gjithsej **807 rekomandime** në institucionet e audituara, nga të cilat: 467 masa janë organizative, 136 masa disiplinore, 35 masa administrative, 74 masa shpërblim dëmi dhe 95 masa për menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.

2.3.4.a NË AUDITIMET NË SHOQËRITË AKSIONARE rezultuan parregullsi si vijon:

Në Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime (UK): (i) Këshilli i Administrimit, në rastet që është mbledhur, përgjithësisht nuk ka analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë; për problematikat e diskutuara nuk janë nxjerrë konkluzione mbi mbarëvajtjen dhe funksionimin e shoqërisë për ta orientuar drejt në zgjidhjen e tyre, nëpërmjet përshtetimit të reformave të sektorit siç parashtrohet në VKM nr.63, 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”;

(ii) Shoqëritë Aksionare UK nuk kanë hartuar apo miratuar ndryshime të programeve ekonomiko-financiare, shoqëruar me relacione shpjegues të faktorëve të paparashikuar, gjë që ka çuar në tejkalim të investimeve dhe të disa zërave të shpenzimeve, krahasuar me programin e miratuar si dhe, mungojnë Programet Ekonomike Afatmesme PBA dhe Programet Ekonomike Afatgjata, mungon plani 5 vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plani i biznesit;

(iii) evidentohen fenomene si emërime, largime, pezullime, dorëheqje, ndryshime pozicioni dhe ndryshime page pa dhënë shpjegimet përkatëse. Numri i punonjësve është i pa miratuar dhe i pa programuar nga Këshilli i Administrimit. Niveli i pagave është diferencial dhe diskriminues, dhe në përgjithësi nuk përkon me nivelin e arsimit përkatës. Struktura është e paqartë dhe e paorganizuar në

kuptimin e drejtorive, specialistëve, punonjësve dhe varësia e punonjësve me eprorët përkatës nuk është e mirë përcaktuar;

(iv) Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilën shoqëritë janë palë, nga dokumentacionet e vënë në dispozicion konstatohet se janë humbur çështje gjyqësore, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore;

(v) evidentohet favorizim i Operatorëve Ekonomikë të cilët nuk përmbushin kriteret e veçanta dhe specifikimet teknike të produkteve të lëvrimin dhe hartim i specifikimeve teknike të mallrave, objekt prokurimi duke mos përshkruar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar. Një informacion më i detajuar në lidhje me këtë kategori subjektsh jepet si më poshtë:

Në auditimin e kryer në UK Vlorë SHA, rezultoi se:

Në procedurat e prokurimeve janë konstatuar kritere të paargumentuara teknikisht dhe ligjërish, dhe që kanë favorizuar operatorë të caktuar ekonomik, favorizim i cili ka rezultuar edhe gjatë fazës së vlerësimit të ofertave si dhe gjatë zbatimit të punimeve; nuk janë vlerësuar drejt sugjerimet e bëra nga ana e APP të cilat kanë qenë të shpeshta në procedurat e prokurimit; Nga filtrimi të të dhënave të nxjerra nga sistemi mbi regjistrimin e abonentëve të rinj me matësit përkatës për vitet 2018-2021, u gjetën problematika si: Abonentë të rinj nuk kishin numër serial matësi; Abonentë të rinj me numër serial "0" dhe Abonentë me numër vule "0"; apo 1048 Abonentë të rinj kanë matës me numër serial të njëjtë (dy ose tre abonentë më një numër serial matësi); si dhe likuidimi i kreditorëve të shoqërisë nuk është kryer sipas një radhe kronologjike të lidhjes së detyrimeve të UKV SHA ndaj tyre situatë e cila ka sjellë kreditorë të mbartur ndër vite dhe të pa likuiduar.

Në auditimin e kryer në UK Shkodër SHA rezultoi:

Ka mangësi në procedurat e prokurimit publik, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 12 milion lekë, përdorim i fondeve publike pa efektivitet në vlerën 9 milion lekë, mangësi në përcaktimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve standarde të tenderit dhe në kualifikimin e ofertave; Nga zbatimi i kontratave të qirave të automjeteve është krijuar një efekt financiar negativ në vlerën 25 milion lekë; Në lidhje me pagesat për shpërblime të anëtarëve të Këshillit të Administrimit si dhe mjekëve të punësuar paralelisht në të njëjtin orar pune me Spitalin Shkodër kanë rezultuar shpenzime me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë në vlerën 2,4 milion lekë; Në të dy impiantet e UK Shkodër nuk kryhet analiza për lëndët e mbetura pezull (TSS) dhe analizat e kryera nuk japin rezultate të besueshme se uji i trajtuar përpara se të derdhet në trupat ujore pritëse plotëson normat standardin e cilësisë e kërkuar; si dhe mangësi në rregulloren e funksionimit të shoqërisë, në emërimet e punonjësve pa plotësuar kriteret e rekrutimit, në përcaktimin e nivelit të pagave, në kushtet e konfliktit të interesit, etj.

Në auditimin e kryer në AKUKIM rezultoi:

Dëm ekonomik në vlerën 23 milion lekë, kryesisht në zbatimin e kontratave të punimeve civile, për punime të pa kryera, mos aplikim penalitetesh, përcaktim të çmimeve të zërave të punimeve në kundërshtim me manualet e çmimeve teknike; Shpenzime pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, me vlerë 155 milion lekë, në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë;

Në një rast është konstatuar se Urdhri për ngritjen e kolaudit të punimeve është ngritur jashtë afateve ligjore, për kontratën me objekt *Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë'* në të cilën, si pasojë e vendimmarrjes së vonuar të Titullarit të AK nuk është bërë e mundur evidentimi në kohë i mangësive në zbatimin e kontratës; Në kontratën me objekt *Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit'*, me vlerë 320 milion lekë me TVSh është konstatuar se nuk është konfirmuar depozitimi i materialeve në vendin e miratuar sipas lejes së dhënë nga autoriteti përkatës (Bashkia Elbasan) pasi nga ana e OE nuk janë kryer pagesat përkatëse për tarifën e depozitimit në masën prej 880 lekë/m³, duke rekomanduar konfiskimin e garancisë financiare në masën 4 % të preventivit, ose shumës prej afro 13 milion lekë.

Mbi auditimet e kryera në OST & KESH: (i) Në përgatitjen e Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), në kërkesat për kualifikim janë kërkuar në mënyrë të pa argumentuar me natyrën dhe volumet e punës disponimi i një sërë licencave dhe kriterëve të veçanta duke zhvilluar një gare diskriminuese për Operatorët Ekonomik pjesëmarrës; **(ii)** S'kualifikime të Operatorëve Ekonomikë, megjithëse plotësojnë në thelb dokumentacionin e kërkuar, apo kualifikime të OE, me mangësi në plotësimin e ofertës, në mospërputhje me LPP; **(iii)** Janë konstatuar raste ku projektimi është kryer nga kontraktori përmes një kontrate me çelësa në dorë, ndërkohë që projektimi duhet të prokurohet nga AK, pasi konceptimi kontratë me çelësa në dorë, përbën risk të lartë të devijimeve në uljen e sasive dhe cilësisë në shërbim nga kontraktori dhe me rritjen e mundësisë së përfitimit të kontratave me çmime të larta dhe pa cilësi; **(iv)** Fondet e parashikuara për investime nuk i referohen kontratave të ngjashme; **(v)** Konstatohet një numër i madh vendimesh gjyqësore të ekzekutuar në periudhën objekt auditimi; **(vi)** Nuk është kryer procesi i planifikimit të burimeve njerëzore, për realizimin e një përshtatje efikase e të vazhdueshme, cilësore dhe sasiorë të burimeve njerëzore për të realizuar objektivat e vendosura në fusha të ndryshme të shoqërisë; **(vii)** Janë hequr rregullat për komisionin e zhvillimit të procedurës dhe penalitetet për subjektet të cilat mund të bëjnë shkelje të përsëritura dhe është eliminuar procesi i performancës së tyre në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike që do të zhvillojë KESH Sh.A; **(viii)** Për sa i përket ofertës për tregtimin e energjisë elektrike konstatohet se është kërkuar paraqitja e një çmimi fiks për sasinë në shitje apo blerje, pa u referuar në çmimin orar të bursës. Nga ana e KESH Sh.A nuk ka një studim nëse kërkesa për ofertë duke u referuar në çmimin orar të bursës me përqindjen përkatëse të fitimit me anë të të cilit subjektet do të konkurronin do të ishte më efiçente, pasi për fashën orare të pikut (1800 deri 2100), çmimet janë të ndryshme me fashën orare të ditës përkatëse; **(ix)** Në muajt shkurt-maj, në vend që të rezervohet energji në KEK, pasi çmimi i shitjes në bursa është shumë i ulët, është marrë nga KEK dhe është shitur me çmime të pa favorshme, siç është shitja në kushtet e prurjeve të mëdha, duke dëmtuar interesat e KESH Sh.A. Një informacion më i detajuar në lidhje me këtë kategori subjektësh jepet si më poshtë:

Në auditimin e kryer në KESH SHA rezultoi:

Nga ana e shoqërisë, me atributin e Aksionarit të vetëm të shoqërisë "TEC Vlora" Sh.A, është realizuar mbulimi i shpenzimeve operacionale të "TEC Vlora" me një staf prej 62 punonjës, ku vetëm për periudhën e auditimit, 01.01.2018 – 31.12.2020 vlera e shpenzimit të kryer është llogaritur prej 420,480,516 lekë dhe përbën një efekt negativ financiar për KESH Sh.A.

Reduktimi i kapacitetit energjetik “HEC Vau Dejës” pas ndërtimit dhe vënies në shfrytëzim të “HEC Ashta” (për periudhën Janar 2018 – Dhjetor 2020), ka sjellë të ardhura të munguara ndaj shoqërisë KESH dhe buxhetin e shtetit në vlerën 1,748,160 euro (222,016,320 lekë).

KESH ka kryer pagesa të vendimeve gjyqësore për zgjidhje të kontratave të punësimit, duke mos zbatuar afatet ligjore të njoftimit dhe pa shkaqe të arsyeshme, me pasojë efekt financiar negativ për vlerën 15,770 mijë lekë, nga të cilat 1,459 mijë lekë janë shpenzime përmbartimore.

Punonjësit e KESH dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, kanë përfituar shpërblim, për periudhën e vitit 2018, para daljes së rezultatit financiar të periudhës në masën e një page mujore në vlerën totale prej 62 milion lekë, veprim i cili ka përkeqësuar gjendjen ekonomiko financiare të shoqërisë me efekt financiar negativ për shoqërinë dhe në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Në 11 procedura prokurimi operatori ekonomik (OE) i shpallur fitues nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, procedura të cila duheshin anuluar nga KVO-ja dhe zhvilluar procedurë tjetër me kushte më të favorshme për rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë për të shmangur keq menaxhim të fondeve të prokuruar me vlerë 1.3 miliard lekë, pasi vetëm për periudhën objekt auditimi nga 111 procedura me fond limit 5.4 miliard lekë, janë zhvilluar 41 procedura prokurimi me vetëm një operatorë ekonomik me fond limit 2.2 miliard lekë ose 40.6% e fondit total të prokuruar. Mos llogaritja e saktë e fondit limit në disa procedura prokurimi, ka çuar në keq menaxhim të fondeve të buxhetit të KESH me pasojë dëm ekonomik me vlerë 65 milion lekë.

KESH ka prokuruar për vlerën prej 143 milion lekë shërbimin e sigurimit të shëndetit dhe sigurimi nga aksidentet në punë të punonjësve të institucionit kur në fakt referuar ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, kanë të përfshirë përveç të tjerash, edhe mbulimin me të ardhura për shpenzimet për paaftësinë e përkohshme në punë për shkak të sëmundjes si dhe aksidentet në punë dhe sëmundjeve profesionale. Në kushte të tilla një pjesë e shërbimeve për të cilat është kërkuar mbulim nga kompanitë e sigurimit rezulton se ka qenë shërbim i siguruar për punonjësit, prej të qenit kontribues në sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe si i tillë ky mbulim me sigurim nuk duhet të ishte kërkuar për sa kohë ka qenë shërbim i siguruar falas. Përveç sa sipër VKM nr. 611, datë 17.09.2014 ka miratuar *Planin Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Rajonale për Evropën Juglindore, 2014 – 2020*, pjesë e të cilës ka qenë edhe kryerja e check-up falas për grup moshën 40-65 vjeç, shërbim ky i cili ndër të tjera është prokuruar dhe më pas paguar për operatorin fitues të procedurës së prokurimit. Për rrjedhojë vlera prej 143 milion lekë është konsideruar si përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet i fondeve të KESH.

KESH ka prokuruar shërbimin e hartimit të strategjisë së institucionit për vlerën 83 milion lekë me TVSH, kur në fakt nga Këshilli i Ministrave është miratuar Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030 dhe ky dokument dhe akte të tjera pasuese si nga ana konceptuale edhe praktikisht strategjia është plotësuar me të gjithë elementët e domosdoshëm të saj për tu hartuar, zbatuar, monitoruar, vlerësuar në bazë të indikatorëve të miratuar dhe në rast nevojë rishikimin e tyre gjatë rishikimit të saj çdo 3 vite. Sa sipër, prokurimi dhe akoma më tepër produkti i sjellë nga operatori ekonomik fitues nuk ka qenë gjë tjetër veçse një përsëritje e atyre çka përshkruhen në këtë kuadër ligjor e rregullator dhe si e tillë nuk ka qenë risi apo vlerë e shtuar.

Në zbatimin e kontratave të investimeve, janë evidentuar punime të pa kryera ose ndryshime projektsh të pa miratuara, veprime të cilat kanë çuar në keq menaxhim të fondeve me dëm ekonomik për buxhetin e KESH, për vlerën 36.6 milion lekë.

Mbi Auditimin e Performancës ushtruar në KESH SHA, OST SHA, OSHEE SHA dhe Entin Rregullator të Energjisë

Kriza globale energjetike është shoqëruar me rritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga importi dhe me mungesë të likuiditeteve financiare të shoqërive të sistemit elektroenergjetik shqiptar, duke vështirësuar garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit dhe furnizimin e pandërprerë me energji elektrike. Mos menaxhimi i mirë i kaskadës së Drinit, ka sjell si pasojë rënien e rezervës hidroenergjetike në liqenin e Fierzës dhe rritjen e kërkesës për import të energjisë elektrike, në një periudhë që ka përkuar me çmime shumë të larta të energjisë elektrike në bursë. Strategjitë e ndjekura nga sistemi për diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike, kanë rezultuar deri tani jo eficiente, duke sjellë ekspozimin e përhershëm të sistemit elektroenergjetik kundrejt riskut meteorologjik. Kjo si pasojë, ka sjellë rritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga importi me çmime të larta.

KESH përveç disa nismave fillestare në investime për burime foto volta-ike (PV), është larg realizimit të objektivave strategjike, për diversifikimin e portofolit gjenerues, me energji të rinovueshme.

Një nga sfidat e tjera të sistemit, ngelet niveli i lartë i humbjeve në shpërndarjen e energjisë elektrike, e vlerësuar 21 % për 2021 dhe 20 % në 2022. Niveli i lartë i humbjeve, është pasojë e investimeve të pamjaftueshme në infrastrukturën e sistemit të shpërndarjes dhe mos implementimit të sistemit inteligjent të matjes.

Siguria kibernetike, gjithashtu mbetet një çështje sensitive, në kushtet kur sistemi elektroenergjetik është i klasifikuar, si infrastrukturë kritike e rëndësisë së veçantë për sigurinë kombëtare. Shoqëritë e sektorit elektroenergjetik, nuk janë të certifikuara me standardin ISO 27001, duke mos bërë garantimin e sistemeve të informacionit dhe ruajtjen e të dhënave korporatave.

Krahas masave të marra për përbalimin e krizës së energjisë elektrike, Qeveria Shqiptare duhet të gjejë zgjidhje të qëndrueshme dhe eficiente për vënien në funksion të TEC-it të Vlorës, si dhe fillimin e operimit të bursës shqiptare të energjisë, për ta bërë të plotë modelin e tregut të energjisë.

Në auditimin e kryer në ALBPETROL & AlbGaz SHA rezultoi:

(i) nuk janë hartuar dhe miratuar specifikime ekonomike, teknike objektive që duhet të plotësojnë operatorët pjesëmarrës në procedurën për lidhjen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimet e naftës (kriteret bazë të nevojshme); (ii) Nuk kanë të plotësuar regjistrin e aktiveve që kanë në pronësi apo posedim, sipas kërkesave ligjore që duhet të përmbajë ky regjistër; (iii) evidentohet rritje e vlerave të mallrave stok dhe e mallrave me qarkullim të ngadalshëm; (iv) Lëvizje punonjësish pa kërkesë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për vendet vakante, për të cilat nuk ka procedurë nga institucioni, si: shpallje në faqen zyrtare të shoqërisë, vendosje kriteresh për pozicionet e vendeve të punës etj. Një informacion më i detajuar në lidhje me këtë kategori subjektsh jepet si më poshtë:

Në auditimin e kryer në ALBPETROL SHA, rezultoi:

Në zbatimin e kontratës së ankandit publik për shitjen e naftës bruto, është konstatuar se edhe pas mos realizimit të kontratës nga kontraktori, ALBPETROL nuk ka kërkuar transferimin në llogarinë e vet të vlerës së sigurimit të kontratës nga shoqëria në vlerën 328 milion lekë.

Nga pagesat e kryera me bankë është konstatuar se janë likuiduar 5.7 milion lekë, për të cilën përfitues është grupi i konsulentëve për hartimin e rregullores së brendshme të shoqërisë, kontrata për këtë shpenzim është kryer pa procedurë prokurimi dhe nga ana e grupit të konsulentëve nuk është dorëzuar produkti për të cilin është paguar.

Nga zbatimi i marrëveshjeve hidrokarbure janë krijuar detyrime të kontraktorëve ndaj ALBPETROL, konkretisht për pjesën e PPE dhe ASP, si detyrime financiare të papaguara për shërbimet e ofruara nga shoqëria, korigjimi i koeficientit R nga mos zbritja e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure nga kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure, të cilat kanë sjellë efekte financiare negative në vlerën 8.4 miliard lekë. Janë krijuar detyrime të papaguara nga kontraktorët edhe ato për energji elektrike të papaguar në vlerën 1.2 miliard lekë, vlerë e cila është konsideruar si e ardhur e munguar për buxhetin e shoqërisë. Prej mos pagesave në kohë të detyrimeve për energjinë elektrike, shoqëria ka akumuluar detyrime për kamatëvonesa në vlerën 1.9 miliard lekë, vlerë e cila edhe pse nuk është likuiduar ende, është një detyrim real i cili do të ketë një efekt negativ financiar në buxhetin e shoqërisë në vijim.

Në pasqyrat financiare të vitit 2020, shoqëria nuk ka paraqitur vlerën e kamatëvonesave prej 1.3 miliard lekë për mos pagesën e faturave të energjisë elektrike dhe përveç kësaj është konstatuar se shoqëria në pasqyrat e saj financiare ka në detyrime afatgjata vlerën 2.8 miliard lekë e cila përbën vlerën e dividendit të papaguar në llogarinë e ortakut të vetëm Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Paga e fundit është kryer në vitin 2017, e më pas nuk janë kryer më likuidime. Në po këtë fushë u konstatua mos kryerje e plotë e procesit të inventarizimit, shpenzime në vlerën 315 milion lekë, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e vendime gjyqësore për largime nga puna të punonjësve në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, për shpërblime dietash me vlerë më të madhe se kufijtë e lejuar ligjorë, si dhe persona të punësuar mbi strukturën e aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës, të cilat janë konsideruar si efekt financiar negativ. Janë konstatuar mangësi në procedurat e prokurimit publik, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 4.2 milion lekë, mangësi në përcaktimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve standarde të tenderit dhe në kualifikimin e Operatorëve Ekonomik.

Nga ALBPETROL është kryer reduktimi i pagave të punëmarrësve të shoqërisë për një periudhë të pacaktuar, deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë, duke përfshirë në këtë reduktim vetëm punonjësit e administratës qendrore dhe administratës së qendrave të prodhimit, ndërkohë kur ka rezultuar se janë kryer 235 emërime dhe lëvizje punonjësish të cilat janë bërë pa kërkesë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për vendet vakante dhe pa asnjë dokumentacion për kërkesat apo nevojat e vendeve vakante nga administrata qendrore apo qendrat e prodhimit. Për këta punonjës nuk ka dosje personale të plotësuar, pasi emërimet dhe lëvizjet paralele janë bërë vetëm me vendim apo urdhër të Administratorëve të Shoqërisë.

Për dhënien e tre vendburimeve Amonicë, Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, MEI dhe ALBPETROL nuk kanë hartuar dhe miratuar specifikime ekonomike, teknike e objektive që duhet të plotësojë operatorët pjesëmarrës në procedurë (kriterë bazë të nevojshme), si dhe në mungesë të një rregullore të qartë mbi procedurat e dhënies së marrëveshjeve hidrokarbure, ku të përcaktohen kriteret e domosdoshme ekonomik, teknik e të tjera, që duhet të plotësojnë.

Të drejtat e shfrytëzimit të vendburimeve Ballsh-Hekal i janë marrë ALBPETROL, nga Shoqëria "Anio Oil" Sh.A, nëpërmjet procedurave përmbartimore. Anio Oil Sh.A ka marrë shfrytëzimin e tyre pa dorëzuar sasi të naftës PPE, ndaj Albpetrol SHA, sipas marrëveshjes duke pretenduar se paraardhësi i saj shoqëria Trans Atlantic Albania, ka dorëzuar më tepër rreth 15,418 ton naftë, me vlerë 3.2 milion

USD. Firmosja e Instrumentit të Transferimit nga ALBPETROL te “Anio Oil” Sh.A, është krye në kushtet kur shoqëria nuk dispononte dokumente e dëshmi të arsyeshme për kompetencën teknike dhe financiare, veprim në kundërshtim me pikën b, të nenit nr. 16, të marrëveshjes hidrokarbure.

Mbi Spitalet dhe Qendrat e përkujdesit: (i) Sa i takon magazinave konstatohet se ambientit janë në kushte të papërshtatshme për magazinimin e mallrave dhe ushqimeve dhe nuk plotësojnë parametrat higjieno-sanitarë, etj.; (ii) Furnizimet janë kryer në kundërshtim me kushtet e kontratës pasi mungon njoftimi për furnizimin, mungon njoftimi nga furnizuesi 5 ditë para dorëzimit të mallit si edhe nuk është respektuar grafiku i furnizimit, gjithashtu dhe nuk janë mbajtur raportet mbi cilësinë e ushqimeve, ambalazhit të tyre; (iii) Problematika në inventarizimin e pronave dhe kartelave të pasurisë; dhe (iv) Godina të amortizuara për të cilat nuk rezulton të kenë ndërmarrë asnjë procedurë për kryerjen e aktekspertizës së thelluar të godinës, me qëllim vlerësimin e gjendjes teknike dhe kapacitetin e tyre mbajtës. Një informacion më i detajuar në lidhje me këtë kategori subjektsh jepet si më poshtë:

Në auditimin e kryer në Qendrën e Personave me Aftësi të Kufizuara, Vlorë rezultoi:

Ambienti ku ushtron QZHPAK veprimtarinë, nuk plotëson standardet sipas parashikimeve të VKM 1503/2008 dhe nga verifikimet e gjendjes së magazinave është konstatuar se ambientet janë në kushte të papërshtatshme për magazinimin e mallrave dhe ushqimeve dhe nuk plotësojnë parametrat higjieno-sanitare; QZHPAK, ofron shërbime të kujdesit shoqëror dhe nuk është licencuar për të ushtruar veprimtarinë e saj; Bashkia Vlorë dhe QZHPAK, lejojnë që një pjesë e pronës me sipërfaqe 54 m² të përdoret nga subjekte private, pa lidhur një kontratë qiraje, duke shkaktuar në këtë mënyrë një efekt negativ prej 1 milion lekë; Megjithëse janë ngritur strukturat për zhvillimin e aftësimin të fëmijëve si “logopedi” dhe “fizioterapi”, nuk janë marrë masat për pajisjen e kabineteve me bazën e nevojshme didaktike e materiale; Referuar kontratave të furnizimit të nënshkruara nga palët konstatohet se gjendja e mallrave ushqimore në magazinë nuk ishte kryer referuar kushteve dhe përcaktimeve kontraktuale.

Në auditimin e kryer në Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë rezultoi:

Objektivat e përcaktuara në projektin e Bashkisë Korçë, nuk janë arritur. Nuk është arritur parandalimi i ndarjes së fëmijëve nga prindërit, përfitimi i shërbimeve të specializuara dhe pilotimi i kujdesit alternativ profesional për fëmijët prindërit e të cilëve nuk mund të ushtrorjnë kujdes prindëror për një kohë të caktuar; Struktura e ngritur nga Bashkia Korçë “Për Shërbimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Familjes”, është angazhuar vetëm në parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve dhe jo në deinstitutionalizimin e tyre. Fëmijët e qendrës rezidenciale Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” janë larguar për arsye birësimi dhe për shkak të arritjes së moshës për transferimin në qendra rezidenciale të tjera për fëmijë të moshës nga 6-18 vjeç dhe jo se janë rikthyer në familje biologjike ose pozicionuar në familje kujdestare profesionale; Në Bashkinë Korçë, mungon një listë e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku. Ky fakt, bën të pamundur deinstitutionalizimin e fëmijëve të cilët nuk mund të kthehen në familjet biologjike apo në familje me lidhje gjaku; Nga pushteti vendor dhe qendror nuk janë hartuar ende plane për transformimin e Shtëpisë së Foshnjës Korçë si institucion dhe si shërbimi si dhe nuk është bërë vlerësimi i kapacitetit të stafit; Moratoriumi i vendosur për rastet e reja të fëmijëve që kanë nevojë për institucionalizim krijon një problem të ri ekonomik-social i cili është ai i vështirësisë për ndjekjen e kujdestarisë së fëmijës nga familja biologjike si pasojë e institucionalizimit të këtyre fëmijëve në qytete të tjera të Shqipërisë.

Edhe pse bashkisë Korçë i është transferuar e drejta e pronësisë, nuk rezultojnë të jetë marrë asnjë masë për përgatitjen dhe azhurnimin e formularit të inventarit të pronës (truall dhe ndërtesë).

Mbi auditimin në ARRSH dhe Drejtoritë Rajonale

Ecuria e kontratave të lidhura mes OE dhe AK nuk ka ndjekur parashikimet e bëra në dokumentin *Specifikimet Teknike "Për Shërbimin e Mirëmbajtjes me Performancë të Rrugëve"*, si dhe nuk është realizuar në përputhje me qëllimin e investimit, pasi punimet e rehabilitimit jo në të gjitha rastet janë kryer me fillimin e kontratës të cilat kanë qenë detyrimisht për tu kryer brenda vitit të parë të kontratës, kjo me qëllim sjelljen e rrugëve në kushte të pranueshme e për të vijuar më tej me kryerjen e punimeve/shërbimeve periodike, veprime këto me pasojë përdorimin pa EEE të fondeve në shumën prej të paktën 22 milion lekë pa TVSH; Nga ana e Kontraktorëve nuk janë marrë masat e duhura për sigurimin e të gjithë sinjalistikës horizontale dhe vertikale, parrakëve të sigurisë në pajtueshmëri të plotë me Standardet Rrugore; etj.

Mbi auditimet e kryera në fusha të tjera

Në auditimin e kryer në Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile AKMC rezultoi

Mungon një *Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë* duke vështirësuar kështu vlerësimin e duhur të mbrojtjes nga rreziqet përkatëse si dhe ato parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; Niveli qendror dhe lokal nuk zotëron burimet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/zjarret. Bashkive dhe njësive administrative u mungojnë pajisjet mbrojtëse personale dhe pajisjet e jashtme për shuarjen e zjarreve; Në 90% të bashkive, raportohen 152 zjarrfikëse, nga të cilat 131 në gjendje pune, 8 me defekte të vogla, 3 me defekte të konsiderueshme, 10 jashtë përdorimit dhe 36 të pa targuara (pa dokumentacion). Shumë nga zjarrfikëset në dispozicion janë të vjetruara (disa që datojnë nga vitet gjashtëdhjetë), janë në gjendje të keqe dhe nuk janë të ndërveprueshme. Raporti banorë/zjarrfikës për 2021 rezultoi 2,185, duke e kaluar me 205 banorë për zjarrfikës; Gjendja e mangët operationale e helikopterëve të Forcave të Armatosura të destinuar për emergjencat civile (zjarret), ka krijuar boshllëk në kryerjen e operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna, kjo edhe për faktin se Ministria e Mbrojtjes, nga 4 helikopter gjithsej që ka për emergjencat civile (zjarret), ka në gjendje operationale vetëm një helikopter të gatshëm; AKMC, në ndërhyrjen për fikjen e zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, ka kryer procedurë prokurimi për ofrimin e dy mjeteve ajrore pa kompetencë (tagër ligjor) të deleguar nga Ministri i Mbrojtjes në kushtet kur nuk ka përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit prej 4.7 milion lekë.

2.3.4.b NË AUDITIMET E PROJEKTEVE ME INVESTIME TË HUAJA rezultuan parregullsi si vijon:

(i) Strukturat drejtuese të ARRSH nuk dorëzojnë tek Banka informacion në formatin e kërkuar në marrëveshje; nuk mban libra dhe regjistra të rregullt kontabël për të gjitha transaksionet financiare dhe nuk është kryer asnjë auditim dhe të jetë paraqitur raport nga auditues të pavarur, fenomen ky i konstatuar në Projektin *"Ndërtimi i By-Pass-ëve Fier & Vlorë"* në ARRSH; (ii) Palët e përfshira në implementimin e projektit, ARRSH dhe Konsulentët nuk kanë kryer një vlerësim të objektivave të përcaktuara në marrëveshjet e financimit me qëllim vlerësimin e rezultateve të punës së deritanishme. Objektivat e përcaktuara në marrëveshjen e ratifikuar për projektet e sipërpërmendura nuk janë objektiva konkrete dhe të matshme, fenomene këto të konstatuara në Projektin *"Ndërtimi i By-Pass-ëve Fier & Vlorë"* si dhe Projektin *"Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Plloçe"* në Autoritetin Rrugor Shqiptar,

Projektin Koncesioni ‘Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Marrjen në Pronësi, Shfrytëzimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Projektit të Hidrocentraleve Në Lumin Devoll në Republikën E Shqipërisë’, në MIE si dhe Projektin “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, në FSHZH; (iii) evidentohen raste të likuidimit të punimeve të pakryera në fakt si dhe në disa raste vonesa në likuidimin e TVSH-së, fenomene këto të konstatuara në Projektet “Ndërtimi i By-Pass-eve Fier & Vlorë” si dhe Projektin “Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Pllloçe” në ARRSH si dhe Projektin “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, në FSHZH; (iv) Tejkalime të afateve të zbatimit të projekteve me pasojë rritje e kostove totale të tij, si rrjedhojë e pagesave për shërbime konsulente, staf projekti PMU, etj., fenomene këto të ndodhura në subjektet “Ndërtimi i By-Pass-eve Fier & Vlorë” si dhe Projektin “Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Pllloçe” në ARRSH; (v) Mangësitë në studimet paraprake, projekt-identë apo projekt preventivët shoqërohen me kosto shtesë apo me vonesa të zbatimit të punimeve, kjo në disa raste edhe për shkak të kohës së gjatë nga hartimi i projektit deri në implementimin e tij në të gjitha Projektet e audituara për shkak edhe të ndryshimit të herë pas hershëm të projekt – preventivave të punimeve; (vi) Mungesë transparence për procedurat që lidhen me dëgjesat publike, fenomen ky i ndodhur në Projektin ‘Rikonstruksion i Rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe Ndërtimi i dy By-Pass-Eve’, Projekti ‘Konektiviteti i rrugëve rajonale dhe lokale’; (vii) Problem kyç në vonesat e projekteve strategjike janë edhe vonesat të shkaktuara për shpronësimet, siç janë ato në rastet e konstatuara në subjektet Projekti ‘Ndërtimi i By-Pass-eve Fier & Vlorë’ apo në Projektin ‘Rikonstruksion i Rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe Ndërtimi i dy By-Pass-Eve’, Projekti ‘Konektiviteti i rrugëve rajonale dhe lokale’; (viii) Të ardhura të munguara nga mos respektimi i kushteve kontraktuale me koncesionarët, fenomen ky i ndodhur në rastin e koncesionit ‘Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Marrjen në Pronësi, Shfrytëzimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Projektit të Hidrocentraleve në Lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë’, në MIE, prej përjashtimit të pagesës së tarifës së koncesionit prej 2%, ka sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 5,119,000 Euro deri në gusht 2022; (ix) Në zbatimin e punimeve për Projektin “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, në FSHZH nga auditimi është konstatuar nisja e punimeve pa u mbikëqyrur nga konsulentë kompetentë, sipas kërkesave të projektit, duke u mbikëqyrur përkohësisht nga punonjës të institucionit jo kompetentë, për tu certifikuar më pas nga konsulenti përkatës, kontrata e të cilit është lidhur 10 muaj pas nisjes së zbatimit të punimeve. Një informacion më i detajuar në lidhje me këtë kategori subjektësh jepet si më poshtë:

Mbi auditimin e kryer në FSHZH, Auditim Tematik përputhshmërie” Projekti ‘Konektiviteti i rrugëve Rajonale dhe Lokale, investimi “Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë-Orikum dhe ndërtimi i 2 by-pass-eve’

Dëgjesat publike nuk janë publikuar në regjistrin elektronik për konsultimet si dhe në programin e transparencës; Nuk ka një bazë të dhënash mbi procesin e konsultimit publik.; Takimet e zhvilluara, nuk janë shoqëruar me procesverbale për dokumentimin procesit; Nuk është përcaktuar koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik dhe nuk dokumentohet publikimi i njoftimit të konsultimit publik, marrja e komenteve dhe rekomandimeve; Mungon një projekt përfundimtar i pranuar dhe i miratuar, por vetëm një projekt i cili është në proces ndryshimi dhe ku është evidentuar një gjurmë dhe një listë me prona që preken nga projekti

Mbi auditimin e kryer në Autoritetin Rrugor Shqiptar Projekti “Ndërtimi i rrugës Qukës – Qafë Pllloçe”

Projekti ka tejkaluar afatet e parashikuara për përfundimin e tij pasi duhet të përfundonte në vitin 2018, ndërkohë që deri në fund të muajit dhjetor 2021, nuk është realizuar më shumë se 81% e disbursimeve. Deri në përfundim të fazës së auditimit në terren, kosto e projektit është rritur me mbi 105 milionë USD nga kontratat fillestare, vlerë e cila pritet të rritet deri në përfundim të projektit duke shkuar rreth 255 milionë USD, si pasojë ndër të tjera e rritjes së shërbimeve të konsulencës (për mbikëqyrjen e punimeve) e përlogaritur në vlerën 5.6 milionë USD. Loti 3, për mungesë financimi ka qenë pezulluar, duke shkaktuar vonesë në përfundim për të gjithë projektin, duke rrezikuar arritjen e objektivave dhe rritjen e mëtejshme të kostove, si pasojë e degradimit të punimeve të realizuara; Si pasojë e mosrealizimit të punimeve në afatin e përcaktuar në kontratë, rezultuan *efekte negative* financiare me vlerë 687 mijë USD, *dëm ekonomik* me vlerë 43,380 USD për pagesa të shpenzimeve për mirëmbajtje të mjeteve motorike, si dhe 134,379 USD për volume punimesh të pakryera por të situacionuara dhe likuiduara; Projekt zbatimi për Lotin 2, rezultoi me mangësi të theksuara në aspektin topografik, konstruktiv, gjeoteknik, gjeologjik, etj.; Objektivat e parashikuara, shkurtimi i distancës me qytetin e Korçës apo ulja e kostove për qytetarë, deri në këto momente mbeten objektiva të pamatshme. Ky aks rrugor po ndërtohet në një zonë malore ku lartësia maksimale e një segmenti arrin në 1200 m mbi nivelin e detit, gjë e cila rrit ndjeshëm mundësin e ngricave, dëborës dhe akullit, duke shtuar ndjeshëm dhe kostot e mirëmbajtjes në të ardhmen.

Mbi auditimin e kryer në MIE ‘Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë’

Kushtet e kontratës së koncesionit kanë ndryshuar ndjeshëm gjatë zbatimit të saj duke prekur edhe elementë thelbësorë të cilët kanë shërbyer në përzgjedhjen e fituesit. Këto ndryshime në thelb kanë bërë që risku i realizimit të kontratës të kalojë tek Autoriteti Kontraktor dhe të bjerë ai i vetë koncesionarit, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”. Është konstatuar se edhe pse ndërtimi i HEC-eve është parashikuar të ndërtohen për të rritur sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend, ndryshimet e kontratës por edhe formati fillestar nuk ka përcaktuar qartë dhe me terma të matshëm këtë objektiv. Konkretisht, kontratat ka parashikuar që koncesionari mund ta eksportojë energjinë elektrike pa asnjë kufizim por ky përcaktim ka devijuar objektivin kryesor, që është rritja e kapaciteteve energjetike në vend.

Nga MIE është kryer heqja e detyrimit të pagesës së tarifës së koncesionit për një periudhë 15 vjeçare për vlerën prej 5,119,000 euro, duke mos vlerësuar si duhet pasojat e heqjes së pagesës së tarifës së koncesionit. Në dokumentet standarde të procedurës së zgjedhjes së operatorit fitues ishte parashikuar si kusht për zgjedhjen fitues, Tarifa e Koncesionit jo më e vogël se 2 %. Megjithëse në ofertën fituese kjo tarifë ishte 2 %, në kontratën e fundit përcaktohet mos pagesa e tarifës për 15 vjet, veprime në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”. Përjashtimi i pagesës së tarifës së koncesionit prej 2%, ka sjellë të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit në vlerën 5,119,000 Euro deri në gusht 2022.

Janë konstatuar mangësi në drejtim të plotësimit të kritereve dhe specifikimeve gjatë procedurave të zgjedhjes së operatorit fitues në kontratën përfundimtare. Gjithashtu në terma financiarë nga auditimi janë konstatuar efekte negative në administrimin e fondeve për ndërtimin e strukturës zëvendësuese në Banjë dhe Moglicë si dhe menaxhim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet i tyre në vlerën

5,528,607 euro si dhe janë konstatuar dëme ekonomike në vlerën 1,016,272 euro në rimbursimin e shpenzimeve jo të justifikuara.






2.3.5 DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS:

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i zbatimit të buxhetit është edhe përdorimi me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitetet e fondeve dhe pasurisë publike, shqyrtimin e të cilit KLSH e realizon edhe nëpërmjet auditimeve të performancës. Në objektivat e këtyre auditimeve kanë qenë çështjet që kanë të bëjnë me minimizimin e kostos së burimeve që përdoren në një veprimtari publike, optimizimin e raportit burime-rezultate, si dhe vlerësimin e rezultateve përfundimtare kundrejt objektivave të vendosur, në përputhje me politikat e subjektit të audituar.

Gjatë vitit 2022, në **17 auditime** të kryera në mbi 55 subjekte, për vitin 2022, u konkludua me 379 gjetje, **310 konkluzione** dhe **369 rekomandime**. Mesatarisht për çdo auditim, u realizuan 17 gjetje, 17 konkluzione dhe 20 rekomandime. Nga 369 rekomandimet e dhëna, 35 masa janë përmirësime ligjore, 324 rekomandime organizative, dhe 10 masa për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike, të konstatuara në fushat si vijon:

Referuar Indikatorit të Vetëvlerësimit nr. 8 (SAI⁴ 8) sipas Kuadrit të Vetëvlerësimit, të miratuar nga INTOSAI, Departamenti i Auditimit të Performancës, përgjatë vitit 2022, ka plotësuar kriterin e mbulimit të fushave që dikton ky indikator, duke mbuluar me auditim 6 nga 10 fushat e kërkuara. Temat e auditimeve të Performancës dhe që përfshijnë aspekte me impakt edhe në vitin buxhetor 2021, të grupuara sipas fushave, paraqiten si më poshtë:

Skema nr.1 Auditimet e performancës sipas fushave

	Mjedisi dhe Energjia	1.Incineratori i Tiranës; 2.Menaxhimi i burimeve ujore 3.Efektiviteti i politikave “Tirana e Gjelbër; 4.Efektiviteti i politikave mjedisore në NJVV; 5.Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e lagunave.
	Infrastruktura & Transporti	6.Garantimi i të drejtave në transportin ajror; 7.Efektiviteti i sinjalistikës rrugore; 8.Menaxhimi i terreneve sportive
	Siguria sociale & tregu i punës	9.Menaxhimi i sistemit te informacionit veterinar RUDA 10.Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve/përdorimi i pesticideve; 11.Sistemi arsimor parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara
	Kultura & Arsimi	12.Universitetet Publike gjatë periudhës së pandemisë; 13.Mbrojtja dhe administrimi i Monumenteve të Kulturës
	Zhvillimi ekonomik kombëtar	14.Efektiviteti i programit te integruar per zhvillimin rural - Programi 100 fshatrat
	Reforma të rëndësishme në sektorin publik	15.Objektivat e Zhvillimit te Qëndrueshëm

Në vijim, po paraqesim një përmbledhje të shkurtër të auditimeve sipas fushave, subjektet nën auditim, konteksti auditues dhe mesazhin e auditimit:

4 Self-Assessment Indicator.

MJEDISI & ENERGJIA 5 Auditime

TEMA 1: INCINERATORI I TIRANËS

Subjektet nën auditim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Bashkia Tiranë.

Konteksti auditues

Qëllimi thelbësor i të gjitha rregulloreve mbi mbetjet është mbrojtja e shëndetit të njerëzve dhe e mjedisit nga efektet e dëmshme që shkaktohen nga grumbullimi, transportimi, përpunimi, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve. Direktiva 2008/98/KE (Direktiva Kuadër mbi Mbetjet) parashikon një qasje të re mbi administrimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe duke synuar kufizimin e prodhimit të mbetjeve, si dhe nxitjen e përdorimit të mbetjeve si burim nga riciklimi dhe rikuperimi. Mbetja është një burim i lëndës së parë (dhe jo diçka që duhet shpërbëre sa me lire që të jetë e mundur), kështu që duhet të merren masa për të ripërdorur mbetjet sa më shumë të jetë e mundur.

Për sa i përket riciklimit, SKZHI-II paraqet një objektiv mjedisor që është “55% e masës totale të mbetjeve të ripërdoret apo riciklohet, deri në 2020”. Kjo gjë siguron, gjithashtu, që të mos bëhen investime të panevojshme, por, gjithashtu, edhe kursehet hapësira dhe të shmangen impaktet e panevojshme në mjedis. Në vitin 2017, moment kur nga Ministria e Mjedisit u konkretizua investimi për Incineratorin e tretë në vend, Eurostat e rendit Shqipërinë të tretën në listën e atyre pak vendeve evropiane që përdorin metodën e incenerimit për përpunimin e mbetjeve, pas Gjermanisë dhe Sllovenisë. Ky proces mbulon djegien e mbeturinave ku qëllimi kryesor i djegies është trajtimi termik i mbeturinave në mënyrë që të zvogëlohet vëllimi dhe rrezikshmëria e mbeturinave dhe të merret një produkt inerte. Përfitimi i energjisë përmes incenerimit apo landfillet janë opsionet më pak të preferueshme për mbetjet. Organizata Botërore e Shëndetit vlerëson se gjatë djegies çlirohen dioksina që kanë një sërë efektesh toksikë në trupin e njeriut dhe klasifikohen si kancerogjene. Ato mund të japin efekt edhe tek pjesa hormonale dhe imune në trup.

Për sa më lart, por referuar edhe faktit se Shqipëria është renditur mes vendeve që kanë një nivel të ulët të mbetjeve për frymë në Evropë, lind shqetësimi nëse ky investim është i nevojshëm dhe mund të përballohet në këto kapacitete dhe nëse është i duhuri nga të gjithë hallkat e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve të cituara më lart. Në këtë kuadër theksojmë edhe faktin se gjatë të gjithë procesit të vendimmarrjes lidhur me këtë investim, i gjithë diskutimi ndërmjet palëve të përfshira fokusohet në aspektin financiar dhe pothuajse aspak në aspektin mjedisor dhe efekteve që do të ketë ky investim në mjedis. Po kështu, referuar Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve, objektivat kryesore të saj lidhen me parandalimin, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve, me kushtin primar të ndarjes së tyre në burim. Megjithatë, problemi me menaxhimin e mbetjeve në vendin tonë nuk lidhet me ekzistencën e kuadrit ligjor e rregullator, por me zbatimin e tij, pasi mos zbatimi i këtij kuadri është edhe arsyeja e zhvillimit të këtij auditimi, duke marrë parasysh fenomenin e përsëritur të ngritjes së Incineratorëve në vendin tonë, si zgjidhjen parësore në menaxhimin e mbetjeve, duke anashkaluar çdo përcaktim ligjor, apo dhe hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve.

Pra problemi social që nxiti këtë auditim lidhet me veprimet kontradiktore sa i takon palëve të përfshira në menaxhimin e mbetjeve, duke qenë se vendi ynë ka një legjislacion që synon ripërdorimin dhe riciklimin, por në realitet është duke ndërtuar incineratorë për djegien e tyre, duke mos përfshirë kësaj në skemën reale as ripërdorimin e as riciklimin. Po kështu, problemi social në fjalë lidhet edhe me faktin e mos marrjes në konsideratë gjatë vendimmarrjes për këtë investim, të faktit se vendi ynë ka ende shumë probleme lidhur me ndarjen në burim të mbetjeve, si dhe mangësitë e mëdha në mbledhjen e të dhënave mbi sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe rrjedhimisht të nevojave për trajtimin e tyre.

Mesazhi i auditimit

Drejtimit dhe politikat e Ministrisë së Mjedisit (sot MTM) në lidhje me reduktimin e mbetjeve kanë qenë të pa fokusuara dhe jo në linjë me objektivat strategjike kombëtare dhe evropiane. Procedura e planifikimit të projektit të Incineratorit të Tiranës ka mungesa dhe paqartësi në lidhje me propozimin paraprak të ardhur në ministri nga shoqëria dhe konfirmimin e miratimit paraprak nga ana e Ministrisë së Financave (sot MFE). Mungesa e vendimmarrjes së MFE në cilësinë e vlerësuesit dhe miratuesit paraprakisht të gjithë projektit koncesionar dhe PPP, nga pikëpamja e implikimeve financiare për incineratorin e Tiranës, shpreh në mënyrë të qartë paqëndrueshmërinë dhe ndërmarrjen e angazhimeve publike që rrezikojnë në mënyrë të konsiderueshme përbalueshmërinë dhe efektivitetin e projektit. Mungesa e përgjigjeve zyrtare dhe dakordësisë së institucioneve qendrore, fushë veprimtaria e së cilave lidhet ngushtësisht me objektin e projektit koncesionar, ka devijuar procesin e rregullt të këtij angazhimi duke sjellë mungesë eficiense dhe identifikim të risqeve potenciale, konkretisht ai fiskal dhe financiar lidhur me kostot e shpronësimeve dhe përbalimin e riskut nga çmimi i energjisë elektrike. Mungesa e dakordësisë me shkrim e bashkive të tjera të Qarkut Tiranë përveç Bashkisë Tiranë, provokon në të ardhmen kosto financiare për këto bashki, mos përfshirja e të cilave mbi këtë argument do të sjellë mungesë efektiviteti për realizimin e projektit të Incineratorit të Tiranës. Mos dakordësimi i tarifës prej 29 euro/ton së depozitimit në landfill, ka dyfishuar shpenzimet për Bashkinë Tiranë, të paguara nga MIE si transferues i “Transfertës së Pakushtëzuar”, për zërin e pastrimit të qytetit. Aktualisht çmimi i paguar 29 euro/ton nuk është çmimi real i shërbimit që kryhet, pasi kjo tarifë përfshin edhe incinerimin e mbetjeve procesi i cili nuk është kryer deri më sot. Procedura konkurruese për dhënien e këtij projekti me koncesion nuk është kryer në përputhje me parimet e transparencës dhe përcaktimet ligjore. Janë shkaktuar vonesa të konsiderueshme në afatin e fillimit dhe vijimit të punimeve të projektit, si pasojë e veprimeve dhe mos veprimeve si dhe shmangies nga detyrimet e përcaktuara në kontratë si nga AK ashtu edhe nga Konkensionari.

TEMA 2: MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE

Subjektet nën auditim: Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit.

Konteksti auditues

Uji është thelbësor për zhvillimin ekonomik, shëndetin human dhe mjedisin. Qeveritë kudo në botë janë duke hasur sfida të mëdha në menaxhimin efektiv të burimeve ujore. Problemet janë të llojeve të ndryshme dhe komplekse, krahas aksesit të ujit me cilësi të mirë, konkurrenca për përdorime dhe përdorues të ndryshëm të ujit është duke u rritur kudo në botë. Veç kësaj, kërkojnë investime të mëdha për të mirëmbajtur dhe përmirësuar infrastrukturën e ujit. Uji është një nga substancat më të zakonshme në tokë duke qenë se ai mbulon 71 % të sipërfaqes së Tokës. Uji është burim natyror

strategjik për Shqipërinë. Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore (MIBU) përkufizohet si “një proces që nxit zhvillimin dhe menaxhimin e bashkërenduar të ujit, tokës dhe burimeve përkatëse, për të rritur në maksimum mirëqenien ekonomike dhe sociale, në mënyrë të barabartë dhe pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve jetësore. Shqipëria është e pasur me burime ujore, me tetë lumenj të mëdhenj, tre liqene të lundrueshme ndërkufitare, një numër të madh dhe të çmuar ligatinash si dhe burime nëujore të bollshme. Megjithëse burimet ujore janë shpërndarë në të gjithë vendin, shpërndarja e tyre përgjatë territorit nuk është në mënyrë të njëtrajtshme. Shqipëria konsiderohet si një vend me ujë të bollshëm dhe me burime ujore të rinovueshme që llogariten afërsisht deri në 41.7 km³ /vit, nga të cilat 65% burojnë brenda vendit dhe 30% janë ujëra nëntokësore. Burimet e ujit përbëhen nga ujërat sipërfaqësore (lumenjtë) dhe akuiferët (ujërat nëntokësore).

Në rastin e Shqipërisë, burimet ujore sipërfaqësore brenda vendit rriten nga flukset hyrëse nga vendet fqinje. Ujërat sipërfaqësorë përfshijnë lumenjtë, liqenet, rezervuarët dhe lagunat. Rreth 150 përranj të vegjël formojnë tetë lumenj të mëdhenj në Shqipëri. Këto përfshijnë Bunën (41 km), Drinin (285 km), Matin (115 km), Ishmin (74 km), Erzenin (109 km), Shkumbinin (181 km), Semanin (281 km), dhe Vjosën (272 km), të cilët rrjedhin në drejtim jug-lindje-veri-perëndim në drejtim të detit Adriatik. Lumenjtë kanë një rrjedhë stinore të parregullt të cilat kulmojnë në dimër ose në fillim të vjeshtës. Tre liqene të mëdhenj dhe 247 liqene të vegjël mbulojnë gjithsej 4% të territorit të vendit. Tre liqenet e mëdha (Ohri, Prespa dhe Shkodra) janë ndërkufitare. Liqenet ndikohen nga ndryshime të forta natyrore, dhe nga ndërhyrjet intensive dhe të pakontrolluara të njeriut. Liqeni i Ohrit dhe liqeni i Prespës janë liqenet më të mëdha tektonike në Evropë dhe i përkasin pellgut ujëmbledhës të Drinit, i cili derdhet në detin Adriatik. Sipërfaqja e liqenit të Ohrit është 358km², nga të cilat 249km² i përkasin Maqedonisë dhe 109km² Shqipërisë. Vetë liqeni ka një gjatësi maksimale prej rreth 30km, me thellësi maksimale prej 289m dhe një thellësi mesatare prej 164m.

Cilësia e ujit i referohet karakteristikave kimike, fizike, biologjike dhe radiologjike të ujit. Cilësia përshkruan gjendjen e ujit duke marrë parasysh speciet që gjenden brenda tij dhe/ose çdo nevojë apo qëllim njerëzor. Shumë qeveri (përfshirë dhe ajo shqiptare) kanë vendosur standarde të cilësisë së ujit kundrejt të cilave mund të vlerësohet përputhshmëria. Standardet më të zakonshme të përdorura për të vlerësuar cilësinë e ujit kanë të bëjnë me shëndetin e ekosistemeve, sigurinë e kontaktit me njerëzit dhe ujit të pijshëm. Standardet e cilësisë së ujit shpesh vendosen duke marrë parasysh përdorimin e ujit (konsumin njerëzor, përdorimin industrial) dhe veçmas për ujin e ambientit (lumenj dhe liqene).

Programet kombëtare të monitorimit mjedisor zakonisht mbulojnë monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Në Kapitullin 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”, Progres Raporti i BE-së për Shqipërinë ndalet dhe evidenton disa problematika që lidhen me menaxhimin e ujërave. Edhe pse citohet se Shqipëria ka treguar përmirësime në këtë drejtim, progres i limituar është bërë sa i përket përafrimit të legjislacionit vendas me “acquis” në drejtim të menaxhimit të ujërave. Rekomandimet e Progres Raportit të 2020 kanë ngelur ende në fuqi në Progres Raportin e 2021 ku në veçanti theksohet se Shqipëria duhet të harmonizojë më tej kuadrin ligjor me direktivat e BE-së, të përforcojë dhe të bëjë përpjekje më të mëdha sa i përket përmirësimit të cilësisë së ujërave si dhe të fuqizojë buxhetin në drejtim të agjencive dhe strukturave përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore.

Mesazhi i auditimit

Masat e marra nga institucionet përgjegjëse lidhur me menaxhimin e përdorimit të burimeve ujore kanë qenë pjesërisht efektive dhe eficiente. Edhe pse, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore si një institucion i krijuar në vitin 2018 ka bërë hapa pozitivë në kuadër të përmirësimit të situatës në tërësi, evidentohen mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore, ose akte nënligjore të pa përditësuara dhe që nuk përputhen me Ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i ndryshuar me Ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018. Aktivitetet e parashikuara për arritjen e objektivave strategjike për menaxhimin e ujit, nuk u mbështetën me buxhetet e nevojshme, pasi për periudhën nën auditim u alokuan 60% më pak fonde se ato të nevojshme referuar Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SKMBIU), çka përmban riskun e mos zbatimit me efektivitet të tyre. Për periudhën 2018-2021, nuk janë hartuar Raporte Vjetore të Monitorimit mbi implementimin e SKMBIU dhe planit të parë të veprimit duke mos adresuar shkaqet që kanë cenuar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë, siç është edhe mungesa e fondeve. AMBU nuk ka arritur të maksimizojë mbledhjen e të ardhurave të veta, prej mos aplikimit për leje të subjekteve private dhe publike që aktualisht përdorin burimet ujore, por edhe si pasoje e mos arkëtimit të debitorëve (edhe pse vihet re një përmirësim i situatës për periudhën në auditim krahasuar me periudhën e para vitit 2018). Numri i subjekteve që përdorin burime ujore pa leje për qëllime dhe aktivitete të ndryshme vazhdon të jetë shumë herë më i lartë se ata që janë me leje/autorizim dhe që faturohen/arkëtohen nga AMBU. Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional, veçanërisht sa i përket kontrollit dhe inspektimit të përdoruesve të jashtëligjshëm të burimeve ujore, por dhe mungesa e burimeve njerëzore e logjistike në institucionet përgjegjëse, janë ndër arsyet kryesore të një menaxhimi jo efektiv të burimeve ujore në vend.

TEMA 3: TIRANA E GJELBËR

Subjektet nën auditim: Bashkia Tiranë

Konteksti auditues

Gama e përfitimeve nga hapësirat e gjelbra është e konsiderueshme. Referuar studimeve të ndryshme hapësirat e gjelbra urbane përmbushin një sërë rolesh. Ato shërbejnë si hapësira sociale dhe zona për qëllime rekreative dhe kulturore dhe gjithashtu kanë përfitime ekonomike dhe mjedisore, pasi është vënë re se nëpërmjet shtimit të gjelbërimit urban është ruajtur apo rritur vlera e pronës. Po kështu, ka rezultuar se shkatërrimi mjedisor apo mungesa e hapësirave të gjelbra në lagje apo blloqe banimi, ndikon negativisht në ndjesinë e sigurisë tek banorët, pasi këto zona perceptohen si më të ekspozuara ndaj ngjarjeve kriminale. Nga një studim amerikan ka rezultuar se pas gjelbërimit të zonave të lira urbane, janë reduktuar ndjeshëm rastet e krimeve apo vandalizmave në këto zona dhe gjithashtu është vënë re një rritje e aktivitetit fizik të banorëve. Krahas sa më lart, vlera të tjera që i atribuohen hapësirave të gjelbra janë edhe përfitimet mjedisore dhe shëndetësore në jetën e qytetarëve. Bimësisë i atribuohet shpesh herë efekti i “purifikimit” të ajrit nga ndotësit atmosferikë. Për shembull, hapësirat e gjelbra ndikojnë në reduktimin e nxehtësisë nga temperaturat në zonat urbane, duke ulur kështu kostot e energjisë për ftohjen e ndërtesave, apo në zbutjen e efekteve të përmbytjeve nëpërmjet zvogëlimit të dëmeve nga vërshimi i ujit. Nga këndvështrimi shëndetësor, hapësirat e gjelbra urbane janë hapësira që lejojnë të zhvillohen aktivitete promovuese të shëndetit, si aktiviteti fizik ose pushimi dhe relaksimi. Në këtë mënyrë, ato kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me cilësinë e jetës së banorëve të qytetit. Përfitimet e hapësirave të gjelbra më të mëdha dhe më cilësore përfshijnë përthithjen dhe depozitimin e ujërave të shiut, eliminimin e karbonit, zbutjen e ngrohjes urbane, përmirësimin e cilësisë së ajrit, reduktimin e kërkesës për energji dhe sigurimin e habitateve për përmirësimin e biodiversitetit. Megjithatë, pavarësisht benefiteve nga hapësirat e gjelbra, urbanizimi i vazhdueshëm i qyteteve duket se nuk po i merr parasysh ato. Forma strukturore e qytetit, shpërndarja dhe dendësia e përdorimeve të tokës ndikojnë thellësisht në efikasitetin dhe performancën e përgjithshme të sistemeve infrastrukturore fizike dhe komunitare të qytetit.

Ndërsa Tirana ka gjallërinë e një qyteti të dendur kozmopolit, në periferitë e qytetit gjendet trashëgimia e periudhave të fundit të rritjes së pakontrolluar dhe vendbanimeve joformale. Nëse nuk kontrollohet, rritja e qytetit mund të marrë formën e një shtrirjeje të vazhdueshme urbane, duke shkaktuar rritjen e shpenzimeve të infrastrukturës, zgjatjen e kohës së udhëtimit të përditshëm, shkatërrimin e mjedisit natyror dhe zonave bujqësore prodhuese, si dhe rritjen e përgjithshme të konsumimit të energjisë dhe karburantit për transport. Tirana ende nuk ka politika për uljen e zhvillimeve të pakontrolluara urbane. Megjithatë, bashkia është në proces të ndërmarrjes së veprimeve për të adresuar sfidat e përdorimit të tokës në qytet. Në 25 vitet e fundit, për shkak të migracionit të brendshëm nga zonat rurale në ato urbane, qytetet më të mëdha të Shqipërisë si Tirana, Durrësi, Elbasani, etj., kanë përjetuar një proces urbanizimi të shpejtë dhe të pa kontrolluar. Zhvillimi i qyteteve sot për shkak të urbanizimit i ka krijuar qytetarëve mundësi më të mira për akomodim, infrastrukturë, larmi më të madhe zgjedhjeje apo thënë shkurt, përmirësim të cilësisë së jetës. Megjithatë, ky zhvillim është shoqëruar me ndikime negative në natyrë. Mjedisi po degradon me ritme të shpejta, fakt ky që reflektohet në probleme të tilla si pasiguria e tokës, përkeqësimi i cilësisë së ujit, ndotja e ajrit, zhurmat dhe problemet e depozitimit të mbeturinave, etj. Zhvillimi i pa kontrolluar urban ka shkaktuar ulje të raportit për frymë të hapësirave të gjelbra. Tirana ka një raport të ulët të

hapësirave të hapura të gjelbra për 100,000 banorë, i cili referuar Planit të Veprimit “Qyteti i Gjelbër është 4,6 ha për 100.000 banorë ose 0.46m²/banor. Kjo vlerë është plotësisht e papërfillshme krahasuar me normën minimale të parashikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë prej 9m²/banor dhe po njësoj e papërfillshme krahasuar me vendet e rajonit.

Mesazhi i auditimit

Bashkia Tiranë, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve ndaj qytetarit, lidhur me hapësirat publike, gjelbërimin e qytetit, duhet të synojë në drejtim të rritjes dhe forcimit të masave për shtimin e hapësirave të gjelbra, të reja, në territorin që kjo bashki administron. Politikat e ndjekura në këtë drejtim, sa i takon objektivit 2 të shprehura në Planin e Veprimit “Qyteti i Gjelbër” janë ambicioze por ato duhet të shoqërohen me kapacitete të mjaftueshme financiare dhe logjistike nga ana e bashkisë. Projekti i Pyllit Orbital për mbjelljen e pemëve, për shkak të pamundësive financiare për mbështetje me buxhet, si dhe problematikave që lidhen me mungesën e hapësirave të nevojshme për mbjellje dhe çështjeve të pronësisë rezultoi në një nivel të ulët realizimi, megjithëse ka kaluar një pjesë e konsiderueshme e periudhës së zbatimit të këtij objekti. Objektivat e tjerë të parashikuar në Planin e Veprimit që lidhen me shtimin e hapësirave të gjelbra me gjithë fokusin e Bashkisë Tiranë rezultojnë të realizuara jo në nivelet e pritshme dhe në përgjigje të ritmeve të rritjes së urbanizimit.

TEMA 4: EFEKTIVITETI I POLITIKAVE MJEDISORE NË NJËSITË E VETQEVERISJES VENDORE

Subjektet nën auditim: Bashkia Tiranë; Vlorë; Fier; Lezhë; Shkodër; Pogradec; Korçë.

Konteksti auditues

Mjedisi jetësor është një e mirë e përgjithshme, për tërë njerëzimin dhe botën e gjallë, duke i përfshirë bimët dhe shtazët. Mjedisi jetësor është toka, uji, ajri, në të gjithë pjesët e botës, është *res communis omnium*, pra është e imja, e jotja, edhe e atyre që do të vinë pas nesh, është *jus divinum*, kemi të drejtë ta shfrytëzojmë deri në atë pikë sa të mos shkelim të drejtat e tij, kemi obligim që ta mbrojmë dhe bartim përgjegjësi nëse e dëmtojmë. Zhvillimi i vrullshëm ekonomik i botës e civilizimi i saj, krahas progresit të madh që kanë sjellë në jetën sociale e ekonomike, në të njëjtën kohë ka ndikuar edhe në ndotjen e mjedisit ku ne jetojmë. Sot, mjedisi në vendin tonë paraqitet shumë i ndotur me produkte e mbeturina të shumëllojshme, ndër to vendin kryesor e zënë mbetjet urbane, kimike, emetimi i gazrave në hapësirë dhe industrive të ndryshme që operojnë, zhurmat dhe kaosi përbëjnë një ndotës tjetër që ndikon dukshëm në gjendjen emocionale dhe psikologjike duke dëmtuar ndjeshëm cilësinë e jetës. Veprimet e njeriut, ndonëse kanë qëllime primare zhvillimin dhe përparimin, shpesh herë paraqesin edhe burime ndotëse. Të tilla janë: teknologjia e shpejtë dhe e përparuar, shtimi i madh i popullsisë, industrializimi, shtimi i gazit karbonik (CO₂) dhe i gazrave të tjera “serë” në atmosferë, prerja e pyjeve, ndotësit e ndryshëm të rinj që përdoren gjatë kultivimit të tokës dhe detit, etj., paraqesin kërcënim serioz për sistemin klimatik dhe të ekosistemit. Me ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit, dëmtohen e gradualisht shkatërrohen ekosistemet dhe habitatet natyrore të kafshëve dhe bimëve. Diskutimi në lidhje me mbrojtjen e mjedisit përveçse detyrim i çdokujt, përqendrohet fort në rolin e qeverisë, legjislativitetit dhe zbatimit të ligjit. Vendimet që ndikojnë në mjedis do të përfshijnë në mënyrë ideale një gamë të gjerë të palëve të interesuara, përfshirë industrinë, grupet indigjene, grupet e mjedisit dhe përfaqësuesit e komunitetit. Gjatë viteve të fundit janë zbatuar një sërë projektesh me financim të huaj dhe nga buxheti i shtetit për studime të ndryshme fizibiliteti, për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit, hartimin e dokumenteve strategjike për menaxhimin e burimeve natyrore, të zonës bregdetare e të tjera. Megjithatë, mbështetja financiare nga buxheti i shtetit për sektorin e mjedisit

është akoma e kufizuar. Shkalla e ndërgjegjësimit mjedisor të publikut dhe të komunitetit të biznesit nuk është ende në nivelin e duhur. Roli i organizatave jofitimprurëse mjedisore, edhe pse është rritur në mënyrë të ndjeshme nga viti në vit, nuk ka ndikimin e duhur në jetën publike dhe politike të vendit. Ngritja e strukturave vendore për mbrojtjen e mjedisit përbën një arritje të rëndësishme, veçanërisht po të merret parasysh që trashëgimia institucionale dhe ligjore në këtë fushë ka qenë e ulët. Por duke qenë se problemet mjedisore janë specifike dhe të veçanta, në varësi të vendndodhjes gjeografike, roli i zbatimi i strategjive/planeve të veprimit në mënyrë të decentralizuar është vendimtar. Pikërisht decentralizimi i vendim-marrjes (delegimi i funksioneve nga qeverisja qendrore në atë vendore) ka qenë një hap efektiv për adresimin e problemeve mjedisore. Duke parë përpara, perspektivat për uljen e rreziqeve mjedisore për shëndetin do të përmirësohen vetëm me integrimin më të mirë të politikave mjedisore dhe shëndetësore.

Mesazhi i auditimit

Edhe pse mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, ajo nuk ka patur vëmendjen e duhur nga ana e NJVQV-ve subjekt auditimi. Pavarësisht përpjekjeve, për periudhën objekt auditimi, vitet 2018- 2021, ka ende shumë punë për të bërë në drejtim të politikave mjedisore në nivel vendor. Thujse në të gjitha NJVQV-të e audituara mungojnë struktura të dedikuara për të prodhuar politika mjedisore, si dhe qartazi ka munguar mbështetja me fonde buxhetore. Niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve, pjesë e procesit të hartimit dhe implementimit të politikave mjedisore është i ulët, dhe sistemi i raportimit në lidhje me politikën mjedisore mungon plotësisht në të gjitha NJVQV. Zbërthimi i plotë i politikave të nivelit qendror në politika lokale, nuk pasqyrohet në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Edhe në rastet e pakta të politikave të ndërmarra nga disa NJVQV, nuk është kryer asnjë analizë apo vlerësim, për të matur ndikimin që këto politika sjellin në mjedis. Proceset e informimit të publikut për çështjet mjedisore, tërheqja e mendimit të tij gjatë hartimit të politikave në nivel vendor, edukimi dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve me synimin e përfshirjes së çdo anëtari të shoqërisë për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi, si përgjegjësi e të gjithëve, kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

TEMA 5: EFEKTIVITETI I POLITIKAVE NË RUAJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E LAGUNAVE

Subjektet nën auditim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Konteksti auditues

Megjithëse një vend i vogël, Shqipëria është shumë e pasur në diversitetin biologjik. Zonat detare e bregdetare janë më të pasurat në biodiversitet. Aktualisht, ligatinat (tokat e lagura) janë ekosistemet më të përfaqësuara në bregdetin shqiptar. Ligatinat e shëndetshme janë jetike për përmbushjen e objektivave të klimës globale, zhvillimit të qëndrueshëm dhe biodiversitetit. Ruajtja dhe restaurimi i ligatinave është thelbësor për arritjen e objektivave të Marrëveshjes së Parisit, ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit si dhe arritjen e objektivave në kuadër të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Rëndësia që paraqesin këto zona edhe në arenën ndërkombëtare, qëndron në faktin se:

- Më shumë se 1 miliard njerëz në mbarë botën varen drejtpërdrejt nga zonat ligatinore për cilësinë e jetesës së tyre, ushqimin dhe ujin e freskët;
- Ligatinat mbrojnë komunitetet nga ndikimi i ndryshimeve klimatike;

- Në këto zona ndodhet 40% e biodiversitetit të Botës;
- Ndhimojnë për të zvogëluar nivelin dhe shkarkimet e gazeve serrë dhe janë rezervuarë të karbonit.

Për sa më sipër, sipërfaqet e zonave ligatinore, pjesë të cilave janë edhe lagunat, sipas Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Mjedisit në MTM, janë zona të mbrojtura thuajse në masën 100% të tyre dhe përbëjnë rreth 5.6% të sipërfaqes totale të zonave të mbrojtura. Ekosistemet komplekse të lagunave bregdetare strehojnë mbi 70% të vertebrorëve në vend, veçanërisht shpendë shtegtarë dhe dimërues. Rreth 70 lloje shpendësh uji gjenden çdo vit në lagunat bregdetare duke numëruar mbi 180.000 individë gjatë dimrit. Shqipëria është edhe një rrugë e rëndësishme shtegtimi për faunën e egër. Lagunat në Shqipëri shtrihen duke filluar nga laguna e Viliunit në Velipojë deri tek ajo e Butrintit në jug. Sipërfaqja e përgjithshme e tyre është rreth 100 Km², janë me ujë të kripur, shtrihen paralel me detin dhe kanë kanale komunikimi me të. Liqeni i Shkodrës-Velipojë (pjesë e të cilit është edhe laguna e Vilunit), Laguna e Karavastasë dhe Butrinti konsiderohen si zona ujore me rëndësi jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare sipas “Konventës së Zonave Ujore RAMSAR” dhe janë pjesë e Trashëgimisë Botërore nga UNESCO. Gjithashtu duke marrë në konsideratë rëndësinë e tyre për ruajtjen e biodiversitetit, laguna e Karavastasë dhe Nartës konsiderohen si zona me rëndësi ndërkombëtare për shpendët e ujit njohur si IBA, me më shumë se 20,000 lloje shpendësh uji për një zonë. Sa kaq, mjedisi nuk është vetëm pasuri e shumëllojshme ekosistemesh, por edhe një burim ekonomie që duhet përdorur me kujdes e strategjik. Vlerat rekreative që sjell larmia biologjike dhe ajo e peizazhit janë një pasuri, të cilat mund të përdoren për të nxitur zhvillimin e turizmit. Zhvillimi i konceptit të ekoturizmit është një drejtim i vlerësuar si i rëndësishëm dhe krijon mundësinë e përfitimeve ekonomike, veçanërisht për Zonat e Mbrojtura, duke siguruar dhe mbajtur në konsideratë gjithmonë përdorimin e qëndrueshëm të komponentëve të biodiversitetit. Me modelin aktual të zhvillimit, bazuar në “turizmin masiv”, rritja e parashikuar e zhvillimit të turizmit në rajon kërcënon dëmtimin e peizazheve dhe biodiversitetit. Njëkohësisht, sforcimi apo përdorimi tej mase i burimeve ujore në dispozicion, rritja e sasisë së mbeturinave dhe shkarkimi i ndotjeve në det, veç të tjerave është dhe një përçarje kulturore. Ndërtimet afër lagunave, me qëllim zhvillimin e turizmit ka shkaktuar gjithashtu dëme të mëdha edhe në ekosistemet e brishta bregdetare dhe detare në vend.

Mesazhi i auditimit

Zonat detare e bregdetare janë më të pasurat në biodiversitet. Aktualisht, lagunat janë ekosistemet më të përfaqësuar në bregdetin shqiptar, të cilat kanë rol mjaft të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të klimës globale, zhvillimit të qëndrueshëm dhe biodiversitetit. Ruajtja e tyre është thelbësore për mbrojtjen e biodiversitetit si dhe arritjen e objektivave kombëtar dhe ndërkombëtar në kuadër të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Pavarësisht faktit që lagunat gjenden krejtësisht brenda zonave të mbrojtura nuk kanë patur vëmendjen e nevojshme dhe nuk i kanë shpëtuar problematikave të ndërtimeve të padisiplinuara, ndotjes, tjetërsimit, apo shfrytëzimit pa kriter. Sa i përket ruajtjes dhe administrimit të tyre, nga ana e institucioneve përgjegjëse kanë munguar politika të qarta dhe të mbështetura në studime si dhe masat e nevojshme për një monitorim permanent dhe efektiv. Mangësitë në bazën ligjore ekzistuese, mbivendosja e strukturave dhe kompetencave, mungesa e kontrolleve konsistente, bashkëveprimi i pamjaftueshëm ndër-institucional si dhe buxhetet e pamjaftueshme të akorduara kanë ndikuar negativisht në ruajtjen dhe miradministrimin e këtyre ekosistemeve. Për rrjedhojë, problematikat e evidentuara kërkojnë zgjidhje të shpejta dhe të qëndrueshme nga ana e institucioneve përgjegjëse në mbrojtje të këtyre pasurive të rëndësishme kombëtare.

INFRASTRUKTURA & TRANSPORTI

3 Auditime

TEMA 6: GARANTIMI I TË DREJTAVE NË TRANSPORTIN AJROR

Subjektet nën auditim: Autoriteti i Aviacionit Civil

Konteksti auditues

Transporti ajror është një nga mjetet më të përdorur nga pasagjerët në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi, urdhrat dhe udhëzimet kombëtare, si dhe rregulloret evropiane të transpozuar në Republikën e Shqipërisë, pasagjerët që përdorin transportin ajror gëzojnë të drejta dhe çdo shkelje e të drejtave të tyre sanksionohet nga normat ligjore dhe kompensimi financiar, i detyrueshëm për tu zbatuar nga çdo kompani ajrore. Në vendin tonë këto të drejta duhet të garantohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Problemet më të zakonshme që hasen gjatë fluturimeve ajrore janë vonesat dhe anulimet e fluturimeve, të cilat shpeshherë janë identifikuar si problematika edhe në media. Në 2018, në Republikën e Shqipërisë kanë operuar 21 linja ajrore. Nga viti në vit numri i tyre ka ardhur në rënie, duke e çuar numrin e linjave ajrore që operojnë në Republikën e Shqipërisë për vitin 2020 në 14. Autoriteti Shqiptar i Aviacionit Civil, synon që përmes ligjit dhe akteve nënligjore që janë në fuqi në vendin tonë (i) të informojë pasagjerët që zgjedhin transportin ajror, për tu njohur me të drejtat e tyre në rast se linja ajrore: vonohet në nisje më shumë se 3 orë, anulon fluturimin, ose ndonjë problem tjetër gjatë udhëtimit, si dhe (ii) të trajtojë çdo ankesë të depozituar pranë këtij institucioni nga pasagjerët lidhur me kompanitë ajrore. Autoriteti i Aviacionit Civil është organ përgjegjës për të garantuar respektimin e të drejtave të pasagjerit. Në rast të mosrespektimit të drejtave të tij, pasagjeri fillimisht duhet të paraqesë ankesën pranë kompanisë ajrore dhe në rast të mungesës së përgjigjes për shkeljet e prezumuara, pasagjeri paraqet ankesë formale pranë AAC-së. Nga ana tjetër, përhapja e COVID 19 dhe shpallja e gjendjes së pandemisë botërore nga Organizata Botërore e Shëndetësisë nxiti shtetet në marrjen e masave të jashtëzakonshme për menaxhimin e situatës së krijuar. Nëpërmjet VKM nr. 243, datë 24.3.2020 “Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore” në vendin tonë u implementuan disa kufizime, të cilat sollën edhe mbylljen e një sërë aktiviteteve tregtare dhe mbyllje të kufijve tokësor dhe ajror. Kriza e krijuar nuk ishte vetëm një krizë shëndetësore por edhe ekonomike. Ecuria e ekonomisë së Shqipërisë, si pasojë e kësaj krize paraqitet e zymtë në vlerësimet e bëra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. OECD në një raport të tij thekson se sektorët më të prekur nga kjo krizë në vendin tonë janë turizmi, transporti dhe tregtia. Për rrjedhojë, një nga sektorët në të cilët u reflektua më shumë kriza e pandemisë së COVID 19, ishte sektori i aviacionit civil. Përhapja e pandemisë COVID-19 solli ndërprerje të udhëtimeve të programuara, për shkak të masave të marra dhe mbylljes së kufijve, duke çuar në anulimin e rreth 60.7% të gjitha fluturimeve. Linjat ajrore u përballën me probleme likuiditeti, duke rrisur rrishtur kështu rimbursimin e pasagjerëve në rastet e cenimit të drejtave të tyre nga udhëtimet e anuluar, në mënyrë që të zvogëlonin humbjet e tyre.

Mesazhi i auditimit

Pavarësisht faktit se AAC vazhdimisht ka ndërmarrë masa në drejtim të garantimit të drejtave të pasagjerëve, ky objektivi prioritar institucional, nuk është përmbushur plotësisht me efektivitet. AAC nuk ka hartuar një Strategji dhe si pasojë nuk ka përcaktuar objektiva konkrete dhe as plane veprimi,

duke treguar deri diku, mungesë fokusi ndaj garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pasagjerëve që përdorin transportin ajror. Bazuar në interpretimin ligjor të dispozitave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, kjo veprimtari institucionale si pjesë përbërëse e misionit të AAC-së, mbarë një rëndësi të veçantë, dhe kërkon një rol tërësisht aktiv të AAC-së kah efektivitetin të procesit që garanton të drejtat e pasagjerëve. Autoriteti i Aviacionit Civil nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim implementimin e kompensimeve për pasagjerët. Pavarësisht mandatit të kufizuar të AAC-së, në implementimin e sanksioneve për operatorët ajror të huaj që operojnë në Republikën e Shqipërisë, ky institucion duhet të kishte ndërvepruar në mënyrë efektive me institucionet homologe, me qëllim garantimin e të drejtave të pasagjerëve. AAC nuk ka luajtur një rol proaktiv në mbikëqyrjen e kompanive ajrore dhe në informimin e qytetarëve. AAC nuk ka monitoruar statusin e ankesave dhe nuk ka kërkuar informacion periodik javor në kompanitë ajrore lidhur me zgjidhjen e dhënë dhe ankesat e drejtuara nga qytetarët. Nga 225 të anketuar që ju përgjigjën pyetësorit të shpërndarë për temën nën auditim, rezultoi se rreth 36 % e tyre nuk kishin informacion mbi të drejtat që gëzojnë gjatë udhëtimit me transport ajror dhe 58.3 % nuk kishin informacion se AAC është institucioni shtetëror kompetent që garanton mbrojtjen e këtyre të drejtave.

TEMA 7: EFEKTIVITETI I SINJALISTIKËS RRUGORE

Subjektet nën auditim: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Autoriteti Rrugore Shqiptar; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Bashkia Tiranë; Bashkia Fier.

Konteksti auditues

“Sinjalistika ka një rol vendimtar për ta bërë çdo vend të aksesueshëm dhe miqësor për qytetarët dhe vizitorët.” Sinjalistika rrugore ofron informacione të vlefshëm për drejtuesit e mjeteve dhe përdoruesit e tjerë të rrugës, pasi ajo përcjellin mesazhe tek shoferët dhe këmbësorët për t’i orientuar drejtë destinacioneve të dëshiruara, duke i komunikuar rregullat që janë në fuqi për të përfutur udhëtime të sigurta, e rrjedhimisht për të reduktuar numrin e aksidenteve në rrugë.

“Sinjalet rrugore apo sinjale të ndryshme, simbolet dhe shënimet e rrugës (vijëzimet) janë vendimtare për sigurinë e rrugëve dhe gjithashtu janë komponent integral të infrastrukturës rrugore të sigurt. Për dhjetëvjeçarin e fundit, objektivi i vendit tonë në lidhje me sigurinë rrugore, ku komponent integral është edhe sinjalistika rrugore, ka qenë reduktimi i numrit të vdekjeve dhe plagosje në rrugë me 50 % në vitin 2020 krahasuar me vitin 2010. Ky objektivi është parashikuar në Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Rrugore në Shqipëri 2011-2020, publikuar në vitin 2011. Në Strategjinë Sektoriale të Transportit 2016-2020 të vendit tonë përcaktohet se, sipas Bankës Botërore dhe inspektimeve vizuale në vend të bëra nga konsulentët ndërkombëtarë, ndër shenjat e cilësisë së dobët të infrastrukturës së rrugës janë edhe “sinjalizimet e dobëta dhe kontradiktore, e probleme të tjera të sigurisë Në vlerësimin e performancës të sigurisë së rrugëve në Shqipëri, të kryer në vitin 2018 nga Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara (UNECE), u konkludua se:

- Plani Veprimit të Strategjisë për Sigurinë Rrugore 2011-2020 nuk është mbështetur në mënyrën e duhur nga burime financimi të qëndrueshme.
- Zbatimi i tabelave dhe shenjave sipas Kodit Rrugor nuk është i saktë në shumë situata. Mbështetja e mirëmbajtjes së sinjalistikës duhet adresuar. Në shumë rrugë urbane mungojnë shenjat horizontale;
- Komiteti Ndërmintor për Sigurinë rrugore, si organi më i lartë politik dhe strategjik për sigurinë rrugore duhet të forcohet dhe fuqizohet për rezultate më të mira të sigurisë rrugore. Funkcionet e

koordinimit dhe sekretariatit duhet të ofrohet nga personeli me përvojën e nevojshme në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Infrastruktura.

- “KNSR shihet më shumë si një organizatë politike, nuk mblidhet rregullisht dhe sekretariati teknik ekzistues nuk ka fuqi reale koordinuese”;
- Përqindja e financimit të sigurisë rrugore si nga buxheti i shtetit ashtu edhe nga pushteti vendor është shumë i ulët. Nuk ka një fond buxhetor të dedikuar për sigurinë rrugore. Krijimi i fondeve të dedikuara është thelbësor për përmirësimin e situatës së sigurisë rrugore në Shqipëri. Financohen aktivitete të limituara, me qëllim përmirësimin e sinjalistikës rrugore; (është evidente se asnjë nga pushtetet vendore në Shqipëri nuk ka dedikuar fonde për sigurinë rrugore. Ky është rasti edhe për qeveritë vendore të mëdha dhe të fuqishme, siç është bashkia e Tiranës). “Në rastin e Shqipërisë, megjithëse qeveria mbledh taksa që duhet të përdoren për përmirësimin e sigurisë rrugore (të ardhurat nga taksat e përgjithshme, fondet e rrugëve, taksa e karburantit, etj.), publiku nuk është i informuar se si këto taksa përdoren për përmirësimin e sigurisë rrugore dhe të destinuara për të mbështetur shpenzimet për çështjet e sigurisë rrugore në përgjithësi.”
- Rezultatet e fushatave të ndërgjegjësimit nuk janë monitoruar.
- Inspektimi i sigurisë rrugore është një aktivitet rutinë që duhet të kryhet nga ARRSH dhe që është i detyrueshëm me ligj. Nuk ka udhëzime që përcaktojnë shpeshtësinë dhe metodologjinë e kryerjes së inspektimeve rrugore nga ARRSH.
- Trajnimi i auditorëve të licencuar të sigurisë rrugore ka nisur, por auditimet e sigurisë për çdo projekt projektimi rrugor nuk janë ende rutinë.
- Mungesa e hetimeve të thelluara të aksidenteve do të thotë që kontributi i infrastrukturës rrugore në aksidentet rrugore dhe viktimat nuk merret plotësisht në konsideratë.”

Gjithashtu edhe në Raport Progresin e KE 2021 për vendin tonë, tërhiqet vëmendja mbi vonesën në përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjik të fushës ku sinjalistika rrugore vepron, si dhe mbi pamjaftueshmërinë e kapaciteteve për të kryer inspektimet e nevojshme. “Shqipëria duhet të përgatisë dhe miratojë Strategjinë e re të Sigurisë Rrugore dhe Planin e Veprimit të saj, në përputhje me Planin e Veprimit për Sigurinë Rrugore të Komunitetit të Transportit. Shqipëria përafroi më tej legjislacionin e saj për testet periodike të kontrollit. Shqipëria nuk i ka forcuar ende kapacitetet e saj inspektuese. Nevojiten më shumë përpjekje për të harmonizuar legjislacionin shqiptar për sistemet e menaxhimit të trafikut dhe sigurinë rrugore (duke përfshirë edukimin dhe zbatimin e sigurisë rrugore).”

Mesazhi i auditimit

Për periudhën 2018-2021, përmirësimi i sinjalistikës rrugore nuk është adresuar në mënyrë plotësisht efektive dhe eficiente. Strategjia për Sigurinë Rrugore 2011-2020, pavarësisht parashikimit për t’u përditësuar në intervale kohore (p.sh çdo vit), nuk është rishikuar asnjëherë. Plani i fundit i veprimit për këtë Strategji, i cili ka pasur në përbërje edhe aktivitete për përmirësimin e sinjalistikës rrugore, ka mbuluar periudhën deri në vitin 2015. Me gjithë zvogëlimin e numrit të vdekjeve në aksidentet rrugore në vitin 2020 krahasuar me vitin 2009 (viti referencës sipas strategjisë), numri i aksidenteve dhe numri i të plagosurve në aksidentet rrugore ka mbetur në të njëjtat nivele. Në vitet 2020-2021, megjithëse lëvizja ka qenë e kufizuar si rezultat i pandemisë Covid-19, numri i personave të plagosur rëndë në aksidente rrugore me faktor sinjalistikën rrugore, zinte rreth 10 % të totalit të aksidentuarve rëndë. Edhe pse periudha në të cilin shtrihej strategjia e parë ka përfunduar, ende nuk është hartuar Strategjia

e re për Sigurinë Rrugore. Nga auditimi nuk u siguruan evidenca mbi funksionimin e Komitetit Ndër-Ministror për Sigurinë Rrugore (KNSR), Sekretarisë Teknike të tij, apo Grupit Qendror të Drejtimit, që sipas kuadrit ligjor në fuqi, përbëjnë sistemin e menaxhimit të sigurisë rrugore në Shqipëri, pjesë e të cilës është edhe sinjalistika rrugore.

Auditimi dhe inspektimi i sigurisë rrugore pothuajse nuk është kryer për periudhën në auditim, pasi në entet pronare të rrugëve dhe në MIE nuk janë ngritur strukturat përgjegjëse për to. Certifikimi i fundit i audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore është kryer në vitin 2017, e nuk ka vijuar më tej, pasi me ristrukturimin e ministrive të ndodhur në këtë vit, janë shkruar drejtoritë përgjegjëse. Për ata auditues të certifikuar (26 gjithsej) nuk ka vijuar trajnim periodik, duke mos siguruar aftësimin e plotë të tyre për kryerjen e auditimeve dhe inspektimeve të sigurisë rrugore. Vendi ynë ende nuk ka një Qendër të Kontrollit dhe Monitorimit të Trafikut, ndërsa 23 pajisjet e Sistemit të menaxhimit të trafikut në rrugët kombëtare, nuk funksionojnë. Sinjalistika rrugore është ngarkuar në mënyrë të pjesshme në sistemin GIS. Bashkëpunimi i institucioneve përgjegjëse për të koordinuar aktivitetet në funksion të rritjes së ndikimit të sinjalistikës në përmirësimin e sigurisë rrugore evidentohet nga auditimit se, në faza të caktuara të zbatimit të strategjisë ka qenë jo i mjaftueshëm dhe në momente të tjera deri në jo-ekzistent.

TEMA 8: MENAXHIMI I TERRENEVE SPORTIVE

Subjektet nën auditim: Ministria e Arsimit dhe Sportit; Bashkia Librazhd; Bashkia Pogradec; Bashkia Përrenjas; Bashkia Kurbin.

Konteksti auditues

Sporti, pa dyshim në të gjitha aspektet e ekzistencës dhe zhvillimit të tij, është elementi më i pranishëm në jetën e njerëzve, është argëtimi kryesor për të gjithë pjesëtarët e familjes, evenimenti më interesant për mediat, biznesin dhe politikën. Shoqëria njerëzore ka hyrë kështu në epokën e sportit dhe me siguri do të qëndrojë gjatë në të. Sporti dhe kultura janë imazhi i parë i një vendi dhe me sport e kulturë njihen në arenën ndërkombëtare më mirë tiparet e tij. Vlerat e sportit janë si të rrafshit kombëtar, ashtu dhe ndërkombëtar. Në Shqipëri, kalimi nga sistemi komunist në sistemin demokratik u shoqërua me ndryshime që përveç të tjerave ndikuan edhe zhvillimin e sportit. Duket sikur sporti pas rënies së komunizmit, vuan nga politikat shterpë të shtetit, të ndërkombëtarësh gjitha qeverive. Nga gjendja ku ndodhet aktualisht sporti, të krijon bindjen se ky sektor nuk është parë asnjëherë si prioritet. Natyrisht, janë shumë faktorë që ndikojnë negativisht në këtë situatë të vështirë të sportit, por kryesorët lidhen me mungesën e vëmendjes nga institucionet publike; Mungesën e strategjive për sportin; Mungesë e investimeve në infrastrukturën sportive, e cila nuk plotëson as kushtet më minimale për zhvillimin e veprimtarive; Financime të pakta të sporteve individuale dhe kolektive, të cilat megjithëse të pakta përsëri abuzohet me ato; Mungesë e bazës materiale (komplete sportive, topa, tapet, uniforma zyrtare për ndeshje) dhe të produkteve mjekësore (vitamina) etj. Roli pozitiv i të bërit sport në shkolla si dhe marrja me sport e shoqërisë. Përfshirja e sportit në shkolla është një mundësi e mirë për të rinjtë që të rriten të shëndetshëm. Sporti përmirëson jetën. Është shumë e rëndësishme të kuptohet që fëmijët duhet ta vlerësojnë rëndësinë e aktivitetit fizik që në moshë të re. Sporti përcaktohet sot si mjeti më efikas i edukimit, argëtimi dhe parandalimit të sëmundjeve, zhvillimit të identitetit kombëtar, forcimit të marrëdhënieve sociale dhe eliminimit të faktorëve negativ shëndetësorë e socialë të zhvillimit të fëmijëve, alternativë e shëndetshme për kohën e lirë të rinisë, mundësi punësimi dhe degë e

rëndësishme e ekonomisë kombëtare për një moshë të tretë aktive produktive dhe ndërkombëtare, “ilaçi” më i mirë.

Mesazhi i auditimit

Menaxhimi i terreneve sportive në Shqipëri, pavarësisht punës dhe përpjekjeve në nivel qendror e lokal, nuk ka rezultuar mjaftueshëm efektiv në drejtim të ngritjes, funksionimit dhe monitorimit të tij. Mungesa e një strategjie të miratuar për sportin nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ka cenuar realizimin e objektivave për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe veprimtarive të tjera rekreative me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve që të merren me edukim fizik dhe sport në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit si dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. Mungesa e strukturave të veçanta për menaxhimin e terreneve sportive në nivel qendror dhe lokal dhe funksionimi jo në nivelin e duhur i disa strukturave përgjegjëse për zhvillimin e sportit në tërësi dhe në veçanti për menaxhimin e terreneve sportive, tregon qartë se këto institucione vuajnë nga një mungesë menaxhimi me eficiency dhe efektivitet të ambienteve, terreneve dhe objekteve sportive. Mungesa e një database të plotë i ambienteve dhe objekteve sportive bart risk lidhur me identifikimin e nevojave për menaxhimin e terreneve ekzistuese dhe ngritjen e atyre të reja. Niveli i ulët i financimeve si nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit dhe nga vetë NJVQV, si edhe puna e pamjaftueshme për gjetjen e burimeve alternative të financimit është tregues për mungesën e efektivitetit në menaxhimin e terreneve sportive. Nga auditimi i këtij aktiviteti në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe në Bashkitë Librazhd, Përrenjas, Pogradec, Kurbin, rezultoi se masat e marra për zhvillimin e sportit dhe ngritjen e terreneve sportive janë të pamjaftueshme për të siguruar mjedise për zhvillimin e veprimtarive sportive, të sigurta dhe sipas standardeve bashkëkohore, jo vetëm për arsimin para universitar por dhe për komunitetin.

SIGURIA SOCIALE DHE TREGU I PUNËS

TEMA 9: MENAXHIMI I SISTEMIT TË INFORMACIONIT VETERINAR RUDA

Subjektet nën auditim: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; Autoriteti Kombëtar Ushqimit; Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Konteksti auditues

Shqipëria është një vend bujqësor me traditë të hershme për kujdesin për kafshët blegtorale, të cilat ofrojnë potencial ushqimor dhe ekonomik, ku përfshihen prodhimet e qumështit dhe nënproduktet e tij, të mishit dhe nënproduktet e tij, të leshit, të lëkurës, etj. Familja fshatare shqiptare në çdo kohë ka treguar kujdes për shëndetin e kafshëve blegtorale duke shpenzuar kohë dhe vlera monetare, me qëllim për të siguruar bazë ushqimore për vazhdimësinë e jetës. Zhvillimi i kësaj dege të bujqësisë, vazhdimisht është dinamik, dhe trajtohet dhe financohet nga programet qeverisë si një sektor me prioritet të lartë, pasi është i lidhur ngushtësisht me cilësinë dhe sigurinë ushqimore, një çështje kjo shumë e rëndësishme për shëndetin publik. Incidentet e ndodhura në të kaluarën në fushën e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, të cilat lënë pasojë domethënëse në shëndetin publik, për shkak të transmetimit të sëmundjeve zoonotike apo edhe të lëndëve mbetëse të dëmshme të cilat gjenden

në produktet ushqimore me origjinë shtazore, kanë treguar se një organizim i mirë i shërbimit veterinar, me një linjë vertikale të zinxhirit të komandës dhe llogaridhënies, mund të shmangte në një nivel të lartë këto incidente. Në vendin tonë ky zinxhir komande ka qenë i shkëputur për shkak të fragmentimit të shërbimit veterinar midis pushtetit qendror dhe qeverisjes lokale, deri në fund të vitit 2020, pasi që nga viti 2016 kryerja e masave profilaktike shtetërore dhe identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve iu delegua klinikave veterinare private të kontraktuara. Nga vlerësimi i punës së tyre për punën e kryer në lidhje mbi detyrat e deleguara, rezultoi se kryerja e masave profilaktike shtetërore dhe identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve nuk garantohej sipas standardeve dhe strategjive në fuqi në një masë të konsiderueshme. Për këtë qëllim në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2020, ligji nr. 10465, 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me ligjin nr.71/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10465 datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ka pësuar ndryshime duke parashikuar që kryerjen e shërbimeve në shëndetin e kafshëve të kryhet nga shërbimi veterinar rajonal, duke krijuar dhe Autoritetin Kombëtar Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, duke pasur në varësi veterinerët zyrtarë dhe ata të shërbimit, të cilët kryejnë këto funksione, janë më afër fermerit në çdo njësi administrative, janë përgjegjës për ofrimin e shërbimit në zbatim të strategjive për sëmundje të ndryshme, mbajtjen nën kontroll të situatës epizootike si dhe të lëvizjes së kafshëve në njësinë ku është përgjegjës, duke populluar sistemin e informacionit blegtoral dhe veterinar (RUDA) në kohë reale.

Nga viti 2002, është implementuar, sistemi i informacionit blegtoral dhe veterinar (RUDA) në zbatim të bazës ligjore, duke përfshirë në të identifikimin dhe regjistrimin individual të kafshëve dhe fermave blegtorale, në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për garantimin e një kontrolli më të mirë të shëndetit të kafshëve blegtorale i cili është lidhur ngushtësisht me efektivitetin e cilësinë dhe sigurinë ushqimore për popullatën. Menaxhimi i sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave (IR/RUDA) në gjedhë fillimisht, u ngrit në 7 rrethe pilot në zonën e ulët bregdetare, me mbështetjen teknike dhe financiare të Programit PHARE të BE me objekt “Forcimi i Shërbimit Veterinar”, më pas me mbështetjen e Programit CARDS 2003, “Monitorimi i shëndetit të bagëtive të imta në Shqipëri” e në vazhdim dhe me mbështetjen e projektit PAZA (IPA 2008) në vitin 2009. Prej vitit 2012 është vendosur sistemi elektronik i gjurmueshmërisë dhe hedhjes së të dhënave mbi identifikimin, regjistrimin, sëmundshmërinë e kafshëve, lëvizjen e tyre dhe kontrollin e sëmundjeve (sistemi RUDA), në të 36 rrethet e vendit të Shqipërisë.

Mesazhi i auditimit

Menaxhimi i Sistemit të Identifikimit, Regjistrimit të Kafshëve Blegtorale RUDA nuk rezultoi krejtësisht efektiv, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e nivelit të sigurisë ushqimore të produkteve nga ferma në tavolinë për popullatën. Kuadri ligjor mbi të cilin funksionon ky sistem, ka mbivendosje duke sjellë fragmentimin e shërbimit veterinar, ndërmjet Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) dhe Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV). Kjo situatë ka ndikuar në mos vlerësimin e duhur të riskut në shërbimin veterinar dhe marrjen e masave për menaxhimin e tij. Mangësitë më të rëndësishme të evidentuara në këtë auditim, kanë të bëjnë me: mungesën e analizave operacionale për punën e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Bujqësisë në MBZHR dhe nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; mos përcaktimin e indikatorëve të matshëm, relevant dhe të arritshëm për të

vlerësuar punën e veterinerëve; mos parashikimin me prioritet të fondeve buxhetore të nevojshme për të rritur efektivitetin dhe eficiencën e shërbimeve veterinarë; mungesën e planeve të kontrollit/inspektimit për monitorimin e punës së veterinerëve në AKVMB; mungesën e kontrolleve të brendshme (përfshirë këtu edhe rolin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në AKVMB); si dhe plotësimin e vendeve bosh për pozicione të profilit “veteriner”, në MBZHR dhe AKVMB. Institucionet e ngarkuara me menaxhimin e këtij sistemi duhet të rrisin shkallën e bashkëpunimit dhe të marrin përgjegjësi në mënyrë që sistemi të jetë plotësisht efektiv me qëllim përmirësimin e sigurisë ushqimore.

TEMA 10: PËRDORIMI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE/PËRDORIMI I PESTICIDEVE

Subjektet nën auditim: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Drejtoritë Rajonale të AKU-së; Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë; Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Konteksti auditues

Qeveria Shqiptare i konsideron Politikat për Produktet e Mbrojtjes së Bimëve (PMB) dhe sigurinë ushqimore si një prioritet të rëndësishëm të saj, nën përgjegjësinë e MBZHR-së, si institucioni qendror përgjegjës për krijimin e kuadrit ligjor, koordinimin e harmonizimit të legjislationit me kuadrin ligjor të BE-së dhe zbatimin e tij. Në fushën e sigurisë së ushqimit, çështjeve veterinarë dhe fitosanitare, përdorimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve ka për qëllim mbrojtjen e bimëve bujqësore nga parazitët, me ndikim sa më minimal në shëndetin e njerëzve, sigurinë ushqimore, kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit. PMB –të janë një agjent kimik ose biologjik si pesticid, virus, baktere, antimikrobik ose dezinfektues. Përdorimi i pesticideve është jashtëzakonisht i zakonshëm. Termi pesticid përdoret shpesh në mënyrë sinonime me një produkt për mbrojtjen e bimëve. Llojet më të zakonshme të pesticideve janë insekticide që përdoren për të vrarë insektet, herbicide që përdoren për të vrarë barërat e këqija, brejtësit që përdoren për të vrarë brejtësit dhe fungicidet që përdoren për të shkatërruar kërpudhat, mykun dhe bakteret. Mos përdorimi i PMB-ve, cenon sigurimin e ushqimit të nevojshëm për njerëzimin dhe nuk garanton një shëndet cilësor. Ushqimet e prodhuara pa përdorimin e PMB-ve janë më të dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve si rezultat i përmbajtjes së fitotoksinave. Përdorimi i PMB-ve ndihmon në ruajtjen e mjedisit dhe biodiversitetit, pasi për të njëjtën sasi ushqimesh nga bujqësia organike do të përdorej 65-200 % më tepër tokë e kultivuar e do kishim pasoja si: rritja e erozionit, dëmtimi i peisazhit, florës dhe faunës së egër deri në zhdukjen e shumë specieve të egra.

Përdorimi i PMB-ve është i domosdoshëm për sigurimin në sasi dhe cilësi të ushqimit me një impakt të lartë social. Asnjëherë nuk mund të garantohet që rreziku nga përdorimi i tyre është zero. Bazuar në kuadrin rregullator kombëtar e ndërkombëtar, PMB-të janë kimikatet më të testuara dhe kontrolluara në botë, të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së jetës së njeriut. Kostoja e prodhimit (sintetizimit) të lëndës vepruese është shumë e lartë (në vlerë që shkon deri në 200 milion euro) dhe përbëhet nga tre elementë: a) efikasiteti i lëndës kimike, zë 1/3 e kostos. b) shqyrtimi i biologjisë, zë 1/3 e kostos dhe c) testimi për mbetjet, toksikologjinë dhe mjedisin, zë 1/3 e kostos. Nisur nga kostoja shumë e lartë, prodhuesit e tyre e konsiderojnë fat, nëse dështojnë në fillim deri në mes të ciklit të prodhimit. Pra të tre elementët i shërbejnë një qëllimi: Mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe sigurisë ushqimore. Por, shqetësim mbeten importi dhe përdorimi i PMB-vetë falsifikuara dhe të

paregjistruara, ku: në tregun e vendeve të BE arrin 10-15%, ndërsa në vendet Europës Lindore të BE-së është deri 25%.

Në raportin e ri të Autoritetit European për Sigurinë Ushqimore (EFSA) është cituar se në mbi 96% të ushqimit, niveli i mbetjeve të pesticideve është brenda limiteve ligjore dhe ushqimi në dispozicion të konsumatorëve është i kontrolluar dhe i sigurt, por në këtë raport nuk është përfshirë Shqipëria. Shqetësimet në rritje lidhur me aplikimin e PMB-ve dhe kërkesat në rritje për ushqim e drejtojnë vëmendjen drejt sigurisë së ushqimit, si dhe në rregullimin global të prodhimit të ushqimit. Popullsia në tërësi, individët dhe familjet si grupe sociale, në ditët e sotme janë më të shqetësuar për sigurinë e produkteve ushqimore për shkak të një seri skandalesh ushqimore që kanë ndodhur gjatë dekadave të fundit dhe për shkak të faktit se nuk ka shenja të uljes së shpeshtësisë së shfaqjes së skandaleve të ushqimit. Që sistemi i sigurisë së produkteve ushqimore të jetë sa më efikas, institucionet shtetërore dhe ato të financuara nga shteti kontribuojnë në krijimin e legjislacionit, sigurinë e vazhdueshme dhe rigorozë të shëndetit dhe kontrollin e cilësisë, aplikimin e njohurive shkencore në praktikë dhe edukimin e konsumatorëve në fushën e ushqimit. Gjatë dekadave të fundit ka pasur një rritje të kërkesave për ushqime të sigurisë së lartë. Zhvillimi i shpejtë ekonomik dhe ndryshimet e fundit në zinxhirin e furnizimit ushqimor, kanë kontribuar në rritjen e interesit për çështjen e cilësisë në sektorin e ushqimit. Shqetësimi në lidhje me sigurinë dhe cilësinë e produkteve ushqimore përfshin çdo fazë të zinxhirit të prodhimit.

Mesazhi i auditimit

Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pavarësisht masave të marra në funksion të arritjes së një niveli të kënaqshëm të sigurisë ushqimore, konstatojmë se reformat strukturore nuk janë kryer bazuar plotësisht në nevoja dhe kritere të qarta vlerësuese, në analiza të sakta të kostove, veçanërisht në fushën e investimeve për laboratorë dhe infrastrukturë ndihmëse në institucionet e zinxhirit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve (PMB), si dhe në praktikat më të mira. Mungesa e një planifikimi strategjik, si dhe programimi të dedikuar, të pambështetur në plane konkrete veprimi, nuk ofron garanci për monitorimin e procesit për sigurinë ushqimore. Mungesat e konstatuara në kuadrin e ri rregullator dhe në standardet e reja të sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe atë fitosanitare, rrezikojnë menaxhimin jo efektiv në shumë hallka të zinxhirit të kontrollit të PMB-ve. Kapacitetet institucionale të MBZHR në fushën e vlerësimit të riskut dhe monitorimit të mbetjeve, kritereve mikrobiologjike dhe ndotësve, si dhe kapacitetet administrative të ISUV sa i takon inspektimeve dhe kontrolleve, rezultuan të jenë të kufizuara; si pasojë, zbatimi i standardeve të sigurisë ushqimore dhe fitosanitare nuk realizohet në mënyrë të plotë. Mos përmbushja nga ana e ISUV, e detyrimit ligjor mbi marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave brenda afatit të parashikuar, ose moskryerja fare e tyre (gjatë periudhës 2018-2019), ka ndikuar që AKU të mos kryejë në kohë marrjen e masave për bllokimin e tregimit të PMB-ve që kanë rezultuar “Jo konform”, duke ekspozuar kështu konsumatorin përpara riskut të përdorimit të tyre. Moskryerja e kontrollit në pikat e inspektimit kufitar (PIK) nëpërmjet sistemit online “e-inspektim”; mungesa e regjistrimit të fermave, mosmonitorimi i fermerëve në përdorimin e PMB-ve, si dhe mosdokumentimi nga ana e tyre i shërbimeve agroteknike për kulturat bujqësore (respektimi i karencës); mungesa e udhëzimit mbi rregullat specifike për ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve, nuk i kanë shërbyer garantimit të sigurisë ushqimore. Në kushtet kur, mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit garantohet jo vetëm, nga përdorimi i PMB-ve por dhe nga produktet plehëruese për ushqyerjen e bimëve, të cilat përmirësojnë cilësitë fiziko-kimike dhe rrisin pjellorinë e tokës, mungesa e një sektori të dedikuar për produktet plehëruese si dhe e akteve nënligjore në këtë

fushë, ka lënë jashtë vëmendjes, monitorimin e këtij procesi duke mbartur risqë për garantimin e sigurisë ushqimore dhe atë mjedisore. Reflektimi i detyrave të vendosura në progres raportet e BE-së, në lidhje me PMB-të, nuk ka ndikuar shumë në parandalimin e regjistrimit të PMB-ve helmuese e shumë helmuese, si rezultat i reformave institucionale joefektive, përdorimit dhe menaxhimit joeficient të kapaciteteve institucionale përgjatë gjithë zinxhirit të monitorimit.

TEMA 11: SISTEMI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Subjektet nën auditim: Ministria e Arsimit dhe Sporteve; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Konteksti auditues

Arsimimi është një e drejtë themelore njerëzore, thelbësore për arritjen e të gjithë të drejtave njerëzore. Në këtë kuadër, ai duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë njerëzit pa dallim. Në sistemin e arsimit parauniversitar përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuar kryhet në shkollat normale dhe në shkollat speciale. Nxënësit me aftësi të kufizuar përkufizohen si individë që kanë për një kohë të gjatë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në arsim, në baza të barabarta me të tjerët. Aftësi e kufizuar (ose handicap) quhet gjendja e personave të cilët kanë një ose më shumë dëmtime ose aftësi të zvogëluar për të bashkëvepruar me mjedisin shoqëror, krahasuar me atë që konsiderohet si normë. Sipas studimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 15% e popullsisë botërore dhe një në dhjetë fëmijë në mbarë botën ka aftësi të kufizuara. Historikisht, jo vetëm në Shqipëri por kudo, personat me aftësi të kufizuara (PAK) për sa i përket arsimit të tyre, kanë qenë të përjashtuar nga sistemi i arsimit të përgjithshëm dhe janë trajtuar nga arsimi special, duke u vendosur dhe arsimuar në shkolla speciale. Në shumë raste, PAK janë ndarë nga familjet e tyre dhe janë vendosur në institucione rezidenciale afatgjata, ku janë arsimuar pothuajse krejtësisht të izoluar nga bashkëmoshatarët e tyre dhe nga komuniteti. Koncepti i aftësisë së kufizuar ka ndryshuar shumë bazuar në klasifikimin e ri (të aprovuar nga pothuajse të gjitha shtetet që i përkasin UN) ICF (*International Classification of Functionality*), që identifikon vështirësitë e funksionimit të personit si në nivelin personal ashtu edhe në pjesëmarrjen shoqërore. Në këtë klasifikim, nuk konsiderohen vetëm faktorët biomjekësor dhe patologjikë, por merret në konsideratë edhe ndërveprimi shoqëror gjithashtu. Në këtë mënyrë qasja ndaj PAK bëhet multi-perspektive: biologjike, personale, sociale. Në vendin tonë arsimimi i personave me aftësi të kufizuara ka filluar me strukturimin e arsimit special dhe është formalizuar me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 160, datë 29.04.1963 për hapjen në Tiranë të "Institutit për mësimin dhe edukimin e fëmijëve shurdhmemecë dhe të verbër". Në vitet pasuese, në qytete të ndryshme të vendit janë hapur sipas nevojës disa shkolla të arsimit special ku janë arsimuar dhe trajtuar persona të moshës shkollore (7-16 vjeç) me lloje të ndryshme pa aftësi dhe diagnoze. Niveli arsimor në arsimin special **ka qenë arsimit bazë**, i përshtatur për shkolla speciale të veçanta me plane dhe programe mësimore të veçanta të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Aktualisht funksionojnë 10 shkolla të specializuara (përfshi edhe institutet e fëmijëve që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë) në Tiranë, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Fier, Berat, Durrës dhe Lezhë (shkollë 9-vjeçare private në Pllanë). Nxënësit në shkolla të specializuara trajtohen dhe arsimohen me shpenzimet e shtetit. MAS është përgjegjëse për monitorimin dhe evidentimin e arritjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Të dhënat që mblidhen nga shkollat në DRAP/ZVAP dhe pastaj në MAS, duhen të detajuara, sipas moshës, gjinisë, klasës, llojit të aftësisë së kufizuar,

vendbanimit dhe prejardhjes me qëllim përpunimin e tyre dhe daljen në konkluzione për të hartuar dhe përmirësuar politika që synojnë sigurimin e një sistemi arsimor cilësor. E drejta për arsim për të gjithë fëmijët në Shqipëri, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, është e garantuar nga një shumëllojshmëri ligjesh dhe rregulloresh, si dhe nga objektivat sociale të përcaktuara në kushtetutë. Ligji për arsimin parauniversitar përcakton parime që udhëzojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, konkretisht për zhvillimin e potencialit të tyre fizik dhe intelektual, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurimin e integritetit të tyre të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës. Ministria e Arsimit dhe Sportit, regjistron dhe monitoron fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. MAS në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, prindërit dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, duhet të sigurojnë që çdo fëmijë të regjistrohet në një shkollë të përgjithshme apo speciale. Shteti duhet të sigurojë një arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët duke mbështetur arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara me mësues ndihmës dhe psikolog, me programe mësimore në shërbim të arsimimit të tyre.

Mesazhi i auditimit

Rritja e bashkëveprimit dhe koordinimit të institucioneve arsimore, për arsimim si e drejtë themelore njerëzore, është thelbësore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fuqizimin e sistemit të gjithëpërfshirjes dhe monitorimin e tij, përmirësimin e infrastrukturës dhe procesit të mësim nxënies, evidentim e vlerave, dijeve dhe aftësive që duhet të ketë gjithsecili, ndërgjegjësimin e prindërve dhe komunitetit me qëllim zhvillimin e plotë të konceptit të gjithëpërfshirjes, integritimin e këtyre fëmijëve në jetën shoqërore dhe aftësimin për përfshirjen në tregun e punës.

KULTURA & ARSIMI

2 auditime

TEMA 12: UNIVERSITETET PUBLIKE GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË

Subjektet nën auditim: Ministria e Arsimit dhe e Sportit; Universiteti Politeknik i Tiranës;

Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës; Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës; Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës; Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit.

Konteksti auditues

Arsimi i lartë në Shqipëri është mes sektorëve me historikun e polemikave të shumta përgjatë viteve si në aspektin social por dhe politik, me reformime të vazhdueshme, me kërkesa të herëpashershme të studentëve, stafit akademik të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL në vijim), stafit administrativ, etj. dhe interesit të lartë publik për një arsim cilësor dhe që t’u përgjigjet nevojave të tregut, ekonomisë dhe zhvillimit strategjik të vendit. Është e nevojshme që të krijohen balanca të rëndësishme, duke garantuar ekuilibër të qëndrueshëm mes ndërhyrjes ligjore të shtetit në zbatimin e politikave të arsimit e autonomisë universitare në katër fushat e kësaj autonomie: në atë financiare; organizative; akademike dhe atë të personelit, veçanërisht vetëfinancimit nga burimet e veta. Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, jep një përcaktim të qartë mbi autonominë universitare, ku institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me

legjislacionin në fuqi. Roli i shtetit në arsimin e lartë, ushtrohet nëpërmjet organeve dhe strukturave përgjegjëse të tij, ku në çdo rast garanton autonominë dhe lirinë akademike dhe vë në dispozicion fonde publike për mbështetjen e programeve të studimit ose fushave të caktuara të kërkimit shkencor në përputhje me përparësitë e zhvillimit dhe interesave strategjike të vendit. Këto parime thelbësore të përcaktuara nga ligji i sipërcituar, në disa raste bien ndesh me disa nene dhe me disa vendime të ndryshme të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në disa drejtime që prekin atë të organizimit të mësimdhënies dhe të menaxhimit të fondeve publike. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) shpalli gjendjen e jashtëzakonshme të shkaktuar nga epidemia e COVID-19 më 30 janar 2020, si dhe pandeminë me 11 mars 2020, datë kjo ku dhe Qeveria shqiptare shpalli gjendjen e epidemisë nga infeksioni COVID-19, dhe më 24 mars 2020 shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë territorin e vendit, me qëllim të luftimit dhe përballimit të epidemisë së shfaqur. Situata pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme e detyroi qeverinë të merrte masa urgjente për nxjerrjen e akteve nënligjore, për mënyrën se si duhej proceduar për vazhdimin pa ndërprerje të procesit mësimor, duke ndryshuar qasjen tradicionale pedagogjike të mësimdhënies në auditorët e Universiteteve, duke e kaluar tërësisht mësimdhënien online nëpërmjet platformave të ndryshme të krijuara e administruar si të reja të teknologjisë informatike, por të pa unifikuara për të gjithë IAL-et. Vendimmarrjet e menjëhershme të Bordeve dhe Senateve të Universiteteve në përputhje me zbatimin e rregullores së nxjerrë nga Komiteti i Eksperteve i ngritur pranë MSHMS, krijimi i platformave të veçanta për mësimin online pa kontaktet fizike, përvojë e marrë edhe nga Universitetet e BE e rajonal, bëri që mësimi të zhvillohej, por sigurisht jo me rezultatet e pritshmëritë e duhura, ku u shfaqën mangësi e probleme si të procesit të mësimdhënies, por dhe mungesës së infrastrukturës informatike si Laptop, kompjuter dhe internet kryesisht për studentët që ishin në zona rurale e atyre që ishin me mungesa financiare, ku familjet trajtohen me ndihmë ekonomik\nevojë por dhe atyre me aftësi të kufizuara, etj.

Mesazhi i auditimit

Institucionet e arsimit të lartë (IAL) për t'iu përgjigjur situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 dhe pamundësisë së krijuar nga zbatimi i kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 për përjashtimin e formës së studimeve në distancë, u ballafaquan me nevojën për përdorimin efektiv të platformave elektronike dhe familjarizimin e thelluar me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), me qëllim realizimin me sukses dhe pa pengesa të proceseve mësimore on-line. Mospërdorimi i mëparshëm i kësaj forme studimi në distancë, e ka vendosur arsimin tonë të lartë jo në linjë me standardet mësimore ndërkombëtare të e-learning. Mungesa e këshillave studentorë në ndonjë IAL, apo pasiviteti i tyre në IAL-et e tjerë, i la studentët pa një përfaqësim të zëshëm të shqetësimeve dhe problemeve me të cilat ata u ndeshën gjatë pandemisë. Procesi mësimor on-line shfaq mangësi në drejtim të pamundësisë për t'iu monitoruar dhe si pasojë për t'iu matur saktësisht edhe cilësia e tij. Në asnjë rast nuk u hartua dhe miratua rrjedha e dokumentuar e aktiviteteve nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, sa i takon procesit mësimor on-line. Konkretisht, monitorimi i orëve të mësimin, u bazua tek vetëdeklarimi i secilit pedagog pas zhvillimit të procesit mësimor. Mungesa e gjurmëve të auditimit për zhvillimin e procesit mësimor on-line, nuk arriti të sigurojë dokumentimin e plotë të operacioneve në formë të tillë që t'iu mundësonte audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptonin mjedisin e kontrollit në universitete. Për përzgjedhjen e platformës on-line, nuk u bë asnjë analizë nevojash që të niste nga departamentet respektive, në lidhje me kapacitetet që duhet të kishin klasat virtuale; nevojës ose jo për punë laboratorike; volumit të detyrave, etj. Si pasojë e sa më sipër, rezultoi se universitetet aplikuan

disa platforma (shpesh të përzgjedhura individualisht nga pedagogët) si Google-classroom, Teams dhe Zoom, të cilat nisur edhe nga përgjigjet e pyetësorëve paraqitën vazhdimisht problematika teknike. Universitetet nuk arritën të prioritarizonin buxhetet në funksion të orientimit të fondeve karshi nevojave që diktoi pandemia, duke bërë që rreth 20-30% e fondeve buxhetore të tyre, të “digjeshin” dhe të mos përdroreshin.

TEMA 13: MBROJTJA DHE ADMINISTRIMI I MONUMENTEVE TË KULTURËS

Subjektet nën auditim: Ministria e Kulturës; Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore; Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore; Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore; Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore.

Konteksti auditues

Monumentet e Kulturës së një kombi janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin në shekuj të tij. Këto institucione shpirtërore dhe materiale të një kombi duhet të marrin vendin që ju takon, të bëhen të vlefshëm deri të shenja për të gjithë popullin shqiptar. Trashëgimia kulturore e secilit vend del nga kultura, traditat, zakonet dhe historia e banorëve të atij vendi, prandaj duhet ruajtur dhe mbrojtur për gjeneratat e ardhshme. Përmes trashëgimisë kulturore, procesi historik i formimit dhe jetës së një populli shprehet dhe përfaqësohet, sepse është sinteza e dukshme dhe e prekshme e elementeve që e karakterizojnë atë. Përmes kësaj trashëgimie përforcohet identiteti rajonal ose kombëtar dhe ndjenja e përkatësisë ndaj një populli. Meqenëse është produkt dhe shprehje e krijimtarisë njerëzore, trashëgimia kulturore transmetohet, rikrijohet dhe modifikohet. Ajo kalon nga brezi në brez dhe mund të shkatërrohet nëse vlera e saj kulturore dhe historike nuk vlerësohet dhe ruhet. Zhvillimet sociale dhe urbane mbas viteve '90-të, problemet e pronësisë, zhvillimi dhe “nënvleftësimi” i monumenteve të kulturës në këto vite, marrja me to e gjithkujt qoftë edhe pa një formim dhe edukim në këtë fushë, (jo profesionistë), kanë marrë përmasa shqetësuese duke rrezikuar ekzistencën e tyre. Monumentet e kulturës në Republikën e Shqipërisë, të çfarëdo lloji, natyre dhe kulture, mjedisi social dhe natyror, përkatësie të të njëjtit civilizim klasik mesdhetar, varësie, menaxhimi, madhësie apo pozicioni gjeografik ku ndodhen, kanë qenë dhe do të mbeten një faktor i rëndësishëm i zhvillimit historik, kulturor dhe social ekonomik në vendin tonë. Këto asete krijojnë mundësinë e nxitjes dhe aktivizimit të të mirave materiale dhe shërbimeve, me synim përmirësimin e cilësisë së jetës, veçanërisht të komuniteteve përreth, të cilët e kanë kuptuar se jeta e tyre është e lidhur ngushtë me kontekstin në të cilin jetojnë dhe punojnë. Ky kontekst përbën thelbin e identitetit të tyre kulturor dhe shërben si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për një cilësi të ekuilibruar të jetesës. Meqenëse trashëgimia kulturore materiale është një prej burimeve më të rëndësishme kombëtare në vend, i cili nuk ripërtërihet, duhen bërë disa përpjekje të veçanta për të rivendosur ekuilibrin ndërmjet nevojave tona dhe mbrojtjes së këtij burimi. Monumentet e kulturës zënë një vend të veçantë në spektrin e “destinacioneve ekoturistike”, të cilat janë tashmë të njohura në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Në ditët e sotme, koncepti i monumenteve të kulturës po ndryshon drejt një prespektive të re që synon jo vetëm mbrojtjen e tyre, por dhe domosdoshmërinë për rritjen ekonomike dhe mirëqenien e popullsisë drejt standardeve evropiane. por edhe në zhvillimin ekonomik si dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë. Përballja me çështje kontradiktore lidhur me, zotërimin e certifikatës së pronësisë, mos inventarizimin, mos regjistrimin, ndryshimet globale, ruajtjen e asaj që ekziston e cila është e njohur dhe asaj çka është akoma për t'u zbuluar dhe nevojës për ta shfrytëzuar këtë burim për përfitime socio - ekonomike të komuniteteve lokale,

aksesueshmërinë për publikun, financimin, zhvillimet urbane të paplanifikuara, të cilat janë në qendër të politikave të që merren me monumentet e kulturës, kanë bërë që menaxhimi i tyre nga institucione shtetërore përkatëse të ketë mangësi të cilat shfaqen dhe ndikojnë në jetën e qytetarëve dhe, në kushtet aktuale nuk mund të sigurojnë dhe garantojnë ruajtjen, duke rrezikuar dhe ekzistencën e tyre. Mbrojtja dhe administrimi i monumenteve të kulturës rregullohet nga ligji nr. 27/2018 për “Trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe disa akte nënligjore në zbatim të tij. Menaxhimi i monumenteve të kulturës duhet të synojë vendosjen e ekuilibrave midis përdorimit dhe ruajtjes së tyre. Kjo kërkon njohjen, mbrojtjen, regjistrimin, menaxhimin dhe vlerësimin e tyre. Nëse institucionet shtetërore me politikat e tyre nuk janë në gjendje të njohin dinamikën e zhvillimit dhe sfidat themelore, menaxhimi i monumenteve të kulturës është i pamundur.

Mesazhi i auditimit

Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e monumenteve të kulturës nuk e kanë orientuar veprimtarinë e tyre në mënyrë efektive, me qëllimin final, mbrojtjen, mirë - administrimin, inventarizimin dhe vlerësimin e monumenteve në vendin tonë, me rezultatin e vetëm që 122 monumente nuk ekzistojnë, 122 monumente janë plotësisht të shkatërruara, 884 monumente në gjendje të pranueshme por që kanë nevojë për restaurim, 745 objekte në gjendje të mirë dhe në nevojë për një mirëmbajtje të vazhdueshme, 98 objekte të tjetërsuar si dhe 15 objekte pa kartelë. Kjo situatë është shkaktuar edhe nga një programim i efektivitetit i burimeve njerëzore dhe financiare në territor, sidomos sa i takon institucioneve të specializuara të ngarkuara me mbrojtjen dhe administrimin e këtyre monumenteve. Nga ana tjetër, Ministria e Kulturës, si institucion politikbërës nuk është angazhuar maksimalisht në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për trashëgiminë kulturore, duke lënë sistemin kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore pa Inspektoriat, çka do të thotë, pa patur në dorë mundësinë e ndëshkimit ndaj atyre që abuzojnë, shkatërrojnë apo tjetërsojnë monumentet e kulturës. Ministria e Kulturës në të ardhmen duhet të angazhohet në bashkëpunim me institucionet e varësisë, por edhe me institucionet e tjera për të hartuar dokumentet dhe propozuar miratimin e procedurave të domosdoshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme në vendin tonë, për të sjellë një përmirësim konkret në gjendjen e tyre aktuale.

ZHVILLIMI EKONOMIK KOMBËTAR

TEMA 14: EFEKTIVITETI I PROGRAMIT TË INTEGRUAR PËR ZHVILLIMIN RURAL - PROGRAMI 100 FSHATRAT

Subjektet nën auditim: Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural; Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural; Ministria e Kulturës; Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë; Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit; Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit.

Konteksti auditues

Zhvillimi Rural është një element i rëndësishëm i politikave zhvillimore të një vendi dhe pjesë komplementare përkrah politikave të bujqësisë. Zhvillimi rural konsideron integrimin e instrumenteve të zhvillimit të hapësirës rurale, që lidhen ngushtë me zhvillimin e infrastrukturës, diversifikimin

ekonomik, ruajtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore si dhe zhvillimin e kapitalit social dhe njerëzor. Fshati, si strukturë thelbësore e hapësirës rurale, përballlet me sfida të mëdha, mundësi të pakta për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike përtej bujqësisë, të cilat kanë sjell migrim masiv drejt zonave urbane të vendit dhe emigracion të lartë në shtete të tjera. Ky sektor, pavarësisht potencialit, haset në disa kufizime, siç është infrastruktura rrugore dhe transporti jo i përshtatshëm publik, që pengon rritjen e kërkesës, gjithashtu edhe niveli i ulët i arsimit në zonat rurale apo emigrimi, sjell mungesë në staf të kualifikuar. Në kontekstin e zhvillimit të vendit dhe në kuadër të adresimit të sfidave me të cilat përballlet fshati hapësira rurale, është krijuar një program i posaçëm “Programi i Integruar për Zhvillimin Rural” (PIZHR) – Programi i 100 fshatrave. Ky program është në zbatim të politikave qeveritare të viteve 2017-2021, Strategjisë Kombëtare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020 si dhe dokumenteve të tjera strategjike si marrëveshja e programit IPARD 2014-2020, strategjia dhe plan veprimi për turizmin 2014-2020. Synimi i këtij programi është ndërtimi i një modeli zhvillimi rural, bazuar tek potenciali turistik, duke zhvilluar rrjetëzime të investimeve në agroturizëm ku të përfshihen infrastruktura, agroturizëm, trashëgimi kulturore dhe nxitje të punësimit përmes mbështetjes direkt për sipërmarrjen. Programi i Integruar për Zhvillimin Rural, duke u fokusuar tek potencialet turistike të zonës rurale, si një territor i pa eksploruar në Shqipëri për vite me radhë, synon transformimin ekonomik dhe social në fshat, për të krijuar 100 zona zhvillimi ekonomik rural, të bazuar tek investimet në agroturizëm, duke shfrytëzuar trashëgiminë kulturore, mrekullitë natyrore, traditën në tërësi. Kombinimi i të gjitha këtyre sjellin kushte të reja, për ta parë të ardhmen në fshat si një të ardhme të lidhur jo thjesht me prodhimin bujqësor në funksion të tregut në ofrimin e produkteve bujqësore, por edhe si zhvillim turistik me bazë bujqësore dhe blegtorale.

Mesazhi i auditimit

“Programi i integruar për 100 fshatrat”, projekt i cili do të çonte nivelin e turizmit dhe promovime të tjera të tyre, është konkretizuar pjesërisht me sistemimin e zonave/fshatrave, por ende ka punë për të bërë në drejtim të organizimit dhe bashkërendimit të punës mes njërive përgjegjëse për ndjekjen dhe monitorimin e këtij programi, konkretisht: Nuk ka një rezultat gjithëpërfshirës mbi shkallën e realizimit të objektivave specifike të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, si dhe shkallën e përmbushjes së indikatorëve/impaktit që synon të arrijë ky program siç janë rritja e numrit të vendeve të punës; numrit të punësuarve gra/vajza; dhe të rinj; numrit të bizneseve start-up, të bujtinave; të inkubatorëve për produkte tradicionale; numrit të sipërmarrjeve të reja të agroturizmit; numrit të sipërmarrjeve prodhuese të produkteve tradicionale; si dhe numrit të projekteve të realizuara të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Nuk është dokumentuar aktiviteti dhe përbërja e Komisionit Ndërmnistror, i cili duhet të vendoste për ecurinë e programit dhe nuk rezulton të jetë ngritur as Sekretariati Teknik për të mbështetur Komisionin. Për zbatimin e Programit të Integruar për Zhvillimin Rural. Programi i 100 fshatrave, si pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, nga ana e ministrive përgjegjëse nuk u krijuan struktura të posaçme, të cilat do të mundësonin administrimin, bashkërendimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e programit të 100 fshatrave, sipas ndarjes së qartë të roleve. Ky program nuk është zbërthyer më tej në plane vjetore pune; si pasojë kanë munguar raportet e monitorimit për të ndjekur ecurinë e projektit në mënyrë të koordinuar. Edhe pse këtij projekti i është dedikuar një program buxhetor specifik, konstatuam përdorimin e programeve të tjera buxhetore nga ana e

subjekteve, për fonde që lidhen me Programin e 100 fshatrave, duke bërë të vështirë gjurmimin e shpenzimeve për këtë program nga pikëpamja e zbatimit të buxhetit.

TEMA 15: OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Subjektet nën auditim: Kryeministria; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/

Konteksti auditues

Edhe pse nuk ka një përcaktim të vetëm, koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm u paraqit për herë të parë në 1987 në Raportin e Komisionit Botëror në Mjedis dhe Zhvillim të titulluar “Our Common Future” (i njohur ndryshe si Raporti i Brundtland-it). Komisioni e përkufizoi zhvillimin e qëndrueshëm si “zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.” Zhvillimi i qëndrueshëm përfshin integrimin e objektivave sociale, mjedisore dhe ekonomike. Në mënyrë ideale, çdo politikë apo aktivitet njerëzor duhet të sjellë një

REFORMA TË RËNDËSISHME NË SEKTORIN PUBLIK

përmirësim në të tre objektivat. Megjithatë, përparimi në një front mund të arrihet me koston e dëmtimit në një tjetër. Kudo që është e mundur, vendimet duhet të marrin parasysh kostot dhe përfitime të tre shtyllave (sociale, ekonomike e mjedisore). Përkufizimi i Komisionit nxori në pah gjithashtu se brezat e sotëm nuk duhet të arrijnë progres ekonomik në kurriz të prosperitetit të brezave të ardhshëm. Është e qartë që mjedisi është një nga tre komponentët themelore të zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, zhvillimi i qëndrueshëm nuk e trajton mjedisin si një çështje të paprekshme, por pranon se mund të ketë nevojë për një ekuilibër ndërmjet progresit ekonomik, social dhe mjedisor. Arritja e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm përfshin integrimin e objektivave ekonomike, mjedisore dhe sociale. Ka interpretime të ndryshme të fushës së zhvillimit të qëndrueshëm dhe peshës që duhet t'i kushtohet shqetësimeve ekonomike, mjedisore dhe sociale. Qeveritë kanë një rol kyç në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ato janë përgjegjëse për përcaktimin e drejtimit, bërjen e politikave dhe sigurimin e koordinimit. Ato përfaqësojnë interesat e kombit në negociata ndërkombëtare dhe angazhohen për shembull për përgatitjen e politikave/programeve kombëtare për të promovuar dhe nxitur zhvillimin e qëndrueshëm. 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm demonstrojnë nivelin dhe ambicien e Axhendës 2030 duke kërkuar të drejta të barabarta për të gjithë, fuqizimin e grave dhe vajzave si dhe integruar në mënyrë të pandashme një balancë midis tre dimensioneve të zhvillimit të qëndrueshëm, atij ekonomik, social dhe mjedisor.

17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm përbëhen nga 169 *targets* ose synime dhe 231 indikatorë. Korniza globale e indikatorëve për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm u zhvillua nga Grupi i Ekspertëve dhe Ndër-Agjencive për Indikatorët e OZHQ (*Inter-Agency and Expert Group on SDG Indicators- IAEG-SDGs*) dhe u ra dakord në sesionin e 48-të të Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara të mbajtur në mars 2017. Korniza globale e treguesve u miratua më vonë nga Asambleja e Përgjithshme më 6 korrik 2017 dhe përfshihet në Rezolutën e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme për Punën e Komisionit Statistikor në lidhje me Axhendën 2030, për Zhvillim të Qëndrueshëm (A/RES/71/313). Sipas Rezolutës, korniza e treguesve do të përpunohet çdo vit dhe do të rishikohet në mënyrë gjithë përfshirëse nga Komisioni i Statistikave. Kuadri global i treguesve do të plotësohet me

tregues në nivel rajonal dhe kombëtar, të cilat do të zhvillohen nga Shtetet Anëtare. Pra, e thënë më qartë, të gjitha shtetet të cilat janë zotuar vullnetarisht të zbatojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm duhet të hartojnë indikatorët në kontekstin kombëtar të tyre.

Mesazhi i auditimit

Forcimi në vijimësi i harmonizimit dhe përthyerjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, nëpërmjet përcaktimit të qartë dhe të plotë të strukturave përgjegjëse, afateve kohore, indikatorëve, buxheteve, si dhe rritja e nivelit të zbatimit dhe monitorimit duhet të jetë prioritet i qeverisë shqiptare, për të minimizuar varfërinë, mbrojtur mjedisin e për të siguruar mirëqenien e njerëzve.

2.2.5.1 AUDITIMET NË INSTITUCIONET E MJEDISIT

Në auditimet në institucionet mjedisore, të cilat kanë për detyrë, menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit janë ushtruar kontrole të aktivitetit të tyre financiar dhe përputhshmërisë, në drejtim të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për menaxhimin ruajtjen e zonave të mbrojtura mjedisore dhe fondit pyjor, menaxhimin e kujdesshëm të burimeve të tokës, përfshirë ajrin, ujin, florën dhe faunën, gjithashtu në integrimin e politikave të mbrojtjes së mjedisit në ato të zhvillimit ekonomik, ndërgjegjësimin e popullatës, ndalimin e gjuetisë paligjshme, monitorimin e kontrollin si dhe krijimin e përdorimit të ardhurave, etj. Në këto institucione u realizuan **gjithsej 5 auditime**, nga të cilat 2 auditime përputhshmërie dhe 3 auditime përputhshmërie dhe financiare, dhe u lanë **gjithsej 126 rekomandime**, nga të cilat: 82 masa organizative, 37 masa disiplinore, 3 masa shpërblim dëmi, 4 masa për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, të konstatuara në fushat si vijon.

Në fushën e inspektimit si në rastin e subjekteve Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) Tiranë dhe ARM Berat ku konstatuam: *Pamjaftueshmëri financiare dhe organizative*, në përmbushje të funksioneve në fushën mbrojtjes së mjedisit, pasi vumë re se ka mungesë në bazë logjistike dhe burime njerëzore për kryerjen e inspektimeve, si mungesë buxheti në shpenzime operationale për të mbështetur inspektorët mjedisorë në kryerjen e inspektimeve në distanca të largëta nga qendra e punës; *Mungesë analize risku për inspektimin e subjekteve me risk të lartë*, të lejeve të tipit A, B, ku konstatuam se analiza e riskut nuk është e plotë, pasi vumë re se, nuk ka një bazë të dhënash të sakta dhe të listuara sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet përkatëse; si dhe *Mangësi në procedurat inspektuese*, pasi planet mujore të inspektimit nuk janë të plota në informacionin që përmbajnë, ku vumë re se në këto plane pasqyrohet vetëm tematika e inspektimit, jo edhe grupet e inspektimit. Po ashtu, mungonin relacionet, raportet e realizimit të inspektimeve, nga Sektorët e mjedisit dhe ujërave, ku nga raportimet mujore konstatohet se kryesisht treguesit janë raportuar vetëm në nivelin faktik dhe jo sipas treguesve të parashikuar në Planet vjetore .

Në fushën e menaxhimit të zonave të mbrojtura, ku në Administratat e Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe Lezhë, konstatuam: *Mungesë e një baze të dhënash mbi ndërtimet pa leje në Zonat e Mbrojtura*: pasi identifikimi i ndërtimeve pa leje duhet të ishte raportuar pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Nga informacioni i administruar për auditimet, rezulton se ka pasur një numër të ndërtimeve pa leje dhe vetë deklarimeve për legalizim. Për këtë arsye, në disa zona aty ku ka pasur edhe një dendësi të lartë të ndërtimeve është vepruar duke i shpallur Zona Informale; *Mungesë regjistrimi të zonave të mbrojtura në kadastër*, ku qindra hektarë sipërfaqe të zonave të mbrojtura figurojnë ende pa një status juridik të qartë në kartelat e pasurive të paluajtshme, e për rrjedhojë krijohen risqe për tjetërsimin e tyre përmes procedurave të legalizimit; *Mungesa e përcaktimit të territorit buferik të zonave të mbrojtura në raport me kufijtë e bizneseve që ushtrojnë aktivitetet në*

këtë zonë. Konkretisht, nuk ka evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësi, kulturore dhe shërbimet turistike. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetin, mendime , territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike).

Në fushën e menaxhimit të fondit pyjor, ku në subjektin Agjencia Kombëtare e Pyjeve, konstatuam: *Mangësi në përditësimin e fondit pyjor*: Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) nuk është i plotë, pasi në këtë fond nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat i kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet VKM-së Nr. 707, datë 21.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier”. Sipas nenit 2 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, ligji i shtrin efektet për çdo sipërfaqe pyjore pavarësisht pronësisë, për sa kohë plotësohet kushti i përkufizimit të “pyllit”, pavarësisht administrimit qoftë privat apo publik. *Mangësi në inventarizimin dhe dixhitalizimin e fondit pyjor*: Në lidhje me procesin inventarizimit të fondit pyjor konstatohet se inventari i fundit i përket vitit 2018 e për rrjedhojë rezulton se nuk ka nisur cikli i radhës 8 vjeçar i ri-inventarizimit kombëtar të pyjeve, duke inventarizuar 25% çdo 2 vjet të fondit pyjor. Nga krahasimi i inventarëve 2003-2018, nga vëllimi total drunor, është hequr për 15 vjet një vëllim prej 32.9 mln m3 (përfshi materialin drusor të djegur nga zjarret në pyll), pra 2.2 mln/m3/vit, ose dyfishin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit. Në lidhje me dixhitalizimin, ky proces është paplotë, pasi rezulton se është pasqyruar pjesërisht vetëm fondi pyjor nën administrimin e bashkive dhe jo sipërfaqet pyjore të ministrive dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.


2.3.6 DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

KLSH e zhvillon Auditimin e Teknologjisë së Informacionit (TI) prej 8 vitesh tashmë, me objektiv kryesor ekzaminimin e zbatimit të sistemeve TI-së, për të siguruar që ato përmbushin nevojat e subjektit të audituar, pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimtarisë së tij⁵. Në zbatim edhe të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2018-2022 për thellimin në këtë lloj auditimi, KLSH i ka kushtuar vëmendje të veçantë angazhimit të audituesve me përvojë dhe të trajnuar për të kryer auditime në përputhje me legjislacionin Kombëtar në fushën e TIK dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310) si dhe standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke vlerësuar rolin e sistemeve të TI në mirë menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe risqet që këto sisteme mbartin, për vitin 2022 u planifikuan bazuar në Manualit Aktiv të Auditimit të TI (MAATI)⁶ dhe u **realizuan 5 auditime** në subjekte të cilat kanë sisteme të Teknologjisë së Informacionit, të vlerësuar me risk të lartë paraprakisht, si dhe **2 auditime tematike** mbi “Zbatimin e rekomandimeve të mëparshme”. Gjatë vitit 2022 është vazhduar me përfshirjen në auditime më shumë se 1 subjekt që ka lidhje me çështjen e audituar, duke bërë që për çdo auditim të kryer të mbulohen mesatarisht 2 subjekte, duke ruajtur trendin e tre viteve të fundit për këtë tregues.

Për përmirësimin e gjendjes janë dhënë **gjithsej 154 rekomandime**, nga të cilat 147 rekomandime të llojit “Masa organizative”, 2 “Masa për shpërblimin e dëmeve” të shkaktuara buxhetit të shtetit, 1 “Masë disiplinore”, 3 “Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike” dhe 1 “Masë administrative” si dhe është arritur në 7 konkluzione të përgjithshme mbi auditimet.

Grafiku nr.1: Struktura e gjetjeve të auditimeve të kryera gjatë vitit 2022



Në vijim, paraqiten konkluzionet në përfundim të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2022:

Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në: **Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, (AKU), Inspektoratin Qendror(IP) dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)** për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më datë 30.06.2021.

⁵ Ligji nr.115/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 3, pika 3

⁶ Krijuar gjatë projektit të binjakëzimit ndërmjet KLSH-së me SAI-n Polak dhe Kroat, dhe është miratuar me Vendimin nr. 171 datë 27.11.2018 të Kryetarit të KLSH-së

Qëllimi këtij auditimi ka qenë përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, në pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të. KLSH në përfundim të auditimit konstatoi se:

Procesi i inspektimit nuk është informatizuar plotësisht; Problematikat e pjesëve të informatizuara janë të shumta, duke u bërë pengesë për aktivitetin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; Mungesa e strategjisë, akteve rregullatorë, e të dhënave historike të AKU-s, pajisjeve dhe internetit për inspektim, problematikat në funksionalitetet e sistemit “e-inspektimi”, si dhe adresimi i tyre tek Inspektorati Qendror, kur administrator dhe ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes është AKSHI, janë disa nga faktorët kryesore që kanë ndikuar në cilësinë dhe saktësinë e të dhënave që gjeneron AKU.

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 33 masa organizative, ku në disa prej tyre nevojitet bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Inspektoratit Qendror, në mënyrë që sistemi informatik t’i shërbejë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Prokurimit Publik, me objekt auditimi përcaktimin nëse administrimi i elementëve kritikë në ofrimin shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit është i mjaftueshëm, kunkludoi se:

Ka mbivendosje të detyrave dhe përgjegjësi, midis Agjencisë së Prokurimit publik dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit; Shërbimet e ofruara nga AKSHI në APP nuk monitorohen sipas përcaktimeve të marrëveshjes së Nivel Shërbimit; Mungesa e procedurave dhe akteve rregullatorë në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa përcaktuar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera në sistem; Strukturat Drejtuese të APP në bashkëpunim me AKSHI-n, nuk kanë marrë masat e duhura për krijimin e një infrastrukture BCC, për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit. Struktura e TI- së AKSHIT atashuar në APP ka mungesa të konsiderueshme të burimeve njerëzore.

Nga auditimi i të dhënave të sistemit për vitin 2021 konstatohet se: Sistemi i prokurimit Elektronik nuk ka kontrollet e nevojshëm të validimit për të mos lejuar lidhjen e kontratave pa pasur fondin limit të nevojshëm, ka raste në të cilat fondi i prokuruar është më i madh se vlera e fondi limit. Në përfundim të këtij auditimi, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 15 masa organizative.

Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit **në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës** me objektiv përcaktimin nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës mbrojnë asetet e informacionit; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe mbështeten në kontrole të duhura për periudhën e aktivitetit 01.01.2020 deri me datë 31.12.2021. Kontrolli i Lartë i Shtetit në përfundim të këtij auditimi ka konstatuar se:

Mungesa e strategjisë institucionale dhe strategjisë në drejtim të teknologjisë së informacionit mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së ASHK; Mungesa e kontroleve dhe mekanizmeve të duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe mungesa e akteve rregullatorë të përditësuar në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa përcaktuar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera; Performanca e funksionimit të sistemit multifunksional, shkaktuar

nga mbingarkesa e lartë është e dobët. Sistemi multifunksional vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme me ecurinë normale të punës duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e punës së specialistëve dhe institucionit në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve dhe bizneseve. Identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve dhe bizneseve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit pa ndërprerje nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pamjaftueshëm; Administrimi elektronik i informacionit zyrtar të pasurive të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi të, kryhet nga Operatori Ekonomik i kontratës së shërbimit të regjistrit elektronik të pasurive të paluajtshme, kur këtë duhet ta realizojë ASHK duke përcaktuar personat përgjegjës, të cilët duhet të administrojnë çdo lloj informacioni zyrtar të pasurive të paluajtshme dhe të drejtat e tyre. Kjo në kundërshtim edhe me Nenin 8, pika 4, shkronja c. Ligjin nr. 111/2018 datë 07/02/2019 “Për Kadastrën”; ASHK nuk ka marrë masa për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK tek AKSHI si dhe dorëzimin e Sistemeve dhe Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosur në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

Për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 33 Masa Organizative, 1 masë për shpërblim dëmi, 1 masë administrative dhe 1 masë disiplinore.

Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në **tre Universitete: Universiteti i Tiranës, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi**.

Qëllimi i këtij auditimi ka qenë përcaktimi nëse institucioni arrin objektivat e tij duke përdorur burimet IT në mënyrë efektive dhe në përputhje me: kërkesat ligjore/rregullative, integritetin, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2021 nga ku rezultoi se:

Në *Universitetin e Tiranës*, ka: mungesa e strategjisë institucionale dhe strategjisë në drejtim të teknologjisë së informacionit mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Universitetit të Tiranës.

Identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave, si dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pamjaftueshëm. Në këtë drejtim, përdorimi i sistemeve në Universitet mbart një risk të lartë në mbarëvajtjen e funksionaliteteve të ndërtruara në shërbim të qëllimit dhe objektivave institucionale.

Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit. Për periudhën e audituar, u konstatua se Universiteti i Tiranës nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-ëve. Nga auditimi i procedurave të prokurimit të Teknologjisë së Informacionit për periudhën nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2021 nuk është vepruar në përputhje me aktet ligjore/ nënligjore në fuqi.

Në *Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali"*, rezultoi se janë zhvilluar sisteme të Teknologjisë së Informacionit pa hartuar bazën e nevojshme rregullatorë për funksionimin e tyre dhe të pa

mbështetura me burimet e nevojshme njerëzore; Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit; Identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pa pamjaftueshëm;

Nga auditimi i zbatueshmërinë së akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e vlerësimit) për procedurat e prokurimit publik për investimet në fushën e Teknologjisë së Informacionit të zhvilluara gjatë periudhës objekt auditimi nga 01.01.2020 deri më 31.12.2021, subjekti i audituar, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", ka mangësi në veprime në përputhje me kriteret e përcaktuara në bazën ligjore dhe rregullatore.

Në *Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi"*, ka: mungesa e strategjisë institucionale dhe strategjisë në drejtim të teknologjisë së informacionit mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Universitetit të Shkodrës.

Universiteti "Luigj Gurakuqi" ka në përdorim sisteme të Teknologjisë së Informacionit pa hartuar bazën e nevojshme rregullatore për funksionimin e tyre. Identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pa pamjaftueshëm. Në këtë drejtim, përdorimi i sistemeve mbart një risk të lartë në mbarëvajtjen e funksionaliteteve të ndërtuara në shërbim të qëllimit dhe objektivave institucionale. Investimet në sistemet e teknologjisë së informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit dhe nuk kanë siguruar rimëkëmbjen nga katastrofat. Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në Universitetin e Shkodrës mbështeten në një infrastrukture IT jo të konsoliduar e cila në disa pjesë është e amortizuar. Shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurt dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës dhe perspektiven e zhvillimeve të përcaktuara.

Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në **Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.**, për periudhën e aktivitetit 01.01.2020 deri me datë 31.12.2021, me qëllim përcaktimin nëse sistemet e teknologjisë së informacionit mbrojnë asetet e informacionit; ruajnë integritetin e të dhënave, sigurojnë disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe mbështeten në kontrole të duhura, rezultoi:


Mungesa e kontroleve dhe mekanizmave të duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe mungesa e akteve rregullatore të përditësuar në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa përcaktuar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera.

Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës duhet të mbështetet në praktikat më të mira si dhe në rekomandimet e AKSHI. Performanca e funksionimit të sistemit Flare ERP është jo e kënaqshme, pasi sistemi vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme me ecurinë normale të punës duke ndikuar në veprimtarinë e specialistëve dhe institucionit në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve dhe bizneseve por edhe vetë administratës së UKD. Sistemi krijon vonesa në shqyrtimin dhe gjenerimin e raporteve të ndryshme.

Nga analizimi i të dhënave me teknikat CAAT, rezultoi se sistemi nuk ka mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna të gabuara, e për pasojë nxjerrjen e raporteve të pasakta. Organizimi i strukturës së IT-së me një staf shumë të vogël, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në UKD.

Për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 20 Masa Organizative.

REKOMANDIMET E VITIT 2021 DHE ZBATIMI I TYRE



2.3.7 MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA AUDITIMET E MËPARSHME

Bazuar në Ligjin Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe në zbatim të kërkesave të Kornizës së Deklaratës Profesionale të INTOSAI-t (IEPP), me qëllim përmbushjen e objektivave të vendosura në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022, Kryetari i KLSH me vendimin Nr.67, datë 23.06.2020 ka miratuar manualin e ndjekjes ë zbatimit të rekomandimeve si dhe regjistrin institucional të zbatimit të rekomandimeve.

KLSH, krahas përcaktimit të çështjes së parë në çdo auditim për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, ka monitoruar ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, nëpërmjet:

- Planit të pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve përcjellë në KLSH nga subjekti, pas marrjes së raportit të rekomandimeve, *brenda afatit ligjor 20 ditor*;
- Informacion i përcjellë përsëri nga subjekti i audituar, *brenda afatit ligjor 6 mujor*, i cili përmban të dhëna të hollësishme për ecurinë e mëtejshme të zbatimit të planit të zbatimit të rekomandimeve.
- Auditimeve të posaçme për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve: për të cilat në kuadrin e bashkëpunimit institucional, si dhe në zbatim të kërkesave të Vendimit të Kuvendit 49/2017, datë 20.04.2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura” dhe Vendimit të Kuvendit nr. 134/2018 “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”,

KLSH gjatë vitit 2022 ka kryer auditime të posaçme për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve dhe ka përgatitur raportin përmbledhës mbi statusin e implementimit të rekomandimeve të lëna institucioneve të audituara, konkretisht:


- ✓ KLSH ka përcjellë me shkresën nr. 624, datë 20.06.2022 në Kuvendin e Shqipërisë “Raporti përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara gjatë periudhës 01.01.2021-30.06.2021”; dhe me shkresën nr. 136, datë 03.02.2023 ka përcjellë “Raporti përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara gjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021”.
- ✓ Gjithashtu me shkresën shkresat 624/1 prot., datë 20.06.2022 ka përcjellë Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Raportin Përmbledhës, i cili përmban Raportin “Mbi Verifikimin e Zbatimit të Rekomandimeve të auditimeve të përfunduara gjatë periudhës 01.01.2021–30.06.2021”; dhe me shkresën nr. 136/1 datë 03.02.2023 ka përcjellë “Raporti përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara gjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021”.
- ✓ KLSH ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë me shkresën nr. 136 prot., datë 10.02.2023 Raporti i konsoliduar i cili jep informacion të detajuar për zbatimin e rekomandimeve të auditimeve kryera dhe evaduar në periudhën 01.01.2021-31.12.2021. Raporti i sipërcituar i është përcjellë edhe Ministrit për Marrëdhëniet me shkresën nr. 136 prot., datë 10.02.2023 me synimin e rritjes së përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike nga subjektet e audituara.

Për vitin 2022, ka kryer auditimin e posaçëm për 127 subjekte të audituara në vitin 2021, lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, nga i cili ka rezultuar se janë dhënë gjithsej **3764**

masa: për përmirësime ligjore, masa organizative, masa administrative dhe masa disiplinore, nga të cilat janë pranuar **3646** masa ose **97%** dhe nuk janë pranuar **118** masa ose **3%**.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga **3646** masa të pranuar, janë zbatuar (plotësisht dhe pjesërisht) **1805** ose **50%**, janë në proces zbatimi **1020** ose **28%** dhe **821** masa nuk janë zbatuar ose **23%**.

Grafiku nr.2: Niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH



Burimi KLSH

Më konkretisht:

A. Rekomanduar **39** “*Masa për përmirësime ligjore*”, nga të cilat janë pranuar **36** masa ose **92%** dhe nuk janë pranuar **3** masa ose **8%**. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar janë zbatuar **13** masa ose **36%**, janë zbatuar pjesërisht **9** masa ose **25%**, janë në proces zbatimi **10** masa ose **28%** dhe nuk janë zbatuar **4** masa ose **11%**.

B. Rekomanduar **2798** “*Masa organizative*”, nga të cilat janë pranuar **2699** masa ose **96%** e tyre dhe nuk janë pranuar **99** masa ose **4%**. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht **1076** masa ose **40%**, janë zbatuar pjesërisht **145** masa ose **5%**, janë në proces zbatimi **903** ose **33%** dhe nuk janë zbatuar **575** ose **21%** e tyre.

C. Rekomanduar **437** “*Masa për eliminimin e efekteve negative*” nga të cilat janë pranuar **413** masa ose **95%** dhe nuk janë pranuar **24** masa ose **5%**. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar janë zbatuar **103** masa ose **25%**, janë zbatuar pjesërisht **26** masa ose **6%**, janë në proces zbatimi **168** masa ose **41%** dhe nuk janë zbatuar **116** masa ose **28%**.

D. Rekomanduar “*Masa për shpërbllim dëmi*” në vlerën **2,087,442¹ mijë lekë**, nga të cilat është pranuar **2,072,515 mijë lekë** ose **99%**. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve në subjekte

¹ Janë 2 masa shpërbllimi dëmi me kusht në vlerën 38,278 mijë lekë


rezultoi se nga vlera e shpërblimit të dëmit të pranuar është zbatuar plotësisht vlera **65,582 mijë lekë ose 3%** dhe është zbatuar pjesërisht vlera **247,275 mijë lekë ose 12%** e vlerës së pranuar, është në proces zbatimi shpërblimi i dëmit në vlerën **238,571 mijë lekë ose 12%**.

E. Rekomanduar **830 “Masa disiplinore”**, nga të cilat janë pranuar **828** masa ose **99.8%** dhe nuk janë pranuar **2** masa ose **0.2%**. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar janë zbatuar **523** masa ose **63%** e tyre, janë zbatuar pjesërisht **15** masa ose **2%**, janë në proces zbatimi **74** ose **9%** dhe nuk janë zbatuar **216** ose **26%** e tyre.

F. Rekomanduar **97 “Masa administrative”**, nga të cilat janë pranuar **83** masa ose **86%** e tyre dhe nuk janë pranuar **14** masa ose **14%**. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar janë zbatuar **14** masa ose **17%** e tyre, janë zbatuar pjesërisht **10** masa ose **12%**, janë në proces zbatimi **33** ose **40%** dhe nuk janë zbatuar **26** ose **31%** e tyre.

KLSH ka rikërkuar nga të gjitha subjektet përsheptimin e zbatimit të masave të shpërblimit të dëmit të pranuar por të pazbatuar si dhe të të gjitha masave që kanë rezultuar “*në proces zbatimi*” ose “*të zbatuara pjesërisht*”.

**3. KOMUNIKIMI DHE BASHKPUNIMI ME
PALËT E INTERESIT**



3. KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESIT

3.1 OBJEKTIVAT E STRATEGJISË SE KOMUNIKIMIT

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në vizionin e tij është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe për të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve. Kjo bazuar në vlera si: integriteti, pavarësia, objektiviteti, kompetenca, konfidencialiteti dhe transparenca.

Zhvillimi dhe zbatimi i një Strategjie Komunikimi është thelbësor për përmbushjen e misionit të KLSH-së dhe objektivave strategjike të zhvillimit institucional.

Për këtë qëllim, në bashkëpunim me ekspertët e SIGMA-s, u hartua Strategjia e re e Komunikimit të KLSH-së 2022-2025 duke u finalizuar me miratimin dhe publikimin e saj në korrik të vitit 2022. Strategjia e Komunikimit 2022-2025 përmban katër objektiva kryesorë strategjike, si vijon:

- Promovimi i rolit dhe mandatit të KLSH nëpërmjet shtimit të mjeteve të komunikimit me palët e interesit, me qëllim forcimin e besimit tek institucioni i auditimit të jashtëm publik
- Rritja e impaktit të veprimtarisë audituese të KLSH-së nëpërmjet raporteve cilësore, relevante dhe të qarta në funksion të llogaridhënies dhe transparencës,
- Intensifikimi i ndërveprimit me Kuvendin e Shqipërisë për rritjen e kontrollit parlamentar ndaj institucioneve publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit të auditimit të jashtëm,
- Rritja e komunikimit me subjektet e audituara dhe e konsultimit me qytetarët, median, shoqërinë civile, botën akademike dhe partnerët ndërkombëtarë.

3.2 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

KLSH, ka zhvilluar përgjatë vitit 2022, komunikimin me partnerët e jashtëm dhe të brendshëm, në ndjekje të praktikave më të mira, me qëllim rritjen e impaktit të punës audituese dhe optimizimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale, për t'iu përshtatur sa më mirë mjedisit në të cilin operon.

Në kuadër të bashkëpunimit me INTOSAI-n dhe EUROSAI-n, përmendim në veçanti pjesëmarrjet e Kryetarit të KLSH-së në evente¹ si:

- Kongresi XXIV INCOSAI, organizuar në Rio de Janeiro, Brazil, në muajin nëntor 2022, ku ndër të tjera, Kryetari i KLSH-së pati takime me homologë dhe përfaqësues të SAI-ve të pranishëm;
- Konferenca ndërkombëtare e nivelit të lartë për Institucionet Supreme të Auditimit “E ardhmja e Evropës”, ku ndër të tjera, Kryetari i KLSH-së pati disa takime me homologë;
- Takimi i Presidentëve të SAI-ve të Rrjetit të Vendeve Kandidate dhe Kandidate të mundshme për në BE;

Bashkëpunimi në nivel bilateral nëpërmjet vizitave zyrtare dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, u konkretizua si vijon:

¹ Pasqyruar gjerësisht në faqen zyrtare të KLSH

- Vizita zyrtare e zhvilluar nga Kryetari i KLSH-së në datat 16-17 shkurt 2022 pranë **Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (ZKA)**, me ftesë të Auditorës së Përgjithshme, znj. Vlora Spanca. Gjatë kësaj vizite të dy titullarët, shprehën angazhimin e plotë për të vijuar bashkëpunimin tashmë të konsoliduar ndërmjet dy institucioneve, me qëllim përsosjen, modernizimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale. Kryetari i KLSH-së, gjatë kësaj vizite marri pjesë gjithashtu, në ceremonialin shtetëror të organizuar me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës;
- Vizita zyrtare e Kryetarit të KLSH-së e zhvilluar në datat 9-10 maj 2022 pranë **Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Norvegjisë**, me ftesë të homologut z. Karl Eirik Schjøtt-Pedersen, me qëllim nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Gjatë kësaj vizite, Kryetari i KLSH-së zhvilloi edhe një takim me Kryetarin e Komisionit për Kontrollin dhe Çështjet Kushtetuese në Parlamentin e Norvegjisë, z. Peter Frølich dhe disa prej anëtarëve të këtij komisioni, ku u diskutua roli i institucioneve supreme të auditimit dhe marrëdhëniet e tyre me Parlamentin, në kontekstin e ndryshëm shoqëror dhe politik të të dy vendeve;
- Vizita zyrtare e Kryetarit të KLSH-së e zhvilluar në datat 29-30 nëntor 2022 pranë **Zyrës Shtetërore të Auditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut** me ftesë të homologut z. Maksim Acevski, me qëllim nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Gjatë kësaj vizite, Kryetari i KLSH-së u prit në një takim zyrtar edhe nga zv. Presidenti i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Goran Misovski.

Roli dhe aktiviteti i KLSH-së kanë gjetur shprehje edhe në pjesëmarrjet dhe takimet e ndërsjella që Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, ka zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional ku veçojmë:

- Konferencën ndërkombëtare “Parandalimi i Korrupsionit, sfidat aktuale dhe nevoja për bashkëpunim”, organizuar në Tiranë nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Agjencia Kombëtare Italiane Anti Korrupsion (ANAC) dhe Ambasadën e Italisë në Tiranë. Në fjalën e mbajtur, z. Shehu paraqiti një ekspozitë të punës së KLSH-së, duke e vënë theksin në angazhimet konkrete që institucioni ka ndërmarrë në drejtim të luftës kundër korrupsionit, nëpërmjet kryerjes së detyrat funksionale me profesionalizëm dhe përgjegjësi të lartë në drejtim të konstatimit dhe parandalimit të rasteve që përbëjnë korrupsion;
- Takimin me Këshilltarin Ligjor Rezident të OPDAT, z. Constantine Soupios në kuadrin bashkëpunimit të ndërsjellë;
- Takimi me Shëfën e Shërbimit Rajonal Ekonomik për Ballkanin, znj. Florence Dobelle, ku u diskutua mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit dhe rëndësinë e pavarësisë institucionale në funksion të menaxhimit sa më të mirë të financave publike, si dhe bashkëpunimin rajonal dhe me institucionet e BE-së në vend;
- Takimi me Ministrin e Punëve të Jashtme të Polonisë, njëkohësisht Kryetar i radhës i OSBE-së, Sh.T.Z. Zbigniew Rau, si edhe Ambasadoren e Polonisë në Shqipëri, Sh.S. Znj. Monika Zuchniak-Pazdan, ku u vlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve dhe bashkëpunimi i suksesshëm që institucioni i KLSH-së ka ndërtuar tashmë me NIK të Polonisë;
- Takimin me përfaqësues të Ambasadës së Italisë në Shqipëri dhe të Guardia di Finanza, gjatë të cilit u dakordësua zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta me qëllim ofrimin e shembujve dhe ekspertizës më të mirë italiane në fushat me interes të veçantë.

INTOSAI



Kongresi i XXIV i INCOSAI-t (Kongresi Ndërkombëtar i Institucioneve Supreme të Auditimit), nën drejtimin e Gjykatës Federale të Llogarive të Brazilit, u zhvillua në datat 7-11 nëntor 2022, në Rio de Janeiro. Ky Kongres trajtoi dy tema kryesore: *“Puna e Institucioneve Supreme të Auditimit përballë emergjencave publike”* dhe *“Zëri global, rezultati global dhe ndikimi i gjerë”*.

Gjatë punimeve të tij u miratuan dokumente si: Deklarata e Rios, udhëzuesi *“Rritja e Bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Kontrollit dhe Organeve anti-korrupsion në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit”* dhe *“Plani Strategjik INTOSAI 2023–2028”*.

“Duke punuar së bashku brenda komunitetit INTOSAI, SAI-t bashkëpunojnë me integritet, gjithë përfshirje, me synimin për të mos lënë askënd pas....

.....Suksesi i INTOSAI-t varet nga përkushtimi dhe angazhimi i anëtarëve të tij”

Nga Deklarata e Rios

Udhëzuesi *“Rritja e Bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Kontrollit dhe Organeve anti-korrupsion në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit”*, i cili përmbledh ekspertizën dhe bashkëpunimin ndërmjet një sërë institucionesh supreme të auditimit, vjen si kontribut i përbashkët i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe financimit të SAI-t të Emirateve të Bashkuara Arabe. Ai reflekton një pasqyrim të kuadrit të ndryshëm juridiksional dhe institucional në të cilin SAI-t operojnë. Ndër të tjera, në këtë Udhëzues, është reflektuar edhe kontributi i dhënë nga KLSH nëpërmjet ekspertëve të tij.

Bashkëpunime me Inicativën për Zhvillim të INTOSAI-t

Një ndër partnerët kryesorë të KLSH-së është Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI²). Gjatë vitit 2022, nëpërmjet konsulencës, trajnimeve dhe programeve profesionale, ekspertët e IDI-t kanë asistuar në vijimësi ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe njerëzore të audituesve në KLSH-së. Kështu, me mbështetjen e tyre u hartua **Strategjia Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027. Gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti strategjik, janë zhvilluar një sërë trajnime dhe komunikime në nivel drejtuesish dhe audituesish. Nën asistencën e ekspertëve të IDI-t dhe të SAI-t të Norvegjisë, KLSH ka kryer vetëvlerësimin e performancës institucionale sipas dokumentit të Kornizës së Matjes së Performancës të Institucioneve Supreme të Auditimit, të INTOSAI-t (SAI PMF Framework), proces i cili u finalizua me Raportin e SAI PMF dhe opinionin e ekspertit të pavarur³. Ky Raport u përcoll tek SAI-t partnere të Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, Serbisë dhe Turqisë. Raporti u përcoll gjithashtu tek ekspertët e SIGMA-s dhe SAI i Suedisë në cilësinë e koordinatorit të Grupit të Punës për aktivitetet e përbashkëta në auditim, me qëllim ndarjen dhe komunikimin e rezultateve.**

KLSH, është bërë pjesë e programit *“Kursi Profesional për Audituesit e SAI-t – Pilot”* ose PESA-P i organizuar nga IDI, me dy auditues të cilët kanë përmbushur me sukses programin

² IDI – INTOSAI Development Initiative (Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t)

³ Trajtuar më hollësisht në Kapitullin nr 4.

detyruet të aktiviteteve dhe portofolin fillestar të zhvillimit profesional, si dhe janë pajisur me certifikatën përkatëse. Në muajin gusht 2022, IDI ka vijuar edhe me edicionin special të edukimit profesional të mentorëve të programit PESA-P dhe KLSH është përzgjedhur të jetë sërish pjesë me përfaqësuesin e saj, në nivel drejtues.

EUROSAI

Konferenca ndërkombëtare e nivelit të lartë për Institucionet Supreme të Auditimit “E ardhmja e Evropës” nën drejtimin e Gjykatës Franceze të Llogarive, zhvilluar më 14-15 mars 2022, në Paris. Kjo konferencë solli në vëmendje auditimet e ndërmarra gjatë periudhës së krizës së pandemisë COVID-19, si dhe përballjen me menaxhimin e saj nga SAI-t evropiane, por edhe forcimin e dimensionit dhe impaktit të punës së Institucioneve Supreme të Auditimit, në garantimin e shpenzimit të fondeve për përballimin e kësaj krize dhe monitorimin e saj me eficiencë dhe efektivitet.

Takimi i Presidentëve të SAI-ve të Rrjetit të Vendeve Kandidate dhe Kandidate të mundshme për në BE, nën drejtimin e OECD/SIGMA, zhvilluar më datën 16 mars 2022, në Paris. Kryetarët e SAI-ve të Shqipërisë, Kosovës, Turqisë, Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, dakordësuan dhe theksuan rëndësinë e bashkëpunimit dhe zhvillimit të aktiviteteve në kuadër të Rrjetit, si një vlerë e shtuar në zhvillimet e kapaciteteve të institucioneve respektive. Në këtë kuadër, u miratua dhe Programi i Punës 2023-2025.

Takimi i Komitetit të Kontaktit nën drejtimin e Gjykatës Evropiane të Llogarive, u zhvillua në datat 3-4 maj 2022, në Luksemburg. Drejtuesit e SAI-ve të BE-së, e vunë theksin në përdorimin me efektivitet të fondeve të alokuara për menaxhimin e pandemisë COVID-19.

AKTIVITETE NË KUADËR TË GRUPEVE TË PUNËS DHE TASK FORCE



Grupi i Punës së EUROSAI për Auditimet e Mjedisit – WGEA⁴:

Përgjatë vitit 2022, janë zhvilluar dy takime të këtij grupi pune, respektivisht takimi që u zhvillua online në datat 10-11 maj 2022, me temë *“Furnizimi me ujë dhe cilësia e tij në aspektin e ndryshimit të klimës”*, i cili u ndoq nga 4 auditues. Takimi i XX, vjetor u zhvillua me prezencë fizike në datat 29-30 nëntor 2022, në Varshavë. Tematika e trajtuar ishte *“Mbrojtja e Mjedisit në kohëra të trazuar”* me fokus në katër aspekte kryesore si: ndryshimet klimatike, kriza energjitike, menaxhimi i mbetjeve në kontekstin e COVID-19 dhe financimi i mbrojtjes së mjedisit, ku morën pjesë 2 auditues.



Grupi i Punës së EUROSAI për Teknologjinë e Informacionit – ITWG⁵:

Takimi i XV i këtij grupi pune u zhvillua në datat 6-7 shtator 2022 në Bukuresht, ku morën pjesë 2 auditues. Ky takim përkoj edhe me 30-vjetorin e ri-themelimit të Gjykatës Rumune të Llogarive. Temat e trajtuara gjatë takimit ishin *“Standardet dhe udhëzimet IT, e ardhmja e auditimit IT”*. KLSH prezantoi Manualin Aktiv të Auditimit *“CUBE&AITM use case”*. Gjithashtu, KLSH si një ndër anëtarët më aktivë të këtij

⁴ WGEA – Working Group on Environmental Auditing

⁵ ITWG – IT Working Group

grupi pune, u prezantua me kontributin e vet në Buletinin e II-të informativ për vitin 2022, me artikullin “Sfidat gjatë auditimit të E-Qeverisjes”.

Pjesëmarrje aktive, audituesit e KLSH-së patën dhe në e-seminarin e zhvilluar më 12 prill 2022, nga ky grup pune, me temë “Uji pas digës – sfidat që lidhen me rrjedhën e të dhënave për një Institucion Suprem Auditimi”, ku morën pjesë 7 auditues, si dhe në modulet profesionale të përgatitura nga ky grup pune për auditues që nuk kryejnë auditime IT me titull “IT for non IT auditors”, të cilat janë në vazhdim dhe po ndiqen nga 6 auditues të KLSH-së.



Grupi i Punës së EUROSAI për Auditimin e Fondeve të Alokua për Katastrofat dhe Fatkeqësitë Natyrore – WGAFADC⁶:

Takimi i VIII i Grupit të Punës së EUROSAI-t, për Auditimin e Fondeve të Alokua për Katastrofat dhe Fatkeqësitë Natyrore u zhvillua më 22 nëntor 2022, përmes platformës online, i organizuar nga SAI i Ukrainës, në cilësinë e drejtuesit dhe sekretariatit të këtij grupi pune. Në fokus të këtij takimi ishin çështjet në lidhje me alokimin e fondeve shtetërore për tërmetet, pandeminë e COVID-19 dhe në veçanti, mbi pasojat e agresionit rus në Ukrainë.

Në këtë forum morën pjesë rreth 15 SAI-e dhe u prezantuan praktikak më të mira në fushën e auditimit të fondeve të alokuara për katastrofat dhe fatkeqësitë natyrore, si: përdorimi efektiv i fondeve për pandeminë e Covid-2019; auditimi mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në Ukrainë si pasojë e agresionit ushtarak të Federatës Ruse; dhe auditimi mbi menaxhimin e fatkeqësive nga zjarret në pyje. Ky takim u ndoq nga 3 auditues të KLSH-së, të cilët theksuan vëmendjen që institucioni po i kushton këtyre çështjeve, përmes auditimeve të zhvilluara si në nivel vendor ashtu edhe në atë qendror për tërmetin e rëndë të 26 nëntorit 2019 dhe pandeminë e Covid-19.



Task-Force e EUROSAI për Auditimin e Bashkive – TFMA⁷:

Takimi i VI i Task Forcës së EUROSAI-t për Auditimin e Bashkive si dhe seminari me titull “Dixhitalizimi i shërbimeve publike të ofruara nga Bashkitë”, u zhvilluan në datat 19-20 tetor 2022 në Vilnius. Në këtë takim morën pjesë rreth 26 SAI dhe KLSH u përfaqësua me 3 auditues. Në fokus të diskutimeve ishin problematikat dhe zgjidhjet e mundshme lidhur me shërbimet që Bashkitë ofrojnë në format të dixhitalizuar, tranzicioni dixhital në Evropë, si dhe mundësitë për rritje dhe zhvillim në të ardhmen. Në punimet e këtij takimi, KLSH paraqiti prezantimin me temë “Aksesi i qytetarëve në shërbime të dixhitalizuara” dhe moderoi diskutimin mbi “Përmirësimin e mundësive të qytetarëve në përdorimin e shërbimeve online”. Gjithashtu, ata morën pjesë edhe në e-seminaret e organizuara nga kjo task force në bashkëpunim me Bankën Botërore me temat “Shkëmbimi i rezultateve të auditimeve më të fundit të anëtarëve të TFMA-së, inovacioni në auditimet e bashkive ose inovacioni që nxitet nga auditimi” dhe “Praktikat ndërkombëtare në auditimin e institucioneve të qeverisjes vendore”. KLSH është prezantuar me kontributin e saj edhe në Revistën nr. 5 të TFMA-së me artikullin “Sfidat e reja të KLSH-së në kontekstin e ndryshimeve ligjore të ligjit financiar për Bashkitë”.

⁶ WGAFADC - Working Group on the Audit of Funds Allocated to Disasters and Catastrophes

⁷ TFMA – Task Force on Municipality Audit

Grupi i Punës i INTOSAI për Vlerësimin e Politikave Publike dhe Programeve⁸

Në forumin e zhvilluar në Bernë në datat 26-28 shtator 2022, morën pjesë 85 auditues nga 35 SAI të ndryshme të botës. Ky grup pune ka si objektivi strategjik shkëmbimin e njohurive dhe synon të informojë SAI-t me informacione, metodologji dhe shembuj praktikash të mira. KLSH mori pjesë në këtë forum me 2 auditues, të cilët u angazhuan edhe në workshopin mbi identifikimin e temave të mundshme të auditimit, të përshtatshme në nivel ndërkombëtar, mbi të cilat mund të zhvillohen auditime të përbashkëta.

KLSH DHE BASHKËPUNIMI BILATERAL ME SAI HOMOLOGE

Gjatë vitit 2022, në kuadër të thellimit të bashkëpunimit ndërinstitucional me SAI-t homologe, janë nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi:

- ⊖ **Marrëveshja e Bashkëpunimit me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Norvegjisë** u firmos më datë 9 maj 2022, në Oslo. Kjo marrëveshje ka për qëllim vendosjen e bashkëpunimit në shkallë të gjerë, në auditimet e performancës në fushën e mjedisit dhe në auditimet IT. Ky bashkëpunim, krahas mundësisë së shkëmbimit të eksperiencave profesionale midis palëve në fushat e parashikuara në marrëveshje, do të mundësojë ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së në auditimet e performancës, mjedisit dhe IT. Gjithashtu, angazhimi i ndërsjellë do të vijojë edhe në forcimin e bashkëpunimit në fusha të tjera me interes të përbashkët. Plani i punës për bashkëpunimin e ndërsjellë ka përcaktuar serinë e aktiviteteve që do të zhvilloheshin dhe është materializuar në një sërë Workshop-e të zhvilluara në KLSH.
- **Marrëveshja e bashkëpunimit me Zyrën Shtetërore të Auditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut u firmos më datë 29 nëntor 2022**, në Shkup. Kjo marrëveshje ka për qëllim vendosjen e bashkëpunimit dypalësh në shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve mbi çështje me interes të përbashkët si buxhetimi gjinor në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, auditimet në fushën minerare, etj., si dhe ndërveprimin në sferën e trajnimeve profesionale dhe përmirësimin e standardeve profesionale dhe metodologjisë së auditimit, me qëllim rritjen e kapaciteteve të audituesve, si dhe kryerjen e auditimeve paralele, të koordinuara dhe të përbashkëta.

BASHKËPUNIMI NË AUDITIME PARALELE

Me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe praktikave audituese, KLSH ka vijuar angazhimin në auditimet paralele të ndërmarra si në nivel bilateral ashtu edhe në kuadrin e anëtarësisë në grupet e punës së EUROSAT-t, si vijon:

1. Auditimi paralel i performancës, me temë *“Garantimi i të Drejtave të Pasagjerëve në Transportin Ajror”*, u organizua nën drejtimin e SAI-t të Suedisë me institucionet supreme të auditimit të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë;
2. Auditimi paralel me temë *“Menaxhimi i Mbetjeve plastike në Shqipëri”* aktualisht i përmbyllur nga ana KLSH;

⁸ WGEPPP – Working Group on Evaluation of Public Policies and Programs

3. Auditimi paralel me temë “Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e Bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë “ për të cilin ka përfunduar puna për pjesën takuese të KLSH-në, pritet të përmbyllet në muajin mars 2023;
4. Auditimi paralel me temë “Sistemet e TI-së në Ujësjellës – Kanalizime Tiranë sh.a”, po zhvillohet në bashkëpunim me ZKA e Kosovës. Grupet respektive të auditimit kanë zhvilluar takimet paraprake dhe auditimi është në fazën e evadimit të raportit përfundimtar.

KLSH dhe shkëmbimi i praktikave dhe eksperiencave nëpërmjet pjesëmarrjes në takime, konferenca, seminare dhe trajnime

Me gjithë rikthimin në normalitet pas pandemisë së COVID-19 dhe organizimit të aktiviteteve me prezencë fizike, përgjatë vitit 2022, përsëri, një pjesë e tyre u organizuan edhe në formatin online. Si vijon janë të renditura disa prej aktiviteteve të tjera ku përfaqësues të KLSH-së kanë marrë pjesë respektivisht:

- Konferenca e 13-të e UNCTAD (United Nations Conference on Trade and Development) mbi “Menaxhimin e Borxhit Publik”, zhvilluar në Gjenevë, në datat 5-7 dhjetor 2022;
- Post Kongresi i EUROSAT nën drejtimin e Zyrës Supreme të Auditimit të Çekisë, u zhvillua në datat 22-24 maj 2022, në Pragë. SAI-t pjesëmarrëse diskutuan dhe shkëmbyen eksperiencë në çështjet si: lufta kundër korrupsionit dhe auditimi i taksave, bashkëpunimi profesional, si dhe sfidat për të ardhmen;
- Konferenca V Young EUROSAT mbi “Kulturën Eksperimentale”, nën drejtimin e Zyrës së Auditimit të Suedisë, u zhvillua në datat 12-15 shtator 2022, në Stokholm. Kjo konferencë trajtoi nevojën dhe domosdoshmërinë e SAI-ve për t’u përshtatur në rrethanat e reja të një mjedisi që ndryshon, për të qenë inovativë në metodat e punës duke ruajtur gjithmonë besueshmërinë dhe pavarësinë;
- Takimi i Bordit të audituesve të NATO-s, i zhvilluar në platformën online më datë 22 qershor 2022;
- Trajnimet rajonale mbi “Krijimin e mbikëqyrjes gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut; dinamika brenda vendeve dhe sfidat rajonale” të zhvilluara në Prizren në datat 15-17 qershor 2022 dhe në Ohër në datat 21-23 shtator 2022 në kuadër të projektit DECOS financiar nga Ministria e Jashtme e Hollandës dhe i zbatuar nga Qendra për Studime të Sigurisë Evropiane në Holandë;
- Trajnimi mbi “Analizat Sasiore”, i zhvilluar në datat 26-27 shtator 2022 në Prishtinë, i organizuar nga ZAP i Kosovës në bashkëpunim me SAI-n e Suedisë;
- Trajnimi tre-javor mbi auditimet e performancës, i zhvilluar në datat 14 nëntor – 9 dhjetor 2022, i organizuar nga SAI i Indisë në kampusin Noida në New Delhi;
- Konferenca “E ardhmja e BE-së”, e zhvilluar në datën 22 mars 2022 e organizuar nga ECA në Luksemburg;
- Workshopi rajonal “Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve” i zhvilluar në Podgoricë, në datat 10-11 mars 2022, i organizuar nga SAI i Malit të Zi në bashkëpunim me Fondacionin Westminster;
- Trajnimi dy javor online i zhvilluar në datat 12-23 shtator 2022, i organizuar nga Gjykata

- e Llogarive Franceze për audituesit e rinj;
- Webinari “Përshtatja e dixhitalizimit në auditim dhe lufta kundër korrupsionit”, i zhvilluar në datën 30 qershor 2022, i organizuar nga SAI i Emirateve të Bashkuara Arabe;
- Forumi rajonal me titull “Lufta kundër korrupsionit, në fokus Ballkani Perëndimor”, i zhvilluar online më datë 7 prill 2022, nga Instituti për Demokraci në Shkup;
- Konferenca online, mbi “Menaxhimin financiar të agjencive të BE-së”, e zhvilluar në datën 27 tetor 2022, e organizuar nga ECA;
- Konferenca ndërkombëtare online “Edukimi në kontekstin modern dhe edukimi i profesionistëve në të ardhmen”, i zhvilluar në datë 2 mars 2022, me iniciativë të Bordit Drejtues të INTOSAI-t;
- Trajnimi dy javor online “Mbi menaxhimin e mbetjeve i zhvilluar nga data 14-25 nëntor 2022, i organizuar nga INTOSAI WGEA dhe SAI i Indonezisë;
- Workshop i EUROSAT-t për DEA (data envelopment analysis), qasja praktike, i zhvilluar në datat 24-25 nëntor 2022, i organizuar nga SAI-t e Suedisë dhe Norvegjisë, në Pragë;
- KLSH gjithashtu ishte pjesëmarrëse në eventin e nivelit të lartë të organizuar online nga IDI dhe Unioni Ndër-Parlamentar, me fokus bashkëpunimin ndërmjet SAI-ve dhe Parlamenteve, me qëllim rritjen e impaktit të punës audituese dhe përgjegjshmërisë.
- Trajnimet online për audituesit IT organizuar nga i CISA – SAI i Indisë, zhvilluar në muajt shkurt, qershor, korrik, si dhe takimet online mbi terminologjinë në auditime në gjuhën angleze, sigurinë e cilësisë, integritetin, qëllimet strategjike SG1 dhe SG2 të EUROSAT-t.

Gjatë vitit 2022, janë përmbyllur gjithashtu procedurat për pjesëmarrje në Internship-in e Gjykatës Evropiane të Llogarive ECA (mars-korrik, 2023 - dy auditues); Fellowship-in e Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, GAO (maj – korrik 2023, 1 auditues); dhe bashkëpunimi me Universitetin e Auditimit Nanjing të Kinës, për programin Master të cilin aktualisht po e ndjekin dy auditues.

BASHKËPUNIMI ME PARTNERË TË TJERË NDËRKOMBËTARË

KLSH dhe SIGMA: Në procesin e hartimit të Strategjisë të Komunikimit 2022-2025, SIGMA përveç konsulencës dhe praktikave më të mira të ofruara, zhvilloi gjithashtu anketa me subjektet e audituara dhe aktorë të tjerë të jashtëm, në lidhje me rolin dhe statusin e KLSH-së. Rezultatet e këtij anketimi ndihmuan në evidentimin e prioritete dhe formulimin e objektivave strategjike institucionale.

Krahas bashkëpunimit për Strategjinë e Komunikimit 2022-2025, ka vijuar gjithashtu komunikimi dhe takimet me ekspertët e SIGMA-s dhe grupit të punës të ngritur, për hartimin e Manualit praktik mbi Auditimin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit.

KLSH dhe Prezenca e OSBE-së dhe Autoriteti Kombëtar Italian Anti Korrupsion ANAC: Në kuadër të bashkëpunimit të filluar tashmë që në vitin 2021, OSBE në partneritet me ANAC kanë vijuar përgjatë vitit 2022, respektivisht në muajin mars dhe tetor, me modulën e III të trajnimeve për audituesit e KLSH-së, dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet tyre dhe ekspertëve të lartë të ANAC. Fokusi kryesor ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave koncesionare nga perspektiva e auditimit të jashtëm duke prezantuar mjetet se si mund të përshtaten praktikat

më të mira ndërkombëtare në kuadrin institucional kombëtar.

KLSH dhe SECO për Projektin *“Forcimi i mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat në Shqipëri”*, i financuar nga Sekretariati i Çështjeve Ekonomike të Zvicrës (SECO), përfundoi procedurat dhe realizoi nënshkrimin e kontratës me bashkimin e operatorëve në datë 11.10.2022. Manuali i auditimit të kontratave koncensionare dhe PPP do të hartohet në përfundim të 3 auditimeve pilot (parashikuar në tremujorin e fundit të vitit 2023). Pas miratimit të këtij manuali do të zhvillohen trajnimet për zbatimin e tij (parashikuar në tremujorin e parë të vitit 2024).

KLSH dhe UN Women Albania: Në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet KLSH dhe UN Women Albania, me qëllim ofrimin e asistencës në drejtim të barazisë gjinore dhe monitorimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, KLSH ka ndërmarrë auditimin e performancës me temë *“Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë”*. Ky auditim u konkretizua në vijim të sesionit 3 ditor të trajnimit të zhvilluar në datat 27-29 prill 2022, mbi buxhetimin e përgjithshëm gjinor dhe auditimin gjinor, me fokus përfshirjen e barazisë gjinore në metodologjinë dhe praktikën e auditimit, si dhe ofrimin e njohurive mbi realizimin e auditimeve gjinore.

Në vijim, nga UN Women Albania, në datën 12 korrik 2022 u organizua në Banja Luka, takimi ndërmjet përfaqësuesve të lartë të SAI-ve të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe të Bosnje dhe Hercegovinës, me qëllim dakordësimin për zhvillimin e një auditimi paralel me fokus objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm SDG 5 – Barazia Gjinore. Në këtë kuadër, në datat 17-19 tetor 2022, u zhvillua në Stokholm vizita studimore e organizuar me përfaqësues të SAI-ve të rajonit pranë SAI-t Suedez, si dhe disa institucioneve të tjera me qëllim shkëmbimin e eksperiencave mbi buxhetimin gjinor duke vijuar me pjesëmarrje në konferencën rajonale të organizuar nga UN Women me temë *“Financimi transformues për avancimin e barazisë gjinore”*.

KLSH DHE BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE

Duke i konsideruar një partner të rëndësishëm këto organizata, si një përçues i vlefshëm i mesazhit të rekomandimeve të KLSH-së mbi përdorimin e fondeve publike dhe që shërbejnë gjithashtu, si një ndihmesë për të identifikuar problematikat e ndryshme të shoqërisë, edhe gjatë vitit 2022, ka vijuar komunikimin me to, duke marrë pjesë dhe duke kontribuar në panele diskutimi, takime dhe tryeza të rrumbullakëta, si vijon:

- Takimi i punës *“Shqipëria n’Kuvendim – Mbikqyrja parlamentare”*, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim;
- Paneli i diskutimeve *“Përfshirja e kriterëve të menaxhimit mjedisor në prokurimet publike”* ku KLSH diskutoi mbi sfidat e kriterëve specifike në parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve plastike në prokurimet publike, organizuar nga Milieukontakt Shqipëri dhe Qendra Rajonale e Konventës së Baselit në Bratislavë;
- Tryeza e rrumbullakët *“Prezantimi i gjetjeve të Barometrit të Sigurisë, Shqipëri 2022”* edicioni i IV, me fokus *“Ndërlidhja e politikë bërjes dhe ofrimit të sigurisë me qëndrimet dhe preokupimet e qytetarëve”*, organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes;
- Konferenca kombëtare *“Angazhimi i qytetarëve në proceset parlamentare”*, organizuar nga IDM në kuadër të projektit PACEP *“Mbështetja për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri”*;

- Konferenca e III Rajonale “Qytetarët të parët” organizuar nga IDM dhe Rrjeti “Mendo për Europën”, TEN;
- Workshop-i “Shkëmbimi i të dhënave dhe prezantimi i analizave mbi monitorimin e qeverisjes 2021-2022”, organizuar nga KLSH dhe Qëndresa Qytetare.

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me universitetet në vend, KLSH ka organizuar përgjatë muajit shkurt 2022, disa prej analizave vjetore të punës të departamenteve të auditimit në disa prej katedrave universitare më të rëndësishme në vend, si ato Universiteteve të Shkodrës, Elbasanit, Durrësit, Korçës, Vlorës. Gjatë prezantimeve të analizave të punës kanë marrë pjesë edhe pedagogë e studentë të këtyre universiteteve, të cilët kanë shkëmbyer ide, diskutime dhe kanë bërë pyetje për të kuptuar më mirë rolin e institucionit dhe impaktin e punës audituese.

3.3 KLSH DHE PARLAMENTI



KLSH, në cilësinë e institucionit më të lartë kushtetues të kontrollit ekonomik e financiar në vend, ka si mision të tij të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit. Në përputhje me të gjitha parimet themelore dhe standardet ndërkombëtare, rekomandimet e BE-së, por edhe në zbatim të planeve strategjike të zhvillimit institucional, ku në fokus mbetet bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me Kuvendin, KLSH ka vijuar komunikimin nëpërmjet Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, në kuadër të përmbushjes së detyrimit periodike raportuese si dhe, për të rritur eficiencën e punës audituese dhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve në mbështetje të qeverisjes së mirë, llogaridhënies dhe transparencës. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2022, KLSH ka përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë:

- ✓ Raportin e Performancës për vitin 2021, në muajin mars 2022, duke vijuar më pas me paraqitjen e këtij raporti në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave më 20.04.2022, nga Kryetari i KLSH, z. Arben Shehu. Ky raportim, duke marrë në konsideratë interesin e shtuar të deputetëve për çështjet e trajtuara në raport, ka vijuar edhe më datë 31.05.2022 ku përfaqësuesit e KLSH-së i janë përgjigjur të gjitha pyetjeve të drejtuara nga deputetët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Raporti i performancës së aktivitetit të KLSH për vitin 2021 është raportuar në seancën plenare të datës 07.07.2022 nga Kryetari i KLSH-së, në përfundim të së cilës është miratuar edhe Rezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021”.
- ✓ Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2021, në muajin tetor duke vijuar më pas me paraqitjen e rezultateve dhe opinionin mbi zbatimin e buxhetit faktik të vitit paraardhës, të Komisionit për Ekonominë dhe Financat më datë 28 tetor 2022, nga Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu.
- ✓ Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Kryetarit të Kuvendit, nr. 134/2018 “Për Manualin e monitorimit vjetor dhe periodik të këtyre institucioneve”, KLSH edhe gjatë vitit 2022 ka informuar Kuvendin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna institucioneve të audituara. Raporti për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për auditimet e kryera për vitin 2020, i është përcjellë Kuvendit në muajin shkurt 2022 dhe raporti për periudhën janar-qershor 2021, i është përcjellë Kuvendit në muajin qershor 2022. Njëkohësisht, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë për menaxhimin e fondeve publike nga subjektet e audituara, këto raporte i janë përcjellë edhe Ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Platforma elektronike e Kuvendit vijon të përditësohet me informacion lidhur me statusin e pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna për institucionet qendrore dhe ato të varësisë.
- ✓ KLSH përgjatë vitit 2022 e ka informuar Kuvendin në vijueshmëri nëpërmjet përcjelljes periodike të raporteve përfundimtare të auditimit, të cilat përmbajnë rezultatet konkrete mbi përdorimin e parasë publike nga institucionet në të gjitha nivelet e qeverisjes.
- ✓ Në kuadër të bashkëpunimit, përfaqësues të KLSH-së janë ftuar për të marrë pjesë dhe dhënë kontributin e tyre edhe në seancat e komisioneve të tjera parlamentare si në rastin e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrative Territoriale.
- ✓ Përfaqësuesit e KLSH-së kanë marrë pjesë gjithashtu në takimin e Grupit Ndërinstitucional, i cili do të rishikojë kuadrin rregullator të funksionimit të mekanizmit ndërinstitucional për monitorimin e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të

institucioneve të pavarura në kuadër të projektit të OSBE-së “Për mbështetjen e Kuvendit dhe Edukimin Qytetar”.

Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit

Me qëllim evidentimin e progresit të arritur në zbatim të rekomandimeve të shprehura në Rezolutën e Kuvendit të miratuar më 07.07.2022, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka miratuar më datë 29.07.2022, Planin e Veprimit “Për zbatimin e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021”, në të cilin janë përcaktuar masat, strukturat përgjegjëse, afatet dhe treguesit e rezultateve në zbatim të këtyre rekomandimeve, me vëmendje të veçantë në:

Rekomandimi 1: Auditime sistemi për të vlerësuar eficiencën dhe efektivitetin e tyre mbi çështje të përfshira në strategjitë ndërsektoriale.

Me fokusin tek strategjitë sektoriale të hartuara nga qeveria dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB, KLSH duke u bazuar në problematikat e konstatuara vitet e fundit për këto sektorë dhe nëpërmjet analizës së riskut të përditësuar, kanë përfshirë në planin vjetor të vitit 2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së me vendimin nr. 234, datë 16.12.2022⁹, auditime të sistemeve në fushën e shëndetësisë, minierave etj.

Rekomandimi 2. Rritja e impaktit të auditimit nëpërmjet përmirësimit të qasjeve dhe cilësisë së raporteve si produkt i punës audituese, duke synuar nxitjen e ndryshimeve pozitive dhe përmirësimeve në drejtim të qeverisjes së mirë në vend.

- ✓ Në këtë kuadër, krahas monitorimit të cilësisë dhe zbatimit të standardeve gjatë procesit auditues “në të nxehtë” është vijuar me kryerjen kontrollit të cilësisë “në të ftohtë”, në zbatim të urdhrit nr. 83 datë 11.10.2022, të Kryetarit të KLSH-së, “Për kontrollin e sigurimit të cilësisë në procesin auditues për vitin 2022” për auditimet e kryera gjatë këtij viti, duke përzgjedhur për kontroll 52 dosje auditimi ose rreth 30% e dosjeve të evaluara gjatë vitit 2022.
- ✓ Ndërkohë, nga pikëpamja e përmirësimit metodologjik i qasjes së auditimeve në funksion të rritjes së cilësisë, është rikonceptuar njësi e metodologjisë, planifikimit strategjik dhe zhvillimit profesional, si dhe po vijon puna për rishikimin e Rregullores së Procedurave të auditimit.

Rekomandime 3. Të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe parandalimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP), nëpërmjet zhvillimit të auditimeve cilësore, si dhe dhënien e rekomandimeve me vlerë të shtuar në mirëmenaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmirësuar dhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderëve publikë përkatës dhe lidhjes së zbatimit të kontratave koncesionare.

- ✓ KLSH, në zbatim të projektit të financuar nga SECO “Forcimi i mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat në Shqipëri” për auditimin e 3 kontratave koncesionare dhe PPP, me qëllim ofrimin e asistencës ndaj audituesve në kryerjen e auditimeve cilësore në këtë fushë, në tetor të vitit 2022 u realizua kontraktimi i konsulentëve dhe aktualisht ky projekt është në fazën e kryerjes së auditimit të parë pilot. Në përfundim të projektit do të hartohet edhe një manual për auditimin e këtyre

⁹ Plani vjetor i auditimeve i publikuar në <https://panel.klsh.org.al/storage/phpcHQaU7.pdf>

lloj kontratave, i cili do të shërbejë si një udhëzues praktik për audituesit shtetëror, në funksion dhe të dhënies së rekomandimeve koherente në mirëmenaxhimin e tyre.

- ✓ Gjithashtu, KLSH ka realizuar me sukses një sërë modulesh trajnimi për audituesit, të zhvilluara nga Autoriteti Kombëtar Italian kundër Korrupsionit (ANAC) në bashkëpunim me OSBE me fokus kontratat e PPP dhe Prokurimin Publik, si dhe identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik në auditimin e jashtëm.

Rekomandimi 4. Në funksion të rritjes së shkallës së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së të forcojë bashkëpunimin me ekzekutivin dhe legjislativin nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të ndërtuara të bashkëpunimit me këto institucione dhe të ketë një qasje bashkëpunuese me Ministrinë e Financave, për kategorinë e rekomandimeve që paraqesin detyrime financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

- ✓ Në mënyrë periodike janë dërguar: raportet e auditimit pranë Kuvendit të Shqipërisë si dhe rast pas rasti KLSH ka vendosur në dispozicion dokumentacion mbi çështje të veçanta të audituara, në përgjigje të kërkesave të deputetëve. Ndërkohë, pritet të dërgohet draft Memorandumi i bashkëpunimit nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat.
- ✓ Në lidhje me bashkëpunimin me ekzekutivin, KLSH ka patur një komunikim proaktiv me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë gjatë procesit të auditimit mbi zbatimin e buxhetit faktik. Ndërkohë, MFE pritet të vijojë me axhendën e takimeve në kuadër të veprimtarisë së Sekretariatit të përbashkët.

Rekomandimi 5. Të publikojë raportet e auditimit në faqen Web brenda 60 ditëve nga protokollimi i vendimit të auditimit, si dhe të angazhohet për pasurimin e Platformës Ndërinstitucionale Online dhe hedhjen e të dhënave sipas përcaktimeve në vendimin e Kuvendit nr. 49/2017 "Për krijimin e mekanizmit të monitorimit sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj".

- ✓ Raportet përfundimtare të auditimit janë publikuar në faqen zyrtare brenda afateve kohore të përcaktuara. Për vitin 2022 janë publikuar 179 raporte përfundimtare auditimi krahasuar me 100 raporte të publikuara në vitin 2021. Gjithashtu, KLSH ka vijuar edhe gjatë vitit 2022, të përditësojë me informacion Platformën Institucionale të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me rekomandimet e dhëna në auditimet e kryera në 6 mujorin e parë dhe të dytë të vitit 2021.

Rekomandimi 6. Të përmirësojë treguesit e transparencës përmes komunikimit të rezultateve të KLSH-së për Kuvendin, publikun dhe palët e interesit, si dhe duke rritur nivelin e publikimeve të raporteve të auditimit në faqen zyrtare.

- ✓ Kuvendi i Shqipërisë është informuar në mënyrë të vazhdueshme me raportet e auditimit të cilat janë evaduar gjatë vitit 2022. Në Kuvend janë dërguar 179 raporte auditimi si dhe janë publikuar dhe dërguar në Kuvend dhe 3 Buletine Statistike.

Rekomandimi 7. Të modernizojë kanalet e komunikimit për të forcuar mesazhet kyçe në qasje të çdo pale të interesit duke aplikuar metoda dhe rrugë inovative, duke theksuar rëndësinë e komunikimit efektiv midis KLSH-së e publikut dhe rritjes së transparencës, si dhe të krijojë një hapësirë të dedikuar në faqen zyrtare për komunikimin me publikun dhe

institucionet.

- ✓ Përfaqësuesit e KLSH-së kanë marrë pjesë në dy seanca dëgjimore të Komisionit për Reformën Administrative Territoriale, ku kanë prezantuar veprimtarinë audituese të fushës,
- ✓ Gjatë vitit 2022, KLSH ka administruar 428 ankesa dhe kërkesa për informacion nga qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit, krahasuar me 399 të trajtuara një vit më parë.
- ✓ Në cilësinë e anëtarit të komunitetit EUROSAI dhe INTOSAI, KLSH ka thelluar bashkëpunimin profesional me SAI-t homologe. Janë firmosur gjatë kësaj periudhe dy Marrëveshje Bashkëpunimi, respektivisht, me SAI-n e Norvegjisë si dhe me SAI-n e Maqedonisë së Veriut.

Rekomandimi 8. Të angazhohet për optimizimin e kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse si prioritet kryesor në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

- ✓ Gjatë vitit 2022, në kuadër të ngritjes dhe forcimi i kapaciteteve të stafit auditues dhe atij mbështetës nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave midis kolegëve, trajnimeve të brendshme dhe të jashtme, etj., është hartuar dhe miratuar me vendimin nr.25 datë 04.02.2022, Programi i Zhvillimit të Integruar profesional i KLSH për vitin 2022 me rreth 21 module trajnimi të brendshme.
- ✓ Lidhur me trajnimet e zhvilluara me organizata të huaja për vitin 2022 janë realizuar në total 28 module trajnimesh.
- ✓ Në kuadër të trajnimeve me ASPA për vitin 2022 kanë ndjekur trajnime online-webinar, 111 auditues.
- ✓ Në total, nga trajnime të brendshme, ASPA dhe organizata ndërkombëtare për vitin 2022 janë realizuar nga stafi auditues 3905 ditë trajnimi me një mesatare 27 ditë trajnimi/auditues.

Rekomandimi 9. Të intensifikojë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare për përditësimin e vazhdueshëm të metodologjive të auditimit dhe aplikimin e praktikave më të mira në frymën e zbatimit të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të institucionit.

- ✓ Sa trajtuar edhe më sipër, KLSH-së ka vijuar komunikimin dhe bashkëpunimet me organizatat ku KLSH aderon, grupet e punës respektive, si dhe me SAI homologe.

Rekomandimi 10. Të bashkëpunojë në mënyrë të vazhdueshme me faktorët kyç vendimarrës në luftën kundër korrupsionit dhe vënies para përgjegjësisë nëpunësve të lartë të shtetit, abuzues me interesin publik.

- ✓ KLSH, rast pas rastit ka vijuar të përcjellë pranë organeve kompetente rastet e identifikuara me elementë të veprës penale në raportet e auditimit, si dhe në kuadër të bashkëpunimit me këto organe ka shkëmbyer informacione të nevojshme duke kontribuar në evidentimin e rasteve që përbëjnë abuzim me fondet publike.

3.4 KLSH DHE MEDIA

Në përmbushje të objektivave strategjikë të zhvillimit institucional dhe strategjisë së komunikimit bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës, qartësisë, vërtetësisë, inovacionit, koherencës dhe aksesueshmërisë në informacion, media konsiderohet një partner i rëndësishëm strategjik i institucionit, me të cilin KLSH ndërvepron për të përcjellë rezultatet e auditimit tek me qytetarët dhe palët e tjera të interesit, duke rritur kështu impaktin e punës audituese të KLSH.

Konkretisht, aktiviteti auditues i KLSH-së për vitin 2022 është pasqyruar gjerësisht në shtypin e shkruar nëpërmjet 300 artikuj të publikuar si dhe mbi 1500 artikujve dhe kronikave në median audio-vizive dhe online, që i referohen raporteve përfundimtare të auditimit të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ndër raportet e auditimit të ndjekura dhe të raportuara me më shumë interes nga media, të cilat kanë pasur në fokus çështje sensitive për përdorimin e fondeve publike dhe shëndetin apo mirëqenien e qytetarëve përfshihen: raportet për zbatimin e buxhetit të shtetit, auditimet e kryera në tatime dhe dogana, kontratat e partneritetit publik-privat, si koncensionet në shëndetësi, inceneratorët, projektet e infrastrukturës rrugore, etj.

Gjetjet dhe rekomandimet e evidentuara nga KLSH përmes raporteve të auditimit kanë shërbyer si burim informacioni për kronika investigative të zgjeruara televizive ku konkretisht emisioni investigativ “InsideStory” ka përgatitur 7 dokumentarë, në të cilët janë përfshirë disa raporte auditimi të KLSH-së, të kryera në institucione qendrore dhe bashki të vendit, ku janë trajtuar çështje, si: sulmi kibernetik, shpërdorimi i fondeve universitare, keqtrajtimi i jetimëve, koncesionet në infrastrukturën rrugore, “Rilindja urbane”, fondet e bujqësisë, shërbimet e ofruara në sistemin shëndetësor publik, etj., duke ndikuar në këtë mënyrë në rritjen e profilit publik të veprimtarisë së institucionit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, në media ka gjetur një pasqyrim të zgjeruar 97-vjetori i krijimit të institucionit nëpërmjet: intervistës televizive në SCAN TV e Kryetari i KLSH, z. Arben Shehu ku ai u shpreh mbi rezultatet e punës audituese, por edhe sfidat e institucionit për të ardhmen; intervistës së Drejtorit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit për një prezantim të Raportit vjetor të performancës 2021 të institucionit, si dhe të një bisede në studio e RTSH me 4 auditues të rinj, për të promovuar rolin e KLSH si institucioni më i lartë dhe i pavarur i auditimit të jashtëm publik. Gjithashtu, lidhur me historinë e rrugëtimit të institucionit ndër



vite, Report Tv ka realizuar një kronikë speciale *“Nga kanuni tek gjykata e llogarive, si u kontrollua Shqipëria në 10 dekada”*.

3.5 PROGRAMI I TRANSPARENCËS

Programi i transparencës përveç se një detyrim ligjor, vlerësohet nga KLSH si një mënyrë konkrete përmes së cilës institucioni ndërton dhe rrit profilin e tij publik, impaktin e punës audituese për rrjedhje dhe besueshmërinë e institucionit tek palët e interesit. Informacioni i bërë publik në këtë program përditësohet në përputhje me pikën 2, neni 5 i Ligjit nr. 119/20124“Për të drejtën e informimit”, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare.

Në faqen zyrtare të KLSH-së ka vijuar publikimi periodik i raporteve përfundimtare të auditimit, si dhe materialeve të tjera informuese si: buletinet statistikore, planet vjetore dhe mujore të auditimeve, si dhe auditimet e kryera brenda afatit të përcaktuar nga momenti i evadimit. Konkretisht, për vitin 2022 janë publikuar në faqen zyrtare 179 raporte përfundimtare auditimi si dhe janë përgatitur dhe publikuar 3 buletine statistikore në të cilat paraqitet periodikisht aktiviteti auditues.

Ndërkohë, gjatë vitit 2022, faqja zyrtare e Kontrollit të Lartë të Shtetit është klikuar nga mbi 50 mijë vizitorë.

Ankesa dhe kërkesa për informacion


Kontrulli i Lartë i Shtetit vijon të shqyrtojë me korrektësi dhe profesionalizëm të gjitha ankesat, denoncimet dhe kërkesat për informacion të ardhura nga qytetarët dhe media të ndryshme, konkretisht gjatë vitit 2022, KLSH ka administruar 428 ankesa dhe kërkesa për informacion nga qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit, nga të cilat 365 kanë qenë ankesa nga qytetarët. Ankesat e qytetarëve kanë të lidhura kryesisht me çështjen e regjistrimit të pronave, të prokurimit publik, largimeve nga puna, etj. Këto ankesa, janë përcjellë për kompetencë në institucionet përkatëse për trajtim dhe zgjidhje të problematikës së paraqitur nga qytetarët. Gjithashtu, rast pas rasti, çështjet e sjella nëpërmjet këtij kanali komunikimi janë vlerësuar në veçanti duke u bërë pjesë e auditimeve në proces apo auditimeve tematike.

KLSH ka pasur një numër në rritje kërkesash për informacion, kryesisht mbi vënien në dispozicion të raporteve përfundimtare të auditimit të kryera nga KLSH por edhe pyetësorëve lidhur me veprimtarinë audituese të KLSH-së. Konkretisht, në KLSH janë depozituar 4 kërkesa për informacion nga deputetë të Kuvendit, të cilëve ju janë vënë në dispozicion 36 raporte auditimi; 10 kërkesa për informacion nga gazetarë dhe përfaqësues të medias dhe 49 kërkesa për informacion nga qytetarë.

Krahasuar me tre vitet e fundit, numri i kërkesave për informacion gjatë vitit 2022 ka pësuar një rritje të ndjeshme.

4. MENAXHIMI INSTITUCIONAL DHE ZHVILLIMI STRATEGJIK

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL 2018-2022



4. MENAXHIMI INSTITUCIONAL DHE ZHVILLIMI STRATEGJIK

4.1 Performanca bazuar në Kornizën e Indikatorëve të Matjes së Performancës:

KLSH, edhe gjatë vitit 2022, ka vijuar me procesin e vetëvlerësimit nëpërmjet Kornizës së Matjes së Performancës (KMP) si një mjet i zhvilluar nga Grupi i Punës së INTOSAI-t mbi Vlerat dhe Përfitimet e SAI (INTOSAI - P 12). Raporti i Vetëvlerësimit të Performancës sipas Kuadrit të INTOSAI-t synon të luajë një rol të rëndësishëm në përpjekjet e KLSH - së drejt përmirësimit të metodologjive të auditimit, qeverisjes së brendshme dhe etikës, zhvillimit të kapaciteteve, si dhe angazhimit të palëve të interesuara. Implementimi i KMP për vitin 2022, u finalizua nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e Inicativës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI) dhe nga SAI i Norvegjisë, si dhe u vlerësua nga një ekspert ndërkombëtar krejtësisht i pavarur nga procesi, çfarë e bën këtë vlerësim edhe më objektiv. Në përfundim të këtij procesi të gjatë vlerësues, të nisur në vitin 2021, i cili përfshiu një paketë të plotë trajnimesh, diskutimesh dhe orientimesh nga IDI dhe SAI i Norvegjisë, raporti përfundimtar i vetëvlerësimit u finalizua me një vlerësim shumë pozitiv.

Rezultatet e këtij raporti i shërbyen më së miri konceptimit dhe hartimit më tej, të planit strategjik të institucionit për periudhën 2023 - 2027¹. Përdorimi i vlerësimit të PMF është shumëdimensional, duke mos u kufizuar vetëm në përputhshmërinë dhe plotësimin e kërkesave që burojnë nga standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI), por duke ofruar një perspektivë më të gjerë në përdorimin e rezultateve të tij.

Korniza, në formën e një matrice treguesish të detajuar, është e organizuar në 6 dimensione, të cilat zërthehen në indikatorë të mirë përcaktuar, si nga pikëpamja e matjes ashtu edhe nga pikëpamja e pikëzimit, nga vlerësimi i të cilëve prodhohet një informacion i sintetizuar edhe analitik. Monitorimi periodik vjetor, i treguesve të performancës i mundëson KLSH-së të ndjekë progresin në aspektet kryesore dhe të sigurojë informacion të rëndësishëm mbi të cilin mund të bazohen vendimet menaxheriale dhe organizative.


Matja e performancës nëpërmjet këtij instrumenti përbëhet prej 25 treguesish, të cilit vlerësojnë veprimtarinë e KLSH-së në 6 fushat kryesore, si më poshtë:

1. Pavarësia dhe Korniza ligjore.
2. Qeverisja e Brendshme dhe Etika.
3. Cilësia e Auditimit dhe Raportimi.
4. Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Strukturat Mbështetëse.
5. Burimet Njerëzore dhe Trajnimi; si dhe
6. Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesit.

Secila prej fushave detajohet në dimensione dhe indikatorë, të cilat janë subjekt i një vlerësimi analitik. Në bazë të vlerësimit bëhet pikëzimi përkatës, ku për secilin dimension në veçanti dhe fushë në përgjithësi, niveli i pikëzimit varion nga 0 në 4 (ku 0 është vlerësimi minimal dhe 4 maksimal) dhe për vitin 2022 rezultuan si në grafikun e mëposhtëm:

¹ Raporti i Vetëvlerësimit të KLSH-së, gjendet i publikuar në faqen zyrtare të KLSH, së bashku me Vlerësimin e Vlerësuesit të Jashtëm.

Grafiku nr. 3: Vlerësimi i treguesve të Performancës, sipas fushave për vitet 2021 dhe 2022



Sikurse paraqitet në grafik, KLSH edhe për vitin 2022 paraqet qëndrueshmëri sa i takon pesë fushave të vlerësimit dhe një rritje nga 3 pikë në 4 të fushës D “Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse”. Pavarësisht sa më sipër, brenda secilës fushë/dimension, konstatojmë aspekte që ende kanë nevojë të përmirësohen më tej dhe kërkojnë vëmendje në periudhat në vijim me qëllim:

- forcimin e efektivitetit të punës së kryer nga institucioni nëpërmjet propozimit të ndryshimeve ligjore në mbështetje të mandatit dhe pavarësisë së institucionit;
- forcimin e kapaciteteve audituese në drejtim të auditimeve të PPP-ve dhe kontratave konçensionare;
- trajnimin e vazhdueshëm të audituesve mbi qasjet audituese, metodologjitë dhe teknikat audituese për audituesit e rinj dhe ata me më eksperiencë;
- përmirësimin e dokumentimit të punës audituese në mbështetje të gjetjeve të auditimit, duke pasur parasysh gjithmonë përputhshmërinë e plotë me standardet e duke shmangur mbivendosjen e letrave të punës;
- përmirësimin e vazhdueshëm të manualeve të auditimit, për të reflektuar ndryshimet e vazhdueshme në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
- përmirësimet e nevojshme në procesin e planifikimit strategjik veçanërisht për auditimet e performancës, duke përditësuar dokumentin e fushave me risk,
- përmirësimin e shkrimit të raporteve në mënyrë që gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e tyre të jenë të qarta dhe të kuptueshme për përdoruesit e tyre;
- një praktikë të mirë të vlerësimit të materialitetit për të parashikuar rastet se kur një praktike “follow - up”, kërkon vlerësime/auditime të mëtejshme;

Fusha A: “Pavarësia dhe Korniza Ligjore

”Kjo fushë ka të bëjë me pavarësinë dhe mandatin ligjor të KLSH, për vlerësimin e bazës ligjore dhe institucionale për operacionet e institucionit. KLSH është një institucion kushtetues i pavarur i cili e ka të sanksionuar parimin e pavarësisë institucionale, në aktin themelues të rendit kushtetues në vendin tonë. Gjithashtu, parimi i pavarësisë institucionale nga ekzekutivi dhe influenca të tjera të jashtme është ritheksuar edhe në ligjin organik të KLSH. Kjo fushë vlerësohet nëpërmjet dy dimensioneve SAI-1 dhe SAI-2.

Pikëzimi për katër dimensionet evidenton se institucioni gëzon pavarësi të garantuar nga korniza kushtetuese dhe ligjore në fuqi. Në vlerësimin e këtyre dimensioneve, KLSH është vlerësuar “shumë mirë”.

Fusha B “Qeverisja e Brendshme dhe Etika

”Treguesit e performancës për këtë fushë janë 5, nga të cilët vetëm katër janë të zbatueshëm për KLSH, si vijon: SAI 3: Cikli i Planifikimit Strategjik; SAI 4: Mjedisi i Kontrollit të Organizatës; SAI 6: Liderhipi dhe Komunikimi i brendshëm; SAI 7: Planifikimi i Përgjithshëm i Auditimeve.²

Për ciklin e planifikimit strategjik, KLSH është vlerësuar “4”, kjo pasi institucioni ka zbatuar parimet bazë të planifikimit strategjik për periudhën e vlerësuar. Më konkretisht, KLSH ka hartuar një Strategji Zhvillimi 2018 – 2022, bazuar në një vlerësim të nevojave që mbulon aspektet kryesore të organizatës dhe në identifikimin e boshllëqeve ose fushave që kërkojnë përmirësime të performancës. Procesi i hartimit dhe zbatimit të kësaj strategjie ka përfshirë menaxhmentin e nivelit të lartë deri tek i gjithë stafi i SAI-t. Zbatimi i kësaj strategjie është kryer nëpërmjet një plani veprimi, në të cilin të gjitha objektivat janë të lidhura me qëllimet strategjike. KLSH ka monitoruar dhe raportuar për ecurinë e realizimit të këtyre objektivave në bazë vjetore. Raportet janë të disponueshme në faqen zyrtare të KLSH.

Për mjedisin e kontrollit të organizatës, KLSH është vlerësuar “3”. KLSH ka miratuar strukturën organizative për të siguruar që përgjegjësia mbi çështjet e etikës të caktohet qartë për të gjithë punën e kryer. KLSH ka një Drejtor të Auditimit të Brendshëm, kontrollet e së cilës nënshkruhen nga titullari. KLSH çdo vit harton dhe dorëzon në MFE, Deklaratën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit shoqëruar me pyetësorin e vetëvlerësimit. Nevojitet që brenda një periudhe kohore 5 vjeçare, SAI të ndër marrë një rishikim të plotë të sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, në respekt edhe të kuadrit COSO. Janë kryer rishikime të kontrolleve të brendshme për departamente të veçanta dhe gjithashtu ka pasur një vlerësim mbi kontrollet e brendshme të KLSH nga SAI Holandez në shkurt të vitit 2020 duke synuar në veçanti “vlerësimin e integritetit dhe etikës”. KLSH ka vendosur një sistem në të cilin konflikti i interesit deklarohet periodikisht nga të gjithë anëtarët e stafit.

² Nuk zbatohet për institucionin tonë SAI - 5, Auditimet e jashtme.

Fusha C “Cilësia e auditimit dhe raportimi”.

Kjo fushë ka vlerësuar cilësinë dhe rezultatet e punës së auditimit si funksionin thelbësor të çdo SAI. Ajo përfshin 13 tregues, nga të cilët vetëm 10 janë të zbatueshëm për institucionin tonë³. Këto tregues janë: SAI-8 “Mbulimi me auditim”; SAI-9 “Standardet e Auditimit Financiar dhe Menaxhimi i Cilësisë”; SAI-10 “Procesi i Auditimit Financiar”; SAI-11 “Rezultatet e Auditimit Financiar”; SAI-12 “Standardet e Auditimit të Performancës dhe Menaxhimi i Cilësisë”; SAI-13 “Procesi i auditimit të performancës”; SAI-14 “Rezultatet e auditimit të performancës”; SAI-15 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Menaxhimi i Cilësisë”; SAI-16 “Procesi i Auditimit të Përputhshmërisë”; SAI-17 “Rezultatet e Auditimit të Përputhshmërisë”.

Për treguesin e mbulimit me auditim, KLSH është vlerësuar “4”, kjo pasi ligji organik i KLSH garanton që institucioni të kryejë auditimet e duhura brenda mandatit të vet për këtë qëllim. Për treguesin mbi standardet e auditimit financiar dhe menaxhimit të cilësisë KLSH është vlerësuar “3”. Në përgjithësi, Standardet dhe Politikat e Auditimit Financiar përcaktohen në Manualin e Auditimit Financiar si dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit. Megjithatë, ka disa aspekte që nevojiten të shtjellohen më qartë.⁴ Gjithashtu, letrat e punës së këtij manuali duhet të rishikohen për të qenë më në linjë me Rregulloren e Procedurave të Auditimit. Gjithashtu përmirësime kërkohen në treguesit e “Procesi i Auditimit të Përputhshmërisë” dhe “Rezultatet e Auditimit të Përputhshmërisë” për implementimin të plotë në praktikë të kërkesave të manualit.

Për **kontrollin e cilësisë**, KLSH mbështetet në rishikimin hierarkik të dokumenteve të auditimit nga përgjegjësi i grupit, kryeaudituesi, drejtuesi i departamentit, Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të cilësisë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Kryetari. I gjithë aktiviteti auditues i nënshtrohet procedurave të kontrollit të cilësisë, nga fillimi i auditimit deri në publikimin e raportit përfundimtar. Një element i rëndësishëm, me ndikim në cilësinë e veprimtarisë audituese është kuadri rregullator në të cilën bazohet kontrolli dhe sigurimi i cilësisë së auditimit, si: Rregullorja e Procedurave të Auditimit; Manuali i Auditimit Financiar; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; Manuali i Auditimit të Performancës; Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve, Udhëzuesi për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit. Në mënyrë të përgjithshme nga **kontrolli i cilësisë “në të nxehtë”** gjatë procesit të evadimit të auditimit konstatohet se Raportet Përfundimtare të Auditimit: (i) në përgjithësi janë strukturuar sipas nenit 35 të Rregullores së Procedurave të Auditimit; (ii) ndjekin drejtimet sipas programit të auditimit, gjetjet janë formuluar duke respektuar formën dhe elementët e gjetjes duke reflektuar observacionet e subjekteve dhe komentet përkatëse; (iii) janë sugjeruar saktësime të mundshme në formulimin e gjetjeve, rekomandimeve dhe opinioneve në

³ Për KLSH dhe për të gjithë SAI-et që nuk funksionojnë edhe si gjykata, nuk zbatohen treguesit si vijon: SAI-18 “Standardet e Kontrollit Juridiksional dhe Menaxhimi i Cilësisë”; SAI-19 “Procesi i Kontrollit Juridiksional”; SAI-20 “Rezultatet e Kontrolleve Juridiksionale”.

⁴ Pas finalizimit të Raportit të Vetëvlerësimit, KLSH në Dhjetor 2022 miratoi Manualin e ri të Auditimit Financiar, pikërisht për të reflektuar sa rezultuar nga Raporti i Vetëvlerësimit

Raportet Përfundimtare të Auditimit dhe Projektvendimeve për të vijuar më pas me evadimin e mëtejshëm. Sigurimi i cilësisë kryhet edhe në bazë vjetore nëpërmjet **kontrollit “në të ftohtë”** të dosjeve të auditimit të evaduara për të gjitha fazat e auditimit: planifikim, auditim në terren dhe raportim, kjo duke ruajtur pavarësinë,

objektivitetin, skepticizmin profesional, si dhe duke zbatuar në çdo rast dhe vazhdimisht Kodin e Etikës. Gjatë vitit 2022, **kontrolli i cilësisë “në të ftohtë”** është kryer në zbatim të Urdhrit nr. 83 datë 11.10.2022 të Kryetarit të KLSH-së, në zbatim të të cilit është realizuar kontrolli për 52 dosje auditimi të përzgjedhura në mënyrë rastësore, ose 30% të dosjeve të auditimit të evaduara për vitin 2022. Vlerësimi i detajuar për çdo dosje është bërë për 20 tregues që përfshijnë të gjitha fazat e ciklit të plotë auditues. Në përfundim të kontrollit të cilësisë “në të ftohtë” rezultoi se 61.5% e dosjeve plotësojnë kriteret e vlerësimit “shumë mirë”.

Fusha D “Menaxhimi Financiar Asetet dhe Struktura Mbështetëse”

Në mënyrë që një SAI të menaxhojë operacionet e tij në mënyrë ekonomike, efikase, efektive dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret (ISSAI 20:6), duhet të ketë një strukturë të përshtatshme të menaxhimit dhe mbështetjes organizative që do t'i japë efekt proceseve të mirëqeverisjes dhe do të mbështesë kontrollin e brendshëm dhe praktikën e menaxhimit të shëndoshë. (ISSAI 12, parimi 9). Kjo vlen njëloj për shërbimet mbështetëse të SAI-t, duke përfshirë menaxhimin e financave dhe pasurive materiale të saj. Kjo fushë vlerësohet në kornizën e matjes së performancës së SAI – ve, nëpërmjet vlerësimit të një treguesi, i cili është “Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse”. Nën këtë tregues, KLSH është vlerësuar “4”.

Fusha E “Burimet njerëzore dhe trajnimi”

Kjo fushë vlerëson mënyrën se si KLSH menaxhon dhe zhvillon burimet njerëzore. Vlerësimi për këtë fushë bazohet në dy tregues: Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe Zhvillimi dhe Trajnimi Profesional. Për këto tregues KLSH është vlerësuar respektivisht “3” dhe “4”. Funkcioni i Burimeve Njerëzore në KLSH kryhet nga struktura e burimeve njerëzore e institucionit. Aspekti i burimeve njerëzore është i integruar më së miri në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH për 2018 – 2022 dhe në Dokumentin mbi Politikën e BNj⁵. Aktualisht zhvillimi profesional dhe avancimi në karrierë realizohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit periodik të performancës dhe aftësive individuale, testimit të njohurive nga formimi profesional dhe konkurrencës transparente (po aq e rëndësishme sa procesi i rekrutimit).

Fusha F “Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit”

5 Me urdhrin nr. 23, datë 28.02.2023 është ngritur grupi i punës për hartimin e dokumentit të Politikave të Burimeve Njerëzore në KLSH

Kjo fushë shtjellon parashikimet e ISSAI 12, i cili identifikon si një nga objektivat kryesore demonstrimin e rëndësisë së tij për palët e interesit. Pikërisht për këtë arsye SAI duhet të komunikojë me palët e interesit për të siguruar që ato e kuptojnë punën dhe rezultatet e punës së auditimit. Vlerësimi për këtë fushë është kryer me dy tregues: Komunikimi me legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin dhe komunikimi me mediat, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile. Për treguesin mbi komunikimin me legjislativin,

ekzekutivin dhe gjyqësorin, KLSH është vlerësuar “4”. KLSH ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e re të Komunikimit 2022 - 2025, publikuar gjithashtu në web, si dhe mban një komunikim të vazhdueshëm me legjislativin nëpërmjet dorëzimit të raporteve të detyrueshme si dhe raporteve dhe informacioneve të tjera përkatëse në lidhje me rekomandimet në komisionet përkatëse në Kuvend. KLSH ka krijuar praktika të mira komunikimi me ekzekutivin.

Për treguesin mbi komunikimi me mediat, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile, KLSH është vlerësuar sërish “4”. Në këtë drejtim KLSH zbaton praktika të mira në lidhje me komunikimin me median dhe ka një strukturë të posaçme për monitorimin e prezencës së KLSH në media-n e shkruar dhe atë audiovizive.

4.2 Implementimi i Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2018-2022

Viti 2022 njëkohësisht përkon edhe me përfundimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018- 2022 (SZHI), miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 228, datë 31.12.2017, pasuar nga Plani i Veprimit dhe Monitorimit, miratuar më Vendim të Kryetarit të KLSH-së, nr. 1353/4, datë 24.04.2018, i rishikuar. Kjo strategji përcaktoi 3 qëllime strategjike, 21 objektiva dhe 71 nën-objektiva, të cilat mbuluan dimensionet më të rëndësishme të zhvillimit të institucionit, njëkohësisht në koherencë të plotë me objektivat e Planeve Strategjike 2017 - 2023 të EUROSAT-t dhe 2017 - 2022 të INTOSAI-t. Konkretisht, qëllimet strategjike që shoqëruan aktivitetin e KLSH-së përgjatë kësaj periudhe 5 vjeçare konsistuan në:

1. Rritjen e impaktit të punës audituese me fokus 6-E.
2. Optimizimin e kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.
3. Forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit.

Qëllimi i parë strategjik, lidhet me rritjen e impaktit të punës audituese me fokus 6-E. Ky qëllim adreson çështje të një niveli të lartë siç është “Forcimi i pavarësisë dhe mandatit kushtetues të KLSH-së” apo përmirësimi i vazhdueshëm teknik dhe metodik i qasjes audituese. Aktualisht, KLSH ka një ligj organik bashkëkohor, të hartuar më mbështetjen e ekspertizës së Bashkimit Evropian dhe të mbështetur në standardet e INTOSAI-t. Për një vlerësim më të plotë dhe koherent të nevojës për ndryshime, rishikimi i ligjit, në drejtim të forcimit të pavarësisë dhe mandatit të KLSH-së, është konsideruar të mbartet si një nënobjektiv për tu përmbushur në Strategjinë e Zhvillimit 2023-2027.

Përsa i përket planit teknik dhe metodik të qasjes audituese, KLSH, ka vijuar të tregojë kujdesin e duhur në drejtim të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga SZHI 2018 - 2022 dhe prej rekomandimeve të lëna nga Komisioni Evropian⁶ dhe Kuvendi i Shqipërisë, duke hartuar dhe miratuar planet respektive të veprimet për zbatimin e tyre.

Përmirësimi metodologjik gjatë kësaj periudhë 5 vjeçare në përgjithësi, dhe vitit 2022 në veçanti, ka vijuar të mbështesë dhe të nxisë ndryshimin dhe në funksion të këtij objektivit ku ndër të tjera, përmendim: (i) krijimin e departamentit të auditimit të teknologjisë së Informacionit në vitin 2018 (ii) Pasurimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të kuadrit metodologjik të punës audituese me dokumente të rëndësishëm si Manuali Aktiv i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Udhëzuesi për Vlerësimin dhe Matjen e Riskut, në vitin 2018; (iii) Hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit të Menaxhimit të Cilësisë në vitin 2019; (iv) Miratimi i Manualit për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve të auditimeve të KLSH dhe Regjistri elektronik institucional në vitin 2020; etj. Gjatë vitit 2022, KLSH-së rishikoi Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë; përktheu dhe publikoi Dokumentin ISSAI/IFPP 5100 “Udhëzues mbi Auditimin e Sistemeve të Informacionit”; rishikimi i Rregullores së Brendshme të KLSH-së; hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit të Fushave me Risk për auditimet e Performancës; u përkthye Udhëzuesi “ISAM”, i publikuar nga INTOSAI/IDI mbi auditimin e OZHQ-ve; u finalizua me sukses Raporti i Vetëvlerësimit të Performancës; dhe Strategjia e Komunikimit 2022-2025 dhe Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së 2023 - 2027.

Sa i përket kontributit në luftën kundër korrupsionit, KLSH ka pasur një rol të vazhdueshëm proaktiv dhe produktiv nëpërmjet auditimeve, denoncimit të rasteve korruptive dhe shkëmbimit të informacionit në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Strukturën e Posaçme Anti Korrupsion (SPAK), Prokurorinë e Përgjithshme, Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), etj. Gjatë vitit 2022, në partneritet me prezencën e OSBE-së në Tiranë, Autoriteti Italian Antikorrupsion (ANAC), ka zhvilluar dhe do të vijojë të zhvillojë një sërë sesionesh trajnimit për audituesit e KLSH, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale në auditimin e PPP-ve dhe procedurat e prokurimit publik.

Në bazë të marrëveshjes së INTOSAI-t dhe Zyrës së OKB-së për Krimin dhe Drogën (UNODC), me synim zbatimin e bashkëpunimit ndërmjet SAI-t dhe institucioneve kundër korrupsionit, përfaqësuesit e KLSH-së kanë kontribuar në hartimin e udhëzuesit “Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe organeve antikorrupsion në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit” miratuar në Kongresin XXIV të INCOSAI-t, nëntor 2022. Së fundmi, KLSH është pjesë e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Sektoriale Kombëtare Antikorrupsion.

Qëllimi i dytë Strategjik, lidhet me "Optimizimin e kapaciteteve profesionale, aftësi audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse". Në

⁶ Plan Veprimi i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1243 prot., datë 12.11.2021, “Mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë të datës 19.10.2021”;

përmbushje të këtij qëllimi, KLSH çdo vit ka miratuar Programin Vjetor të Zhvillimit të Integruar Profesional të KLSH-së, si një prej prioriteteve kryesore në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Për një konsolidim të vazhdueshëm dhe rritjen e efektivitetit të trajnimeve, është hartuar dokumenti “Rregullore mbi Zhvillimin e Trajnimeve të stafit të KLSH”⁷ në vitin 2022, miratuar me Vendimin nr. 26, datë 08.02.2022. Gjatë periudhës 2018 - 2022, çdo auditues ka zhvilluar mesatarisht 27 ditë trajnimi në vit. Vetëm gjatë vitit 2022, janë realizuar në total 3905 ditë trajnimi, nga 155 auditues. Temat e trajtuara në trajnime variojnë nga manualët dhe standardet e auditimit, te procedurat e prokurimeve, PPP-të, infrastruktura dixhitale, etj. Gjithashtu, gjatë periudhës 2018 - 2022 audituesit kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare. Kështu, 22 auditues kanë përfunduar me sukses programet e internship-t në Gjykatën Evropiane të Llogarive (ECA) dhe 6 auditues kanë ndjekur programet e fellowship-it pranë Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO).

Në përmbushje të qëllimit të tretë strategjik, i cili konsistoi në forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me Kuvendin dhe palët e interesit, KLSH hartoi Strategjinë e Komunikimit 2017 - 2019, e pasuar kjo nga Strategjia e Komunikimit 2022 - 2025 e hartuar nën mbikëqyrjen e SIGMA-s (iniciativë e përbashkët e OECD dhe BE), si pjesë të domosdoshme për përmbushjen e misionit dhe objektivave strategjike të zhvillimit institucional bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës, qartësisë, vërtetësisë, inovacionit, koherencës dhe aksesueshmërisë në informacion.

Gjithashtu, me synimin e institucionalizimit të marrëdhënieve të KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë, në kuadër edhe të rekomandimeve të BE-së, është miratuar Udhëzuesi për Institucionalizimin e Marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin, si dhe i është dërguar Kuvendit propozimi për ngritjen e një nën komisioni parlamentar pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, me qëllim forcimin e mekanizmave të kontrollit parlamentar në funksion të rritjes të zbatimit të rekomandimeve nga ana e ekzekutivit. Në funksion të këtij objektiv, KLSH ka vijuar të përditësojë me informacion platformën elektronike të Kuvendit të Shqipërisë me statusin e rekomandimeve të dhëna për institucionet qendrore dhe atyre të varësisë. Kuvendi është informuar periodikisht për rezultatet e punës audituese edhe nëpërmjet përcjelljes së buletineve statistikore periodike, raporteve të zbatimit të rekomandimeve, raportit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit dhe raportit vjetor mbi të aktivitetit të KLSH-së.

Komunikimi i KLSH, përgjatë periudhës 2018 - 2022, është vendosur edhe nëpërmjet bashkëpunimit me palët e interesit, si nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve ashtu edhe nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta. Edhe gjatë vitit 2022, ka vijuar bashkëpunimi me insitucione dhe organizma të huaja, në zbatim të marrëveshjeve të lidhura, të cilat janë finalizuar me: (i) kryerjen e auditimeve të përbashkëta dhe paralele; (ii) trajnime të vazhdueshme me qëllim forcimin e kapaciteteve audituese (iii) nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI homologe. (iii) ofrimin e ekspertizës për zhvillimin

⁷ <https://panel.klsh.org.al/storage/phpb8EGma.pdf>

e një kuadri metodologjik bashkëkohor si: Hartimi i Manualit të Auditimit të mashtrimit dhe Korrupsionit në kuadër të Projektit IPA; Hartimi manualit të Auditimit të Prokurimit Publik, i përgatitur nga ekspertë të Bankës Botërore dhe përshtatur nga KLSH sipas kërkesave të institucionit.

Në përfundim, referuar Planit të Veprimit dhe Monitorimit të Strategjisë, për 3 qëllimet strategjike, nga 71 aktivitete të SZHI-së për periudhën 2018-2022, 6 nën objektiva rezultojnë të mos jenë realizuar plotësisht. Realizimi i 4 prej tyre, kushtëzohet nga bashkëpunimi me institucione dhe organizma të tjera, si Kuvendi dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, konkretisht:

1. Nën objektivi (1.1.1) i cili ka në fokus miratimin e ndryshimeve në Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nën objektivi (2.4.5) “Hartimi i Programit dhe Kurrikulave për Certifikimin e Audituesve Publik” dhe (2.4.7) “Certifikimi i të gjithë audituesve të KLSH-së, si auditues të jashtëm publikë”, duke qenë në varësi të realizimit të nënobjektivit (1.1.1) për miratimin e ndryshimeve ligjore, nuk mundën të realizohen. Grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të KLSH-së po vijon shqyrtimin e hollësishëm të të gjithë ndryshimeve ligjore të kërkuara, me qëllim vlerësimin e nevojave koherente për ndryshime.
2. Nën objektivi (1.3.3) “Udhëzuesi për Auditimin e Zbatimit të Buxhetit” me asistencë të SIGMA/OECD” vijon të jetë në proces dhe parashikohet të finalizohet gjatë vitit 2023.
3. Nën objektivi (1.8.3) “Hartimi i Metodikës së përbashkët për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm” duhet të rishikohet nga Sekretariati i Përbashkët për bashkëpunimin ndër institucional KLSH-MFE.
4. Nën objektivi (1.10.5) “Kryerja e Auditimit të Integritetit të nëpunësve publikë, bazuar në eksperiencat më të mira ndërkombëtare” nuk është realizuar plotësisht. Në funksion të realizimit të këtij nënobjektivit, KLSH ka punuar për hartimin e bazës metodologjike dhe trajnimin e stafit në lidhje me vlerësimin e integritetit sipas metodologjisë së SAI-t Hollandez, udhëhequr nga SAI Norvegjez, duke realizuar: IntoSaint “Manuali i Vetëvlerësimit të Integritetit të SAI-ve”; EUROSAI “Forcimi i Infrastrukturës Etike në SAI dhe Auditimi i Etikës në Sektorin Publik”⁸. Kodin e Etikës ISSAI 30/IFPP-130 “Auditimi i etikës në organizatat e sektorit publik, si të implementojmë ISSAI-30”⁹, si dhe vazhdimisht punon për zhvillimin e kapaciteteve, nëpërmjet trajnimeve të stafit.

Programet vjetore të trajnimit të stafit përfshin tema, që lidhen me menaxhimin e etikës dhe integritetit, e cila konsiston në implementimin e detyrueshëm të rregullave të etikës, si dhe në ndërgjegjësimin dhe edukimin e punonjësve për ruajtjen e një profili me integriteti të lartë, të audituesit të KLSH-së. Audituesit e KLSH-së kanë marrë pjesë aktive në trajnimet e ofruara nga ASPA me fokus çështjet e integritetit dhe etikës.

KLSH është anëtare e Task Force së EUROSAI-t për Auditimin e Etikës dhe ka marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare, për shpërndarjen e kulturës dhe integritetit në institucionet publike.

⁸ https://www.klsh.org.al/content_text/4530


⁹ <https://panel.klsh.org.al/storage/phpRFnUwY.pdf>

4.3 Strategjia e Zhvillimit Institucional 2023 - 2027

Viti raportues 2022, njëkohësisht përkon me vitin e fundit të Strategjisë 5 vjeçare të Zhvillimit Institucional të KLSH-së, dhe hartimin e Strategjisë së re për periudhën 2023 - 2025. Referuar objektivave strategjike të parashikuar në këtë Strategji, si dhe në linjë me çështjet e diskutuara në Kongresin INCOSAI XXIV (Deklarata e Rios), të zhvilluar në nëntor 2022 në Rio de Janeiro, edhe përgjatë 5 vjeçarit të ardhshëm KLSH do të vijojë të orientohet drejt përgjigjes efektive ndaj sfidave dhe kërkesave të kohës, duke rritur edhe më tej aftësinë për t'iu përshtatur në kohë ndryshimeve në mjedisin rrethues, nëpërmjet investimit në ekspertizën e nevojshme dhe të domosdoshme në fusha të tilla si: qëndrueshmëria e financave publike, efektiviteti dhe eficiency e menaxhimit të programeve qeveritare, kryesisht në ato të partneritetit publik - privat, zhvillimet dixhitale, e të tjera fusha me ndikim në financat publike.

Gjatë procesit të hartimit të planit strategjik, KLSH u udhëhoq nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI) duke aplikuar një sërë mjetesh dhe procesesh, si: (i) ngritja e grupit të punës, me përfaqësues të nivelit të lartë të KLSH-së, të dedikuar për të formuluar çështjet strategjike, (ii) procesi i vetëvlerësimit të performancës për çdo dimension; (iii) rekomandimet e Kuvendit miratuar në rezolutën përkatëse; (iv) analiza SWOT për identifikimin e pikave të forta, dobësive dhe sfidave të mjedisit (v) vlerësimet dhe rekomandimet e misioneve të BE-së në kuadër të zbatimit të Reformës në Menaxhimin e Financave Publike, apo të procesit të integritetit si pjesë e Kapitullit 32 për nënkomponentin, "Auditimi i jashtëm".

Në përfundim u konkludua në 3 qëllimet strategjike që do të udhëheqin punën e KLSH-së në pesë vitet e ardhshme, që paraqiten në infografikun më poshtë:



Qëllimi 1. Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH-së si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të fondeve publike.

KLSH dhe Kuvendi, si pjesë e trekëndëshit të llogaridhënies, kanë role reciprokisht mbështetëse për të siguruar një qeverisje efektive dhe janë partnerë kryesor në promovimin e qeverisjes së mirë.

Kuvendi mund të kryejë funksionet e tij vitale të mbikëqyrjes së aktivitetit qeveritar në mënyrë efeciente dhe efektive, kur ai përdor dhe mbështetet mbi punën audituese të KLSH-së. KLSH mund të jetë shumë më efektiv, nëse Kuvendi dhe komisionet e tij, sigurojnë forume për paraqitjen dhe diskutimin e rezultateve të rëndësishme të auditimeve, duke përbërë aleatin kyç në nxitjen e ekzekutivit dhe në inkurajimin e institucioneve të tjera të pavarura, për të ndërmarrë veprimet e duhura korigjuese të propozuara nga KLSH.

KLSH, nëpërmjet punës audituese synon të sigurojë një rritje të rolit të tij si institucion suprem auditimi në mbrojtje të financave publike në vendin tonë, duke përmirësuar performancën e vet institucionale audituese në përfitim të taksapaguesve dhe në mbështetje të Kuvendit për një shqyrtim të thelluar të punës së ekzekutivit. Në sajë të kryerjes së auditimeve cilësore dhe të thelluara, KLSH synon të nxisë përgjegjshmërinë e institucioneve të audituara duke kontribuar kështu, në forcimin e kulturës së llogaridhënies të këtyre institucioneve. Eksperienca e KLSH-së, si institucion i pavarur në shërbim të qytetarëve dhe Kuvendit, ka treguar rëndësinë e auditimeve për palët e interesit dhe përdoruesit e punës audituese, e reflektuar kjo edhe me një pasqyrim të shtuar në media, si dhe në vlerësime pozitive nga partnerët tanë strategjikë. Me qëllim sigurimin e një vazhdimësie të qëndrueshme dhe të suksesshme në këtë drejtim, KLSH do të angazhohet drejt një konsolidimi të imazhit të vet institucional, si institucioni suprem i auditimit në Shqipëri, në mbrojtje të financave publike. Situatat emergjente gjithashtu, mund të diktojnë nevojën e adaptimit të planeve të auditimit për t'ju përshtatur ndryshimeve. Në këto kushte, identifikimi i mësimave nga eksperiencat e mëparshme, implementimi i praktikave të mira si dhe angazhimi i KLSH-së me INTOSAI-n dhe partnerët e jashtëm, vlerësohet si një faktor për përmirësimin e përgjigjes në kohë ndaj ndryshimeve, në përputhje kjo edhe me Deklaratën e Rios 2022. KLSH do të konkretizojë këtë qëllim strategjik duke:

- konsoliduar edhe më tej praktikave të planifikimit strategjik të auditimeve bazuar në analizë të përditësuar risku të bazuara në metodologji bashkëkohore, si pjesë e pandashme e planifikimit strategjik të auditimeve për të siguruar një mbulim më efektiv dhe cilësor me auditim.
- u angazhuar maksimalisht në implementimin e plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë gjithë fazave të auditimit, në përfitim të rritjes së profesionalizmit dhe objektivitetit.
- thelluar bashkëpunimin me Kuvendin, institucionet e tjera ligj zbatuese dhe palët e interesit, me qëllim parandalimin e rasteve abuzive, si kontribut në luftën kundër korrupsionit dhe në të njëjtën kohë, promovimin e punës audituese si gardian i fondeve publike.

Qëllimi 2. Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

KLSH, synon të rrisë impaktin e punës audituese dhe të kontribuojë në qeverisjen e mirë, nxitjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës së përdorimit të fondeve

publike, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve praktike, të qarta dhe të orientuara drejt veprimeve konkrete, për përmirësimin e situatës së konstatuar dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Monitorimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga entet publike të audituara, në bashkëpunim edhe me Kuvendin, me qëllim nxitjen e institucioneve publike për zbatimin e tyre, do të jetë treguesi kryesor për matjen e impaktit të punës audituese. Duke raportuar gjetjet dhe dhënë rekomandime praktike, KLSH synon të vendosë një bazë të shëndoshë për ndërmarrjen e veprimeve korrektuese dhe parandaluese për të përmirësuar qeverisjen dhe menaxhimin e njësive publike. KLSH do të konkretizojë këtë qëllim strategjik duke:





- hartuar raporte auditimi, të kuptueshme, të qarta dhe relevante për çdo lexues me qëllim rritjen e aksesueshmërisë në punën audituese, rritjen e numrit të përdoruesve të këtyre raporteve dhe rritjen e impaktit të përgjithshëm të gjeneruar nga to.
- përdorur teknika të të shkruarit profesional i cili përcjell informacionet, gjetjet dhe rekomandimet në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive.

KLSH do të përmirësojë mënyrën e komunikimit me palët e interesit, duke pasuruar me informacion faqen zyrtare të web-it si dhe duke krijuar një hapësirë të dedikuar për qytetarët që të shprehin ankesat dhe kërkesat. Gjithashtu, nëpërmjet intensifikimit të bashkëpunimit me median e shkruar dhe atë audio - vizive, KLSH do të rrisë prezencën në këto hapësira duke synuar që të jetë një burim i vlefshëm informacioni për mënyrën se si përdoren burimet publike dhe se si mund të përmirësohet performanca e shërbimeve publike.

Qëllimi 3. Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

Në zbatim të kësaj Strategjie, KLSH do të vlerësojë në vazhdimësi efektivitetin dhe përshtatshmërinë e burimeve të nevojshme në raport me detyrimet mandatore dhe aspiratat strategjike, duke i bërë ato pjesë të mendësisë dhe praktikës institucionale. Në këtë linjë, ky qëllim synon që krahas zhvillimit të vazhdueshëm profesional, të mundësojë një mjedis pozitiv dhe shpërblyes pune të qëndrueshëm dhe që stimulon rezultat në sfida inovative. Gjithashtu, KLSH synon të rrisë më tej aftësitë e audituesve, në përdorimin e teknologjisë dhe analizimit të të dhënave (big data), në mënyrë që të kryejnë auditime më të thelluara me bazë sistemi, të komunikojnë rezultatet në forma më të kuptueshme dhe inovative, si dhe të rrisin aftësitë reaguese në mënyrë efektive ndaj rrethanave që mund të krijohen si pasojë e situatave emergjente, si ato me të cilat u përballëm në dy vitet e fundit.

**5. ZHVILLIMI DHE MENAXHIMI
I BURIMEVE NJERËZORE**



5. Zhvillimi dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

5.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Zhvillimi i burimeve njerëzore, është një nga sfidat më të rëndësishme të menaxhimit institucional dhe faktor i rëndësishëm për realizimin e objektivave strategjike, me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e veprimtarisë audituese. Në këtë aspekt, KLSH, duke e konsideruar menaxhimin e burimeve njerëzore si parakusht për funksionimin e institucionit në mënyrë efektive dhe eficiente, referuar udhëzimeve dhe praktikave më të mira të komunitetit të INTOSAI-t për ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve audituese, ka vjuar të investojë në zhvillimin e burimeve njerëzore.

Në përmbushje të Qëllimit 2 të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2018-2022, *“Optimizimi i kapaciteteve profesionale dhe aftësive audituese”*, KLSH edhe gjatë vitit 2022 është përpjekur që të sigurojë një staf auditues i cili zotëron njohuritë dhe aftësitë e duhura për të realizuar me profesionalizëm detyrat funksionale duke kontribuar në arritjen e objektivave të institucionit dhe me ato të vendosura në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore me fokus në:

- ✓ Dokumentimin dhe zbatimin e praktikave më të mira, të përshtatshme për KLSH-në mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-t në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- ✓ Zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të fushës;
- ✓ Sigurimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- ✓ Rekrutimin e individëve me rezultate maksimale të arsimimit në një ose dy degë diplomimi, që njohin disa gjuhë të huaja, apo dhe të disponimit njëherazi të titujve akademikë, ekspertë dhe specialistë me kontribute të shquara në fusha të ndryshme si të teknologjisë së informacionit etj.;
- ✓ Sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, zhvillimit të kapaciteteve, si dhe kryerjes së trajnimeve në mënyrë të vijueshme;
- ✓ Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi objektiv të vlerësimit të stafit bazuar në performancë, në përmbushjen e objektivave individuale dhe kërkesave të kompetencave profesionale, etj.

Mbi zhvillimet e burimeve njerëzore gjatë vitit 2022

Me miratimin e buxhetit të KLSH-së për vitin 2022, u përditësua edhe struktura organizative me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 19 datë 31.01.2022 “Për strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në KLSH” me numër total 233 punonjës. Në fund të vitit 2022, numri faktik i punonjësve është 209, nga të cilët trupa audituese përbën 78% të numrit total faktik ose 163¹ auditues.

Përgjatë vitit 2022, struktura ka pësuar ndryshime me qëllim për të përforcuar strukturat e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë në të gjitha fazat e auditimit, si dhe për profilizimin e audituesve në fusha specifike të auditimit. Përkatësisht, me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr.141, datë 31.08.2022, u bënë ndryshime në strukturën e Departamenteve të Auditimit duke vendosur që brenda tyre të krijohen sektorë duke mundësuar kështu linja më efektive ndërveprimi dhe raportimi në funksion të përmbushjes së përgjegjësive në nivel njësie më të specializuar.

¹ Trupa audituese përbëhet nga 18 kryeauditues dhe 145 auditues.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 u riorganizua edhe struktura Përgjegjëse për Metodologjinë, Planifikimin Strategjik dhe Zhvillimin, kjo si nevojë e forcimit të bazës metodologjike dhe planifikimit strategjik, por edhe të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, sa i takon procesit të hartimit të planit vjetor të auditimeve mbështetur mbi fushat me risk; realizimin e trajnimeve edhe në fusha specifike siç janë ato të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm; kryerjen e trajnimeve dhe përmirësimin e raporteve të auditimit në drejtim të cilësisë së shkrimit të raportit, si dhe trajnime të tjera në varësi edhe të dinamikave që ndodhin në vend.

Organizimi strukturor i KLSH-së reflekton kërkesat e modelit COSO kundrejt pesë komponentëve (ambienti i kontrollit, menaxhimi i riskut, kontrolli i aktiviteteve, informimi dhe komunikimi), kërkesa që sigurojnë fleksibilitet dhe sisteme efektive të kontrollit të brendshëm duke formuar në këtë mënyrë një sistem të integruar që reagon në mënyrë dinamike ndaj ndryshimit të rrethanave.

Struktura sipas profilit arsimor

Klasifikuar sipas arsimimit, në strukturën organizative për vitin 2022, punonjësit me arsim të lartë janë 196 punonjës ose rreth 94% kundrejt numrit total faktik të punonjësve. Të ndarë sipas profilit të diplomimit, klasifikimi i punonjësve me arsim të lartë përfshin kryesisht ekonomistë, financierë, kontabilistë, juristë, inxhinierë, arkitekt dhe profile të tjera. Në një linjë me objektivat e dokumentit të politikave të burimeve njerëzore si dhe me qëllim aftësimin profesional dhe metodologjik në funksion të përmirësimit të performancës, një pjesë e punonjësve kanë përfunduar studimet universitare në degë të dyta apo janë trajnuar dhe certifikuar brenda dhe jashtë vendit në përgjigje të zhvillimeve të reja në fushën e auditimit publik.

Përbërja strukturore e stafit sipas funksioneve:

Stafi drejtues, ku përfshihet Drejtor i Kabinetit, Drejtor i Përgjithshëm, Sekretar i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive, Këshilltarë, përbën rreth 7% të numrit total faktik të punonjësve ose 14 punonjës; Stafi auditues përbën 78% të numrit total faktik të punonjësve ose 163 punonjës; Stafi mbështetës (përgjegjës sektori, zëdhënës, specialistë, juristë, punonjës shërbimi, etj.) përbën rreth 15% të numrit total faktik të punonjësve, ose 32 punonjës.

Mbi proceset e rekrutimit

Procedurat e rekrutimit të punonjësve përgjatë vitit 2022, janë zhvilluar në koherencë me Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022 si dhe politikave të miratuara të menaxhimit të burimeve njerëzore me qëllim që KLSH të sigurojë stafin e duhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të plotësuar nevojat aktuale dhe të perspektivës.

Si një proces shumë i rëndësishëm që ndikon drejtpërsëdrejti në përmirësimin e performancës së institucionit, gjatë vitit 2022 janë rekrutuar 39 punonjës në pozicione pjesë e shërbimit civil. Punonjësit e rekrutuar janë emëruar rast pas rasti në departamentet e auditimit apo në departamentet dhe drejtoritë mbështetëse në plotësim të nevojave që ka secila njësi për realizimin e planit vjetor të auditimeve apo përmbushjen e objektivave dhe detyrave funksionale. Gjithashtu, janë rekrutuar edhe 3 punonjës nëpërmjet akteve të emërimit² dhe kontratave të përkohshme.

² Në këtë kategori përfshihet rekrutimi i punonjësve të shërbimeve sipas përcaktimeve të Kodit të Punës në pozicione që nuk janë pjesë e Shërbimit Civil.

Politikat e ngritjes në detyrë dhe nxitjes së karrierës

Përgjatë vitit 2022, është treguar kujdes për zhvillimin e karrierës brenda institucionit, duke e vlerësuar si faktor të rëndësishëm që i shërben drejtimit më të mirë dhe sigurimit e rritjes së cilësisë së veprimtarisë audituese. Aktualisht, zhvillimi profesional dhe përparimi në karrierë realizohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit periodik të performancës dhe aftësive individuale, testimit të njohurive nga formimi profesional dhe konkurrimit transparent (po aq i rëndësishëm sa procesi i rekrutimit) për të gjitha pozicionet pjesë e shërbimit civil. Çdo punonjës ka të drejtën e ngritjes në detyrë dhe qëllimi i politikës së ngritjes në detyrë në KLSH është të sigurojë qëndrueshmërinë e potencialit të audituesve, në një linjë me kuadrin rregullator institucional dhe Standardet Ndërkombëtare ISSAI.

Në referencë dhe zbatim të standardeve ndërkombëtare, ku një institucion suprem auditimi duhet të ruajë dhe të zhvillojë trupën profesionale në funksion të qëllimit të krijimit të mundësive për promovimin dhe për integrimin e stafit të ri, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 7 procedura për ngritje në detyrë. Në përfundim të këtyre procedurave janë ngritur në detyrë 14 nëpunës në pozicione audituese dhe drejtuese.

Politikat e sigurimit të Barazisë Gjinore

KLSH, në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore i ka kushtuar vëmendjen e duhur respektimit të parimit të barazisë gjinore në të gjitha politikat, aspektet, veprimtaritë institucionale duke synuar eliminimin e fenomeneve të diskriminimit për shkak të gjinisë. Raporti i punonjësve femra/meshkuj, është përmirësuar duke pësuar një rritje të lehtë prej 1.3% krahasuar me një vit më parë.

Politika e KLSH-së në mbështetje të zhvillimit në karrierë të gjinisë femërore, reflektohet në numrin e konsiderueshëm që femrat zënë në nivele menaxheriale, duke përfaqësuar 8 pozicione drejtuese kundrejt 14 drejtues në total, si: Sekretare e Përgjithshme, Drejtore e Përgjithshme, Drejtore Departamenti, Drejtore Drejtorie dhe Kryeaudituese. Përfaqësimi gjinor për Nivelin e Lartë Drejtues për kategorinë Sekretar/Drejtor i Përgjithshëm, për vitin 2022 rezulton në pozicion drejtues femra në nivelin 100%.

Mosha mesatare e nëpunësve dhe vjetërsia në institucion

Një tregues mjaft i rëndësishëm i politikave të ndjekura në drejtim të garantimit të vijueshmërisë së punës dhe të gërshetimit të përvojës së audituesve të vjetër me stafin e ri janë dhe treguesit moshës dhe të vjetërsisë në punë. Ecuria në këto vite e këtyre treguesve ka njohur trendin e uljes së moshës mesatare të punonjësve. Mosha mesatare në KLSH në fund të vitit 2022 është 41.4 vjeç nga 41.9 vjeç në vitin 2021, duke ruajtur të njëjtin trend renës të 5 viteve të fundit.

5.2 ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE TRAJNIMI

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të nenit 39, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH” ka detyrimin ligjor për zhvillimin profesional të stafit auditues nëpërmjet trajnimeve. Zhvillimi i kapaciteteve audituese është gjithashtu një ndër objektivat strategjike institucionale, i cili vijon të mbetet prioritet edhe Strategjisë së re të KLSH-së 2023-2027. KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të KLSH-së, si një prej prioriteteve kryesore në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, në bashkëpunim kjo me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm si: ASPA,

OSBE/ANAC, SECO, SIGMA si dhe me INTOSAI-n, EUROSAI-n dhe SAI-t homologe. Procesi i trajnimit të vazhdueshëm funksionon në mënyrë efektive, duke u përmirësuar në vijimësi, në formë dhe përmbajtje dhe duke u konsoliduar, në frymën e Kongresit të XXII të INTOSAI-t, ku 192 SAI-t anëtare ranë dakord se: “... për të përcaktuar profesionalizimin si një proces të vazhdueshëm, me të cilin audituesit dhe organizatat e tyre, SAI-t sigurojnë nivele të larta të ekspertizës, kompetencës, sjelljes etike dhe të cilësisë, mbështetur në standardet profesionale (ISSAI)”. Nëpërmjet programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, KLSH ka bërë të mundur rritjen e njohurive dhe aftësive që ju nevojiten audituesve në realizimin e objektivave, mundësisë individuale për t’u rritur në karrierë, për rrjedhojë përmirësimin ndjeshëm të cilësisë së punës audituese, duke ndikuar në rritjen e transparencës, mirëqeverisjes dhe përdorimin e parasë publike, si dhe në rritjen e besimit tek profesionistët, për rrjedhojë edhe të publikut tek KLSH.

Detyrimi i KLSH, për të siguruar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit është materializuar si në dokumentet strategjike të KLSH-së, ashtu edhe në ato vjetore. Konkretisht:

- Në *Strategjinë e Zhvillimit Institucional* të KLSH 2018-2022, Qëllimi nr. 2 “Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse” dhe Plan Veprimit për vitin raportues 2022, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 195, datë 25.11.2021;
- Në *Plan Veprimin* e miratuar nga Kryetari i KLSH me nr.700/1, datë 29.07.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2021, miratuar në datë 29.07.2022”;
- Në *Plan Veprimin* “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë të datës 19.10.2021”, të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 1243, datë 12.11.2021;
- Në *Raportin e Vetëvlerësimit të KLSH-së* “Mbi realizimin e indikatorëve referuar Kornizës së Matjes së Performancës (PMF)”.

Në vijim të dokumenteve strategjike të sipërpërmendur, janë realizuar objektivat si më poshtë:

Objektivat vjetorë mbi trajnimet e stafit

Zhvillimi dhe trajnimi i audituesve, është një proces investimi strategjik i kohës, energjisë dhe burimeve, në përmirësimin e kapaciteteve audituese, konkretisht:

Përmirësim i performancës: Audituesit që marrin pjesë në trajnimet e nevojshme, janë më të aftë të kryejnë punën e tyre, marrin një kuptim më të gjerë të përgjegjësive brenda rolit të tyre dhe nga ana tjetër rritje në vetëbesimin e tyre.

Vlerësimi. Investimi në trajnime, është një tregues që audituesit janë të vlerësuar dhe të mbështetur nga institucioni dhe të sfiduar përmes mundësive të trajnimit, ndjehen më të kënaqur ndaj produktit të tyre.

Zhvillimi i aftësive. Për audituesit që mendojnë se kanë nevojë të përmirësohen në një fushë të caktuar, trajnimet janë formë ideale për ta bërë një gjë të tillë. Një program trajnimi ju mundëson audituesve të forcojnë aftësitë e nevojshme, që t’i aplikojnë pastaj ato në procesin auditues.

Konsistenca: Konsistenca është veçanërisht e rëndësishme për politikën dhe procedurat institucionale, audituese etj. Të gjithë punonjësit e KLSH, duhet të jenë të vetëdijshëm për

pritsmëritë dhe procedurat që zbaton KLSH.

Rritet reputacioni: Nëse do të kemi strategji efektive mbi trajnimet, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare, do të rritet cilësia e auditimeve në vlerësimin e mënyrës se si është shpenzuar paraja publike, në dhënien e kontributit mbi përmirësimin e qeverisjes, rritjen e transparencës, luftën kundër fenomeneve korruptive etj.

Në Planin e Zhvillimit Profesional të vitit 2022, është përcaktuar se KLSH zotëron disa mundësi për realizimin dhe shpërndarjen kohore të trajnimeve, në varësi të rrethanave dhe ngarkesës me angazhimet e programuara audituese, të cilat mund të përfshijnë: trajnimet e brendshme, ofruar nga trajnuesit e brendshëm; trajnime të brendshëm, ofruar nga trajnuesit e jashtëm; trajnime të jashtëm: një përzjerje të trajnimeve të brendshme dhe të jashtëm; E-learning alternativë me kosto efektive, që audituesit publikë dëshirojnë të ndjekin në kohë; udhëheqjen (mentorim) nga audituesi më i vjetër brenda departamentit, kryesisht me audituesit e rinj dhe të sapo rekrutuar. Gjatë vitit 2022, realizimi i trajnimeve në masë është kryer nëpërmjet platformës “Microsoft Skype”, ku audituesit kanë patur si asistencë Udhëzuesin “Mbi përdorimin e platformës “Microsoft Skype”, të hartuar nga Drejtorja e IT.

Realizimi i objektivave strategjikë për vitin 2022

Objektivat dhe nën objektivat strategjikë që rrjedhin nga Strategjia e Zhvillimit Institucional të KLSH, *Qëllimi nr. 2 “Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse”*, kanë fokus të përbashkët përmirësimin e bazës metodologjike dhe ngritjen e kapaciteteve audituese nëpërmjet rritjes së numrit të auditimeve financiare, të përmirësojë cilësinë e tyre me opinione profesionale dhe të kualifikuara auditimi në plotësim të kërkesave të progres-raportit të Komisionit Evropian; Të krijojë një qasje të auditimeve të performancës drejt fushave me ndjeshmëri publike; Të aplikojë praktikat më të mira të auditimit të teknologjisë së informacionit; Të përmirësojë cilësinë e raporteve të auditimit, si dhe të forcojë kapacitetet profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare të auditimit. Në kuadër të Planit të Veprimit për Zbatimin e SZHI për vitin raportues 2022, miratuar me vendimin e kryetarit të KLSH-së nr.195 datë 25.11.2021 vlen të përmendim se janë realizuar dhe kërkesat e fundit lidhur me nën-objektivat 2.4.1; 2.4.3; 2.3.3. dhe i kushtëzuar për tu realizuar në vijim mbetet objektivi 2.4, më konkretisht:

Gjatë vitit 2022, në zbatim të *nën objektivit 2.4.1* të SZHI-së është hartuar “Rregullorja e Trajnimeve në KLSH” miratuar me vendimin e Kryetarit nr. 26, datë 08.02.2022. Të gjithë trajnerët e KLSH, referuar Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional, Plan Veprimit në zbatim të tij, si dhe Programeve mujore dhe individuale për temat e caktuara, kanë patur të programuar kohën e nevojshme për përgatitjen e moduleve të trajnimit për auditimin financiar, përputhshmërinë dhe performancën, të cilat janë depozituar në Drejtorinë e Metodologjisë dhe Zhvillimit gjatë vitit 2022 në zbatim të *nën objektivit 2.4.3* të SZHI-së.

Në zbatim të *nën objektivit 2.3.3*, të SZHI-së. për aktivitetet trajnuese dhe ato e-learning vlen të përmendim se në kuadër të “Programit të Zhvillimit të integruar Profesional të KLSH për vitin 2022”, miratuar me vendimin nr.25, datë 04.02.2022, KLSH ka trajtuar disa forma të ofrimit të zhvillimit profesional si: trajnimi i brendshëm, i ofruar nga trajnuesit e brendshëm; trajnimi i brendshëm, i ofruar nga trajnuesit e jashtëm (ekspertë, ASPA); dhe e-learning.

Vlen të përmendim se në kuadër të programit të zhvillimit për vitin 2022 nga totali prej 21 modulesh trajnimi rreth 18 module janë ndjekur online me trajnerë të brendshëm duke mbajtur parasysht dhe 5 module trajnimesh të zhvilluara online në kuadër të bashkëpunimit me SAI-et homologe dhe 2 trajnime të realizuara me asistencë të ekspertëve të jashtëm nga ASPA

Objektivi 2.4, i cili derivon në 7 nën objektiva, paraqitet me realizim në 5 nën objektiva, si dhe nuk janë realizuar 2 nën objektiva, të kushtëzuara nga ndryshimet e Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së” dhe që kërkojnë certifikimin e audituesve të jashtëm në sektorin publik.

Realizimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2021, miratuar në datë 29.07.2022.

Gjatë vitit 2022, janë realizuar rekomandimet sipas Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, të cilat kishin në fokus: (i) Përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë në raportet e auditimit; (ii) Trajnimin e stafit me qëllim hartimin e raporteve cilësore të cilat kanë në fokus dhënien e rekomandimeve që adresojnë shkaqet e mangësive të identifikuara; (iii) Trajnimin e stafit për aktet rregullatorë që lidhen me projektet koncesionare dhe të partneritetit publik-privat; (iv) Organizimi i workshop-eve për gazetarët për t'i familjarizuar ata me metodologjinë e punës audituese dhe mënyrën e raportimit të KLSH-së; (v) Hartimin dhe miratimin e Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të stafit të KLSH-së dhe planit vjetor të punës me vendimin nr. 07 datë. 13.01.2023; si dhe (vi) reflektimin në planin vjetor 2023 të auditimeve edhe auditimin e sistemeve siç janë ato të kontrollit të brendshëm të cilat do të jenë pjesë e secilit program auditimi; (vii) hartimin e Udhëzuesit të Fushave me Risk për auditimet e Performancës, i miratuar me Vendimin nr. 8 datë 13.01.2023 të Kryetarit të KLSH-së; (viii) si dhe vendosjen si nën objektiv strategjik për periudhën 2023-2027 përmbushjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas Axhendës 2030, në përputhje edhe me prioritetet strategjike të INTOSAI-t për periudhën 2023-2027 (Qëllimi i parë Strategjik i KLSH-së).

Rekomandimet që burojnë nga Rezoluta e Kuvendit, njëkohësisht janë bërë pjesë e Planit Strategjik të KLSH-së për periudhën 5 vjeçare në vijim 2023-2027, e cila u miratua me vendimin nr. 247 datë. 29.12.2022.

Realizimi i rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 1243, datë 12.11.2021.

Për vitin 2022, KLSH ka vijuar punën për zbatimin e rekomandimeve referuar Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, të cilat kishin në fokus: (i) Trajnime mbi zbatimin e kërkesave të standardit ISSAI/IFPP-140 “Kontrolli dhe Sigurimi i Cilësisë” dhe Udhëzuesit të Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit në kontekstin e implementimit të Rregullores së rishikuar të Procedurave të Auditimit dhe Manualit të rishikuar të Performancës për të qenë në përputhje me standardet e INTOSAI.

Gjithashtu, ka vijuar puna në drejtim të forcimit të kapaciteteve audituese të KLSH-së në drejtim të auditimit të koncesioneve, procedurave të prokurimit dhe kontratave të partneritetit publik-privat, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme në këto fusha specifike si me burime të brendshme ashtu edhe me burime të jashtme (rreth 34 aktivitete kanë pasur në fokus prokurimet, koncesionet dhe PPP-te dhe 88 të tjera Standarde dhe Metodologji auditimi, në funksion të forcimit të kapaciteteve audituese).

Tabela nr.6

Nr.	Çështjet kryesore	Aktivitete trajnimi
1	Etika & Integritet dhe të tjera	15
2	IT	44
3	Koncesione & PPP	15
4	Legjislacion	64
5	Për çështje Strategjike te KLSH	35
6	Prokurime	19
7	Standarde & Metodologji	88
	Total	280

Indikatori i trajnimeve

Në Rregulloren e brendshme mbi Organizimin dhe funksionimin e KLSH, miratuar me vendimin 197 datë 12.10.2022, Strategjinë për Zhvillim Institucional 2018-2022, si dhe në Programin e Zhvillimit të Integruar Profesional të miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 25, datë 04.02.2022, është miratuar indikatori 25 ditë/trajnime në vit për çdo auditues.

Tabela nr.7: Të dhëna mbi realizimin e indikatorit ditë trajnimi/auditues në vit:

Departamentet e Auditimit	Nr. audituesish	Ditë trajnimi plan	Ditë trajnimi të realizuara	Mesatarja/ auditues	Realizimi %
Auditimit të Buxhetit të Shtetit	22	550	507	23	92%
Auditimit të Institucioneve Qendrore	27	675	490	18	73%
Auditimit të Performancës	28	700	765	27	109%
Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore	31	775	868	28	112%
Auditimit të SHA dhe investimeve të huaja	23	575	505	22	88%
Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit	15	375	416	28	111%
Auditimit IT	9	225	354	39	157%
Total		3,875	3,905	27	101%

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, trupa audituese e KLSH-së, gjatë vitit 2022, ka realizuar rreth 27 ditë trajnimi/auditues, nga 25 ditë trajnimi/auditues të planifikuara, ku nga audituesit e rinj janë kryer 15.24 ditë mesatare trajnimi. Ky tregues, në total është realizuar në masën 101% kundrejt objektivit.

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm të INTOSAI-t, ISSAI 100, Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit Administrativ të KLSH, në zbatim të Programit të Zhvillimit Profesional të KLSH për vitin 2022, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr.25, datë 04.02.2022, si dhe Programeve mujore të realizuara në përmbushje të detyrimeve të Plan Veprimit, si dhe të programeve të tjera të trajnimit të miratuara në përmbushje të Plan Veprimit të miratuar nga Kryetari i KLSH mbi Rezolutën e Kuvendit për Performancën e KLSH-së-2021 dhe Plan Veprimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, mbi rekomandimet e Bashkimit Europian. KLSH ka realizuar një sërë trajnimesh, të ofruara brenda institucionit; nga ASPA; nga institucione dhe organizma të huaja, si dhe trajnime të ndjekura individualisht nga stafi i KLSH, të

fokusuar në Standardet e auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualet e auditimit dhe udhëzues specifikë, në çështje sensitive si prokurimet publike; PPP dhe koncesionet; çështje të korrupsionit dhe masave parandaluese kundër tij etj.

Gjatë vitit 2022, 111 auditues të KLSH-së kanë qenë prezent në trajnime të zhvilluara nga ASPA, ndërsa nga stafi auditues i KLSH janë realizuar 1720 ditë njerëz/trajnimi për çështje që lidhen kryesisht me: prokurimin publik; Ligjin për nëpunësin civil dhe e drejta administrative; Komunikimi, etika dhe niveli menaxherial; Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli/Auditimi Brendshëm; Buxhet dhe planifikim buxhetor; Fondet IPA; Vlerësim projektsh; TIK; etj.

6. VLERËSIME NGA BE DHE INTOSAI



**SAI Performance Report of the Albania Supreme Audit Institution (ALSAI)
dated September 2022**

Independent Review Statement

The INTOSAI Development Initiative (IDI), as operational lead on SAI PMF, provides support to SAI PMF assessments where requested. Such support includes conducting independent reviews (IR) of draft assessment reports. A request for such an IR was received from the Albania Supreme Audit Institution in April 2022.

This SAI Performance Report (SAI-PR) was prepared by Ms. Aulona Jani, Head of Performance Audit Department and Team Leader for the Assessment Team, Ms. Xhuljeta Celaj, Senior Auditor, Performance Audit Department, Mr. Koco Sokoli, Senior Auditor, Legal, Ethics and Standard Implementation Department, Ms. Elisa Metaj, Specialist, Communication, Publishing and Foreign Relations Sector and Mr. Redi Ametllari, Senior Auditor, Audit Department of Assets and Environment. The five (5) team members received training in the application of the SAI PMF methodology prior to undertaking the assessment.

In compliance with the recommended SAI PMF methodology, the Head of the Albania Supreme Audit Institution received the draft report for review and official comment with the objective of ensuring that the report is factually correct. An internal review group that was not part of the assessment team, consisting of the General Director, Secretary General, Head of Cabinet, and Management Department Directors reviewed the draft report prior to submitting the report to IDI for an independent review. The assessment was based on the SAI PMF 2016 Endorsement Version (Published on 24 February 2017/Modified on 5 September 2017).

The IR arranged by IDI was conducted by Mr. Brighton Nyanga, Manager, SAI Governance Department at the IDI, who had no responsibility for preparing the SAI-PR and is considered to have the appropriate knowledge and experience necessary to perform this task. The objective of this review was to ensure that the SAI PMF methodology was adhered to, that the evidence in the SAI-PR was sufficient to justify the indicator scores and that the analysis throughout the Report was consistent with the supporting evidence.

The review concluded that all the objectives for a quality assessment were satisfactorily met in the final report dated September 2022. In arriving at this conclusion, the independent reviewer relied on the quality control processes of the assessment team and the quality assurance processes of the SAI which were both aimed at ensuring the facts on which the conclusions are based are reliable and accurate.

All the significant matters raised during the independent review process have been adequately addressed in this version of the SAI-PR.

Prepared by: Brighton Nyanga



Date: 28 September 2022

6. VLERËSIME NGA BE DHE INTOSAI



Vlerësim nga Vlerësuesi i Pavarur i Iniciativës për Zhvillim e INTOSAI (IDI), për aktivitetin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

KLSH, gjatë vitit 2022, ka vijuar me procesin e vetëvlerësimit nëpërmjet Kornizës së Matjes së Performancës (KMP) si një mjet i zhvilluar nga Grupi i Punës së INTOSAI-t mbi Vlerat dhe Përfitimet e SAI (INTOSAI-P 12). Raporti i Vetëvlerësimit të Performancës sipas Kuadrit të INTOSAI-t synon të luajë një rol të rëndësishëm në përpjekjet e KLSH-së drejt përmirësimit të metodologjive të auditimit, qeverisjes së brendshme dhe etikës, zhvillimit të kapaciteteve, si dhe angazhimit të palëve të interesuara. Implementimi i KMP për vitin 2022, u finalizua nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI) dhe nga SAI i Norvegjisë, si dhe u vlerësua nga një ekspert ndërkombëtar krejtësisht i pavarur nga procesi, çfarë e bën këtë vlerësim edhe më objektiv.

Rezultatet e këtij raporti i shërbyen më së miri konceptimit dhe hartimit më tej, të planit strategjik të institucionit për periudhën 2023 - 2027¹.

Përdorimi i vlerësimit të KMP-së, është shumëdimensional, duke mos u kufizuar vetëm në përputhshmërinë dhe plotësimin e kërkesave që burojnë nga standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI), por duke ofruar një perspektivë më të gjerë në përdorimin e rezultateve të tij. Në vijim të sa më sipër, KLSH i bëri rezultatet e këtij raporti pjesë të kuadrit menaxherial institucional, jo vetëm duke i përfshirë në planin e ri strategjik të zhvillimit të KLSH-së 2023 - 2027, por edhe duke e kthyer procesin e vetëvlerësimit në një mjet periodik të vlerësimit të punës së KLSH-së, përfshirë kjo edhe si pjesë integrale e Raportit Vjetor të Performancës së KLSH-së.

Vlerësimi u bazua në versionin e miratuar të Kornizës së Matjes së Performancës për SAI-et, “PMF 2016/INTOSAI” (Botuar më 24 shkurt 2017/Ndryshuar më 5 shtator 2017). Vlerësimi i Pavarur i kryer nga IDI u kryesua nga Departamenti për Qeverisjen e SAI-ve në IDI, i cili kishte si objektiv dhënien e sigurisë se, përgjatë procesit të vlerësimit është respektuar metodologjia e përdorur për Kornizën e Matjes së Performancës, se evidencat kanë qenë të mjaftueshme për saktësinë e pikëzimit të treguesve dhe se analiza në tërësinë e raportit ka qenë në përputhje me evidencat mbështetëse.

Në përfundim, referuar Raportit të Vlerësuesit të Jashtëm, u konkludua se, të gjitha objektivat për vlerësimin e cilësisë së punës së KLSH-së, janë përmbushur dhe se të gjitha çështjet e rëndësishme të ngritura gjatë procesit të rishikimit të pavarur, janë trajtuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë.

¹ Raporti i Vetëvlerësimit të KLSH-së, gjendet i publikuar në faqen zyrtare të KLSH, së bashku me Vlerësimin e Vlerësuesit të Jashtëm: <https://panel.klsh.org.al/storage/php0GFcU3.pdf>



Kontributi i KLSH-së tek institucionet që monitorojnë ecurinë e reformave dhe procesin e integritimit në BE

Në kuadër të monitorimit dhe vlerësimeve përkatëse që institucione të ndryshme ndërkombëtare kryejnë mbi zbatimin e reformave për menaxhimin financiar publik dhe auditimin e jashtëm, përfaqësues të lartë të KLSH-së kanë zhvilluar takime dhe kanë raportuar mbi kontributin institucional të dhënë në këtë drejtim, si vijon:

Takimi i datës 31.01.2022 me misionin e vlerësimit të Komisionit Evropian për luftën kundër korrupsionit ku u raportua mbi veprimtarinë dhe hapat e ndërmarra nga institucioni në luftën kundër korrupsionit.

Takimi i datës 29.09.2022 me Nënkomitetin e Çështjeve Ekonomike, Financiare dhe Statistikat ECOFIN, ku u raportua mbi progresin në zhvillimet e reja të planifikimit strategjik, zhvillimet lidhur me amendimet ligjore të propozuara, impaktin e punës audituese dhe marrëdhënia me Parlamentin, si edhe roli i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit.

Takimi i datës 11.10.2022 me misionin e Bankës Botërore me fokus kryesor “Qëndrueshmëria fiskale dhe mbështetja ndaj politikave të financimit të zhvillimit”, gjatë të cilit KLSH paraqiti kontributin e dhënë mbi gjetjet dhe rekomandimet në kuadër të raportimit të risqeve fiskale.

Takimi i datës 18.11.2022 BE-Shqipëri për Kapitullin 5 “Prokurimet Publike” ku KLSH iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga Komisioni Evropian lidhur me këtë fushë komponent.

Në takimin e parë bilateral Shqipëri – BE, mbi Kriterin Ekonomik, Kapitulli 32 “Kontrolli Financiar, i zhvilluar më 09.12.2022 ku KLSH raportoi për nën komponentin “Auditimi i Jashtëm” duke pasqyruar një kuadër të plotë dhe të qartë të organizimit dhe funksionimit të një institucioni modern auditimit, prioritetet strategjike për të ardhmen dhe angazhimin e vazhdueshëm në luftën kundër korrupsionit.



Vlerësimi i Progres-Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2022, për veprimtarinë e KLSH-së.

Në datën 12 tetor 2022, Komisioni Evropian ka publikuar Progres-Raportin e vitit 2022 për Shqipërinë dhe në vlerësimet për Kapitullin 32 “Kontrolli financiar” nënvizon se: *“Në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), kuadri kushtetues dhe ligjor i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Janë të nevojshme ndryshimet ligjore me qëllim forcimin e mandatit auditues për të mbuluar të gjitha subjektet publike. Në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit 2018-2022, KLSH po ndërmerr veprime për të përmirësuar kapacitetin institucional. Nevojitet të hartohet dhe miratohet një plan i ri për 2023 dhe më tej. (me Vendim të Kryetarit të KLSH-së, nr.247, datë 29.12.2022 është miratuar Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027). Zbaton planin vjetor profesional për stafin*

auditues, ndër të tjera duke u fokusuar në prokurimet publike, koncesionet/PPP dhe manualin e ri të auditimit të performancës”.

Në vijim raporti cilëson se *“Cilësia e punës audituese ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm në përputhje të plotë me standartet INTOSAI dhe se objektivat kanë kaluar nga auditimet e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, në ato të performancës. Ndiqet një qasje e auditimit të jashtëm bazuar në risk”.*

Mbi impaktin e punës audituese raporti citon se *“ka progres të moderuar dhe se KLSH vazhdon të hartojë raporte vjetore mbi aktivitetin, i publikon ato në faqen zyrtare të internetit dhe i raporton rregullisht Kuvendit”.*

Gjithashtu, raporti shprehet se, pavarësisht shkallës së lartë të zbatimit të rekomandimeve për vitin 2021 (90% të pranuar nga institucionet dhe me 80% në proces të zbatimit dhe me disa prej tyre plotësisht të zbatuara), shkalla e zbatimit të plotë të këtyre rekomandimeve, duhet të përmirësohet më tej.

Në përfundim, në Progres Raport rekomandohet se, është e nevojshme të rritet shkalla e shqyrtimit nga Parlamenti të zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara, nëpërmjet dëgjësive parlamentare dhe ngritjes së një kuadri parlamentar monitorimi, në vlerësim të veprimeve të ndërmarra nga ekzekutivi për ndjekjen e tyre.

Vlerësimi i veprimtarisë së KLSH-së nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) i publikuar në datën 19 shtator 2022, “Besimi në Qeverisje 2021”

Sondazhi i opinionit publik i zhvilluar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) i publikuar në datën 19 shtator 2022, “Besimi në Qeverisje 2021”, i cili shqyrton perceptimin publik dhe qëndrimet e qytetarëve në çështje, si: besimi në institucionet publike, transparenca dhe llogaridhënia institucionale, korrupsioni, niveli i përfshirjes qytetare në politikë bërje dhe vendimmarrje, kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike, menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave për mbrojtjen nga diskriminimi. Në sondazh paraqitet perceptimi i opinionit publik edhe për Kontrollin e Lartë të Shtetit, lidhur me llogaridhënien e qeverisë, ku evidentohet se tre institucionet e perceptuara si mekanizmat më efikase për llogaridhënien në vend janë: **Kontrolli i Lartë i Shtetit (71.1%)**, ndjekur nga Parlamenti (63.9%) dhe media (61.5%).

7. TREGUESIT BUXHETOR DHE FINANCIAR

7. TREGUESIT BUXHETOR DHE FINANCIARË TË KLSH PËR VITIN 2022

KLSH ka kryer monitorimin e buxhetit të vitit 2022, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar dhe miratuar në Ligjin nr.115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, akteve normative të vitit 2022, në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”.

Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioritetëve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2018-2022. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategorie shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Programi 01120 “Veprimtari audituese e KLSH-së”: Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për vitin 2022

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 dhe Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është bërë miratimi i çeljes dhe rishikimit të fondeve buxhetore për vitin 2022, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të KLSH, sipas zërave për vitin 2022, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.8

Në mijë lekë									
Art.	Programi	Fakti 2021	PBA 2022	Plan Fillestar 2022	Plan AN1 2022	Plan AN2 2022	Fakti Viti 2022	Dif.	%
600	Paga	247,281	269,000	319,000	311,025	294,025	290,957	-3,068	99%
601	Sigurime Shoqërore	40,073	42,000	42,000	40,950	47,950	47,126	-824	98%
602	Mallra dhe Shërbime	52,927	103,810	103,960	93,429	82,729	69,484	-13,245	84%
605	Transferta me jashtë		150		150	150	120	-30	80%
606	Transferta Korente			1,600	1,600	2,600	2,554	-46	98%
Total	Shpenzime Korrente	340,281	414,960	464,960	447,154	427,454	410,241	-17,213	
231	Kapitale të Trupëzuara	7,586	15,000	20,000	20,000	14,000	13,032	-968	93%
230	Kapitale të pa Trupëzuara					6,000	4,291	-1,709	72%
Totali	Shpenzime Kapitale	7,586	15,000	20,000	20,000	20,000	17,323	-2,677	87%
230	Sh.Kapitale F/ Huaj	1,115	0	24,000	24,000	24,000	0	-24,000	0
Totali Kapit.	Shpenzime Kapitale	8,701	15,000	44,000	44,000	44,000	17,323	-26,677	
Totali		348,982	429,960	510,560	491,154	471,454	427,564	-43,890	91%

Analiza e realizimit të buxhetit të KLSH-së për vitin 2022

-Bazuar ne Ligjit 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, për KLSH u miratua fondi në total në vlerën **510,560 mijë lekë** duke përfshirë edhe vlerën për 1,600 mijë lekë nga fondi i veçantë dhe një organikë prej 233 punonjës.

-Me Aktit Normativ, nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “ Për buxhetin e vitit 2022”, buxheti i KLSH-së, është pakësuar në vlerën për 19,406 mijë lekë dhe konkretisht në zërin “Paga dhe Sigurime” për vlerën 9,025 mijë lekë dhe në zërin “mallra dhe shërbime” në vlerën për 10,381 mijë lekë duke kaluar kështu në vlerën totale për **491,154 mijë lekë** duke përfshirë edhe vlerën për 1,600 mijë lekë nga fondi i veçantë ndërkohë që numri i miratuar i punonjësve nuk ka ndryshuar, pra 233 punonjës të miratuar.

-Me Aktit Normativ, nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “ Për buxhetin e vitit 2022”, buxheti i KLSH-së, është pakësuar në vlerën për 20,700 mijë lekë dhe konkretisht në zërin “Paga dhe Sigurime” për vlerën 10,000 mijë lekë dhe në zërin “mallra dhe shërbime” në vlerën për 10,700 mijë lekë. Në zbatim të VKM nr. 898 datë 29.12.2022 “Mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës” nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për institucionin tonë janë akorduar fondet buxhetore për shpenzimet operative në vlerën për 1,000 mijë lekë duke kaluar kështu në vlerën totale për 471,454 mijë lekë ndërkohë që numri i miratuar i punonjësve nuk ka ndryshuar, pra 233 punonjës të miratuar.

Për vitin 2022, buxheti i planifikuar në masën për **471,454 mijë lekë** dukë përfshirë edhe Financimin e Huaj, është realizuar në vlerën për **427,564 mijë lekë** ose realizuar në masën 91%.

1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601.

Për vitin 2022, buxheti i planifikuar, i ndryshuar, në vlerën për **341,975 mijë lekë** është realizuar në vlerën për **338,083 mijë lekë** ose realizuar në masën **99%**.

Shuma e shpenzuar në zëri Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar konform kontratave të nënshkruara me ta.

2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2022 në Ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, për zërin shpenzime operative, është në vlerën për **103,960 mijë lekë**, ose 20% e planit të përgjithshëm buxhetor të vitit 2022.

Për vitin 2022, plani i buxhetit me ndryshime në vlerën për 82,729 mijë lekë është realizuar në vlerën për 69,485 mijë lekë ose **realizuar në masën 84%** ose me një mosrealizim për 13,244 mijë lekë.

Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si shpenzime për shërbimin e sigurisë, drita, ujë, telefon etj. Një pjesë të konsiderueshme në

shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit në vlerën për 45,515 mijë lekë dhe që përfaqësojnë 66% të shpenzimeve faktikë të këtij zëri.

3- Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.

Për periudhën raportuese 2022, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, në shumën 120 mijë lekë nga 150 mijë lekë të planifikuara.

4- Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.

Gjatë periudhës ushtrimore 2022, është dhënë Fond i Veçantë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën 1,600 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje. Në zbatim të VKM nr. 898 datë 29.12.2022 “Mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës” nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për institucionin tonë janë akorduar fondet buxhetore shtesë për këtë zë për 1,000 mijë lekë. Plani i rishikuar në vlerën masën për 2,600 mijë lekë në llogarinë 606, është realizuar në vlerën 2,504 mijë lekë ose 96.3%, nga të cilat 356 mijë lekë për daljen e punonjësve në pension, rastet e fatkeqësie dhe sëmundjeje dhe 2,148 mijë lekë për pagesën e mbështetjes financiare të menjëhershme të punonjësve të institucionit.

5- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.

Bazuar në Ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale është në shumën 44,000 mijë lekë, nga të cilat 20,000 mijë lekë investime me Financim të Brendshëm dhe 24,000 mijë lekë për investime kapitale me Financim të Huaj.

A-Financim i Brendshëm.

Bazuar në Ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Brendshëm në artikullin 230 dhe 231 është miratuar në vlerën **20,000 mijë lekë** dhe është parashikuar për zbatimin e projekteve si në vijim:

Tabela nr.9

Në mijë lekë					
Kodi I projekt	Përshkrimi	Plani Vjetor	Plani Rishikuar	Realizimi 2022	%
M240002	Blerje automjete	9,700	8,700	8,580	99%
M240009	Blerje pajisje kompjuterike	3,000	3,000	2,580	86%
M240003	Rikonstrukcion Godina	1,600	1,600	1,203	75%
M240010	Blerje pajisje zyre	700	700	668	95%
19AA402	Kosto Lokale	5,000	6,000	4,291	72%
		20,000	20,000	17,323	87%

Realizimi i shpenzimeve kapitale me Financim të Brendshëm në vlerën për 17,323 mijë lekë për vitin 2022, krahasuar me buxhetin e planifikuar, është në masën 87 %.

B-Financim i Huaj

Bazuar në Ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Huaj në artikullin 231 është miratuar në vlerën **24,000 mijë lekë** dhe është parashikuar për zbatimin e projektit “Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri”. Në muajin Tetor të vitit 2022, KLSH ka realizuar me sukses procedurën e prokurimit dhe ka lidhur kontratën me operatorët ekonomikë me qëllim realizimin e këtij projekti investimi. Qëllimi kryesor i projektit është rritja e kontributit të KLSH-së për të forcuar llogaridhënien qeveritare në përdorimin e fondeve publike përmes auditimeve më profesionale dhe gjithëpërfshirëse të prokurimeve publike për koncesionet dhe partneritetet publike-private.

6.2 Konkluzioni i auditit të brendshëm mbi Pasqyrat Financiare 2022

Në kuadër të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, bazuar në Planin Vjetor të punës, miratuar me shkresën nr. 965/2 datë 18.10.2021, të Kryetarit të KLSH-së, është kryer misioni i auditimit “Mbi auditimin e sistemeve dhe përputhshmërisë në fushën e menaxhimit financiar” për periudhën 01 janar 2022 deri më 31 dhjetor 2022.

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare të institucionit për periudhën e mbyllur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto si dhe shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të institucionit më datë 31 dhjetor 2022, dhe performancës financiare në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të raportimit financiar.

Auditimi u krye në përputhje me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar e Kontrollin”, UMF nr. 86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, UMF nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik”; UMF nr. 12, datë 5.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Ligjin nr. 25/2015, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndërsa struktura, funksionimi dhe mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në, njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe udhëzimit nr. 34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2022”. Qëllimi i auditimit është të ndihmojë institucionin e KLSH-së dhe të japë siguri, që të arrijë objektivat nëpërmjet një veprimtarie në përputhje me kërkesat ligjore, standardet dhe rregulloret në fuqi, duke identifikuar aktivitetet me risk dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit.

Në Raportin Final të Auditimit me nr. prot 1154/4, datë .17.03.2023, “Mbi auditimin e sistemeve dhe përputhshmërisë në fushën e menaxhimit financiar të Sektorit të Financës”, për periudhën ushtrimore 2022, janë dhënë gjithsej 2 rekomandime.

Informacione të tjera.

Gjatë kryerjes së këtij auditimi është pasur në objekt dhënia e një vlerësimi të përgjithshëm mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe dhënien e një opinioni mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2022 nga ku rezulton se, menaxhimi financiar dhe kontrolli në përgjithësi dëshmon një proces të mirë dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit si dhe të gjitha proceset dhe transaksionet e kryera janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, në Raportin Final të Auditimit me nr. 1278/5prot, datë 28.03.2022, “Mbi auditimin e sistemeve dhe përputhshmërisë në fushën e menaxhimit financiar të Sektorit të Financës” janë dhënë gjithsej 3 rekomandime, të cilat janë pranuar dhe është përgatitur dhe dërguar në kohë me shkresën nr. 1278/6, datë 06.04.2022 Plani i Veprimit për zbatimin e tyre. Aktualisht këto rekomandime rezultojnë të zbatuara.

8. ANEKSE

ANEKS 1

Pasqyrat financiare të KLSH për periudhën ushtrimore 2022, janë të prezantuara në Lekë, monedha shqiptare.

Nr.	Llogarive	E M E R T I M I	Në Lekë	
			Viti 2022	Viti 2021
1	A	A K T I V E T	738,231,145	817,148,093
2		I. Aktivet Afat shkurtra	51,572,890	50,801,152
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	2,264,314	2,264,314
6	520	Disponibilitete në Thesar	2,264,314	2,264,314
10	59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	16,507,361	17,283,015
12	31	Materiale	16,507,361	17,283,015
20	39	Provizjone për zhvlerësimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari të Arkëtushme	32,801,215	31,253,823
22	411	Kliente e llogari të ngjashme		
32	468	Debitore të ndryshëm	2,972,409	2,972,409
33	4342	Operacione me shtetin(Të drejta)	29,828,806	25,080,019
	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	3,201,395
36		4.Të tjera aktive afatshkurtra	0	0
37	409	Parapagime		
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme		
42		II. Aktivet Afat gjata	686,658,255	766,346,941
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	141,951,739	162,710,926
44	201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
45	202	Studime dhe kërkime	141,951,739	162,710,926
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	544,706,516	603,636,015
48	210	Toka, Troje, Terene		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	486,673,546	511,102,989
51	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore		
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	36,924,735	48,260,895
53	215	Mjete Transporti	4,641,105	2,727,505
54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	16,467,130	41,544,626
57	24	Aktive afatgjata te dëmtuara		
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	34,928,310	33,250,682
66		I. Pasivet Afat shkurtra	34,928,310	33,250,682
67		1. Llogari të Pagueshme	34,928,310	33,250,682

68	401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	0	3,201,395
69	42	Detyrime ndaj personelit	19,452,094	16,432,436
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhënës		
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	2,504,415	2,033,884
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	7,872,297	6,613,699
80	464	Det. për tu paguar për bl. letrave me vlerë		
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	2,127,095	1,996,859
82	467	Kreditore të ndryshëm		
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	2,972,409	2,972,409
84	49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		
85		2.Të tjera pasive afatshkurtra	0	0
91		II. Pasivet Afat Gjata	0	0
95	Klasa 4	Të tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	703,302,835	783,897,411
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	703,302,835	783,897,411
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	703,811,034	784,897,604
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	-775,654	-2,383,050
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	267,455	1,382,857
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara në përdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata		
107		Të Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	738,231,145	817,148,093

A. Në mbyllje të periudhës ushtrimore 2022, **Aktivi i Bilancit Kontabël**, paraqitet në vlerën **738,231,145 lekë**, nga e cila :

1. Aktive të Qëndrueshme të pa Trupëzuara, në mbyllje të periudhës ushtrimore rezultojnë me vlerë neto totale **141,951,739 lekë** dhe i përket fondeve për realizimin e projekteve me Financim të Huaj, projektit IPA 2013 “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”. Ky zë i aktivitet është shtuar nga blerjet e vitit 2022 për vlerën 4,291,120 lekë, është pakësuar me: vlerën 25,050,307 lekë me amortizimin e vitit 2022

2. Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara (AQT) në fund të vitit 2022 rezultojnë me vlerë **544,706,516 lekë**. Vlera e rivlerësimit të ndërtesës, fondi i bibliotekës, pajisjet kompjuterike etj. deklarohen me koston e blerjes dhe shtesat respektive, minus amortizimin, në bazë të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

2.1-Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione, paraqitet në Aktiv të bilancit me vlerën neto për 486,673,546 lekë dhe që përbehet nga:

- **Kosto historike** e ndërtesës në vlerën totale për **619,172.472 lekë** e përbërë nga:

-Kosto historike e Rikonstruksionit të ndërtesës, në vlerën 110,163,443 lekë,

-Rivlerësimi të Ndërtesës, në baze të Akt Vlerësimit nr.588/1 prot., datë 25.06.2018, në vlerën 502,824,300 lekë.

-Vlera e projektit të godinës prej 3.480.000 lekë.

-Vlerën e rikonstruksionit të kryer përgjatë vitit 2021, në vlerën për 1,519,775 lekë për shkak të miratimit të rritjes së kërkuar të numrit të punonjësve të KLSH-së.

-Vlerën e rikonstruksionit të kryer përgjatë vitit 2022, në vlerën për 1,184,954 lekë për shkak të miratimit të rritjes së kërkuar të numrit të punonjësve të KLSH-së.

- Pakësuar me:

Amortizimin e akumuluar në çelje të periudhës ushtrimore në vlerën për 106,884,529 lekë

Amortizimin vjetor, i cili është llogaritur në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” në vlerën për 25,614,397 lekë me normë amortizimi 5% e llogaritur veçmas me vlerën e mbetur.

Në fund të periudhës, vlera neto e godinës është **486,673,546 lekë**.

2.2-Llogaria- 215 “Mjete transporti” në vlerën neto për **4,641,105 lekë**. Ky zë i aktivitetit është shtuar në vitin 2022 për vlerën 8,580,000 lekë dhe është pakësuar me vlerën 5,480,000 lekë, si rezultat i daljes jashtë përdorimi me kosto historike të dy automjeteve dhe me amortizimit e llogaritur për vitin 2022 në vlerën për 1,186,400 lekë .

2.3-Llogaria- 214 “instalime teknike, makineri e vegla pune”, në mbyllje të

periudhës ushtrimore rezulton në vlerën neto prej **36,924,735 lekë**. Llogaria 214 , për vitin 2022 është pakësuar me amortizimin e vitit 2022 në vlerën për 11,336,160 lekë.

2.4-Llogaria- 218 “Inventar ekonomik”, në mbyllje të periudhës ushtrimore rezulton në vlerën **16,467,130 lekë**. Ky zë i aktivitetit është shtuar nga blerjet e vitit 2022 për vlerën 3,266,905 lekë, është pakësuar me:

-vlerën 12,046,947 lekë me amortizimin e vitit 2022:

-vlerën për 15,743,288 lekë për daljet jashtë përdorimi me koston historike: dhe

-nga sistemimi me klasën 31 mallra në vlerën për 554,166 lekë.

3. Aktivet Qarkulluese në fund të vitit 2022, rezultojnë me gjendje në vlerën **51,572,890 lekë** e cila përbehet nga:

Klasa “Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre”, në shumën për **2,264.314 lekë**

dhe që përfaqëson detyrimin që ka institucioni ndaj të tretëve për punimet e kryera (garancitë)

Klasa 3 “Gjendje e inventarit”, në shumën **16,507,361 lekë** në fund të vitit 2022.

Klasa 4 “Kërkesë arkëtimi mbi debitorët”, në mbyllje të periudhës ushtrimore të vitit 2022 paraqitet në vlerën **32,801,215 lekë**. Kjo vlerë përfaqëson të drejtën e institucionit mbi të tretët dhe që mbetet pa paguar në fund të vitit 2022, dhe përbëhet nga:

4.1-Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në shumën 29,828,806 **lekë** në rubrikën e të drejtave dhe që përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit, për pagat e punonjësve si dhe sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi pagën për muajin dhjetor 2022 ,të konstatuara por të pa likuiduara dhe që parashikohet të likuidohen me fondet buxhetore të vitit të ardhëm. Kjo llogari ka në kundër parti në pasiv të bilancit:

llogarinë 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, në shumën për 19,452,094 lekë,

llogarinë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, në shumën 2,504,415 lekë,

llogarinë 435 “Sigurime shoqërore”, në shumën 7,872,297 lekë.

4.2-Llogaria 468, “Debitorë të ndryshëm” në shumën 2,972,409 lekë, e cila përfaqëson vlerën e dëmit që i është shkaktuar institucionit tonë në ngjarjet e 14 Shtatorit 1998 dhe Urdhër Ekzekutimin për shpërblim dëmi personelit të KLSH-së.

B. Nga të dhënat përmbledhëse rezulton se **Pasivi i Bilancit Kontabël**, me 31.12.2022, paraqitet në vlerën **738,231,145 lekë**, nga e cila :

1. Pasivet Afat shkurtra në vlerën për 34,928,310 lekë.

2. Llogaria 101 “Fondi i akumuluar”, në vlerën 703,302,835 lekë

Fondet e akumuluar, në fund të vitit 2022, në krahasim me vitin 2021 kanë pësuar një ulje në vlerë për 80,594,576 lekë. Fondet e veta gjatë vitit 2022 kanë pësuar lëvizjet si më poshtë vijon:

Gjendja e llogarisë në çelje të periudhës ushtrimore për 783,897,411 lekë

Shtuar për 17,192,743 lekë fondet buxhetore për blerjet me pagesë gjatë vitit 2022,

Pakësuar për 97,787,319 lekë si rezultat i pakësimit nga:

-Amortizimi i AQT-ve në vlerën për 75,234,211 lekë,

-Pakësimit i inventarit ekonomik nga nxjerrja nga përdorimi në vlerën e kostos historike për 21,777,454 lekë me vlerë të mbetur për 317,775 lekë përfshirë dhe sistemimin me klasën 31 mallra në vlerën për 554,166 lekë,

-Llogaria 85 Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore, në vlerën 775,654 lekë (ndryshimi i gjendjes së inventarit.

Zëri Fondet e veta në pasiv të bilancit është i kuadruar në formatin nr.4 të pasqyrave financiare të KLSH.

ANEKS 2: Evidenca e kallëzimeve penale për periudhën janar – dhjetor 2022

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr. prot. data e kallëzimit	Nr. Personave	Detyra funksionale	Referenca ligjore për kallëzim penal	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
1	DVASHK Sarandë	Nr.Prot. 774/11 Datë 24/03/2022	6	<ol style="list-style-type: none"> 1) Ish-Drejtor, Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t, (aktualisht DVASHK Sarandë); 2) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, aktualisht specialist; 3) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit 4) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë; 5) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë; 6) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë. 	Konsumim i figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
2	DRAKU Tiranë	Nr.Prot. 1153/24 Datë 12/10/2022	1	<ol style="list-style-type: none"> 1) Kryeinspektor DRAKU Tiranë 	Konsumim i figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal	Në hetim	
3	ASHK Vlorë	Nr.Prot. 108/46 Datë 12/10/2022	6	<ol style="list-style-type: none"> 1) Ish-Drejtor, DVASHK Sarandë; 2) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, DVASHK Sarandë; 3) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit 4) Specialist jurist në DVASHK Sarandë; 5) Ish-Përgjegjës i Sektorit në DVASHK Sarandë; 6) Ish-Drejtor, ZVRPP Sarandë; 	Konsumim i figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar në nenin 48 të Kodit Penal	Në hetim	

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr. prot. data e kallëzimit	Nr. Personave	Detyra funksionale	Referenca ligjore për kallëzim penal	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
4	DRTK Shkodër	Nr.Prot. 100/11 Datë 28/10/2022	3	<ol style="list-style-type: none"> 1) Administrator shoqërie 2) Administrator shoqërie 3) Mbukëqyrës punimesh 	Konsumim i figurës së veprës penale të “Shkatërrimit të veprave kulturore” parashikuar në nenin 160 të Kodit Penal	Në hetim	

ANEKSI 3: Institucionet e audituara nga KLSH, për periudhën Janar – Dhjetor 2022

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHETITIT		
1	1	Banka e Shqipërisë
2	2	Agrokredit SHA
3	3	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ¹
4	4	Fondi i Sigurimit të Detyrueshem të Kujdesit Shëndetësor
5	5	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
6	6	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
7	7	Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
8	8	Drejtoria e Përgjithshme e Doganës
9	9	Dejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
10	10	Dega e Doganës Tiranë
11	11	Dega e Doganës Durrës
12	12	Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
13	13	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit
14	14	Instituti i Integritit të ish të Përndjekurve Politik dhe Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (të përndjekurit politik)
15	15	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e II-të të vitit 2021
16	16	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ²
17	17	Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan
18	18	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE		
19	1	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2021
20	2	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
21	3	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
22	4	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)
23	5	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
24	6	Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor
25	7	Ministria e Mbrojtjes
26	8	Ministria e Kulturës dhe Cirku i Tiranës
27	9	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror
28	10	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
29	11	Ministria e Kulturës
30	12	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
31	13	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
32	14	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
33	15	Shtëpia e Fëmijëve, “Zyber Hallulli”
34	16	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
35	17	Qendra Kombëtare e Tranfuzionit të Gjakut

¹ “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021

² “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020

36	18	Prokuroria e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar
37	19	Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
38	20	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
39	21	Ministria e Arsimit dhe Sporteve, "Auditimin e përputhshmërisë" së veprimtarisë së MAS, sa i përket shpërblimit dhe trajtimit të sportistëve, referuar akteve ligjore e nënligjore në fuqi
40	22	Auditim Tematik: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e II-të të vitit 2021
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETQEVERISJES VENDORE		
41	1	Bashkia Rrogozhinë ³
42	2	Bashkia Belsh
43	3	Bashkia Kamëz
44	4	Bashkia Himarë
45	5	Bashkia Vau i Dejës
46	6	Bashkia Fier
47	7	Bashkia Vlorë
48	8	Bashkia Kolonjë
49	9	Bashkia Poliçan ⁴
50	10	Bashkia Cërrik
51	11	Bashkia Patos
52	12	Bashkia Devoll
53	13	Bashkia Maliq
54	14	Bashkia Mat
55	15	Bashkia Lezhë
56	16	Bashkia Mirditë
57	17	Bashkia Mallakastër
58	18	Bashkia Konispol
59	19	Bashkia Shkodër
60	20	Bashkia Malësi e Madhe
61	21	Bashkia Rroskovec
62	22	Bashkia Gramsh
63	23	Bashkia Krujë
64	24	Bashkia Pogradec
65	25	Bashkia Tepelenë
66	26	Bashkia Sarandë
67	27	Bashkia Berat
68	28	Bashkia Kuçovë
69	29	Bashkia Këlcyrë
70	30	Bashkia Elbasan
71	31	Bashkia Vorë
72	32	Bashkia Prrenjas
73	33	Bashkia Korçë
74	34	Bashkia Dibër
75	35	Bashkia Shijak
76	36	Bashkia Dimal
77	37	Bashkia Tropojë

³ "Mbi Auditimin financiar", për periudhën prej 01.01.2020 deri më 31.12.2020

⁴ "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021

78	38	Bashkia Librazhd
79	39	Bashkia Kavajë
80	40	Bashkia Kukës
81	41	Bashkia Has
82	42	Bashkia Lushnjë
83	43	Bashkia Rrogozhinë ⁵
84	44	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Cërrik
85	45	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Devoll
86	46	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Maliq
87	47	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Mat
88	48	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Mirditë
89	49	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Patos
90	50	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Rroskovec
91	51	Bashkia Peqin
92	52	Bashkia Memaliaj
93	53	Bashkia Delvinë
94	54	Bashkia Finiq
95	55	Bashkia Divjakë
96	56	Bashkia Dropull
97	57	Bashkia Durrës
98	58	Bashkia Klos
99	59	Bashkia Kurbin
100	60	Bashkia Libohovë
101	61	Bashkia Poliçan ⁶
102	62	Bashkia Pukë
103	63	Bashkia Pustec
104	64	Bashkia Fushë Arrëz
105	65	Bashkia Gjirokastër
106	66	Bashkia Përmet
107	67	Bashkia Selenicë
108	68	Bashkia Skrapar
109	69	Bashkia Bulqizë
110	70	Auditim Tematik Safo Morina
111	71	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2021
112	72	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e II-të të vitit 2021
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETIVE DHE MJEDISIT		
113	1	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër
114	2	Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë
115	3	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë
116	4	Agjencina Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër
117	5	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës
118	6	Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan
119	7	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Rurale 1
120	8	Agjencia Kombëtare e Pyjeve

⁵ “Mbi Auditimin financiar”, për periudhën prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021

⁶ “Auditim financiar”, për periudhën prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021

121	9	Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë
122	10	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës
123	11	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec
124	12	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier
125	13	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Rurale 2
126	14	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e II-të të vitit 2021
127	15	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2021
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA		
128	1	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
129	2	Korporata Elektroenergjetike Shqipëtare SHA
130	3	AlbPetrol SHA
131	4	Operatori i Sistemit të Transmetimit
132	5	Agjenica Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
133	6	Spitali Universtar Obstetrik Gjinekologjik Mbreteresha Geraldine
134	7	AlbGaz SHA
135	8	Ujësjetës Kanalizime SHA Elbasan
136	9	ARRSH, Projekti “Ndërtimi i By-Pass Fier & Vlorë”
137	10	ARRSH, Projekti “Ndërtimi i rrugës Qukës-Qafë Plloç”
138	11	Fondi Shqiptar i Zhvillimit SHA, për projektin Konektiviteti i rrugëve Rajonale dhe Lokale, investimi “Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë-Orikum dhe ndërtimi i 2 by-pass-ëve”
139	12	Ujësjetës Kanalizime SHA Gjirokastër
140	13	Ujësjetës Kanalizime SHA Fier
141	14	Ujësjetës Kanalizime SHA Sarandë
142	15	Ujësjetës Kanalizime SHA Shkodër
143	16	Spitali Bashkiak Sarandë
144	17	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Projekti “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”
145	18	Qendra e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK), Vlorë
146	19	Shtëpia e Foshnjes 'Lulet e vogla', Korçë
147	20	Ujësjetës Kanalizime SHA Vlorë
148	21	Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoritë Rajonale
149	22	Auditimi i performancës ushtuar në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare sha, Operatorin e Sistemit të Transmetimit sha, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sha dhe Entin Rregullator të Energjisë
150	23	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: Projektin e koncesionit “Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë”
151	24	Projekti: “Modernizimi i Asistencës Sociale” në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
152	25	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2021
153	26	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e II-të të vitit 2021

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT		
154	1	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2021
155	2	Auditim IT: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
156	3	Auditim IT: Agjencia e Prokurimit Publik
157	4	Auditim IT: Agjencia Shtetërore e Kadastrës
158	5	Auditim IT: Ujësjellës Kanalizime Durrës (UKD)
159	6	Auditim IT: Universitetit i Tiranës, Shkodrës, Vlorës ⁷
160	7	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e II-të të vitit 2021
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCES		
161	1	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2021
162	2	Auditim Performance me temë: Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve në bujqësi dhe siguria ushqimore
163	3	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave mjedisore në NJVQV, në Bashkitë Tiranë, Fier, Vlorë, Pogradec, Korçë, Lezhë, Shkodër
164	4	Auditim Performance me temë: Garantimi i të drejtave në transportin ajror, në Autoritetin e Aviacionit Civil
165	5	Auditim Performance me temë: Inceneratori i Tiranës
166	6	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave “Tirana e Gjelbër”
167	7	Auditim Performance me temë: Menaxhimi i burimeve ujore
168	8	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i sinjalistikës rrugore
169	9	Auditim Performance me temë: Efektiviteti I Programit të Integruar Për Zhvillimin Rural -Programi I 100 Fshatrave
170	10	Auditim Performance me temë: Mbrojtja dhe Administrimi i Monumenteve të Kulturës
171	11	Auditim Performance me temë: Menaxhimi i terreneve sportive
172	12	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i menaxhimit të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve RUDA
173	13	Auditim Performance me temë: Performanca e Universiteteve publike gjatë periudhës së pandemisë
174	14	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e lagunave
175	15	Auditim Performance me temë: Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm
176	16	Auditim Performance me temë: Sistemi arsimor parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara
177	17	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e II-të të vitit 2021

⁷ <https://panel.klsh.org.al/storage/phpV8t7Df.pdf>
<https://panel.klsh.org.al/storage/phpfozt6s.pdf>

ANEKSI 4: Evidenca përmblendhëse e shkeljeve me dëm ekonomik të konstatuar në auditimet e ushtruara për të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën Janar – Dhjetor 2022

Mijë lekë

Nr.	Subjektet	Gjithsej Zbuluar
1	Agrokredit SHA	367
2	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	37
3	Drejtoria e Përgjithshme e Dognave	966
4	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit	1,000
5	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	1,458
6	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	48,076
7	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)	2,994
8	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	178
9	Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor	300
10	Ministria e Mbrojtjes	26,866
11	Ministria e Kulturës dhe Cirku i Tiranës	957
12	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror	2,839
13	Ministria e Kulturës	947
14	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	129,746
15	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	23,729
16	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	421
17	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	4,504
18	Bashkia Rrogozhinë ⁸	66
19	Bashkia Belsh	1,249
20	Bashkia Kamëz	11,890
21	Bashkia Himarë	9,915
22	Bashkia Vau i Dejës	7,298
23	Bashkia Fier	14,802
24	Bashkia Vlorë	27,629
25	Bashkia Kolonjë	22,923
26	Bashkia Poliçan ⁹	943
27	Bashkia Devoll	4,435
28	Bashkia Mat	21,133
29	Bashkia Lezhë	3,234
30	Bashkia Mirditë	14,997
31	Bashkia Mallakastër	847

⁸ "Mbi Auditimin financiar", për periudhën prej 01.01.2020 deri më 31.12.2020

⁹ "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021

Nr.	Subjektet	Gjithsej Zbuluar
32	Bashkia Konispol	3,346
33	Bashkia Malësi e Madhe	471
34	Bashkia Rroskovec	1,707
35	Bashkia Krujë	957
36	Bashkia Tepelenë	438
37	Bashkia Sarandë	10,317
38	Bashkia Berat	8,686
39	Bashkia Elbasan	8,625
40	Bashkia Vorë	2,828
41	Bashkia Korçë	33,912
42	Bashkia Shijak	1,493
43	Bashkia Librazhd	1,204
44	Bashkia Lushnjë	390
45	Bashkia Rrogozhinë ¹⁰	1,752
46	Bashkia Durrës	17,535
47	Bashkia Klos	737
48	Bashkia Pustec	6,450
49	Bashkia Gjirokastrë	21,107
50	Bashkia Selenicë	1,859
51	Bashkia Skrapar	18,407
52	Bashkia Bulqizë	1,537
53	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	4,670
54	Korporata Elektroenergjetike Shqipëtare SHA	63,224
55	AlbPetrol SHA	346,697
56	Operatori i Sistemit të Transmetimit	3,829
57	Agjenica Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve	22,966
58	Ujësjellës Kanalizime SHA Elbasan	40,772
59	ARRSH, Projekti “Ndërtimi i By-Pass Fier & Vlorë”	8,131
60	ARRSH, Projekti “Ndërtimi i rrugës Qukës-Qafë Pllo”	4,955
61	Ujësjellës Kanalizime SHA Gjirokastrë	9,042
62	Ujësjellës Kanalizime SHA Fier	21,140
63	Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë	486
64	Ujësjellës Kanalizime SHA Shkodër	14,330
65	Spitali Bashkiak Sarandë	1,331

¹⁰ “Mbi Auditimin financiar”, për periudhën prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021

Nr.	Subjektet	Gjithsej Zbuluar
66	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Projekti "Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës	1,307
67	MIE "Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë "	143,569
68	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	44
69	Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë	1,955
70	Auditim Performance me temë: Menaxhimi i burimeve ujore	277,873
71	Auditim IT: Agjencia Shtetërore e Kadastrës	9,914
72	Auditim IT: Universiteti Tiranë, Shkodër, Vlorë	2,000
	Totali	1,508,739

ANEKSI 5: Evidenca e pasqyrimin të parregullsive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, të cila kanë sjell efekt negativ financiar në të ardhurat e subjekteve dhe buxhetin e shtetit për periudhën Janar – Dhjetor 2022

Mijë lekë

Nr.	Emërtimi i subjekteve	A Shuma në të ardhura	B Shuma në shpenzime	TOTALI
1	Agrokredit SHA	0	8,491	8,491
2	Fondi i Sigurimit të Detyrueshem të Kujdesit Shëndetësor	0	106,834	106,834
3	Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve	0	186,466	186,466
4	Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	0	15,490	15,490
5	Drejtorja e Përgjithshme e Doganës	0	24,591	24,591
6	Dejtorja e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	0	32,817,583	32,817,583
7	Instituti i Integritetit të ish Përndjekurve Politik	0	4,312	4,312
8	Drejtorja e Përgjithshme e Policisë	0	1,021	1,021
9	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	0	38,647	38,647
10	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)	0	310,196	310,196
11	Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	0	22,190	22,190
12	Drejtorja e Përgjithshme e Transportit Rrugor	0	6,084	6,084
13	Ministria e Mbrojtjes	0	36,336	36,336
14	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	0	4,780	4,780
15	Ministria e Kulturës	0	17,288	17,288
16	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	0	20,156	20,156

Nr.	Emërtimi i subjekteve	A Shuma në të ardhura	B Shuma në shpenzime	TOTALI
17	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	0	302,886	302,886
18	Shtëpia e Fëmijëve, "Zyber Hallulli"	0	9,950	9,950
19	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	0	26,949	26,949
20	Bashkia Rrogozhinë ¹¹	27,244	0	27,244
21	Bashkia Belsh	37,500	0	37,500
22	Bashkia Kamëz	242,245	143,686	385,931
23	Bashkia Himarë	21,600	0	21,600
24	Bashkia Vau i Dejës	5,328	0	5,328
25	Bashkia Fier	131,180	1,135,834	1,267,014
26	Bashkia Vlorë	1,177,779	157,399	1,335,178
27	Bashkia Kolonjë	1,344	715,282	716,626
28	Bashkia Poliçan ¹²	73,420	1,186,070	1,259,490
29	Bashkia Cërrik	26,178	0	26,178
30	Bashkia Patos	136,905	0	136,905
31	Bashkia Devoll	92,814	98,023	190,837
32	Bashkia Maliq	89,238	0	89,238
33	Bashkia Mat	120,055	1,930	121,985
34	Bashkia Lezhë	435,683	5,373	441,056
35	Bashkia Mirditë	48,852	0	48,852
36	Bashkia Mallakastër	1,255,993	199,625	1,455,618
37	Bashkia Konispol	4,918	1,190	6,108
38	Bashkia Shkodër	904,630	2,285	906,915
39	Bashkia Malësi e Madhe	88,996	3,407	92,403
40	Bashkia Rroskovec	164,276	19,869	184,145
41	Bashkia Gramsh	30,139	0	30,139
42	Bashkia Krujë	710,810	1,070,382	1,781,192
43	Bashkia Pogradec	35,482	0	35,482
44	Bashkia Tepelenë	42,878	275	43,153
45	Bashkia Sarandë	146,770	365,496	512,266
45	Bashkia Berat	283,967	228,191	512,158
47	Bashkia Kuçovë	7,594	0	7,594
48	Bashkia Këlcyrë	73,726	0	73,726
49	Bashkia Elbasan	907,961	2,499	910,460
50	Bashkia Vorë	388,558	210,092	598,650
51	Bashkia Prrenjas	72,799	0	72,799
52	Bashkia Korçë	540,052	101,383	641,435
53	Bashkia Dibër	60,218	0	60,218

¹¹ "Mbi auditimin financiar", për periudhën prej 01.01.2020 deri më 31.12.2020

¹² "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021

Nr.	Emërtimi i subjekteve	A Shuma në të ardhura	B Shuma në shpenzime	TOTALI
54	Bashkia Shijak	145,123	0	145,123
55	Bashkia Dimal	258,098	0	258,098
56	Bashkia Tropojë	41,089	0	41,089
57	Bashkia Librazhd	87,973	111,819	199,792
58	Bashkia Kavajë	227,465	23,330	250,795
59	Bashkia Kukës	334,218	0	334,218
60	Bashkia Has	16,574	0	16,574
61	Bashkia Lushnjë	164,117	30,041	194,158
62	Bashkia Rrogozhinë ¹³	233,342	0	233,342
63	Bashkia Peqin	59,440	0	59,440
64	Bashkia Memaliaj	57,308	0	57,308
65	Bashkia Finiq	200,267	0	200,267
66	Bashkia Delvinë	45,214	0	45,214
67	Bashkia Divjakë	545,796	0	545,796
68	Bashkia Dropull	10,649	0	10,649
69	Bashkia Durrës	948,223	22,167	970,390
70	Bashkia Klos	61,724	0	61,724
71	Bashkia Kurbin	389,141	10,915	400,056
72	Bashkia Libohovë	23,317	0	23,317
73	Bashkia Poliçan ¹⁴	70,361	0	70,361
74	Bashkia Pukë	24,127	0	24,127
75	Bashkia Pustec	17,853	261	18,114
76	Bashkia Fushë Arrëz	75,280	3,759	79,039
77	Bashkia Gjirokastrë	230,412	0	230,412
78	Bashkia Përmet	26,541	1,512	28,053
79	Bashkia Selenicë	374,066	7,305	381,371
80	Bashkia Skrapar	85,008	597,682	682,690
81	Bashkia Bulqizë	6,709,120	850,683	7,559,803
82	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë	38,433	0	38,433
83	Agjencina Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër	4,200	0	4,200
84	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës	1,852	0	1,852
85	Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan	5,000	0	5,000
86	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	0	13,625	13,625
87	DVASHK Pogradec	0	261	261
88	DVASHK Fier	297	0	297
89	DVASHK Rurale 1	7,067	0	7,067

¹³ "Mbi auditimin financiar", për periudhën prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021

¹⁴ "Auditim financiar", për periudhën prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021

Nr.	Emërtimi i subjekteve	A Shuma në të ardhura	B Shuma në shpenzime	TOTALI
90	DVASHK Rurale 2	94,242	0	94,242
91	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	0	78	78
92	Korporata Elektroenergjetike Shqipëtare SHA	222,016	9,165,564	9,387,580
93	AlbPetrol SHA	10,182,517	2,473,437	12,655,954
94	Operatori i Sistemit të Transmetimit	0	98,835	98,835
95	Agjenica Kombëtare e Ujësllës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve	0	155,059	155,059
96	AlbGaz SHA	0	18,452	18,452
97	ARRSH, Projekti “Ndërtimi i By-Pass Fier & Vlorë”	0	549,877	549,877
98	ARRSH, Projekti “Ndërtimi i rrugës Qukës-Qafë Plloç”	0	76,420	76,420
99	Ujësllës Kanalizime SHA Gjirokastër	0	65,886	65,886
100	Ujësllës Kanalizime SHA Fier	0	287,548	287,548
101	Ujësllës Kanalizime SHA Sarandë	0	122,535	122,535
102	Ujësllës Kanalizime SHA Shkodër	0	38,374	38,374
103	Spitali Bashkiak Sarandë	767	2,101	2,868
104	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Projekti "Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës	0	140,760	140,760
105	MIE “Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë ”	665,471	776,484	1,441,955
106	Qendra e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK), Vlorë	1,037	5,114	6,151
107	Ujësllës Kanalizime SHA Vlorë	0	1,840,238	1,840,238
108	Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoritë Rajonale	0	22,366	22,366
119	Auditim IT: Universiteti Tiranë, Shkodër , Vlorë	0	28,091	28,091
110	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i menaxhimit të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve RUDA	0	292,857	292,857
	Totali	31,071,877	57,441,977	88,513,854

ANEKSI 6: Evidenca e mangësive në aktivitetin kontrollues me ndikim negativ në të ardhurat tatimore dhe doganore për periudhën Janar – Dhjetor 2022

Mijë lekë

Nr.	Emërtimi i subjekteve	Detyrime tatimore	Penalitete	Të ardhra të munguara gjithsej
1	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ¹⁵	28,451,895	16,492,869	44,944,764
2	Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan	142,334	131,603	273,937
3	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	960,335	236,256	1,196,591
4	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ¹⁶	48,893,177	10,675,918	59,569,095
5	Dega e Doganës Durrës	-	-	340,927
6	Dega e Doganës Tiranë	-	-	505,215
7	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	-	-	657,648
	Totali	78,447,741	27,536,646	107,488,177

ANEKSI 7: Evidenca e Masave Disiplinore dhe Administrative të rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar – Dhjetor 2022

Në numër

Nr.	Emërtimi i subjekteve	GJITHSEJ MASAT		
		A) ME STATUSIN E NEPUNESIT CIVIL	B) ME KODIN E PUNES	C) MASAT ADMINISTRATIVE
		Rek	Rek	Rek
1	Banka e Shqipërisë		1	
2	Agrokredit SHA		7	
3	Fondi i Sigurimit të Detyrueshem të Kujdesit Shëndetësor		1	
4	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1	1	
5	Drejtoria e Përgjithshme e Doganës	1		
6	Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	1		1
7	Dega e Doganës Durrës	60		
8	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ¹⁷	16		
9	Dega e Doganës Tiranë	55		
10	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit	1		
11	Instituti i Integritit të ish Përndjekurve Politik dhe Instituti i	1		

¹⁵ "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021

¹⁶ "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020

¹⁷ "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021

Nr.	Emërtimi i subjekteve	GJITHSEJ MASAT		
		A) ME STATUSIN E NEPUNESIT CIVIL	B) ME KODIN E PUNES	C) MASAT ADMINISTRATIVE
		Rek	Rek	Rek
	Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit			
12	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ¹⁸	10		
13	Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan	16		
14	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	12		
15	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	1		1
16	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	1		
17	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)	1		
18	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	14		
19	Ministria e Mbrojtjes	1		
20	Ministria e Kulturës dhe Cirku I Tiranës	1		
21	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror	1	1	
22	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore		1	
23	Ministria e Kulturës	1		
24	Shtëpia e Fëmijëve, “Zyber Hallulli”		10	
25	Qendra e Transfuzionit te Gjakut		2	
26	Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar			1
27	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore		10	
28	Bashkia Himarë	11		
29	Bashkia Vau i Dejës	2		18
30	Bashkia Vlorë	36	8	14
31	Bashkia Patos	5		
32	Bashkia Devoll	12	6	
33	Bashkia Maliq	5		
34	Bashkia Mallakastër	11		
35	Bashkia Shkodër	5		
36	Bashkia Malësi e Madhe	5		
37	Bashkia Sarandë	4		6

¹⁸ “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020

Nr.	Emërtimi i subjekteve	GJITHSEJ MASAT		
		A) ME STATUSIN E NEPUNESIT CIVIL	B) ME KODIN E PUNES	C) MASAT ADMINISTRATIVE
		Rek	Rek	Rek
38	Bashkia Berat	3	2	18
39	Bashkia Prrenjas	3	9	
40	Bashkia Korçë	4	6	20
41	Bashkia Dibër	17	11	
42	Bashkia Shijak	34		
43	Bashkia Librazhd	3	5	
44	Bashkia Kavajë	16		
45	Bashkia Finiq	4		
46	Bashkia Divjakë	22	6	
47	Bashkia Durrës	29	11	
48	Bashkia Klos	4	2	
49	Bashkia Kurbin	6		
50	Bashkia Pukë	5	2	
51	Bashkia Pustec			10
52	Bashkia Fushë Arrëz	12		
53	Bashkia Selenicë	5	9	
54	Bashkia Skrapar	7	21	3
55	Bashkia Bulqizë	20	3	
56	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër		9	
57	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë		15	
58	Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër	19		
59	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës		10	
60	Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan	12		
61	DVASHK Rurale 1		23	
62	DVASHK Rurale 2		31	
63	Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë		6	
64	DVASHK Durrës		15	
65	DVASHK Pogradec		10	
66	DVASHK Fier		12	
67	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	5		

Nr.	Emërtimi i subjekteve	GJITHSEJ MASAT		
		A) ME STATUSIN E NEPUNESIT CIVIL	B) ME KODIN E PUNES	C) MASAT ADMINISTRATIVE
		Rek	Rek	Rek
68	Korporata Elektroenergjetike Shqipëtare SHA		21	27
69	AlbPetrol SHA		1	
70	Operatori i Sistemit të Transmetimit		1	
71	Agjenica Kombëtare e Ujësllës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve		12	3
72	Spitali Universtar Obstetrik Gjinekologjik Mbreteresha Geraldine		15	
73	AlbGaz SHA		7	
74	Ujësllës Kanalizime SHA Elbasan		1	
75	Ujësllës Kanalizime SHA Gjirokastrë		12	
76	Ujësllës Kanalizime SHA Fier		6	3
77	Ujësllës Kanalizime SHA Sarandë		9	2
78	Ujësllës Kanalizime SHA Shkodër		8	
79	Spitali Bashkiak Sarandë		13	
80	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Projekti "Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës"		1	
81	Qendra e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK), Vlorë		1	
82	Ujësllës Kanalizime SHA Vlorë		22	
83	Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoritë Rajonale		1	
84	Auditim IT: Agjencia Shtetërore e Kadastrës		1	1
TOTALI		521	398	128

ANEKSI 8: Masat Organizative të rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar – Dhjetor 2022

Nr.	SUBJEKTI	Në numër
		Masa organizative Rekomanduar
1	Banka e Shqipërisë	21
2	Agrokredit SHA	29
3	Fondi i Sigurimit të Detyrueshem të Kujdesit Shëndetësor	31
4	Instituti i Sigurimeve Shoqerore	11
5	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	34
6	Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	30

Nr.	SUBJEKTI	Masa organizative
		Rekomanduar
7	Drejtoria e Përgjithshme e Doganës	13
8	Dejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	39
9	Dega e Doganës Durrës	11
10	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ¹⁹	17
11	Dega e Doganës Tiranë	10
12	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit	18
13	Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	19
14	Instituti i Integritit të ish Përndjekurve Politik dhe Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit	19
15	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ²⁰	17
16	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë Elbasan	11
17	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë Shkodër	10
18	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	18
19	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	13
20	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)	25
21	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	17
22	Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor	18
23	Ministria e Mbrojtjes	41
24	Ministria e Kulturës dhe Cirkut I Tiranës	6
25	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror	10
26	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	40
27	Ministria e Kulturës	14
28	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	31
29	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	46
30	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	6
31	Shtëpia e Fëmijëve, "Zyber Hallulli"	21
32	Qendra e Transfuzionit të Gjakut	4
33	Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	15
34	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	11
35	Prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar	12
36	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	41

¹⁹ "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021

²⁰ "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020

Nr.	SUBJEKTI	Masa organizative
		Rekomanduar
37	MAS, "Auditimin e përputhshmërisë" së veprimtarisë së MAS, sa i përket shpërblimit dhe trajtimit të sportistëve, referuar akteve ligjore e nënligjore në fuqi.	5
38	Bashkia Rrogozhinë ²¹	15
39	Bashkia Belsh	32
40	Bashkia Kamëz	16
41	Bashkia Himarë	13
42	Bashkia Vau i Dejës	19
43	Bashkia Fier	22
44	Bashkia Vlorë	52
45	Bashkia Kolonjë	25
46	Bashkia Poliçan ²²	27
47	Bashkia Cërrik	15
48	Bashkia Patos	9
49	Bashkia Devoll	37
50	Bashkia Maliq	8
51	Bashkia Mat	19
52	Bashkia Lezhë	23
53	Bashkia Mirditë	13
54	Bashkia Mallakastër	36
55	Bashkia Konispol	20
56	Bashkia Shkodër	17
57	Bashkia Malësi e Madhe	20
58	Bashkia Rroskovec	25
59	Bashkia Gramsh	13
60	Bashkia Krujë	25
61	Bashkia Pogradec	20
62	Bashkia Tepelenë	16
63	Bashkia Sarandë	22
64	Bashkia Berat	28
65	Bashkia Kuçovë	18
66	Bashkia Këlcyrë	15
67	Bashkia Elbasan	25
68	Bashkia Vorë	25
69	Bashkia Prrenjas	18

²¹ "Mbi auditimin financiar", për periudhën prej 01.01.2020 deri më 31.12.2020

²² "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021

Nr.	SUBJEKTI	Masa organizative
		Rekomanduar
70	Bashkia Korçë	15
71	Bashkia Dibër	28
72	Bashkia Shijak	40
73	Bashkia Dimal	16
74	Bashkia Tropojë	12
75	Bashkia Librazhd	9
76	Bashkia Kavajë	22
77	Bashkia Kukës	16
78	Bashkia Has	16
79	Bashkia Lushnjë	11
80	Bashkia Rrogozhinë ²³	14
81	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Cërrik	3
82	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Devoll	12
83	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Maliq	4
84	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Mat	6
85	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Mirditë	2
86	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Patos	3
87	(Auditim për pasqyrat financiare të vitit 2021) Bashkia Rroskovec	7
88	Bashkia Peqin	15
89	Bashkia Memaliaj	18
90	Bashkia Finiq	15
91	Bashkia Delvinë	12
92	Bashkia Divjakë	26
93	Bashkia Dropull	9
94	Bashkia Durrës	33
95	Bashkia Klos	14
96	Bashkia Kurbin	16
97	Bashkia Libohovë	11
98	Bashkia Poliçan ²⁴	16
99	Bashkia Pukë	21
100	Bashkia Pustec	22
101	Bashkia Fushë Arrëz	23
102	Bashkia Gjirokastër	27
103	Bashkia Përmet	15
104	Bashkia Selenicë	30

²³ "Mbi auditimin financiar", për periudhën prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021

²⁴ "Auditim financiar", për periudhën prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021

Nr.	SUBJEKTI	Masa organizative
		Rekomanduar
105	Bashkia Skrapar	27
106	Bashkia Bulqizë	21
107	Auditim tematik Sofo Morina	3
108	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër	33
109	Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë	16
110	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë	34
111	Agjencina Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër	16
112	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kukës	14
113	Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan	20
114	DVASHK Rurale 1	23
115	DVASHK Rurale 2	35
116	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	21
117	Administrata e Zonave të Mbrojtura	9
118	DVASHK Durrës	26
119	DVASHK Pogradec	27
120	DVASHK Fie	39
121	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	19
122	Korporata Elektroenergjetike Shqipëtare SHA	20
123	AlbPetrol SHA	50
124	Operatori i Sistemit të Transmetimit	30
125	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve	10
126	Spitali Universtar Obstetrik Gjinekologjik Mbreteresha Geraldine	19
127	AlbGaz SHA	22
128	Ujësjellës Kanalizime SHA Elbasan	26
129	ARRSH, Projekti “Ndërtimi i By-Pass Fier & Vlorë”	16
130	ARRSH, Projekti “Ndërtimi i rrugës Qukës-Qafë Plloç”	19
131	Fondi Shqiptar i Zhvillimit SHA, për projektin Konektiviteti i rrugëve Rajonale dhe Lokale, investimi “Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë-Orikum dhe ndërtimi i 2 by-pass-eve”	6
132	Ujësjellës Kanalizime SHA Gjirokastrë	22
133	Ujësjellës Kanalizime SHA Fier	40
134	Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë	23
135	Ujësjellës Kanalizime SHA Shkodër	26
136	Spitali Bashkiak Sarandë	19
137	Projekti: “Modernizimi i Asistencës Sociale” në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1
138	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Projekti “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”	9

Nr.	SUBJEKTI	Masa organizative
		Rekomanduar
139	Qendra e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK), Vlorë	26
140	Shtëpia e Foshnjes "Lulet e vogla", Korçë	16
141	Ujësjellës Kanalizime SHA Vlorë	19
142	Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoritë Rajonale	8
143	MIE "Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë "	9
144	Auditimin e Performancës ushtruar në: Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare Sha, Operatorin e Sistemit të Transmetimit Sha, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sha dhe Entin Rregullator të Energjisë	12
145	Auditim IT: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	33
146	Auditim IT: Agjencia e Prokurimit Publik	18
147	Auditim IT: Agjencia Shtetërore e Kadastrës	33
148	Auditim IT: Ujësjellës Kanalizime Durrës	20
149	Auditim IT: Universitetit i Tiranës, Shkodrës, Vlorës	43
150	Auditim Performance me temë: Garantimi i të drejtave në transportin ajror	16
151	Auditim Performance me temë: Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve në bujqësi dhe siguria ushqimore	23
152	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave mjedisore në NJVQV	8
153	Auditim Performance me temë: Inceneratori i Tiranës	15
154	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave "Tirana e Gjelbër"	9
155	Auditim Performance me temë: Menaxhimi i burimeve ujore	22
156	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i sinjalistikës rrugore	34
157	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i Programit Të Integruar Për Zhvillimin Rural -Programi I 100 Fshatrave	20
158	Auditim Performance me temë: Mbrojtja dhe Administrimi i Monumenteve të Kulturës	21
159	Auditim Performance me temë: Menaxhimi i terreneve sportive	24
160	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i menaxhimit të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve RUDA	31
161	Auditim Performance me temë: Performanca e Universiteteve publike gjatë periudhës së pandemisë	20
162	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e lagunave	40
163	Auditim Performance me temë: Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm	7
164	Auditim Performance me temë: Sistemi arsimor parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara"	34
TOTALI		3,283

ANEKSI 9: Masat për ndryshime apo përmirësime ligjore

	SUBJEKTI	Nr.
1	Banka e Shqipërisë	1
2	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	1
3	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	2
4	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	2
5	MAS, "Auditimin e përputhshmërisë" së veprimtarisë së MAS, sa i përket shpërblimit dhe trajtimit të sportistëve, referuar akteve ligjore e nënligjore në fuqi	3
6	Dega Doganore Durrës	1
7	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit	1
8	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	1
9	Ministria e Kulturës	1
10	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës	1
11	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	1
12	Shtëpinë e Fëmijëve, "Zyber Hallulli"	1
13	DVASHK Rruale 2	1
14	Auditim Performance me temë: Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve në bujqësi dhe siguria ushqimore	7
15	Auditim Performance: Efektiviteti i politikave mjedisore në NJVQV	7
16	Auditim Performance me temë: Incenartori i Tiranës	1
17	Auditim Performance me temë: Menaxhimi i burimeve ujore	2
18	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i sinjalistikës rugore	1
19	Auditim Performance me temë: Mbrojtja dhe administrimi i Monumenteve të Kulturës	2
20	Auditim Performance me temë: Menaxhimi i sistemit të informacionit veterinar RUDA	5
21	Auditim Performance me temë: Performanca e Universiteteve publike gjatë periudhës së pandemisë	2
22	Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e lagunave	6
23	Auditim Performance me temë: Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm	2
Totali		52



Adresa:

Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë

Tel: +355 4 2247294

Fax: +355 4 2247294 / +355 4 2232491

E-mail: klsh@klsh.org.al

www.klsh.org.al